



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9/2023 regjistër (JR)
Datë 27.02.2023

Nr. 51 i vendimit
Datë 03.07.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 03.07.2025, ditën e enjte, ora 10.00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 604, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 4, 15, 17, 18, 30, 42, 53, 54 dhe 179/b, pika 2 dhe 5. Aneksi i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenet A, Ç, D, DH dhe F; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 1, 3, 6, 7, 13 dhe 14; ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 62 - 66; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 4, 12, 13, 14 dhe 17; ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, nenet 47 dhe 51; Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë; ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; ligji “Për të drejtën e informimit”; ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Andri Ymeri (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në zbatim të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KL Gj”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit,¹ në të cilin ka konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës² për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka ndryshuar konstatimin fillestar, nga përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Andri Ymeri.

2.3. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 604, datë 21.12.2022, vendosi: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër*” [...]. Ky vendim është

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 08.11.2018.

² Raporti nr. {***} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 12.07.2022, të KDZh-së. Në datën 26.09.2022, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. {***} prot., të përditësuar, të kontrollit të figurës, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 10.10.2022.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 15.05.2020.

marrë bazuar në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, sipas konkluzioneve për secilin prej kritereve të rivlerësimit, si më poshtë:

3.1. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të pasurisë: *i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë të pasurive dhe burimeve të ligjshme të tyre në deklaratën e pasurisë vetting, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016; ii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016; iii. Subjekti i rivlerësimit është përpjekur të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim ose në përdorim të tij, sipas parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.* Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3 të nenit 61 të këtij ligji, përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

3.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, *konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmëri të subjektit lidhet me dyshimet për favorizim të palëve në gjykim, që duket se përputhet me rezultatet e hetimit nga analizimi i dosjeve gjyqësore nga Komisioni. Duke qenë se ky rezultat nuk përmbush kushtet e nenit 61, pikat 2 dhe/ose 3 të ligjit nr. 84/2016, këto konstatime do të vlerësohen në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

3.3. Në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, *subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm, në kuptim të germës “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016.*

3.4. Në përmbledhje të sa është konstatuar më sipër për kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

III. Shkaqet e ankimit

4. Kundër vendimit nr. 604, datë 21.12.2022, të Komisionit, subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri, në datën 20.02.2023 ka ushtruar ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, duke kërkuar: *a) Prishjen e këtij vendimi dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Komision, me tjetër trup gjykues, ose b) Kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë publike dhe, në përfundim të shqyrtimit të saj, ndryshimin e këtij vendimi dhe konfirmimin e tij në detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër. [...]*
5. **Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit mbi procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijojnë:**

5.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon për cenim të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), nenit 42, pika 2 dhe nenit 179/b, pika 2 e Kushtetutës, për sa i përket: (i) Formimit të trupit gjykues të Komisionit dhe standardeve kushtetuese të “Gjykatës së paanshme”, “Gjykatës së krijuar me ligj” dhe “Gjykatës së drejtë” nga trupat gjykues të Komisionit që kanë shqyrtuar: kërkesat e tij për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues dhe që kanë shqyrtuar në themel procesin e tij të rivlerësimit. Subjekti referon vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si ato të çështjeve “Besnik Cani kundër Shqipërisë” dhe “Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë”. (ii) Cenimin e parimit të paanësisë dhe të pavarësisë, lidhur

me përbërjen e trupit gjykues dhe zgjedhjen e anëtarëve në kundërshtim me ligjin. (iii) Shkeljen e të drejtës për t'u mbrojtur nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor apo poshtërues, sipas nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 17/2 i Kushtetutës.

5.2. Sipas subjektit, në aspektin procedural, vendimi nr. 604, datë 21.12.2022, i Komisionit, me të cilin ai është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit, është absolutisht i pavlefshëm, sepse: (i) është mbështetur në prova të papërdorshme; (ii) nuk është i arsyetuar në mënyrë të drejtë dhe ligjore; (iii) përmban elemente të paragjykitimit dhe diskriminues në krahasim me subjekte të tjerë të rivlerësimit, pasi në raste të ngjashme, gjyqtarë dhe prokurorë të tjerë janë trajtuar ndryshe nga Komisioni, duke krijuar një praktikë të pabarabartë në vendimmarrje. Kolegji duhet të urdhërojë përsëritjen e gjithë procesit hetimor për të garantuar një vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në prova të ligjshme.

6. Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

6.1. *Për pasurinë “apartament me sip. 111 m²”, lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Shkodër*, subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e Komisionit lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie dhe konstatimin se është pasuri e fshehur e tij. Sipas subjektit, apartamenti në fjalë, për shkak të ekonomisë së përbashkët dhe traditës për administrimin e të gjitha të ardhurave monetare nga kryefamiljari, është regjistruar në emër të babait të tij, pa bërë përcaktimin e pjesëve takuese të secilit kontribues në krijimin e saj. Gjithashtu, fakti që pasuria është përdorur për një periudhë të gjatë nuk mund të interpretohet si një tregues i pronësisë së saj. Subjekti kërkon që të merren në konsideratë disa faktorë, si: (i) lidhja e afërt familjare me pronarin e ligjshëm të pasurisë dhe (ii) kontributi i dhënë në krijimin e kësaj pasurie, i cili është më i madh se ai i pjesëtarëve të tjerë të familjes.

Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, subjekti pretendon se Komisioni, në mënyrë të padrejtë dhe të gabuar, nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat e familjarëve të tij, si dhe huat e marra nga babai në atë periudhë. Konkretisht: (i) të ardhurat nga aktiviteti tregtar si shitës ambulant i babait; (ii) të ardhurat nga aktiviteti i babait për legalizimin e dokumenteve; (iii) të ardhurat nga aktiviteti i vëllait si asistent avokat dhe shitjen e fruta-perimeve; (iv) të ardhura nga dhënia me qira e tokës bujqësore; (v) huan, marrë shtetasit Xh. Th. dhe (vi) huan, marrë shtetasit F. Y.

6.2. *Për pasurinë e luajtshme “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, targa {***}*, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasaktësi në analizën financiare të kryer nga Komisioni, pasi të ardhurat e tij dhe të ardhurat e bashkëshortes nuk janë llogaritur saktë, shumatorja e këtyre gabimeve ka çuar në një bilanc negativ të pajustificuar, mbi bazën e të cilit është nxjerrë përfundimi se nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare për blerjen e automjetit. Për këtë arsye, subjekti kërkon një rishikim të analizës financiare me të dhënat e sakta. Në lidhje me analizën e kryer mbi shpenzimet për dokumentacionin dhe riparimin e automjetit në vlerën prej 80.000 lekësh, subjekti pretendon se shpenzimet e kryera për riparimin e automjetit nuk janë kryer brenda datës së blerjes së automjetit.

6.3. *Për pasurinë e luajtshme “orendi shtëpiake*”, subjekti pretendon se Komisioni ka bërë një llogaritje të gabuar të shpenzimeve të mobilimit, duke i përqendruar ato në vitet 2008 – 2009, pa dhënë një bazë të qartë për këtë ndarje dhe pa marrë parasysh vitet e tjera, duke e trajtuar vlerën totale të mobilimit si një shumë të shpenzuar tërësisht prej tij, pa marrë parasysh dhuratat dhe burimet e tjera. Subjekti pretendon se shuma reale që ka shpenzuar për mobilimin e banesës është 623.000 lekë, dhe jo 1.200.000 lekë, siç është llogaritur nga Komisioni.

6.4. Për pasurinë “bono thesari”, në vlerën 3.150.000 lekë, me datë emetimi 07.04.2016 dhe datë maturimi 06.04.2017 dhe bono thesari, në vlerën 4.200.000 lekë, me datë emetimi 22.12.2016 dhe datë maturimi 21.12.2017, të depozituara në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, A. Y., në Bankën e Shqipërisë, subjekti pretendon se Komisioni ka kryer një analizë të gabuar financiare lidhur me mundësinë e familjes së tij për krijimin e bonove të thesarit ndër vite. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë faktin se për financimin e saj kanë shërbyer si burim: kursimet familjare ndër vite; akumulimi i gjendjes *cash*; tërheqjes së shumës së depozituar nga bashkëshortja e tij në Raiffeisen Bank dhe i interesave mbi depozitën; kursimet nga rroga e tij dhe ajo e bashkëshortes, një pjesë e një kredie bankare që ka marrë në Tirana Bank (në shumën 1.500.000 lekë) dhe huaja e marrë djalit të xhaxhait.

6.5. Për pasurinë “apartament me sip. 73 m²”, lagjja “{***}”, bulevardi “{***}”, pallati {***}, Shkodër, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e saj, duke pretenduar se, edhe nëse merren në konsideratë vetëm të ardhurat nga pagat gjatë viteve 2003 dhe 2004 të përfituara prej tij, motrës, nënës, si dhe pensioni i babait për të njëjtat vite, së bashku me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Bushat, Shkodër, në shumën prej 430.000 lekësh, si dhe gjendja *cash* e kursyer në vitin 2003, rezulton se jo vetëm që mbulohet plotësisht me të ardhura të ligjshme blerja e kësaj pasurie, por edhe tejkalohet vlera e saj.

7. Shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim:

7.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit mbi ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit për shkak të lidhjeve shoqërore dhe familjare me avokatin L. K. Sipas subjektit, njohja shoqërore nuk nënkupton konflikt interesi sipas ligjit, i cili kërkon një lidhje konkrete interesi, jo thjesht një njohje të zakonshme, pasi të qenët shok shkolle nuk krijon automatikisht ndonjë detyrim për dorëheqje nga çështjet e avokatit. Komisioni nuk ka sjellë prova që kjo marrëdhënie ka ndikuar vendimet e tij, nuk ka asnjë provë që vendimet e subjektit në këto çështje kanë qenë favorizuese ose të padrejta.

7.2. Subjekti pretendon se shkeljet e supozuara lidhur me nenin 155/1 të Kodit të Procedurës Civile i përkasin viteve 2004 dhe 2005, qartazi jashtë periudhës së rivlerësimit; edhe ato që i përkasin viteve 2006 – 2009 janë jashtë periudhës së rivlerësimit, për sa kohë nuk ka një vendim të ndërmjetëm të relatores për shtrirjen e hetimit administrativ edhe për këtë periudhë. Gjithashtu, subjekti pretendon se këto mangësi nuk mund të trajtohen në kriterin e kontrollit të figurës. Subjekti kundërshton shkeljet e konstatuara të nenit 155/1 të Kodit të Procedurës Civile, pasi sipas tij nuk përputhen me parimet e objektivitetit, proporcionalitetit dhe barazisë në trajtim.

7.3. Lidhur me shkeljen e supozuar të afatit ligjor 10-ditor për caktimin e seancave gjyqësore, subjekti pretendon se Komisioni, paligjshmërisht, e quan “favor”, neglizhon me dashje natyrën e qartë “tejet simpliste” të gjykimeve ku ka “gjetur” këto shkelje. Sipas subjektit, vetë natyra e këtyre gjykimeve e përjashton mundësinë që të ketë bërë favore gjyqësore.

8. Shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale paraqiten në mënyrë të përmbledhur si në vijim:

8.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale si konkluzion të pabazuar në ligj, në prova dhe në praktikën gjyqësore,

përfundimet e Komisionit për këtë kriter janë arritur në cenim të parimit të paanësisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit. Subjekti pretendon se:

8.2. Komisioni ka injoruar vendimet e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (ILD), i cili, në mënyrë të përsëritur, ka konstatuar se subjekti nuk ka kryer asnjë shkelje disiplinore në lidhje me çështjet e denoncuar. Sipas subjektit, ILD-ja ka sqaruar se vendimet e ndërmjetme për mospezullim të gjykit lidhen me themelin e çështjes dhe mund të adresohen vetëm përmes rrugës së ankimit gjyqësor. Subjekti argumenton se mosrespektimi i këtyre vendimeve bie në kundërshtim me jurisprudencën e Kolegjit (F. V., G. Xh., I. B., N. C.), duke cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë parimin e sigurisë juridike.

8.3. Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 297 të Kodit të Procedurës Civile, duke e konsideruar pezullimin e gjykit si një detyrim automatik. Sipas subjektit, kjo dispozitë i jep gjykatës diskrecion për të vendosur, rast pas rasti, nëse ekziston pamundësi objektive për të përfunduar gjykimin civil pa pritur rezultatin e një procedimi penal. Për më tepër, gjykata nuk mund të ushtrojë një rol aktiv në mungesë të kërkesës dhe argumentimit nga palët, pasi kjo do të shkelte parimin e paanësisë dhe të kontradiktoritetit, të sanksionuar nga nenet 20, 29/1 dhe 15 të KPC-së.

8.4. Komisioni ka cenuar drejtpërdrejt parimin e pavarësisë së gjyqtarit, të garantuar nga neni 3 i ligjit nr. 96/2016, pasi krahasimi i vendimeve të tij me vendimet e gjykatave të tjera, si Gjykata e Apelit, nuk mund të shërbejë si provë për mungesë profesionalizmi. Sipas subjektit, ndryshimet e interpretimeve midis gjyqtarëve janë të lejueshme dhe të natyrshme në funksion të bindjes së brendshme të secilit gjyqtar dhe vetëm nëse provohet keqbesimi i gjyqtarit, mund të argumentohet përgjegjësi disiplinore apo ndëshkim profesional, por në rastin e tij, Komisioni nuk ka paraqitur asnjë provë apo indicie të tillë.

8.5. Subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit sa i përket vendimmarrjeve të tij për pezullimin e çështjeve, pasi duke e konsideruar pezullimin si detyrim automatik, Komisioni ka bërë interpretim të gabuar dhe ka dalë jashtë kompetencave të tij. Subjekti pretendon se ky konkluzion i Komisionit është në kundërshtim me praktikën e konsoliduar të Gjykatës së Lartë dhe me doktrinën e së drejtës së procedurës civile, pasi sipas tij jurisprudenca ka theksuar vazhdimisht se pezullimi i gjykit civil nuk është i detyrueshëm, por mund të bëhet vetëm kur ekziston një pamundësi objektive për të përfunduar gjykimin në mungesë të një vendimi tjetër të formës së prerë.

8.6. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimmarrjet e tij kanë synuar të garantojnë një proces të shpejtë dhe efektiv në mbrojtje të këtyre të drejtave, jo të krijojnë vonesa artificiale, ndërsa qëndrimet e Komisionit për rastet e analizuara bien ndesh me vendimet e ILD-së, me jurisprudencën dhe doktrinën juridike, cenojnë pavarësinë e gjyqtarit dhe parimin e sigurisë juridike, si dhe rrezikojnë drejtpërdrejt të drejtat themelore të qytetarëve.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit

a) Juridiksioni i Kolegjit

9. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*), ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar

nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti synon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

10. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

11. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 604, datë 21.12.2022, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.
12. Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “trupi gjykues”), shqyrtoi fillimisht ankimin dhe parashtrimet⁴ e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj para seancës gjyqësore, si dhe aktet⁵ e depozituara në mbështetje të tyre.

⁴ Subjekti i rivlerësimit depozitoi në Kolegj parashtrime me shkrim, regjistruar me nr. {***} prot., datë 30.01.2025.

⁵ Më datë 10.02.2025, në mbështetje të parashtrimeve, subjekti depozitoi në Kolegj aktet shkresore si më poshtë:

Shkresa nr. {***} prot., datë 20.08.2024, e Bashkisë Shkodër; Shkresa nr. {***} prot., datë 29.08.2024, e Bashkisë Shkodër; Shkresa nr. {***} prot., datë 04.09.2024, e Zyrës Përmbarimore Shkodër; Statement Bankar, marrë pranë Raiffeisen Bank, për shtetasin A. H.; Shkresa nr. {***} prot., datë 10.06.2024, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtorisë Rajonale Shkodër, për shtetasin F. Y.; Shkresa nr. {***} prot., datë 18.07.2024, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtorisë Rajonale Shkodër, për shtetasin F. Y.; Shkresa nr. {***} prot., datë 23.07.2024 e Raiffeisen Bank, për shtetasin E. Y.; Shkresa nr. {***} prot., datë 23.07.2024, e Raiffeisen Bank, për shtetasin F. Y.; Vendimi nr. {***}, datë 21.09.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për shtetasin F. H.; Shkresa nr. {***} prot., datë 26.01.2022, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, për të ndjerin F. Y.; Shkresa nr. {***} prot., datë 27.03.2013, e Universitetit Profesional “{***}” Shkodër (si dhe e gjithë praktika për lejimin e ushtrimit të kësaj veprimtarie); Shkresa nr. {***}, datë 22.07.2024, e Universitetit “{***}”, Shkodër, për Andri Ymeri; Shkresa nr. {***} prot., datë 30.07.2024, e Universitetit “{***}”, Shkodër, për A. Y.; Shkresa nr. {***} prot., datë 30.07.2024, e Universitetit “{***}”, Shkodër, për A. Y.; Shkresa nr. {***} prot., datë 30.08.2024, e Universitetit “{***}”, Shkodër, për Andri Ymeri; Shkresa nr. {***} prot., datë 30.08.2024, e Universitetit “{***}”, Shkodër, për A. Y.; Shkresa nr. {***} prot., datë 30.08.2024, e Universitetit “{***}”, Shkodër për A. Y.; Deklaratë noteriale nr. {***} rep., e datës 29.01.2022, e shtetasve F. Y. dhe E. Y.; Deklaratë noteriale nr. {***} rep., e datës 29.01.2022, e shtetasve F. Y., E. Y., F. Y., S. Y., S. Y., Xh. Th. dhe L. Th.; Deklaratë noteriale nr. {***} rep., e datës 29.01.2022, e shtetasve F. Y. dhe S. Y.; Vendim nr. {***} akti, datë 19.04.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; Akt shitblerje pasurie të paluajtshme, shtëpi banimi nr. {***} rep., {***} kol., datë 15.03.1996, për shitjen e shtëpisë së banimit nga F. Y.; Akt shitblerje pasurie të paluajtshme, shtëpi banimi nr. {***} rep., {***} kol., datë 06.11.2001, për blerjen e banesës nga i ndjeri F. Y.; Shkresa nr. {***} prot., datë 24.09.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (për shortin); Shkresa nr. {***} prot., datë 03.07.2024, e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (ku janë administruar edhe kopje të vendimeve penale, me palë në cilësinë e viktimave apo të pandehurve, shtetasit M. K., P. K., N. K., D. H., B. H., G. A., S. K., Gj. D., shoqëria “{***}” dhe D. D.); Shkresa nr. {***} prot., datë 15.04.2024, e Këshillit të Lartë Gjyqësor; Shkresa nr. {***} prot., datë 28.03.2013, e Këshillit të Lartë të Drejtësisë; Shkresa nr. {***} prot., datë 20.03.2024, e Gjykatës

12.1. Lidhur me provueshmërinë e këtyre akteve në këtë fazë të gjykimit në Kolegj, në zbatim të parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor në Kolegj zhvillohet sipas një grupi dispozitash të ligjit nr. 49/2012, përfshirë nenet 47, 49 dhe 51 të këtij ligji. Sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për sa u përket provave, vlerësimi i tyre dhe i akteve të administruara gjatë procesit të zhvilluar në Komision është pjesë e qenësishme e procedurës së analizimit të shkaqeve të ankimit nga Kolegj.

12.2. Nga përmbajtja e akteve të sjella nga subjekti në mbështetje të parashtrimeve, por edhe dokumentacionit të përcjellë para seancës gjyqësore, së bashku me disa kërkesa⁶ për marrje dokumentacioni nga disa institucione, Kolegji konstaton se disa prej tyre nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas dhënies së vendimit të Komisionit. Si rrjedhojë, nuk mund të argumentohet që paraqitja e tyre në Komision ka qenë e pamundur. Ky konstatim vlen edhe për aktet që mbajnë datat pas dhënies së vendimit, sikurse konstatohet në kërkesat e subjektit drejtuar institucioneve, i përkasin periudhës maj – qershor të vitit 2024 dhe vitit 2025, në një kohë që vendimi i Komisionit mban datën 21.12.2022. Subjekti ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për t'i administruar këto akte gjatë zhvillimit të procedurës së hetimit administrativ në Komision, aq më tepër kur është riçelur hetimi sërish, më datë 21.06.2022.

12.3. Një pjesë e akteve të mësipërme janë paraqitur edhe gjatë procesit të hetimit në Komision, sikurse janë: Deklaratë noteriale nr. {***} rep., e datës 29.01.2022, e shtetasve F. Y. dhe E. Y.; Deklaratë noteriale nr. {***} rep., e datës 29.01.2022, e shtetasve F. Y., E. Y., F. Y., S. Y., S. Y., Xh. Th. dhe L. Th. dhe Deklaratë noteriale nr. {***} rep., e datës 29.01.2022, e shtetasve F. Y. dhe S. Y.

12.4. Ndërsa për sa i përket disa vendimeve të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me ankesat e disa qytetarëve dhe institucioneve ndaj subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se ato janë vendimmarrje që i përkasin një institucioni tjetër, që vepron në një kuadër ligjor të caktuar, tej procesit të rivlerësimit, konkluzionet e të cilit janë bazuar mbi rrethana dhe fakte, të cilat nuk mund të përdoren në mënyrë krahasimore në procesin e rivlerësimit kalimtar, në një kohë që dokumentacioni i

së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; Shkresa nr. {***} prot., datë 23.11.2023, e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (për ankesën e shtetas N. K.); Shkresa nr. {***} prot., datë 23.11.2023, e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (për ankesën e {***}); Shkresë nr. {***} prot., datë 17.07.2024, e Këshillit të Lartë Gjyqësor (për ankesën e shtetas A. M.); Shkresa nr. {***} prot., datë 06.10.2023, e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (për ankesën e shtetas E. K.); Shkresa nr. {***} prot., datë 06.10.2023, e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (për ankesën e {***} ShA); Shkresa nr. {***} prot., e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (për ankesën e {***}); Vendim me numër {***}, datë 20.09.2023, për çështjen me paditës shtetasen Gj. D.; Shkresa nr. {***} prot., datë 16.07.2020, e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe vendimi i mosfillimit të procedimit penal të kallëzimit, me numër {***}, të vitit 2020; Vendimi nr. 6, datë 21.01.2019, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; Printim i Studimit "Household Economies of Scale in Consumption: Theory and Evidence", të Julie A. Nelson (<https://www.jstor.org/stable/1913099>); Printim i Studimit "Urbanizimi dhe ekonomia, rasti studimor: Shqipëria", të botuar në Gazetën Mapo më datën 22.11.2017 (Kumtesë e mbajtur gjatë Konferencës Shkencore Ndërkombëtare "Ditët e Studimeve Shqiptare", organizuar nga UET); Printim i publikimit të datës 17 korrik 2023, në adresën: <https://www.monitor.al/eurostat-shqiperia-me-varferine-dhe-pabarazine-me-te-larteqytet-fshat-ne-europe/> dhe <http://www.panorama.com.al/eurostat-publikon-tedhenat-shqiperia-me-varferine-dhe-abarazine-me-te-larte-qytet-fshat-ne-europe/>; Relacion mbi rezultatet e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit A. P.; Vendim nr. 470, datë 01.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit A. P.; Vendim nr. 57, datë 13.11.2024, për subjektin e rivlerësimit A. P.; Vendimi nr. {***}, datë 18.10.2019, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lënë në fuqi me vendimin me numër {***}, datë 20.11.2023, të Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; Vendimi nr. {***}, datë 31.10.2024, i KLGJ-së, për shtetasin L. K.; Vendimi nr. 30, datë 13.02.2023, i Gjykatës Kushtetuese.

⁶Subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Kolegj nëpërmjet email-it, adresës së tij elektronike: {***} dhe nëpërmjet shërbimit postar, por edhe në protokollin e Kolegjit, disa kërkesa, si dhe disa akte.

administruar në Komision është i mjaftueshëm për të analizuar kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

12.5. Në përfundim, për sa u përket akteve të paraqitura në mbështetje të parashtrimeve para seancës gjyqësore, trupi gjykues vlerëson se, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk legjitimohet që këtij akti procedural t'i bashkëlidhë akte me pretendimin për marrjen e tyre si provë, sepse afati për të paraqitur prova të reja shtrihet maksimalisht deri me paraqitjen e ankimit dhe nuk mund të zgjatet përtej tij.

12.6. Trupi gjykues vlerësoi, gjithashtu, edhe nevojën e marrjes së këtyre akteve, në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, parë lidhur me zbatimin e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 dhe duke analizuar nevojën për të shqyrtuar këto prova të reja në seancë gjyqësore publike, në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji çmoi se ekzistojnë kushtet për refuzimin e marrjes së këtyre provave, sipas parashikimit të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

13. Lidhur me kërkesat dhe aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj

Trupi gjykues, në kuadër të garantimit të një procesi të rregullt ligjor, të sanksionuar në nenin 6, paragrafi 1 i KEDNj-së dhe në dispozitat kushtetuese dhe ligjore, përkatësisht nenet 42, 179/b, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mori në shqyrtim kërkesat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, si edhe dokumentacionin në vijim:

13.1. (i) Kërkesë e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 20.12.2022, nëpërmjet së cilës subjekti kërkon nga Kolegji konstatimin e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor në standardin kushtetues të “Gjykatës së krijuar me ligj”, për shkak të papajtueshmërisë për ushtrimin e funksionit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, të shtetaseve G B., F. Sh., P. Q., B. B., S. Zh. dhe A. F. Në këtë kërkesë, subjekti kërkon shfuqizimin pjesërisht të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 82/2017; marrjen e masës së përkohshme të vijimit të shqyrtimit nga Komisioni të procesit të rivlerësimit që i përket subjektit Andri Ymeri, deri në zgjidhjen e konfliktit gjyqësor me vendim përfundimtar të formës së prerë; përcaktimin nga Gjykata Kushtetuese të faktit se cili organ shtetëror ka juridiksion dhe/apo kompetencën për të shqyrtuar çështjen në themel të saj. (ii) Kërkesë e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 24.04.2023, nëpërmjet së cilës kërkon nga Kolegji përgjigje lidhur me kërkesën e sipërcituar, si dhe me dy kërkesa procedurale që ka bërë subjekti në fund të rubrikës “objekti”, të pjesës hyrëse të ankimit.

13.2. Lidhur me këto kërkesa të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se, pavarësisht se për kërkesën e parë atij i është kthyer përgjigje nga Kolegji me shkresën nr. {***} prot., datë 21.12.2022, konstaton se ato lidhen me zgjedhshmërinë e anëtarëve të Komisionit, veprimtarinë e tyre, kompetencat e Komisionit në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyrën e ushtrimit të tyre, parime këto, për të cilat ka tashmë një qëndrim të konsoliduar të Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën *sui generis* të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e ligjvënësit, që në kontekstin e një vlerësimi kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përzgjedhjen e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'ia nënshtrojnë procedurave të mirëpërcaktuara nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji i posaçëm nr. 84/2016. Në këtë drejtim, dispozitat kushtetuese dhe ligjore përcaktuan në detaj procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, institucionet e ngarkuara në çdo hap të këtij procesi përzgjedhës, deri në emërimin përfundimtar të tyre. Procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të rivlerësimit, e parashikuar në legjislacionin e sipërcituar, ishte në përputhje me vullnetin e legjislatorit dhe, në këto kushte, nuk cenon parimin e gjyqimit nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, në kuadër të procesit të rregullt

ligjor, në zbatim të nenit 6, paragrafi i parë të KEDNj-së. Mënyra e krijimit, veprimtaria e Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre i janë nënshtruar kontrollit mbi kushtetutshmërinë nga Gjykata Kushtetuese, e cila në vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, ka arsyetuar: “Për nga mënyra se si është konceptuar i gjithë sistemi i rivlerësimit në Kushtetutë, pra organet që e kryejnë atë, mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të tyre dhe garancitë që ata gëzojnë, kompetencat që këto organe do të ushtrojnë dhe baza ligjore ku mbështetet kjo veprimtari, vlerësohet se këto organe ofrojnë të gjitha garancitë që kërkon e drejta për një proces të rregullt gjyqësor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së [...]”, si dhe konfirmimin e GjEDNj-së në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, për rrjedhojë, kërkesat e subjektit janë të pabazuara në ligj dhe në prova.

13.3. Nëpërmjet *email*-it, të protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 18.03.2024, subjekti ka përcjellë dy kërkesat që i ka dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm mbi marrjen e dokumentacionit provues që lidhet me çështjen civile me palë paditës I. K. dhe palë e paditur Bashkia Shkodër, me objekt: “*Detyrimin e palës së paditur të njohë paditësin si pronar të pasurisë së paluajtshme që e ka fituar me parashkrim fitues*”. Kërkesa e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 19.03.2024, nëpërmjet së cilës kërkon nga Kolegji të administrojë si provë dokumentacionin elektronik që i është përcjellë nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim provimin e faktit se nuk e ka favorizuar shtetasin I. K., në cilësinë e paditësit, kundër palës së paditur, Bashkia Shkodër, pasi referuar dokumentacionit, ai ka qenë në mendim pakice në këtë çështje. Trupi gjykues e konsideron të panevojshme marrjen e këtyre provave për sa kohë aktet e ndodhura në dosjen e Komisionit janë të mjaftueshme për të analizuar këtë çështje dhe pretendim të subjektit.

13.4. Subjekti, më datë 06.03.2025, ka depozituar në Kolegj korrespondencën e tij me Komisionin, (35 *email*-e), të cilat përmbajnë komunikime të subjektit me Komisionin për çështje që i përkasin të tria kriterëve të rivlerësimit, si dhe përcjellje dokumentacioni përkatës. Kolegji i vlerëson të panevojshme marrjen e tyre në cilësinë e provës, për sa kohë ato kanë qenë pjesë e vlerësimit dhe janë pjesë e dosjes në Komision.

13.5. Kërkesa e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 07.04.2025, nëpërmjet së cilës subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që të marrë informacion dhe dokumentacion nga disa institucione shtetërore⁷, me qëllim kundërshtimin e qëndrimit të Komisionit, se babai i tij nuk ka pasur burime të ligjshme për të krijuar depozitën në shumën 1.850.000 lekë, në muajin korrik të vitit 2008 dhe dyshimin se kjo depozitë është pasuri e fshehur e subjektit.

Trupi gjykues e vlerëson këtë kërkesë si përpjekje të subjektit për të përmirësuar situatën e tij financiare, pasi aktet e administruara gjatë hetimit administrativ në Komision dhe të kontrolluara në Kolegj janë të mjaftueshme për të konkluduar se babai i subjektit nuk ka pasur burime të ligjshme për të justifikuar krijimin e depozitës në shumën 1.850.000 lekë, në muajin korrik të vitit 2008. Fakti që kërkohet të provohet nga subjekti, rezulton i provuar gjatë gjykimit në Komision, për rrjedhojë, trupi gjykues e konsideroi të pabazuar atë.

13.6. Kërkesën e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 07.04.2025, nëpërmjet së cilës kërkon nga Kolegji që të sekuestrojë dokumente në origjinal dhe të kryejë ekspertimin kriminalistik

⁷ Subjekti kërkon që të merret dokumentacion dhe informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, si dhe Qendra Kombëtare e Biznesit, Bashkia Shkodër, ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, Drejtoria e Parandalimit dhe Pastrimit të Parave, nga bankat e nivelit të dytë.

të dorëshkrimit, si dhe kërkesën e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 07.04.2025, nëpërmjet së cilës kërkon nga Kolegji që të sekuestrojë dokumente në origjinal dhe të kryejë një ekspertim kriminalistik, daktiloskopik papilar mbi ekzistencën e mundshme të gjurmëve të tij të gishtërinjve në zarfet në të cilat ndodhet mendimi i pakicës, dosje e cila ndodhet pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm⁸. Subjekti e paraqet këtë kërkesë për kundërshtimin e dyshimit të ngritur prej Komisionit në vendim, se procesverbali i mendimit të tij në pakicë në çështjen me palë paditëse I. K. dhe të paditur Bashkia Shkodër, me objekt “*njohje pronar*”, është i falsifikuar.

13.7. Lidhur me dy kërkesat e mësipërme të subjektit të rivlerësimit për sekuestrim dokumenti në origjinal dhe kryerje ekspertimi kriminalistik, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim lidhur me këtë dokument është shprehur se *nuk ka tagrat e organit të Prokurorisë dhe nuk mund të merret me autenticitetin e kësaj flete, por vlerëson të mos e konsiderojë atë si provë*. Në kushtet kur gjatë hetimit administrativ është administruar në Komision shkresa nr. {***} prot., datë 13.7.2022 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër së bashku me vendimin nr. {***}, datë 01.07.2013 në të cilin ka qenë anëtar i trupës gjykuese që ka dhënë vendimin edhe subjekti i rivlerësimit, nga ana e trupit gjykues të Kolegjit, pranimi i kërkesave të mësipërme të subjektit u vlerësuan të panevojshme.

13.8. Kërkesa e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 08.04.2025, nëpërmjet së cilës kërkon nga Kolegji që të marrë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dokumentacionin lidhur me vlerësimin e kriterit të figurës që ky institucion ka kryer për shtetasin L. K. (aktualisht ndihmës magjistrat në Gjykatën e Apelit Administrativ). Subjekti, më datë 02.05.2025, ka përcjellë në Kolegj, nëpërmjet *email-it*, kthim përgjigjen e KLGJ-së, mbi arsyet e mosvënies në dispozicion të dokumentacionit të përdorur në kuadër të verifikimit të figurës për emërimin në detyrë të ndihmësit ligjor L. K. Më datë 05.05.2025, subjekti, nëpërmjet *email-it*, ka përcjellë në Kolegj vendimin e anonimizuar të KLGJ-së, nr. {***}, datë 31.07.2024 (marrë nga faqja zyrtare e KLGJ-së mbi kualifikimin e kandidatit fitues për në programin e formimit fillestar të Shkollës së Magjistraturës, viti akademik 2023 – 2024, profili ndihmës ligjor), duke nënkuptuar se ky vendim i përket shtetasit L. K.

13.9. Lidhur me kërkesën e subjektit për të administruar dokumentacionin nga KLGJ-ja për ish-avokatin L. K., trupi gjykues vëren se Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit për shkak të lidhjeve shoqërore me këtë shtetas (L. K.). Dokumentacioni i administruar mbi proceset gjyqësore të zhvilluara nga subjekti i rivlerësimit, ku palë ka qenë avokat L. K., është më se i mjaftueshëm për të konkluduar nëse subjekti ka qenë apo jo në kushtet e konfliktit të interesit në këto gjykime, gjithashtu u konstatua se subjekti ka pasur të gjithë kohën e nevojshme t’ia kërkonte KLGJ-së këtë informacion dhe ta paraqiste atë në Komision. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se marrja e dokumentacionit të kërkuar nga subjekti është i panevojshëm në kuptim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

13.10. Kërkesa e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 08.04.2025, nëpërmjet së cilës subjekti kërkon nga Kolegji që të marrë dokumentacionin dhe të administrojë si provë konkretisht: akte nga fashikulli gjyqësor i subjekteve të rivlerësimit I. R., A. P. dhe E. D., lidhur me ankesën që shoqëria “{***}” ka paraqitur ndaj këtyre subjekteve, me qëllim vërtetimin e faktit se Komisionerja P. Q. nuk ka qenë e paanshme në procesin e tij të rivlerësimit. Në të njëjtën kërkesë, subjekti, për të vërtetuar anësinë në proces të Komisioneres F. Sh., kërkon që t’i njoftohet atij, por edhe të merret si provë vendimi i paanonimizuar i subjektit J. Ç., së bashku me mendimin e pakicës, si dhe të gjitha

⁸ Subjekti referon në vendimin nr. {***}, datë 01.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

ankesat e bëra në Komision, Institucionin e Komisionerëve Publikë dhe në Kolegj, nga avokati i tij A. Ll., mbi konfliktin që ka pasur ai me këtë Komisionere.

13.11. Kërkesat e mësipërme të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson të pabazuara, pasi krahasimi i vendimmarrjeve të tjera për mënyrën se si Komisioni ka analizuar dhe trajtuar subjekte të tjerë rivlerësimi në situata faktike e ligjore dhe rrethana të ndryshme, nuk ndihmojnë për të evidentuar anësinë e Komisionerëve të Komisionit, aq më tepër që vendimmarrjet dhe qëndrimet e Komisionit janë analizuar si më poshtë në këtë vendim.

13.12. Kërkesa e protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 17.04.2025, nëpërmjet së cilës kërkon nga Kolegji⁹ të urdhërojë Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të marrë informacionin mbi tatimin që duhej të paguante babai i tij, i cili ka ushtruar aktivitetin si shitës ambulant fruta-perime dhe agjent legalizimesh dokumentesh. Më datë 06.05.2025, subjekti ka përcjellë me *email* kthim përgjigjen nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, nëpërmjet së cilës konfirmohet se, për periudhën 2001 – 2007, nuk rezulton se ky institucion të ketë pasur marrëdhënie kontraktuale/punësimi/shërbimi me z. F. Y. Subjekti pretendon se kjo provë e tërthortë e vendos atë në kushtet e pamundësisë objektive, sipas nenit 32 të ligjit nr. 84/2016.

Më datë 05.05.2025, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë nëpërmjet *email*-it praktikën e dosjes gjyqësore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me palë: paditës F. Y. (babai i subjektit), i paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, me objekt: *“Përcaktimi i vlerës së detyrimit tatimor për të ardhurat e realizuara nga paditës F. Y., gjatë periudhës së viteve 01.01.2005 – 31.12.2007. Detyrimi i palës së paditur për t’i kthyer paditësit diferencën në mes vlerës së detyrimit real tatimor për të ardhurat e realizuara nga paditësi gjatë periudhës së viteve 2005 – 2007, me vlerën e paguar nga ai për këtë detyrim”*.

13.13. Këto kërkesa të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i konsideron të pabazuara, pasi gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me provueshmërinë e të ardhurave dhe pagesës së detyrimeve tatimore nga puna e babait të tij si shitës ambulant, Komisioni ka administruar shkresën nr. {***}, datë 23.02.2022, të Drejtorisë së Përgjithshme e Tatimeve, e cila ka informuar se F. Y. (babai i subjektit), nuk rezulton të ketë ose të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të tij dhe nuk rezulton i punësuar. Gjithashtu është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit për pamundësi objektive të paraqitjes së dokumentacionit justifikues ligjor, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk provohet se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet më dhe nuk merret në rrugë tjetër, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar në ligj.

13.14. Subjekti i rivlerësimit, më datë 22.04.2025, ka dorëzuar në Kolegj aktet si vijon: letër ankesë e vitit 2006 (original), të cilën babai i tij, F. Y., ia ka drejtuar ish-Ministrit të Punëve të Jashtme z. B. M.; letër që babai i tij i drejtohet Kolegjit, e vitit 2025; Akt ekspertimi grafik dorëshkrimesh¹⁰; 21

⁹ Gjithashtu, me *email*-in e datës 23.04.2025, protokolluar në Kolegj, nr. {***} (drejtuar Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme), nr. {***} (drejtuar Ministrisë së Drejtësisë), nr. {***} (drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit) dhe nr. {***} (drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve), nr. {***} (drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor), subjekti ka ripërsëritur kërkesën drejtuar disa institucioneve shtetërore, duke vendosur për dijeni Kolegjin.

¹⁰ Akt ekspertimi grafik i datës 17.04.2025, i kryer nga ekspertët kriminalistikë Xh. Ç. dhe V. I., përmban ekzaminime grafike dhe teknike të dorëshkrimeve të dokumenteve, si: Deklarata Individuale e Pasurisë të viteve 2004 – 2009 të Andri Ymerit, mbi bazë modeli krahasimesh me dokumente të tjera (letrat e sipërcituara) për shtetasin F. Y. dhe Andri Ymeri. Subjekti, duke kundërshtuar konkluzionin e Komisionit, se pasuria “apartament” në përdorim të subjektit, me sip. 111 m², lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Shkodër, është pasuri e fshehur e tij, paraqet ndër të tjera si argumente faktin se deklaratat periodike vjetore të pasurisë, plotësuar me shkrim dore nga babai i tij, megjithëse nuk kishte detyrim për deklarim sipas ligjit, konfirmojnë faktin e besueshmërisë së tyre, pasi deklarinet e bëra në DIPPV, në mënyrë të

email-e të printuara, që pasqyrojnë korrespondencën e z. Andri Ymeri, si me Kolegjin, ashtu edhe me institucione të tjera shtetërore lidhur me pajisjen me dokumentacion, që i përket të tria kritereve të rivlerësimit.

Lidhur me aktet e mësipërme, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit vetëm i liston ato, por nuk paraqet shpjegime se me cilin kriter të vlerësimit lidhen ato, apo nuk shpjegon arsyet se përse kërkon të administrohen si prova. Megjithatë, për sa i përket borderosë së pagave të vitit 2006 (disa muaj) dhe të muajit gusht 2008, që pasqyrojnë pagat që ka marrë subjekti si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, trupi gjykues konstaton se në Komision është administruar dokumentacion gjatë hetimit administrativ lidhur me pagat e subjektit dhe kontrolli i analizës financiare në Kolegj është kryer bazuar në të dhënat bankare të kalimit të pagës së subjektit, për rrjedhojë, është i panevojshëm marrja e këtij dokumentacioni për nevoja të shqyrtimit të çështjes në Kolegj.

13.15. Gjithashtu, më datë 21.06.2025, 22.06.2025 dhe 30.06.2025, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj, kërkesat për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues të KPA-së, përkatësisht për gjyqtaret Ina Rama, Albana Shtylla dhe Mimoza Tasi. Trupat gjykuese të Kolegjit, më datë 03.07.2025, nëpërmjet vendimeve nr. 22, 23 dhe 24, kanë vendosur rrëzimin e kërkesave të tij për përjashtimin e gjyqtarëve të sipërcituar.

13.16. Trupi gjykues e vlerësoi të pabazuar kërkesën¹¹ e datës 30.06.2025 të subjektit të rivlerësimit për shtyrjen e seancës gjyqësore, që do të zhvillohej në Kolegj më datë 03.07.2025, me pretendimin se kishte paraqitur një raport për paaftësi të përkohshme në punë. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur të gjithë kohën e nevojshme për të paraqitur në Kolegj të gjitha pretendimet e tij, dokumentacionin, parashtrimet, aktet në mbështetje të tyre, pasi nga dhënia e vendimit të Komisionit, në muajin dhjetor të vitit 2022 e deri në muajin qershor të vitit 2025, është një kohë e konsiderueshme për të ushtruar në mënyrë efektive dhe të plotë të drejtën e tij të mbrojtjes. Trupi gjykues çmon të theksojë se seanca gjyqësore e datës 03.07.2025 do të zhvillohej në dhomë këshillimi, e cila zhvillohet pa praninë e palëve, për rrjedhojë, dokumenti i paaftësisë së përkohshme në punë është i panevojshëm në këtë fazë të gjyqimit.

14. Nga sa konstatuar më lart, bazuar në parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, parashikohet se: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkojnë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.* Gjithashtu, referuar nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelimit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili, edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit,* trupi gjykues vlerëson se këto akte nuk plotësojnë kërkesat e nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49, pika 6, fjalía e parë e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim vetëm lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja.

padetyruar dhe të pakërkuar nga ligji, përbëjnë indicie të mirëbesimit në deklaram, pra që shkon në favor të besueshmërisë së deklaramit, duke vërtetuar në këtë mënyrë se kjo nuk është një pasuri e fshehur e subjektit.

¹¹ Kërkesë nr. {***} prot., datë 30.06.2025, regjistruar në Kolegj.

15. Lidhur me kërkesën për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në bazë të nenit 51/1, pikat “a” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012, për marrjen e provave të reja dhe riçeljen e hetimit gjyqësor, trupi gjykues vlerëson se parashikimi i nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, nuk legjitimon subjektin, në këtë fazë të shqyrtimit të çështjes, në paraqitjen e provave të reja. Në vështrim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, subjekti i rivlerësimit nuk provon se, jo për fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto akte në Komision. Gjithashtu, në fokusin e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, këto akte shkresore konsiderohen të panevojshme, pasi fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit. Për sa më sipër arsyetuar, në analizë të pretendimeve të subjektit, trupi gjykues e gjen të pambështetur në fakte dhe në parashikimet e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, kërkesën për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe për marrjen e provave të reja. Në rastin objekt shqyrtimi nuk ndodhemi përpara situatës së parashikuar nga neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, që do të legjitimonin Kolegjin të kërkonte mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjonte ndonjë gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit.
16. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerësoi se situata faktike e konstatuar nga Komisioni është e saktë dhe e plotë, dhe çështja mund të zgjidhet në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, duke u mbështetur në të gjitha aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, që referon te neni 49 i ligjit nr. 49/2012.

Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit të vendimit të Komisionit

17. *Shkaqe ankimi lidhur me pretendimet për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit në Komision*

17.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim për shkeljen e standardeve kushtetuese të “Gjykatës së paanshme”, “Gjykatës së krijuar me ligj” dhe, sipas tij, “Gjykatës së drejtë”, nga trupat gjykuese të Komisionit që kanë shqyrtuar kërkesat e tij për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues, si dhe ata që kanë shqyrtuar në themel procesin e tij të rivlerësimit, duke përmendur vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si ato të çështjeve “Besnik Cani kundër Shqipërisë” dhe “Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë”.

17.2. Sipas subjektit, vendimi nr. 604, datë 21.12.2022, i Komisionit, me të cilin ai është shkarkuar nga detyra e gjyqtarit, është absolutisht i pavlefshëm, sepse: (i) është mbështetur në prova të papërdorshme; (ii) nuk është i arsyetuar në mënyrë të drejtë dhe ligjore; (iii) përmban elemente të paragjykimit dhe trajtimit të pabarabartë. Kolegji duhet të urdhërojë përsëritjen e të gjithë procesit hetimor për të garantuar një vendimmarrje të drejtë dhe të bazuar në prova të ligjshme.

18. Lidhur me pavlefshmërinë e aktit administrativ dhe provat e mbledhura në kushtet e konfliktit të interesit, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

18.1. Çdo vendim ose veprim i marrë nga Komisionerët R. I. dhe E. Ç. është absolutisht i pavlefshëm për shkak të konfliktit të interesit. Sipas tij, ata kanë pasur njëanshmëri në ushtrimin e funksioneve të tyre administrative. Të gjitha provat dhe rezultatet e siguruar përmes korrespondencës elektronike me trupin gjykues të Komisionit, gjatë kohës kur në të bënë pjesë R. I. dhe E. Ç., konsiderohen të papërdorshme, për rrjedhojë, vendimet e tyre janë të pabazuara dhe të paligjshme. Sipas subjektit, provat e mbledhura në mënyrë të paligjshme nuk mund të shërbejnë si bazë për një vendim administrativ, sipas nenit 47 të ligjit për Gjykatat Administrative.

18.2. Subjekti pretendon se vendimi i ndërmjetëm për përjashtimin e Komisionerit R. I. nga procesi i tij i rivlerësimit, është i mangët, sepse: (i) nuk ka shqyrtuar të gjitha shkaqet e konfliktit të interesit; (ii) nuk ka nxjerrë pasojat ligjore të përfshirjes së tij në vendimet e mëparshme; (iii) nuk ka shpallur pavlefshmërinë e të gjitha vendimeve të marra nga ai si komisioner/relator. Subjekti kërkon nga Kolegji të konstatojë ekzistencën e shkaqeve për fillimin e procedimit disiplinor ndaj Komisionerit R. I., për ushtrimin e detyrës zyrtare në kushte të ekzistencës flagrante të konfliktit të interesit në raport me të.

18.3. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi vendimin e ndërmjetëm nr. {***} prot., datë 15.06.2022, të një tjetër trupi gjykues, që shqyrtoi dhe pranoi kërkesën e subjektit për përjashtimin e Komisionerit R. I., konstaton se trupi gjykues i Komisionit në arsyetimin e tij ka analizuar faktet, rrethanat dhe pretendimet e subjektit, ka kryer analizën ligjore, madje ka pranuar kërkesën e subjektit për përjashtimin e Komisionerit R. I., duke vlerësuar se ky Komisioner ndodhet në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit. Ky përfundim ka ardhur, pasi u konstatua fakti se në vendimin nr. {***}, datë 30.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me trup gjykues subjektin e rivlerësimit, Komisioner R. I. ka qenë përfaqësues ligjor i dy prej të paditurve (në kohën që ushtronte profesionin e avokatit). Ky vendim është një nga dokumentet që subjekti ka përzgjedhur për të paraqitur pranë organit kompetent, me qëllim vlerësimin e aftësive të tij profesionale, (pavarësisht se deri ditën që subjekti ka bërë kërkesën për përjashtimin e Komisioner R. I. nga procesi i tij i rivlerësimit, rezultatet e hetimit administrativ janë mbështetur vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë).

18.4. Trupi gjykues konstaton se vendimin për përjashtimin e z. R. I. nga trupi gjykues i procesit të rivlerësimit të subjektit Andri Ymeri, Komisioni e ka bazuar në faktin se, nëse nga ana e trupit gjykues riçelja e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, do të duhej të merrte në shqyrtim një çështje civile në të cilën Komisioneri I. ka qenë avokat i palës ndërgjyqëse, kjo situatë mund ta vendoste atë në konflikt faktik interesi me subjektin e rivlerësimit, në kushtet e pengesës ligjore të parashikuar nga neni 30, germa “ç” e Kodit të Procedurës Administrative. Gjithashtu, Komisioni vlerësoi se Komisioneri R. I. ndodhet në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, pasi mund të krijohet perceptimi se situata e agravuar midis tij dhe subjektit të rivlerësimit, si në pamje ose në formë, duket se mund të ndikojë në vlerësimin përfundimtar të këtij subjekti. Trupi gjykues vëren se pranimi i kërkesës për përjashtimin e Komisionerit R. I. është kryer referuar një “konflikti të mundshëm të interesit”. Në ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, *“Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”*, i ndryshuar, në nenin 3, pika 4, germa “c”, *“konflikt i mundshëm i interesit”* është përcaktuar si gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit mund të shkaktojnë në të ardhmen shfaqjen e konfliktit faktik ose në dukje të interesit, nëse zyrtari do të përfshihej në detyra apo përgjegjësi të caktuara.

18.5. Trupi gjykues konstaton se hetimi administrativ fillestar, kur në përbërje të trupit gjykues ishte Komisioner R. I. në cilësinë e relatorit, është kryer vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Gjithashtu, në email-in e datës 11.02.2020, drejtuar Komisionit, vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, në dijeninë e tij, nuk është në konflikt interesi me asnjë nga anëtarët e trupit gjykues. Provat e mbledhura në këtë fazë të hetimit administrativ ishin kryesisht aktet e administruara nga bankat, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme apo organe të tjera shtetërore, aq më tepër ishin prova dhe akte të sjella nga vetë subjekti. Subjekti do të gjendej në një situatë faktike të konfliktit të interesit, nëse do të riçelej hetimi edhe për kriterin e vlerësimit profesional, ashtu sikur rezultoi pas zëvendësimit të dy anëtarëve të trupit të tij gjykues. Aq më tepër, vendimi i ndërmjetëm, i cili ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e R. I. nga trupi gjykues, sipas

përkufizimit për gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit, përmban të gjitha elementet e vlefshmërisë së tij, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

18.6. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pavlefshmëri të akteve të administruara në fazën e parë të hetimit administrativ dhe i rezultoi se: trupi gjykues i Komisionit, i zgjedhur me short¹², me vendimin e datës 15.06.2022, ka vendosur pranimin e kërkesës për përjashtim të Komisionerit R. I. Me vendimin e datës 17.06.2022, trupi gjykues i zgjedhur me short¹³, ka vendosur pranimin e kërkesës për përjashtimin e Komisioneres E. Ç. Me vendimin nr. {***}, datë 17.06.2022, të Komisionit, është caktuar me short relatorja e re e trupit gjykues të çështjes së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, Komisionerja G. T. (B.). Me vendimin nr. {***}, datë 17.06.2022, është caktuar me short anëtarja e re e trupit gjykues, Komisionerja F. Sh. Dy anëtarët e rinj të trupit gjykues kanë deklaruar menjëherë mospasjen e konfliktit të interesit. Për këtë ndryshim të trupit gjykues, subjekti është njohur nëpërmjet postës elektronike me *email*-in e datës 21.06.2022, duke iu kërkuar të shprehet në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit në raport me anëtarët e rinj. Në përgjigje të *email*-it të datës 21.06.2022, subjekti nuk është shprehur në lidhje me ndonjë konflikt interesi me anëtarët e rinj të trupit gjykues.

Anëtarët e trupit të ri gjykues të Komisionit, me përbërje P. Q., G. T. (B.) dhe F. Sh., me vendimin nr. {***}, datë 21.06.2022, kanë vendosur të pranojnë kërkesën e subjektit të rivlerësimit në mbyllje të hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe riçeljen e hetimit administrativ për subjektin Andri Ymeri, dhe vijimin e hetimit për të tria kriteret e vlerësimit.

18.7. Nga analizimi i akteve të ndodhura në fashikullin e Komisionit, trupit gjykues i rezultoi se relatorja e çështjes, në zbatim të procedurave ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, ka kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni, në datën 28.10.2022, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit Andri Ymeri, si dhe njoftimin e subjektit për t'u njohur me materialet e dosjes dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike, të datës 31.10.2022, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni, duke iu përcaktuar si afat data 14.11.2022, ora 12:00. Për rrjedhojë mbeten të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pavlefshmëri të provave të mbledhura gjatë rezultatit të hetimit dhe nuk mund të përbëjnë shkak për cenimin e vlefshmërisë së vendimmarrjes të Komisionit në drejtim të sa më sipër.

18.8. Trupi gjykues, pasi konstatoi se Komisioni ka pranuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e dy anëtarëve të trupit gjykues, duke zëvendësuar dy prej tyre, si dhe ka vlerësuar çdo kërkesë dhe pretendim të subjektit të rivlerësimit, si në fazën e hetimit, ashtu dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore, duke i dhënë mundësi të shprehet për gjetjet e Komisionit, vlerëson se nuk vërtetohen rrethanat e parashikuara nga neni 108,¹⁴ shkronja “b” e Kodit të Procedurave

¹² Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 14.6.2022, të Komisionit.

¹³ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 14.6.2022, të Komisionit.

¹⁴ Neni 108: “Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme: a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me: i) kompetencën e organit publik, ii) procedurën e nxjerrjes së tij ose iii) formën ose elemente të tjera të detyrueshme të aktit; b) është nxjerrë

Administrative, për pavlefshmërinë e aktit administrativ. Për pasojë nga sa më lart, por edhe referuar vendimmarrjeve¹⁵ të mëparshme të tij, trupi gjykues i vlerëson si të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit për pavlefshmërinë e vendimit nr. 604, datë 21.12.2022, të Komisionit, duke cilësuar si shkak konfliktin e interesit të relatorit të mëparshëm dhe të një anëtareje tjetër të trupit gjykues.

19. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankesa dhe kundërshton disa vendime të ndërmjetme të Komisionit, të datuara nga data 9 deri më 16 dhjetor 2022, lidhur me vlerësimin e paanshmërisë dhe ligjshmërisë së trupave gjykuese të Komisionit. Konkretisht: **(i)** Ankim kundër vendimit të Komisionit nr. {***} prot., datë 12.12.2022, me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Komisioneres G B. nga procesi i tij i rivlerësimit; **(ii)** Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit nr. {***} prot., datë 09.12.2022, me të cilin është disponuar “Mospranimi i kërkesës së subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, për përjashtimin e Komisioneres P. Q.”; **(iii)** Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit nr. {***} prot., datë 12.12.2022, me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Komisioneres F. Sh.; **(iv)** Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit nr. {***} prot., datë 15.12.2022, me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Komisioneres G B.; **(v)** Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit nr. {***} prot., datë 15.12.2022, me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Komisioneres P. Q.; **(vi)** Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit nr. {***} prot., datë 16.12.2022, me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Komisionereve P. Q., G B. dhe F. Sh.; **(vii)** Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit nr. {***} prot., datë 16.12.2022, me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Komisioneres F. Sh.; **(viii)** Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit nr. {***} prot., datë 09.12.2022, me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Komisioneres F. Sh.; **(ix)** Ankim kundër vendimit të ndërmjetëm të Komisionit nr. {***} prot., datë 16.12.2022, me të cilin është refuzuar kërkesa për përjashtimin e Komisionereve P. Q., G B. dhe F. Sh.; **(x)** Ankim kundër mosmarrjes së vendimit nga trupi gjykues i Komisionit lidhur me kërkesën për përjashtimin e Komisionereve P. Q., G B. dhe F. Sh.

19.1. Subjekti kërkon që Kolegji të shqyrtojë në themel kërkesat e tij dhe, nëse e gjen të bazuar, të konstatojë pavlefshmërinë e të gjitha veprimeve administrative të kryera nga këta zyrtarë (në cilësinë e Komisionerëve të trupit gjykues të Komisionit), dhe shpalljen e papërdorshmërisë së të gjitha rezultateve dhe provave që janë rrjedhojë e këtyre veprimeve, të konstatojë pavlefshmërinë e vendimeve të Komisionit, të përsërisë të gjithë procesin e rivlerësimit në kushte të paanshme, të marrë masa disiplinore ndaj Komisionerëve të përfshirë në konflikt interesi. Subjekti pretendon se Komisioneret P. Q., G B., F. Sh., A. F., B. B., S. Zh., V. S. nuk kanë qenë të paanshëm dhe kanë marrë vendime në kushtet e paragjyqimit, për shkak të konflikteve të interesit.

19.2. Në funksion të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar në Komision, nga ku konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë gjithsej 11 kërkesa për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit, duke paraqitur shkaqet si: paragjykimin e çështjes, anshmërinë e tyre në gjykim, gjendje të konfliktit të interesit të anëtarëve të Komisionit etj., qëndrime këto që, sipas tij, cenojnë standardet e “Gjykatës së pavarur dhe të paanshme dhe të formuar me ligj”, pjesë e procesit të rregullt ligjor, në zbatim të nenit 6 të KEDNj-së dhe 42 të Kushtetutës. Konkretisht:

nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale; c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal; ç) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj”.

¹⁵ Vendimi i Kolegjit nr. 11/2023, që i përket subjektit të rivlerësimit E. B., paragrafi 24.

- i) Në seancën e datës 13.06.2022, subjekti ka bërë dy kërkesa për përjashtim, përkatësisht të relatorit të çështjes R. I. dhe anëtares së trupit gjykues E. Ç. . Me vendimin e datës 15.06.2022, trupi gjykues i zgjedhur me short¹⁶ ka vendosur pranimin e kërkesës për përjashtim të Komisionerit R. I. Me vendimin e datës 17.06.2022, trupi gjykues i zgjedhur me short¹⁷ ka vendosur pranimin e kërkesës për përjashtimin e Komisioneres E. Ç.
- ii) Në seancën e datës 09.12.2022, subjekti ka bërë kërkesë për përjashtimin e një prej anëtarëve të trupit gjykues, Komisioneres F. Sh. Trupi gjykues i zgjedhur me short¹⁸ vendosi, në datën 09.12.2022, mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 12.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 16.12.2022.
- iii) Në të njëjtën seancë, subjekti ka bërë kërkesë për përjashtim të Komisioneres P. Q. Trupi gjykues i ngritur me short¹⁹ vendosi, në datën 09.12.2022, të rrëzojë kërkesën e subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 12.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 14.12.2022.
- iv) Në seancën e datës 12.12.2022, subjekti, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, paraqiti kërkesën për përjashtim të Komisioneres F. Sh. Trupi gjykues i ngritur me short²⁰ vendosi, në datën 12.12.2022, mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 12.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 15.12.2022.
- v) Në seancën e datës 12.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesë për përjashtim të Komisioneres G. T. (B.). Trupi gjykues i ngritur me short²¹ vendosi, në datën 12.12.2022, mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 12.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 15.12.2022.
- vi) Në seancën e datës 12.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesë për përjashtim të Komisioneres P. Q. Trupi gjykues i ngritur me short²² vendosi, në datën 15.12.2022, mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 15.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 16.12.2022.
- vii) Në seancën e datës 12.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesë të dytë për përjashtim të Komisioneres G. T. (B.). Trupi gjykues i ngritur me short²³ vendosi, në datën 12.12.2022, mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 15.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 16.12.2022.
- viii) Në seancën e datës 13.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesën për përjashtimin e të tre anëtarëve të trupit gjykues, Komisionereve P. Q., F. Sh. dhe G. T. (B.). Trupi gjykues i ngritur me short²⁴ vendosi, në datën 16.12.2022, mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 16.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 19.12.2022.

¹⁶ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 14.06.2022, të Komisionit.

¹⁷ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 14.06.2022, të Komisionit.

¹⁸ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 09.12.2022, të Komisionit.

¹⁹ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 09.12.2022, të Komisionit.

²⁰ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 12.12.2022, të Komisionit.

²¹ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 12.12.2022, të Komisionit.

²² Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 12.12.2022, të Komisionit.

²³ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 12.12.2022, të Komisionit.

²⁴ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 15.12.2022, të Komisionit.

ix) Në datën 12.12.2022, subjekti, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, me anë të postës ka paraqitur pranë Komisionit kërkesën për përjashtim të Komisioneres F. Sh. Trupi gjykues i ngritur me short²⁵ vendosi, në datën 15.12.2022, mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 16.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 20.12.2022.

x) Me anë të postës elektronike të datës 15.12.2022, subjekti ka paraqitur kërkesën për përjashtimin e të tre anëtarëve të trupit gjykues, Komisionereve P. Q., F. Sh. dhe G. T. (B.). Trupi gjykues i ngritur me short²⁶ vendosi, në datën 16.12.2022, mospranimin e kërkesës së subjektit si të pabazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim iu njoftua subjektit me anë të postës elektronike në datën 16.12.2022 dhe iu dërgua i arsyetuar në datën 19.12.2022.

19.3. Lidhur me kundërshtimin që subjekti i rivlerësimit paraqet për qëndrimin e Komisionit për refuzimin e dy kërkesave për përjashtim, të paraqitura në seancën dëgjimore të datës 19.12.2022, trupi gjykues, nga verifikimi i akteve, konstatoi se menjëherë me çeljen e seancës dëgjimore të datës 19.12.2022, Komisioni njoftoi subjektin se të gjitha trupat e ngritur për shqyrtimin e kërkesave të tij për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues, kanë vendosur mospranimin e kërkesave, po ashtu ka rrëzuar kërkesën e bërë në seancën e datës 14.12.2022, për pezullim të procesit të rivlerësimit, për shkak se ka kryer kallëzim penal në SPAK për anëtarët e trupit gjykues të Komisionit. Në momentin që subjektit iu dha fjala për të shprehur qëndrimin e tij përfundimtar në seancën dëgjimore të datës 19.12.2022, përfaqësuesi i tij kërkoi të paraqiste dy kërkesa të tjera për përjashtim, përkatësisht për Komisioneren G. T. (B.) dhe një kërkesë për përjashtimin e të gjithë anëtarëve të trupit gjykues. Komisioni vendosi të mos i administrojë këto kërkesa, duke i konsideruar si abuzive.

19.4. Trupi gjykues e vlerëson si jo korrekt qëndrimin e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të kryer në Komision, e aq më tepër gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore, duke parë sjelljen e tij në raport me kërkesat e shumta për përjashtim. Nëpërmjet paraqitjes së kërkesave procedurale, të drejtë të cilën ia njeh ligji, ai duket se ka pasur tendencën të zvarrisë procesin e rivlerësimit, pasi është njohur me bilancet negative të pasurisë, gjendjen e konfliktit të interesit referuar në aktet për kriterin e kontrollit të figurës, si dhe në shkeljet e evidentuara nga Komisioni për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Trupi gjykues konstaton se, në momentin e paraqitjes së dy kërkesave për përjashtim, subjekti i rivlerësimit ndodhej në fazën e paraqitjes së qëndrimit përfundimtar për çështjen, pra kishte përfunduar paraqitja e kërkesave procedurale, pasi Komisioni i kishte shqyrtuar të gjitha kërkesat e tij, përfshirë edhe 11 kërkesat për përjashtim të anëtarëve të Komisionit, 9 prej të cilave i ishin përcjellë subjektit me vendimin e arsyetuar. Në këto kushte, trupi gjykues i konsideron si abuzive kërkesat e ripërsëritura të subjektit për përjashtim të relatores dhe anëtarëve të tjerë, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin që procesi i rivlerësimit ka etapat e veta procedurale dhe në këtë fazë të fundit ishte paraqitja e konkluzioneve përfundimtare, për rrjedhojë, ishte e paarsyeshme paraqitja e kërkesave të përsëritura për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues të Komisionit.

Nga kontrolli i procedurave të ndjekura nga anëtarët e Komisionit, trupi gjykues nuk identifikon rrethana konkrete apo sjellje subjektive në veprimet e tyre gjatë hetimit administrativ. Si rrjedhojë, shkaku i ankimit, i ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk gjendet i bazuar.

19.5. Trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit për mospranimin e kërkesës së tij për përjashtim të anëtarëve të Komisionit, për shkak të kallëzimit penal ndaj tre Komisionerëve të

²⁵ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 15.12.2022, të Komisionit.

²⁶ Ky trup gjykues është zgjedhur me short me vendimin nr. {***}, datë 15.12.2022, të Komisionit.

Komisionit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Andri Ymeri, Av. G. Y. dhe Av. A. Ll. (të dy këta në cilësinë e përfaqësuesve të shtetasit Andri Ymeri, por të prezantuar edhe si kallëzues në këtë çështje), më datë 15.12.2022, përpara Prokurorisë së Posaçme, kanë depozituar një kallëzim penal ndaj P. Q., G. T. (B.) dhe F. Sh., me detyrë anëtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 186/3, 190/3, 248, 300 të Kodit Penal²⁷. Prokuroria, pas kryerjes së veprimeve verifikuese, bazuar në nenin 290/1 (c) të Kodit të Procedurës Penale, më datë 29.12.2022, ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. {***}/2022, duke argumentuar se fakti nuk përbën vepër penale, si dhe fakti nuk ekziston.

19.5/a. Nga verifikimi i faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë (referuar nga vetë subjekti i rivlerësimit në kërkesat e sjella në Kolegj) konstatohet se në këtë gjykatë është regjistruar çështja me nr. {***} regj. them., me palë Andri Ymeri, av. G. Y., Av. A. Ll., me objekt “Kundërshtimi i vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr. {***} kallëzimi, i datës 29.12.2022, të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”. Pra, sikurse konstatohet nga ana e subjektit të rivlerësimit, është ushtruar ankim ndaj vendimit të mosflimit të procedimit penal të Prokurorisë së Posaçme, por të gjitha shkallët e gjyqësorit, përfshi Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kanë miratuar vendimmarrjen e organit të Prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal, datë 29.12.2022²⁸.

19.5/b. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë dhe të bazuar në ligj, mospranimin e kërkesës së subjektit për përjashtim të anëtarëve të Komisionit, për shkak të kallëzimit penal të depozituar prej tij ndaj tre Komisionerëve të Komisionit, për sa kohë procesi i rivlerësimit është një proces administrativ, që zhvillohet në mënyrë të pavarur nga çdo proces tjetër²⁹. Kallëzimi penal i bërë nga subjekti për anëtarët e Komisionit nuk mund të jetë shkak i arsyeshëm dhe ligjor për pezullim të procesit të rivlerësimit, që bazuar në pikën 3, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, duhet të përmbillet brenda një afati sa më shpejt të mundshëm.

19.6. Lidhur me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, të datës 16.06.2025, për shtyrjen e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi, datë 03.07.2025, të zhvilluar në Kolegj, me pretendimin se më datën 15.07.2025, në Gjykatën e Lartë do shqyrtohej rekursi që ai ka paraqitur, ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, dhe sipas tij, një përfundim i favorshëm i këtij gjykimi do t’i jepte të drejtë për njërin prej shkaqeve të ankimit që ka paraqitur, lidhur me “gjykatën e krijuar me ligj”, trupi gjykues konstaton se: subjekti i rivlerësimit nuk ka përcaktuar bazën ligjore se ku e mbështet kërkesën për shtyrje të seancës gjyqësore. Nga ana tjetër, për sa kohë edhe Prokuroria e Posaçme hetoi mbi faktet e kallëzuara prej tij, duke arritur në përfundimin se fakti nuk përbën vepër penale, si dhe fakti nuk ekziston, por dhe gjykatat e posaçme

²⁷ Kallëzuesi në kallëzimin e tij pretendon se Komisionerja Q. ka kryer veprën penale të shpërdorimit të detyrës, duke marrë vendim përfundimtar në një proces rivlerësimi pa përfunduar procedura dhe nën ndikim politik. Sipas tij, ajo është emëruar komisionere në shkellje të ligjit nr. 84/2016 dhe se ka falsifikuar dokumentacionin e aplikimit. Për Komisioneren G. T. (B.), kallëzuesi pretendon se ka kryer shpërdorim detyre (neni 248 i Kodit Penal), duke mbështetur Komisioneren Qirko në vendimmarrje dhe duke cenuar procesin e rregullt ligjor. Ajo akuzohet se është zgjedhur komisionere në shkellje të ligjit nr. 84/2016, pa provuar vjetërsinë 15-vjeçare në punë dhe duke mos deklaruar masa disiplinore. Ndërsa për Komisioneren F. Sh., kallëzuesi pretendon se ka kryer moskallëzim të veprës penale (neni 300 i Kodit Penal), duke mos denoncuar veprimet e paligjshme të kolegeve në procesin e rivlerësimit. Ajo akuzohet se është zgjedhur komisionere në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, pasi ka pasur masa disiplinore të padeklaruara dhe ka falsifikuar dokumentacionin.

²⁸ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 15.07.2025, ka vendosur “Mospranimin e rekursit të paraqitur nga ankuesi Andri Ymeri kundër vendimit nr. {***}, datë 18.05.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”.

²⁹ Shih edhe vendimin nr. 2/2024 të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit A. G. (C.), paragrafi 19.4.

i konfirmuan përfundimet e Prokurorisë, si dhe në kushtet kur nuk u evidentua ndonjë shkelje e të drejtës së tij nga ana e Komisionit, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit.

19.7. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se anëtarja e trupit të tij gjykues, F. Sh., ka qenë e anshme në gjykimin e çështjes së tij, pasi ka marrë pjesë edhe në procesin e rivlerësimit të motrës së tij, si dhe ndodhej në konflikt interesi, sepse përfaqësuesi ligjor i tij, kohë më parë kishte bërë kallëzim penal ndaj saj, në kohën që ajo ushtronte detyrën e noteres në qytetin e Gjirokastrës, trupi gjykues vlerëson se: në procesin e rivlerësimit të motrës së tij, për të cilën ka një vendim përfundimtar edhe nga ana e Kolegjit, nuk evidentohet ngjashmëri me procesin e tij të rivlerësimit. Madje, edhe në të vetmin kriter të vlerësimit të pasurisë, ku mund të gjendej ndonjë lidhje apo pikë takimi midis tyre, nuk rezulton një gjë e tillë. Ndërsa sa i përket konfliktit të interesit, trupi gjykues vlerëson se, referuar nenit 30 të Kodit të Procedurës Administrative, përfaqësuesi ligjor nuk bën pjesë te rrethi i personave që parashikon kjo dispozitë, që mund të sjellë si pasojë pengesë ligjore për nëpunësin publik ose anëtarin e organit kolegjal për përfshirjen e tij në një procedurë administrative vendimmarrëse. Për sa më lart, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

19.8. Nga analizimi i vendimeve të ndërmjetme të Komisionit, trupi gjykues konstaton se në përmbajtje të tyre janë pasqyruar pretendimet e subjektit për kërkesat për përjashtim, është përcaktuar baza ligjore mbi të cilën refuzohet kërkesa, paraqiten argumente mbi shkaqet e mospranimit të kërkesave të subjektit. Vendimet e ndërmjetme i janë njoftuar subjektit të rivlerësimit, si dhe nuk vërehet ndonjë element paragjykues apo subjektiv nga anëtarët e Komisionit në trajtimin e këtyre kërkesave. Veprimet dhe vendimmarrja e tyre është në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, ato janë të bazuara në prova dhe ligj dhe nuk konstatohet ndonjë shkak për vënien në dyshim të vlefshmërisë së vendimmarrjeve të tyre.

20. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, megjithëse ka kërkuar³⁰ pezullimin e procesit të tij të rivlerësimit derisa të shqyrtohej nga Gjykata Kushtetuese çështja mbi ligjshmërinë e përbërjes së anëtarëve të Komisionit, ky i fundit nuk ka vepruar, duke i mohuar të drejtën për një proces të drejtë. Gjithashtu, subjekti kërkon që, lidhur me kërkesën e paraqitur në datën 19.12.2022 në Kolegj, ky i fundit, nëse vendos ta shqyrtojë këtë kërkesë, të vendosë një masë të përkohshme për pezullimin e fuqisë juridike të vendimit nr. 604, datë 21.12.2022, të Komisionit. Subjekti pretendon se trupat gjykues të Komisionit që kanë dhënë vendimet e ndërmjetme,³¹ Komisioneret (A. F., B. B., S. Zh. dhe V. S.) lidhur me kërkesat e tij për përjashtimin e Komisionerëve që ishin përfshirë në trupin gjykues të Komisionit të çështjes së tij, nuk e plotësojnë standardin kushtetues të “Gjykatës së krijuar me ligj”.

20.1. Trupi gjykues konstaton se këto pretendime të subjektit janë çështje që janë trajtuar tashmë nga jurisprudenca e Kolegjit, e cila i ka konsideruar ato të pabazuara ligjërisht, qëndrim të cilin, gjithashtu,

³⁰ Kjo kërkesë ka për objekt: Konstatimin e shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor në standardin kushtetues “Gjykatë e krijuar me ligj”, për shkak të papajtueshmërisë së disa anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (G. B., F. Sh., P. Q. etj.) për ushtrimin e funksionit në këtë organ. Shfuqizimin pjesërisht të Vendimit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë nr. 82/2017, për miratimin e listës së kandidatëve për në institucionet e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, për sa i përket anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Pezullimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarit Andri Ymeri, deri në zgjidhjen e konfliktit gjyqësor me një vendim përfundimtar të formës së prerë. Përcaktimin nga Gjykata Kushtetuese për kompetencën e organit shtetëror që ka juridiksion dhe kompetencë ligjore për të shqyrtuar çështjen në themelin e saj, duke marrë parasysh edhe vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GjEDNJ) në çështjet “Besnik Cani kundër Shqipërisë” dhe “Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë”.

³¹ Vendimet nr. {***} prot., datë 12.12.2022, nr. {***} prot., datë 09.12.2022, nr. {***} prot., datë 12.12.2022, nr. {***} prot., datë 15.12.2022, nr. {***} prot., datë 15.12.2022, nr. {***} prot., datë 16.12.2022, nr. {***} prot., datë 16.12.2022, nr. {***} prot., datë 09.12.2022, nr. {***} prot., datë 16.12.2022.

e ka konfirmuar edhe GjEDNj-ja. Për shkak të natyrës *sui generis* të procesit të rivlerësimit, referimi në jurisprudencën e GjEDNj-së, tashmë orientohet nga vendimi i kësaj gjykate në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, që materializon vlerësimin e kësaj gjykate mbi institucionet e procesit të rivlerësimit në Shqipëri, në drejtim të garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Konkretisht, në paragrafët 299 dhe 300 të këtij vendimi, GjEDNj-ja ka theksuar se: 299. [...] Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendase, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kishte pushtuar sistemin e drejtësisë. [...]. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është *sui generis* dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve. 300. Sipas këndvështrimit të gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin. Ajo vëren se këta anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj [...].

20.2. Ndërsa lidhur me pretendimin e subjektit se trupat gjykues të Komisionit që kanë dhënë vendime për përjashtimin e Komisionerëve R. I. , E. Ç. , P. Q. dhe G. T., nuk plotësojnë standardin kushtetues të “Gjykatës së paanshme”, pasi kanë dhënë vendimin për motrën e subjektit të rivlerësimit, A. P., trupi gjykues çmon se procesi i rivlerësimit për secilin subjekt vlerësohet mbi bazën e deklarimeve individuale të tyre, është një proces i ndarë, në të cilin merren në shqyrtim dokumentacionet që i përkasin kriterëve të vlerësimit të pasurisë, figurës dhe profesionale në mënyrë të pavarur, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit³². Trupi gjykues konstaton se pasuritë e analizuara nga Komisioni për motrën e subjektit janë të ndryshme me ato që i përkasin subjektit të rivlerësimit, aq më tepër që kriteret që i përkasin kontrollit të figurës dhe vlerësimit profesional kanë karakter individual. Kontrolli ligjor i vendimeve të Komisionit nga Kolegji kryhet vetëm nëpërmjet ankimit. Për rrjedhojë, nuk vërehet shkelje e standardit kushtetues të “Gjykatës së paanshme” nga anëtarët e Komisionit, e për pasojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar në prova dhe në ligj.

21. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer shkelje të rëndësishme procedurale gjatë procesit të rivlerësimit, duke cenuar të drejtën e tij për një proces të drejtë dhe transparent, pasi Komisioni nuk i ka kthyer përgjigje për disa kërkesa të rëndësishme të paraqitura nga ai në lidhje me statusin e provave dhe vlefshmërinë e akteve administrative, të miratuara nga anëtarët e përjashtuar për konflikt interesi. Sipas subjektit, mosdhënia e një përgjigjeje përbën shkelje të këtij standardi, pasi sipas nenit 12 të Kodit të Procedurave Administrative, një organ administrativ ka detyrimin të përgjigjet për çdo kërkesë brenda një afati të arsyeshëm.

21.1. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të këtij shkakut ankimi, mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga Komisioni, nga ku konstatoi se subjekti i rivlerësimit, më datë 20.04.2022 (rezultati i hetimit të parë administrativ vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë), por edhe më datë 03.11.2022 (rezultati i hetimit të dytë administrativ, pas riçeljes së hetimit edhe për dy kriteret e tjera), ka nënshkruar deklaratën për njohjen me dokumentacionin fizik dhe marrjen në formë elektronike (CD) të dosjes së hetimit administrativ të zhvilluar në Komision.

³² Vendim nr. 34/2021 (JR), datë 15.11.2021, subjekti i rivlerësimit I. Sh., prg. 20; vendim nr. 16/2022 (JR), datë 26.05.2022, subjekti i rivlerësimit M. V. prg. 22.3.1; vendim nr. 8/2022 (JR), datë 07.04.2022, subjekti i rivlerësimit E. H., prg. 19.12; vendim nr. 48/2022 (JR), datë 15.12.2022, subjekti i rivlerësimit E. T. prg. 20.

Subjektit të rivlerësimit i është përcjellë çdo vendimmarrje e trupave gjykues të Komisionit lidhur me vendimet e ndërmjetme të marra prej tij, i është kthyer përgjigje kërkesave të shumta procedurale të subjektit. Në datën 30.11.2022, Komisioni i është drejtuar subjektit me anë të postës elektronike, duke i kërkuar të adresonte kërkesat e tij procedurale në një/disë dokumente të ndara nga dokumenti i mbrojtjes së tij, në mënyrë që Komisioni të ishte korrekt dhe i plotë në vlerësimin e tij. Ndërsa në datën 05.12.2022, Komisioni, pasi mori në shqyrtim kërkesat e subjektit, përsëri të integruar në një dokument voluminoz, së bashku me prapësimet, i ka bërë me dije se, përveç faktit se ka konstatuar se subjekti ka refuzuar të depozitojë kërkesat procedurale në formën e kërkuar nga ligji, ai ka abuzuar me afatin e kërkuar për të dërguar kërkesat procedurale, ka përdorur një gjuhë fyese (duke aluduar moskryerjen e detyrës nga Komisioni për leximin e kujdesshëm të materialit mbrojtës). Gjithashtu, në të njëjtin *email*, të datës 05.12.2022, Komisioni ka njoftuar subjektin se ka vendosur të rrëzojë kërkesën për hetime të mëtejshme, pasi dokumentacioni i pretenduar është i administruar nga Komisioni, si dhe në disa raste vlerësohet i panevojshëm për procesin, ndërsa në lidhje me kërkesat për rilogaritje dhe vlerësim/rivlerësim të provave, Komisioni ka çmuar se nuk mund të kryhen në këtë moment procedural, derisa të përfundojë dëgjesa e subjektit në seancë dëgjimore.

21.2. Trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit është një proces administrativ i iniciuar kryesisht. Referuar nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Gjatë hetimit administrativ, ato kërkojnë informacion, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, duke bazuar vendimin vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Sikurse konstatohet, Komisioni ka njoftuar dhe respektuar pjesën më të madhe të kërkesave procedurale të subjektit, e kundërta vihet re në qëndrimin e subjektit, duke mos i specifikuar apo identifikuar në mënyrë konkrete ato, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit është i pabazuar.

22. Subjektit i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka refuzuar kërkesën për thirrjen si persona të tretë dhe dëshmitarë të disa personave³³, të cilët subjekti i konsideron të rëndësishëm për hetimin e pasurisë së tij dhe për trajtimin e çështjes, duke mos dhënë një arsyetim të plotë dhe të bazuar në ligj. Sipas subjektit, refuzimi për të pranuar dëshmitarët, pa dhënë shpjegime të qarta, bie ndesh me parimin e së drejtës për t'u mbrojtur, të garantuar nga neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

22.1. Lidhur me këtë pretendim, nga shqyrtimi i akteve të dosjes, trupi gjykues konstaton se, me vendimin nr. {***}, datë 27.05.2022, Komisioni ka vendosur mospranimin e thirrjes së dëshmitarëve për shkak se marrja e provës duket e panevojshme (neni 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe neni 232, Kodi i Procedurës Civile), duke e njoftuar subjektin për refuzimin e kërkesës së tij për thirrjen e dëshmitarëve apo personave të tretë dhe duke i cituar edhe bazën ligjore se ku është mbështetur refuzimi. KEDNJ, në nenin 6 të saj, parashikon të drejtën për thirrjen dhe pyetjen e dëshmitarëve që mund të kërkohen nga një palë, si kusht për të garantuar procesin e rregullt ligjor, ndërsa pranueshmëria e dëshmimeve është kompetencë e së drejtës së brendshme, duke i lënë një marzh të gjerë vlerësimi gjykatës. Sidoqoftë, procedura e parashikuar në tërësinë e vet, përfshirë edhe mënyrën se si pranohen dëshmitarët, duhet të jetë e rregullt në kuptimin e nenit 6 të Konventës. Nën dritën e zbatueshmërisë së parimeve të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe GjEDNJ-së,³⁴

³³ A. P. (Y.), F. F. Y., E. Y., G. Y., F. F. Y., Xh. C. Th., Sh. G., L. K., N. M. dhe R. I.

³⁴ Shih vendimin nr. 38/2010 të Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet e GjEDNJ-së në çështjet “Dombo Beheer kundër Holandës”, 1993 dhe “Wierzbicki kundër Polonisë”, 2002.

nëse dëshmia nuk do të kishte rëndësi për gjykimin, gjykatat mund ta refuzojnë kërkesën për marrjen në pyetje të dëshmitarit, por duhet që një gjë të tillë ta arsyetojnë. Trupi gjykues vëren se argumentimi i dhënë nga Komisioni për mospranimin e kërkesës rezulton të jetë sqarues lidhur me arsyet e vendimmarrjes, brenda diskrecionit të tij për të vlerësuar marrjen e provave dhe thirrjen e dëshmitarëve në kuadër të parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, duke refuzuar në mënyrë të arsyetuar marrjen e provës me dëshmitarë. Për këtë arsye, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar, për sa i përket refuzimit nga Komisioni të kërkesës së subjektit për thirrjen e dëshmitarëve.

23. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit për mosshqyrtimin e provave që ai ka paraqitur gjatë hetimit administrativ në Komision. Nga verifikimi i tyre konstatohet se për subjektin e rivlerësimit Andri Ymeri është ndjekur e njëjta procedurë, si edhe për subjektet e tjerë të rivlerësimit, përcaktuar nga neni 55 i ligjit nr. 84/2016 dhe akti rregullator i Komisionit, *“Hapat proceduralë të unifikuar”*, si dhe provat në këtë proces janë çmuar në raport me njëra-tjetrën. Në vendimin e Komisionit janë pasqyruar provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, së bashku me prapësimet për rezultatet e hetimit dhe është kryer analizimi dhe vlerësimi i tyre në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket vlerës provuese të tyre në raport me provat dhe aktet e tjera të administruara gjatë hetimit, si dhe për ndikimin e tyre në konkluzionet dhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

23.1. Nga kjo situatë evidentohet qartë se prej Komisionit nuk ka munguar vlerësimi i provave dhe i shpjegimeve të dhëna nga subjekti, por se ato janë çmuar në mënyrë të ndryshme nga pritshmëritë e tij, tagër i cili ushtrohet nga Komisioni sipas diskrecionit të tij dhe kompetencës që i ka dhënë neni 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit³⁵, fakti që këto akte e prova të subjektit Komisioni nuk i ka vlerësuar në mënyrën e dëshiruar prej tij, nuk passjell logjikisht se ka munguar vlerësimi lidhur me to. Ky është edhe interpretimi i vlerësimit të provave zhvilluar nga jurisprudenca e GjEDNj-së, në drejtim të zbatimit në praktikë të garancive të procesit të rregullt ligjor, në çështjen *“Wierzbicki kundër Polonisë”*, 2002. Për sa më sipër, ky pretendim konsiderohet i pabazuar në prova dhe në ligj.

24. Subjekti i rivlerësimit pretendon për shkeljen e së drejtës për t’u mbrojtur nga tortura dhe trajtimi çnjerëzor apo poshtëruës, sipas nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 17/2 i Kushtetutës. Subjekti pretendon se ka kërkuar shtyrjen e disa afateve procedurale për shkak të arsyeve të justifikuara (gjendje shëndetësore dhe angazhime familjare urgjente), por Komisioni ka refuzuar të shqyrtojë këto kërkesa. Sipas subjektit, Kodi i Procedurave Administrative parashikon mundësinë e pezullimit ose të shtyrjes së afateve kur subjekti ka arsye të vlefshme, por në këtë rast, kjo e drejtë është mohuar pa një shqyrtim të drejtë. Subjekti kërkon që Kolegji të verifikojë nëse sjelljet e Komisionerëve të Komisionit, si gjatë procesit, por edhe në seancat dëgjimore, janë të bazuara në ligj dhe nëse ato mund të konsiderohen fyese, poshtëruese dhe çnjerëzore ndaj çdo subjekti që kërkon shërbimin publik të drejtësisë, sipas Parimeve të Bangalores, pasi sipas subjektit kjo ka të bëjë me respektimin e dinjitetit dhe të drejtës për një proces të drejtë dhe të barabartë, pa diskriminim dhe pa trajtim të padrejtë.

24.1. Në funksion të analizimit të këtij shkak ankimi, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar në fashikullin e Komisionit dhe konstaton se:

³⁵ Vendimet nr. 5/2019 (JR), nr. 13/2019 (JR), nr. 12/2020 (JR), nr. 17/2020 (JR), nr. 20/2020 (JR), nr. 26/2020 (JR), nr. 29/2020 (JR), nr. 4/2021 (JR), nr. 19/2021 (JR), të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

(i) Në datën 01.11.2022, subjekti ka kërkuar nga Komisioni kohë shtesë deri më 27.11.2022, me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së tij në përgjigje të barrës së provës. Komisioni, pasi shqyrtoi kërkesën, vendosi ta pranojë atë, duke e njoftuar subjektin, po në datën 01.11.2022 se mund të paraqiste provat dhe shpjegimet e tij brenda datës 27.11.2022.

(ii) Në datën 25.11.2022, subjekti i është drejtuar përsëri Komisionit me kërkesë për shtyrje afati deri më 30.11.2022, për arsye shëndetësore të nënës së tij. Komisioni, pasi vlerësoi kërkesën e subjektit, shoqëruar me dokumentacion mjekësor për kushtet shëndetësore të nënës së tij, e pranoi atë duke caktuar si afat të ri datën e kërkuar nga subjekti, 30.11.2022. Në të njëjtin njoftim, subjektit iu soll në vëmendje detyrimi ligjor për të përmbyllur këtë proces brenda një afati të arsyeshëm.

(iii) Në datën 30.11.2022, subjekti, së bashku me provat, ka depozituar dorazi dhe ridërguar me anë të postës elektronike, në datën 01.12.2022, një kërkesë të përfaqësuesit të tij ligjor A. Ll., për shtyrje afati prej 10 ditësh, me qëllim njohjen me dosjen e rivlerësimit të subjektit që ai përfaqëson. Këtë kërkesë, ai e arsyeton me faktin se i përfaqësuar prej tij i ka vënë në dispozicion dokumentacionin e procesit të rivlerësimit, pikërisht atë ditë, në datën 30.11.2022. Komisioni vlerësoi se kërkesat për shtyrje të afatit tejkalojnë kufijtë e të arsyeshmës, megjithatë, meqenëse subjektit iu caktua si afat për paraqitjen e kërkesave procedurale data 05.12.2022, i njëjti afat iu mundësua edhe avokatit.

24.2. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 14.12.2022, pasi subjekti kishte ushtruar të drejtën e tij të mbrojtjes për afro 10 orë, iu kërkuar nga trupi gjykues të shprehë qëndrimin e tij përfundimtar në lidhje me procesin e rivlerësimit, në përputhje me pikën 2, të nenit 88, të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti kërkoi kohë për të përgatitur konkluzionet e tij përfundimtare. Pavarësisht se nga ana e kryesueses iu qartësua se qëndrimi i tij përfundimtar nuk nënkupton të gjitha shpjegimet nga e para, trupi gjykues e pranoi kërkesën e subjektit, duke njoftuar zhvillimin e seancës tjetër në datën 19.12.2022.

24.3. Gjithashtu nga aktet rezulton se Komisioni, në funksion të hetimit administrativ, me anë të pyetësorëve, i ka drejtuar subjektit të rivlerësimit pyetje e kërkesa për të dhënë shpjegime, për të cilat jo në të gjitha rastet subjekti ka qenë i gatshëm t'i përgjigjet, situatë e cila nuk ka ndryshuar edhe pas rikërkesave për shpjegim të Komisionit. Ndërsa, në disa raste, rezulton se për pyetjet e drejtuara nga Komisioni, subjekti ka dhënë shpjegime kontradiktore dhe nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, duke sjellë si pasojë që të klasifikohet nga ky organ si jobashkëpunues, në kuptim të përcaktimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016. Po ashtu rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në Komision në seancën dëgjimore³⁶ (janë zhvilluar 6 seanca dëgjimore në muajin dhjetor 2022), në të cilën ka marrë të gjithë kohën e nevojshme për të paraqitur shpjegimet dhe pretendimet e tij.

24.4. Në konkluzion nga sa më sipër, trupi gjykues vëren se Komisioni ka pranuar disa herë kërkesat e subjektit të rivlerësimit për shtyrjen, jo vetëm të paraqitjes së prapësimeve, por edhe të zhvillimit të seancave gjyqësore, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, për refuzimin e kërkesave të tij për kohë të pamjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen, është i pabazuar. Madje, kërkesa e përfaqësuesit të subjektit të rivlerësimit, e datës 01.12.2022, për kohë shtesë për t'u njohur me dokumentacionin dhe aktet, në një kohë kur avokati është caktuar si përfaqësues ligjor i subjektit, që në datën 26.05.2022, referuar prokurës së përfaqësimit, është tregues se qëllimi i subjektit ka qenë

³⁶ Në Komision për subjektin e rivlerësimit Andri Ymeri janë zhvilluar seancat gjyqësore, në datat dhe oraret si më poshtë: (i) 27.05.2022, ora 11:00 - 11:48; (ii) 13.06.2022, ora 10:00 - 12:58; (iii) 09.12.2022, ora 10:00 - 11:29; (iv) 12.12.2022, ora 13:00 - 13:26; (v) 12.12.2022, ora 16:00 - 18:56; (vi) 13.12.2022, ora 15:00 - 21:07; (vii) 14.12.2022, ora 10:00 - 19:55; (viii) 19.12.2022, ora 16:00 - 16:14.

shqyrja/zvarritja e procesit të tij të rivlerësimit pa shkaqe të arsyeshme. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, për shkeljen e të drejtës për t'u mbrojtur, është i pabazuar në fakte.

24.5. Gjithashtu, trupi gjykues e konsideron të pavend dhe të pakuptimtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit për trajtim çnjerëzor dhe torturues në kushtet që, përgjithësisht, të tilla vlerësime kanë vend për të dënuarit penalisht ose individë të cilët janë të ndaluar për ndonjë arsye apo masë sigurimi shtrënguese nga organet ligjzbatuese/rendit. Në rrethanat konkrete, jo vetëm që subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar se si “është torturuar” apo ka qenë viktimë e një trajtimi “poshtërues”, apo “çnjerëzor”, por edhe nga aktet në fashikull është e pamundur të parashtrohet si opsion edhe teorik ky pretendim.

Në kushtet që subjekti i rivlerësimit referon në nenin 17, pika 2 e Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit detyrohet të prezumojë që ai duket se pretendon në mënyrë të pashprehur se procesi i rivlerësimit ka përbërë kufizime të të drejtave kushtetuese për të. Duke pasur parasysh që Aneksi i Kushtetutës, në nenin A, shprehet qartë se cilat janë kufizimet e të drejtave që lejohen për shkak të procesit të rivlerësimit³⁷ dhe në interes publik, si dhe kushtetutshmëria e procesit është konfirmuar tashmë shprehimisht edhe nga GjEDNj-ja në çështjen “Xhoxhaj”, edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

25. Trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit, se përdorimi i shprehjes së kryesueses së trupit gjykues, në seancën dëgjimore të datës 12.12.2022: *“këto mund t'i shkruash në ankim”*, jo vetëm tregon paragjykim, por mund të konsiderohet si trajtim poshtërues.

25.1. Nga verifikimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, të datës 12.12.2022, të orës 16:00, rezulton se pas një sërë diskutimesh të gjata mbi kërkesat procedurale të njëpasnjëshme të subjektit të rivlerësimit dhe avokatit të tij, në momentin që ai duhej të jepte shpjegimin për barrën e provës lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit përpigjej të aludonte për raste të tjera të konfliktit të interesit të anëtarëve të Komisionit, duke devijuar në këtë mënyrë paraqitjen e shpjegimeve e tij, deri në kufijtë e abuzimit me të drejtën për t'u dëgjuar apo për t'u mbrojtur. Kryetarja e seancës³⁸, pasi i kishte tërhequr disa herë vëmendjen për përqendrimin në themelin e çështjes, që lidhet me procesin e tij të rivlerësimit, si dhe në kuadër të ekonomizimit të kohës, i ka sugjeruar se: *“shpjegimet e tij mund t'i përdorte për ankimin përfundimtar, pasi nuk kanë lidhje me themelin”*. Parë në këtë këndvështrim, duke mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin tejet garantist të trupit gjykues të Komisionit, gjatë gjithë procesit të tij të rivlerësimit, si dhe në seancat dëgjimore, ky pretendim i subjektit nuk është i bazuar. Komenti i subjektit për ato kërkesa, interpretuar edhe në kontekstin logjik të vijimit të mendimit, si hap të radhës do të kishte ankimin, në nivelin që i përkiste procesit në atë moment procedural, të cilit i korrespondon edhe ndërhyrja e kryetares së seancës, duke ndjekur vijën logjike të fjalës së subjektit.

25.2. Trupi gjykues vëren se, në kushtet e zhvillimit të seancës dëgjimore (disa seancave), me zvarritje dhe pengesa të krijuara në mënyrë të qëllimshme e artificiale nga ana e subjektit të rivlerësimit, përdorimi i një shprehjeje të kryetares së seancës, në formën e udhëzimit për palët, nuk mund të konsiderohet me karakter paragjykues, aq më tepër kur ajo ka për detyrë mbarëvajtjen edhe zhvillimin e seancave dëgjimore në mënyrë sa më efikase dhe të balancuar. Gjithashtu, sikurse konstatohet, kjo

³⁷ Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen më të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “f”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.

³⁸ Referimi në faqen 29 të procesverbalit të seancës dëgjimore, datë 12.12.2022.

situatë ishte krijuar në momentin procedural kur subjektit i ishin rrëzuar kërkesat e tij për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues dhe, bazuar në Kodin e procedurave Civile³⁹, kërkesat për rrëzimin e vendimeve të ndërmjetme nuk mund të jenë objekt debati gjyqësor në seancë dëgjimore dhe ato mund të ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar.

25.3. Në vijim të analizës së mësipërme dhe nga sa rezulton nga aktet në fashikull që dokumentojnë procesin e ndjekur nga Komisioni, pretendimet e subjektit, për tendenciozitet, paragjykim apo paracaktim të vendimit, vlerësohen nga trupi gjykues të pambështetura në fakte dhe si një përpjekje me synimin e delegjitimitimit të procesit të rivlerësimit, kryer në kontekstin e themelit, duke ngritur shkaqe ankimi mbi rrethana që, jo vetëm nuk konstatohen si të tilla, por anashkalojnë konkluzionet e Komisionit për to.

Nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se sjellja e anëtarëve të Komisionit, si gjatë hetimit administrativ, por edhe në seancën dëgjimore, nuk mund të konsiderohet si trajtim poshtërues ndaj subjektit të rivlerësimit.

26. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdhënia e informacionit për pjesëmarrjen në “shortin special”, të datës 15.12.2019, të Komisionit, duke mos i kthyer përgjigje kërkesave të tij, ka krijuar një pozitë të pabarabartë, krahasuar me subjektet e tjerë të rivlerësimit, që kanë pasur rrethana të ngjashme me të. Subjekti kërkon që Kolegji të shqyrtojë nëse mosdhënia e informacionit nga Komisioni është një tregues i procesit të pandershëm, të padrejtë dhe të paragjykuar, dhe të vlerësojë nëse ky mosinformim ndikon në vlefshmërinë dhe drejtësinë e procesit të rivlerësimit të zhvilluar.

26.1. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues fillimisht konstaton se subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri, me funksionin gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i është i nënshtroar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga Komisionerët P. Q., R. I. dhe E. Ç. Relator i çështjes u zgjodh me short Komisioneri R. I. Trupi gjykues konstaton se në njoftimin e procedurës së shortit, të publikuar në faqen zyrtare të Komisionit,⁴⁰ më datë 16.12.2019, rezultojnë të shortuar 120 subjekte rivlerësimi. Në këtë njoftim citohet: “Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ‘Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë’ dhe pas rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, Komisioni, me vendimin nr. 97, datë 06.12.2019, pezulloi shortin e parashikuar në germën ‘a’, të pikës 6, të nenit 3, të rregullores ‘Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit’ dhe vendosi shpërndarjen me short në datën 16.12.2019, të çështjeve të miratuara me vendimin nr. 86, datë 25.11.2019, të Komisionit, sipas pikës 8, të nenit 3, të rregullores ‘Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit’. Lista e subjekteve të shortuar më 16.12.2019, është si më poshtë...”.

26.2. Nga sa më lart, trupi gjykues çmon se, për sa kohë njoftimi mbi procedurën e organizimit të shortit ka qenë publik, në faqen zyrtare të Komisionit, si dhe në të njëjtën ditë janë shortuar 120

³⁹ Neni 470: Ankimi kundër vendimeve të ndërmjetme. Vendimet e ndërmjetme që jepen nga Gjykata e Shkallës së Parë mund të ndryshohen ose të tërhiqen gjatë gjykimit. Këto vendime mund të goditen me ankim së bashku me vendimin përfundimtar. 2. Megjithatë, në rastet e parashikuara shprehimisht në këtë Kod, kundër vendimeve të ndërmjetme mund të bëhet ankimi i veçantë në Gjykatën e Apelit ose rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë, brenda 5 ditëve nga njoftimi i tyre.

⁴⁰ Shih: <https://kpk.al/njoftim-per-shortin-e-dates-16-dhjetor-2019/19/>

subjekte rivlerësimi, nuk vëren elemente që tregojnë paragjykim të procesit apo të ketë pasur ndikim në procesin e tij të rivlerësimit, e për rrjedhojë, e konsideron të pabazuar këtë shkak ankimi.

27. Subjekti pretendon për shkeljen e të drejtës për proces të rregullt ligjor dhe standardin e arsyetueshmërisë së vendimit, pasi Komisioni nuk ka dhënë arsyetim të plotë dhe të qartë në vendim, duke shmangur analizën e provave që favorizojnë subjektin. Sipas subjektit, në vendimin përfundimtar të Komisionit, pjesët më të rëndësishme të prapësimeve të tij në lidhje me kriterin e pasurisë⁴¹ nuk janë as argumentuar, as përmendur fare. Subjekti kërkon që Kolegji të shqyrtojë nëse ky proces është i arsyeshëm dhe nëse është përmbushur kërkesa për argumentimin e prapësimeve në lidhje me kriterin e pasurisë, siç është parashikuar nga Kushtetuta dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në lidhje me kriterin e figurës dhe profesionalizmit, subjekti pretendon se pothuajse të gjitha shpjegimet e tij të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit, në pjesët e tyre thelbësore dhe më të rëndësishme, nuk janë përmendur në vendimin përfundimtar të Komisionit. Për më tepër, ato janë paraqitur të deformuara ose të mangëta dhe nuk është bërë asnjë argumentim i bazuar në ligj për të shpjeguar pse qëndrimet e tij janë të pabazuara. Subjekti kërkon që Kolegji të shqyrtojë nëse kjo është një shkelje e të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe nëse vendimi përfundimtar është i arsyetuar në mënyrë të përshtatshme.

27.1. Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimeve të mësipërme të subjektit të rivlerësimit, mban në konsideratë jurisprudencën⁴² e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, e cila thekson domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Kjo gjykatë ka vlerësuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Ajo arsyeton se vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve, në përfundim të gjyimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Gjykata verifikon nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërcituara.

27.2. Nga analizimi i vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit, trupi gjykues konstaton se ai është arsyetuar në përputhje me standardet e kërkuara nga Gjykata Kushtetuese, në të kanë gjetur pasqyrim pretendimet e subjektit të rivlerësimit, është kryer analiza e provave dhe është shpjeguar bazueshmëria ligjore për shkeljet e konstatuara. Kolegji vëren se mënyra se si trupi gjykues i Komisionit i ka zbardhur në vendim qëndrimet/shpjegimet e subjektit, duket se nuk është një riprodhim literal i deklarimeve të tij. Pavarësisht këtij elementi, trupi gjykues vlerëson se, jo domosdoshmërisht, Komisioni ka për detyrë të kryejë pasqyrime literale të asaj që deklarojnë subjektet, madje ndonjëherë kjo është e pamundur dhe e pakuptimtë, por ajo që është e rëndësishme dhe duhet garantuar, lidhet me moscenimin e vërtetësisë së deklarimeve dhe mosnxjerrjes së tyre jashtë kontekstit, në të cilat ato janë bërë, duke krijuar një imazh të deformuar të këtyre të dhënave.

⁴¹ Prapësimet nuk përfshijnë arsyetimin se babai i tij, pasi ka punuar si shitës ambulant në vitet 2004, 2005 dhe 2006, nuk ishte i detyruar të paguante tatime. Po ashtu, nuk është përmendur as ligjshmëria e depozitës prej 1.000.000 lekësh, në vitin 2008, në emër të bashkëshortes, në Raiffeisen Bank dhe as shpenzimet lidhur me mobilimin.

⁴² Shih vendimet nr. 3, datë 26.01.2015; nr. 63, datë 23.09.2015; nr. 24, datë 25.04.2016 dhe nr. 73, datë 16.12.2016, të Gjykatës Kushtetuese.

Konkretisht, në rastin në analizë, Komisioni, siç edhe vepron përgjithësisht, ka vlerësuar të japë një përmbledhje të informacionit që japin këto shpjegime, si dhe të informacionit që ka rezultuar nga kontrolli që ka kryer vetë Komisioni, për rrjedhojë, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se vendimi është i paarsyetuar.

28. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit, veçanërisht lidhur me kriterin e pasurisë dhe barrën e provës që duhet t'i ngarkohet atij, për "personat e tjerë të lidhur", trupi gjykues sqaron se, megjithëse ky pretendim do të analizohet në mënyrë të detajuar në vlerësimin e kriterit të vlerësimit të pasurisë, proporcionaliteti vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh disa aspekte, si: balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë legjislatori. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëri-tjetrin. Proporcionaliteti është një pjesë e tërësisë së parimeve, nga të cilat udhëhiqen institucionet e rivlerësimit dhe nuk mund të gjejë zbatim si parim i veçantë dhe i vetëm i rivlerësimit.

28.1. Nga analizimi i dokumentacionit, trupi gjykues konstaton se balancat negative dhe situata e subjektit është e tillë që nuk lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues konstaton se Komisioni ka konkluduar për probleme në të tria kriteret e rivlerësimit. Në këtë situatë faktike dhe ligjore, trupi gjykues e vlerëson jorelevant pretendimin e subjektit për shkelje të parimit të proporcionalitetit.

29. Lidhur me pretendimin e subjektit për kalim të barrës së provës tej kufijve ligjorë të parashikuar, trupi gjykues vëren se neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, përcakton se barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal. Komisioni, me kalimin e barrës së provës subjektit të rivlerësimit, lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ, nuk ka cenuar të drejtën e subjektit për t'u mbrojtur, por përkundrazi ka zbatuar me përpikëri procedurën e rivlerësimit kalimtar, sipas parashikimit kushtetues dhe atij ligjor. Megjithatë, këto pretendime të subjektit të rivlerësimit do të analizohen më poshtë në këtë vendim, së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale, që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit.
30. Lidhur me pretendimin e subjektit, se ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminues në krahasim me subjekte të tjerë të rivlerësimit, pasi në raste të ngjashme gjyqtarë dhe prokurorë të tjerë janë trajtuar ndryshe nga Komisioni, duke krijuar një praktikë të pabarabartë në vendimmarrje, trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e konsoliduar tashmë në jurisprudencën e Kolegjit, se standardet e ndryshme të mbajtura nga Komisioni për çështje të ngjashme, nuk mund të adresohen si shkaqe ankimi, për sa kohë që u përkasin trupave gjykues të ndryshëm, të cilët ushtrojnë veprimtarinë si të pavarur nga njëri-tjetri. Gjithashtu, trupi gjykues thekson se, për sa kohë shqyrtimi i ankimit të subjektit do të kryhet në Kolegj, duke u referuar në aktet e çështjes që i përkasin asaj, të administruara gjatë hetimit administrativ në Komision, është e panevojshme dhe e paarsyeshme të kryhen kontrole apo referime mbi elemente të caktuara të vlerësimit të pasurisë apo kritereve të tjera që Komisioni ka bërë në një vendim tjetër të tij.
31. Në përfundim, trupi gjykues konstaton se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për shkelje të të drejtave të tij gjatë zhvillimit të procesit në Komision, janë të pabazuara në prova. Subjektit të rivlerësimit i është garantuar e drejta për një proces të rregullt ligjor (neni 6 i KEDNJ-së), ka gëzuar të gjitha garancitë procedurale që lidhen me mundësinë për të dhënë shpjegime me shkrim dhe me

gojë gjatë procesit të hetimit administrativ, kohën e nevojshme për të paraqitur prova dhe dokumente, si dhe mundësinë për të njohur dosjen e administruar nga Komisioni. Nga aktet në fashikull rezulton se Komisioni, duke e njohur subjektin e rivlerësimit Andri Ymeri me të gjitha faktet kundrejt të cilave analizohej pasuria, si dhe veprimtaria e tij profesionale, i ka dhënë atij mundësinë të ushtrojë të gjitha të drejtat e tij për proces të rregullt. Në konsideratë edhe të jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese⁴³ dhe GjEDNj-së,⁴⁴ lidhur me parimet e procesit të rregullt ligjor, specifikisht për parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, për rëndësinë e veçantë që merr krijimi i mundësive të arsyeshme për të paraqitur provat dhe vlerësimet ligjore të lidhura me çështjen që shqyrtohet, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se pretendimet e subjektit, se Komisioni ka cenuar parimet e procesit të rregullt, nuk qëndrojnë. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se Komisioni ka respektuar garancitë kushtetuese dhe parimet ndërkombëtare të mishëruara nga KEDNj-ja që lidhen me barazinë përpara ligjit, kontradiktorialitetin, mundësinë dhe kohën e nevojshme për t'u mbrojtur, parime që së bashku përbëjnë themelin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

32. Për pasurinë e paluajtshme “apartament në përdorim, me sip. 111 m²”, lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Shkodër, Komisioni ka arritur në përfundimin se: (i) subjekti ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me këtë pasuri; (ii) subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në shumën (-) 3.813.555,33 lekë. Si rrjedhojë, subjekti ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germave “a” dhe “b”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

32.1. ILDKPKI-ja, në konkluzionin e raportit të saj për këtë pasuri, ka konkluduar: *“Deklarim i rremë i vlerës së apartamentit me sipërfaqe banimi 111 m², në lagjen “{***}”, Shkodër, pasi sipas kontratës së sipërmarrjes është 3.936.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes është 3.552.000 lekë, ndërsa sipas EKB-së vetëm kosto e shfrytëzimit është 29.835 lekë/m². Gjithashtu, apartamenti ndodhet në një zonë të lakmueshme në Shkodër, vlera e tregut të të cilit shkon afro 500 euro/m² ose rreth 55.000 euro”.*

32.2. Lidhur me konstatimin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm arsyet e çmimeve të ndryshme në lidhje me këtë apartament, duke e vlerësuar këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij, subjekti i rivlerësimit pretendon se çmimi prej 4.224.000 lekësh që referon Komisioni, ka rezultuar si rrjedhojë e llogaritjes së çmimit bazuar në kontratën e sipërmarrjes datë 10.04.2006. Sipas subjektit, në nenin 1 të kësaj kontrate, gabimisht, noterja ka shënuar si sipërfaqe të apartamentit sipërfaqen 132 m², ndërkohë që sipërfaqja e banimit e apartamentit në fjalë është 123 m², llogaritur me sipërfaqe të përbashkëta dhe 111 m² sipërfaqe funksionale.

32.3. Gjithashtu, për të vërtetuar pretendimet e tij në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit nga babai, subjekti, në përgjigjet e pyetësorit të dytë, ka dorëzuar në Komision disa kontrata noteriale të lidhura nga e njëjta shoqëri sipërmarrëse me blerës të tjerë, për apartamente që ndodhen në të njëjtin pallat ku ndodhet apartamenti i babait të tij. Sipas subjektit, konstatimi jo i drejtë i Komisionit në lidhje me çmimin, rezulton edhe nga të dhënat që disponon EKB-ja, ku kostoja për sipërfaqen e shfrytëzimit në vitin 2006 (kohë e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes), është 29.835 lekë m², vlerë kjo më e ulët se 32.000 lekë m² e blerë nga babai i tij.

⁴³ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 21, datë 16.04.2015; nr. 34, datë 29.05.2015; nr. 37, datë 30.06.2016 etj.

⁴⁴ Shih vendimet e GjEDNj-së, çështjet “Ruiz-Mateos kundër Spanjës”; “McMichael kundër Mbretërisë së Bashkuar”; “Vermeulen kundër Belgjikës”; “Lobo Machado kundër Portugalisë”; “Kress kundër Francës” etj.

32.4. Trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Apartament*⁴⁵ në përdorim, me sip. 111 m², lagjja “{***}”, rr. “{***}”, Shkodër. Çmimi i blerjes 3.936.000 lekë. Pjesa takuese e papërcaktuar. Nga aktet bashkëlidhur rezulton se, me kontratë sipërmarrjeje nr. {***}, datë.10.04.2006, babai i subjektit të rivlerësimit, z. F. Y., ka porositur nga shoqëria “{***}” ShPK⁴⁶ një apartament banimi me sip. 123 m², nga të cilat 111 m² sip. funksionale, ndërsa pjesa tjetër, ambiente të përbashkëta (sip. oborri, shkallësh, ashensori etj.) në vlerën 3.936.000 lekë dhe që është likuiduar tërësisht në kohën e lidhjes së kontratës. Ndërsa, në datën 30.04.2007, është lidhur kontrata e shitblerjes me nr. {***} për këtë apartament, me një vlerë të përcaktuar prej 3.552.000 lekësh, ku deklarohet e likuiduar kjo shumë që në kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes.

32.5. Në lidhje me pasqyrimin e ndryshëm të çmimit të shitblerjes së kësaj pasurie në kontratën e sipërmarrjes dhe atë të shitjes, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se çmimi që është paguar për blerjen e apartamentit, është ai i shprehur në kontratën e sipërmarrjes dhe jo ai i shprehur në kontratën e shitjes, pasi nën dritën e dispozitave të neneve 690 dhe 705 të Kodit Civil, kontrata e shitjes ka forcën e ligjit dhe prezumohet të përmbajë kushtet kontraktore, për të cilat palët kanë rënë dakord me vullnet të lirë.

32.6. Nga sa më lart konstatuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar saktësisht çmimin e blerjes së kësaj pasurie, pasi në deklarin e tij, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ai deklaroi vlerën 3.936.000 lekë, në një kohë që sipas kontratës së shitjes nr. {***}, datë 30.04.2007, çmimi i blerjes është 3.552.000 lekë. Ky fakt merr peshë në raport me konkluzionin e arritur prej Komisionit për këtë pasuri, sipas të cilit ky apartament është konsideruar si pasuri e fshehur e subjektit, por edhe në përfundimin e arritur se subjekti ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

32.7. Sa i përket konkluzionit të Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimet e tij, sipas nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, duke kryer fshehje të pasurisë “apartament me sipërfaqe 111 m²”, subjekti i rivlerësimit i kundërshton ato, duke paraqitur në mënyrë të përmbledhur pretendimet si vijon:

(i) Apartamenti i blerë nga babai në vitin 2008, nuk është në pronësinë e tij, edhe pse ai pretendon të drejta bashkëpronësie mbi këtë apartament. Të drejtat e tij të bashkëpronësisë mbi këtë apartament burojnë nga kontributi i tij financiar, të cilat nuk janë të vetme, pasi kjo pasuri është blerë edhe me të ardhurat e realizuara nga prindërit dhe vëllai, G. Y.

(ii) Në kohën e blerjes së këtij apartamenti, familja e tij e origjinës ishte e pandarë (veç motrës, e cila ishte martuar në shtator të vitit 2004). Në këto kushte, për shkak të ekonomisë së përbashkët dhe traditës për administrimin e të gjitha të ardhurave monetare nga kryefamiljari, që ishte babai i tij, kjo pasuri është regjistruar në emër të babait, pa bërë përcaktimin e pjesëve takuese të secilit kontribues në krijimin e saj.

(iii) Nëse ky apartament do të ishte në pronësinë e tij, nuk do të kishte asnjë pengesë ligjore ta pasqyronte këtë fakt, për sa kohë ka dhënë shpjegime të hollësishme në lidhje me këtë pasuri, duke filluar nga momenti i fitimit të pronësisë nga babai dhe në çdo fazë të dhënies së deklarimeve dhe shpjegimeve përpara ILDKPKI-së.

⁴⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën: (i) Vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. {***}, dt. 23.05.2007, e ZVRPP Shkodër. (ii) Kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 10.04.2006. (iii) Kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 30.04.2007.

⁴⁶ Shoqëria përfaqësohet në nënshkrimin e kontratës nga administrator L. L.

(iv) Gjatë 16 viteve nga momenti i blerjes së kësaj banese, nga ana e tij nuk është kryer asnjë shtesë apo ndërhyrje në këtë pasuri. Fakti që prindërit e tij kanë pasur një apartament tjetër dhe kanë kryer një shtesë kati mbi këtë apartament, në vitin 2008, nuk është një argument i mjaftueshëm për të konkluduar se apartamenti, objekt vlerësimi, është në pronësinë e tij. Subjekti e konsideron të pavërtetë konstatimin e Komisionit se në këtë apartament nuk kanë banuar familjarë të tjerë të tij, pasi në këtë apartament, në periudha të ndryshme kohe, kanë jetuar dhe vijnë të jetojnë prindërit e tij, për shkak të nevojave të tyre si të shkuar në moshë dhe të sëmurë kronikë (në kushtet që apartamenti është më afër institucioneve shëndetësore dhe ka ashensor), si dhe vijnë shpesh për të ndihmuar subjektin në rritjen e fëmijëve të tij.

(v) Fakti që pasuria është përdorur për një periudhë të gjatë, nuk mund të interpretohet si një tregues i pronësisë së saj. Në vlerësimin e kësaj periudhe kohore, sipas subjektit, duhet të merren në konsideratë disa faktorë, si: (i) lidhja e afërt familjare me pronarin e ligjshëm të pasurisë dhe (ii) kontributi i dhënë në krijimin e kësaj pasurie, i cili është më i madh se ai i pjesëtarëve të tjerë të familjes.

32.8. Në funksion të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mori në analizë shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e administruar në Komision, nga i cili rezulton se, në lidhje me këtë apartament, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratimet si më poshtë:

- i. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti, ndër të tjera, ka deklaruar se: *“...pavarësisht se nga ana formale është regjistruar me pronar të vetëm babain, shtetasin F. Y., unë kam të drejta bashkëpronësie, por aktualisht të papërcaktuara në pjesë ideale. Kjo, pasi pasuria në fjalë është krijuar edhe me kontribute të mia, gjatë kohës që kam qenë beqar (përpara lidhjes së martesës), nga bashkimi i kontributeve të përbashkëta të anëtarëve të familjes së origjinës”*.
- ii. Në DIPP 2006, subjekti ka deklaruar se: *Apartamenti në fjalë do të jetë në pronësi të gjithë familjes, pavarësisht se kontrata është lidhur nga kryefamiljari*.
- iii. Në rubrikën “të dhëna konfidenciale” të DIPP 2007, subjekti ka deklaruar: *“Apartament banimi i blerë me kontratën nr. {***}, me sip. 112 m², me vlerë përafërsisht 4.000.000 lekë”*.
- iv. Në DIPP 2008, subjekti ka deklaruar: *“...gjatë vitit 2008 jam martuar dhe pas martesë banoj me bashkëshorten time dhe djalin në apartamentin e banimit, që ndodhet në lagjen “{***}”. Ky apartament banimi është në bashkëpronësinë time me prindërit dhe vëllain tim...”*.
- v. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar si adresë banimi këtë pasuri, në deklaratimet periodike nga viti 2008 e në vijim.
- vi. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar se ka banuar në këtë adresë nga muaji janar i vitit 2008 e në vijim.

32.9. Bazuar në dokumentacionin e administruar, sipas të cilave rezulton se: (i) ky apartament është blerë nga babai i subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës që subjekti ka ushtuar detyrën e gjyqtarit; (ii) prindërit e subjektit kanë pasur një apartament tjetër dhe kanë ndërtuar një shtesë kati mbi këtë apartament, në vitin 2008; (iii) nga analiza financiare e kryer, subjekti dhe prindërit e tij rezultojnë me pamundësi financiare për blerjen e apartamentit; (iv) sjellja si pronar i vetëm i këtij apartamenti nga ana e subjektit, për sa kohë rezulton e provuar se ai e ka përdorur në mënyrë ekskluzive, ka deklaruar të drejta bashkëpronësie dhe kontribut në blerjen e tij; trupi gjykues vlerëson se, megjithëse këto rrethana mund të përbëjnë indicie drejt një dyshimi për një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhej t'i hetonte dhe verifikonte shpjegimet e subjektit për përdorimin e këtij apartamenti, nëpërmjet një hetimi më të thelluar, duke i sqaruar dhe ballafaquar ato me

dokumentacionin përkatës. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit, se subjekti ka kryer fshehje të pasurisë “apartament me sipërfaqe 111 m²”, është i pabazuar në prova.

33. Në lidhje me përfundimin e arritur nga Komisioni, se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në shumën (-) 3.813.555,33 lekë, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, si burim⁴⁷ për krijimin e pasurisë “apartament me sipërfaqe 111 m²”, ka deklaruar kontributet e pagës së tij, si dhe kontributet e familjarëve.

33.1. Në kushtet kur si burim për blerjen e këtij apartamenti, subjekti, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ndër të tjera, ka deklaruar kursimet nga të ardhurat e realizuara nga familja e origjinës, për të cilat Komisioni kishte arritur në përfundimin se, jo vetëm që subjekti nuk ka provuar të ardhurat e vëllait dhe të babait të tij nga aktiviteti tregtar privat, por ka kryer edhe deklarime kontradiktore në lidhje me këto të ardhura, duke vlerësuar të mos i përfshijë në analizë financiare. Për rrjedhojë, subjekti rezultoi me një pamundësi financiare në shumën (-) 602.464,07 lekë për krijimin e kursimeve *cash* në vitin 2005, kursime *cash*, të cilat Komisioni nuk i ka përfshirë në analizën financiare për blerjen e apartamentit në vitin 2006. Trupi gjykues mori në shqyrtim secilin prej tyre konkretisht: (i) kontributet e babait të tij nga fitimet e nxjerra nga ushtrimi i aktivitetit privat, si shitës fruta-perimesh, në vitin 2005; (ii) kontributet e babait të tij nga fitimet e nxjerra nga ushtrimi i aktivitetit privat, si person fizik, në vitin 2006, me objekt “*legalizimin e dokumenteve zyrtare...*”; (iii) kontributet e vëllait të tij, G. Y., nga kursimet e bursës së fituar, në vitin akademik 2004 – 2005.

33.2. Lidhur me të ardhurat e babait, subjekti pretendon se të ardhurat e deklaruara për vitet 2005 dhe 2006 nga puna e babait, si shitës ambulant me pakicë të frutave dhe perimeve, janë rezultat i një aktiviteti të ushtruar kryesisht gjatë festave të fundvitit, me ndihmën e vëllait të tij, F. Y., i cili në atë kohë merrej me tregti me shumicë. Për shkak të natyrës jo të vazhdueshme të kësaj veprimtarie, ai nuk ishte i regjistruar në organet tatimore dhe nuk disponon dokumentacion zyrtar që ta vërtetojë. Megjithatë, për të konfirmuar këtë aktivitet, ka paraqitur deklarata noteriale të tij dhe të bashkëshortes së tij, si dhe dy fotografi që tregojnë mënyrën e ushtrimit të tregtisë ambulante. Subjekti pretendon

⁴⁷ Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar se: “Kjo pasuri e paluajtshme është regjistruar në regjistrat publikë në pronësi të shtetasit F. F. Y., që është babai im dhe aktualisht është në përdorimin tim dhe të familjes time (të krijuar pas martesës time). Mbi këtë pasuri që është në përdorimin tim, pavarësisht se ajo nga ana formale është regjistruar me pronar të vetëm babain tim, shtetasin F. Y., unë kam të drejta bashkëpronësie, por aktualisht të papërcaktuara në pjesë ideale. Pasuria në fjalë është krijuar edhe me kontributet e mia, gjatë kohës që unë kam qenë beqar (përpara lidhjes së martesës), nga bashkimi i kontributeve të përbashkëta të anëtareve të familjes time të origjinës. Me sa mbaj mend, kontributet për krijimin e kësaj pasurie renditen si më poshtë: Kontributet e mia, nga kursimet e pagës që kam marrë gjatë kohës që kam ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës (gjatë viteve 2001 – 2002). Kontributet e mia, nga kursimet e pagës që kam marrë si gjyqtar, nga data kur kam filluar punë, 21.10.2003, deri në datën kur është fituar pasuria, 10.04.2006. Kontributet e motrës time, A. F. Y., nga kursimet e pagës që ajo ka marrë gjatë kohës që ka ndjekur studimet në Shkollën e Magjistraturës (gjatë viteve 2001 – 2002). Kontributet e motrës time, A. F. Y., nga kursimet e pagës që ajo ka marrë si prokurore, nga data kur ka filluar punë, dt. 01.10.2003, deri në datën kur është martuar (rreth vitit 2004). Kontributet e nënës time, E. F. Y., nga kursimet e pagës si mësuese përgjatë viteve, deri në kohën e fitimit të pasurisë. Kontributet e babait tim, F. F. Y., nga kursimet e pensionit si ish- ushtarak, përgjatë viteve, deri në kohën e fitimit të pasurisë. Kontributet e babait tim, F. F. Y., nga fitimet e nxjerra, nga ushtrimi gjatë vitit 2005, të aktivitetit privat tregtar si shitës fruta - perimesh. Kontributet e babait tim, F. F. Y., nga fitimet e nxjerra nga ushtrimi, gjatë vitit 2006, të aktivitetit privat si person fizik, me objekt “*legalizimin e dokumenteve zyrtare dhe ofrimin e shërbimeve parakonsullore, në Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë, ambasadat e huaja dhe institucionet të tjera shtetërore. Kontributet e vëllait tim, G. F. Y., nga kursimet e bursës së fituar si shpërblim për rezultate të shkëlqyera, gjatë kohës që ai, në vitin akademik 2004 - 2005, ka ndjekur studimet në Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit “{***}”, Shkodër. Të ardhura nga produktet e tokës bujqësore në bashkëpronësi të F., E., Andri, A. dhe F. Y., të realizuara gjatë viteve 2005 dhe 2006.*”

se edhe shpjegimet që ka dhënë mbi këtë çështje pranë ILDKPKI-së duhet të merren në konsideratë si pjesë e deklarimeve të pasurisë.

33.3. Sipas subjektit, mungesa e regjistrimit tatimor nuk e bën të paligjshëm aktivitetin, pasi ai është kryer në mënyrë ambulante, pa një vend fiks të ushtrimit të tregtisë. Referuar normave juridike në fuqi, regjistrimi i babait të subjektit si shitës ambulant me pakicë, duhej të ishte kryer nga administrata tatimore. Ky regjistrim do të kishte të njëjtën vlerë ligjore si regjistrimi i kryer nga vetë ai. Subjekti pretendon se nuk e disponon dokumentacionin përkatës për shkak të kohës së kaluar ose mënyrës së organizimit të arkivit dhe kjo nuk mund të ngarkojë me përgjegjësi as babain e tij dhe as vetë subjektin. Në këtë kontekst, subjekti pretendon se duhet të vlerësohet situata në përputhje me nenin 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe të merret në konsideratë fakti se babai i tij e ka ushtruar aktivitetin si shitës ambulant, gjë që provohet sipas tij nga deklaratat dhe deklarimet në DIPP-në e viteve 2005 dhe 2006.

33.4. Subjekti pretendon se të ardhurat e babait të tij, për vitet 2005 dhe 2006, të fituara nga aktiviteti si shitës ambulant, duhet të konsiderohen si burime të ligjshme, në të kundërt, një veprim ndryshe do të binte në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë, si dhe me parimet e objektivitetit dhe të ligjshmërisë. Shkelja e parimit të objektivitetit do të ndodhte për faktin se, edhe nëse supozohet se pagesa e një tarife ka qenë e nevojshme, mosveprimi i babait të tij për pagesën e saj është rezultat i drejtpërdrejtë i mosveprimit të administratës tatimore për regjistrimin e aktivitetit të tij, siç parashikohet nga nenet përkatëse të ligjit nr. 8978, datë 12.12.2002, dhe ligjit nr. 9326, datë 06.12.2004. Gjithashtu, sipas subjektit, parimi i ligjshmërisë do të shkelej, pasi edhe nëse detyrimi tatimor ka ekzistuar në momentin e realizimit të të ardhurave, ky detyrim është shuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 33, të vitit 2017, i cili ka parashikuar fshirjen dhe shuarjen e detyrimeve tatimore.

33.5. Në funksion të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe i analizoi ato në raport me dokumentacionin e administruar, nga i cili rezulton se:

33.5/a. Në DIPP-në e viteve 2003 dhe 2004, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti tregtar i babait si shitës ambulant apo nga legalizimet. Subjekti deklaroi për herë të parë të ardhura në shumën 350.000 lekë nga aktiviteti “tregti me pakicë”, e babait të tij, në DIPP-në e vitit 2005, ku në këtë vit subjekti ka deklaruar edhe kursime *cash* në një shumë të konsiderueshme prej 1.500.000 lekësh. Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti deklaroi shumën 200.000 lekë nga aktiviteti privat *tregti me pakicë*, ambulant, dhe si person fizik, në shumën 300.000 lekë.

33.5/b. Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresë nr. {***}, datë 23.02.2022, informon Komisionin se F. Y. (babai i subjektit), nuk rezulton të ketë ose të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të tij dhe nuk rezulton i punësuar. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për pamundësi objektive të paraqitjes së dokumentacionit justifikues ligjor, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, nga shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve nuk provohet se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet më dhe nuk merret në rrugë tjetër, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit është i pabazuar në ligj.

33.5/c. Për sa i përket detyrimit ligjor të regjistrimit dhe të pagimit të taksës së tregtisë ambulante, për efekt të verifikimit të ligjshmërisë së të ardhurave të babait, trupi gjykues sqaron se fillimisht ligji nr. 7679, datë 03.03.1993, “Për tatimin mbi biznesin e vogël”, parashikonte që personat fizikë që ushtronin veprimtari private të pavarur, me qëllime fitimprurëse në tregti etj., i nënshtroheshin tatimit mbi të ardhurat që realizojnë. Konkretisht, në nenin 4 të këtij ligji përcaktohej se: “Personat fizikë që ushtrojnë veprimtari ambulante e forma të tjera të kësaj natyre, paguajnë tatim vjetor me kuotë fikse”,

sipas veprimtarisë që kanë ushtruar. Ndërsa, në nenin 5 të këtij ligji parashikohej se tatimi vjetor llogaritet dhe caktohet nga organet tatimore të komunave, bashkive e rretheve brenda muajit janar për çdo vit tatimor, mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese të bërë nga tatimpaguesi dhe verifikime të bëra nga punonjësit e organeve tatimore. Nëse subjektet e këtij ligji nuk mbanin dokumentet për të ardhurat e realizuara; nëse nuk paraqisnin deklaratën për të ardhurat e realizuara; nëse nuk derdhnin në afatin e caktuar tatimin mbi të ardhurat, konsiderohej se kishin kryer shkelje, për të cilën parashikohej edhe gjoba përkatëse. Po ashtu, ky detyrim përcaktohej në ligjin nr. 8313, datë 26.3.1998, *“Për tatimin mbi biznesin e vogël”*. Në Udhëzimin nr. 2, datë 11.02.2002, *“Për tatimin mbi biznesin e vogël”*, kategoria “E” e tatimpaguesve përfshinte edhe shitësit ambulantë, të cilët duhet të paguanin një kuotë fikse, në varësi të qytetit në të cilin ushtronin aktivitetin. Subjekte të kuotës fikse ishin ato subjekte që realizonin qarkullim deri në 2.000.000 lekë në vit. Ky ligj, po ashtu, sanksionon edhe përgjegjësinë e tyre për regjistrim.

33.5/ç. Gjithashtu, referuar ligjit nr. 8982, datë 12.12.2002, *“Për sistemin e taksave vendore”*, shitësit ambulantë kishin detyrimin e regjistrimit dhe pagimit të taksës lokale; të pagimit të tatimit vjetor me kuotë fikse në bashkinë që ushtronin aktivitetin [mbështetur në deklaratën vjetore parashikuese për qarkullimin deri në 2 milionë lekë]; si dhe kishin detyrimin e regjistrimit dhe pagimit të taksës vendore 1.000 lekë për tregtinë/shërbimet ambulante. Nga aktet në dosje, nuk provohet se babai i subjektit ka qenë i regjistruar apo nëse ka paguar kuotën fikse të aktivitetit tregtar, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

33.6. Lidhur me burimin tjetër të kursimeve të familjes së origjinës së subjektit, konkretisht të të ardhurave të babait të tij nga fitimet e nxjerra nga ushtrimi i aktivitetit privat si person fizik, në vitin 2006, me objekt *“legalizimin e dokumenteve zyrtare”*, subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e përfituara nga babai për veprimtarinë e legalizimit të dokumenteve parakonsullore në Ministrinë e Jashtme, janë në shumën 300.000 lekë. Këto të ardhura janë të ligjshme⁴⁸ dhe provohen, pasi janë deklaruar që në vitin 2006, si dhe në sqarimet përkatëse të dhëna në ILDKPKI (referuar memos së datës 13.02.2015). Sipas subjektit, ushtrimi i kësaj veprimtarie nga babai provohet edhe nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i vitit 2002, për regjistrimin e tij si person fizik.

33.6/a. Në lidhje me çështjen e tatimeve ose tarifave të aplikueshme mbi këto të ardhura, subjekti pretendon se veprimtaria e tij ka pasur një karakter ndihmës/përgatitor për noterët, në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 8438, *“Për të ardhurat”*, dhe konsiderohet si tatimpagues pa një vend të caktuar biznesi. Në këtë kontekst, për përlllogaritjen e tatimit mbi këto të ardhura duhej të zbatohej Udhëzimi⁴⁹ nr. 5, datë 30.01.2006, *“Për tatimin mbi të ardhurat”*, veçanërisht pikat 4, 4.1 dhe 4.2.

⁴⁸ Kjo veprimtari e ligjshme sipas subjektit ka gjeneruar të ardhura në shumën e përafërt prej 300.000 lekësh, konsistente në transportimin dhe dorëzimin për legalizim të dokumenteve në Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë dhe/ose në ambasadat e huaja në Tiranë. Këto dokumente mund të ishin dërguar edhe me postë ose të legalizoheshin personalisht nga qytetarët në institucionet përkatëse. Megjithatë, përmes këtij shërbimi, babai siguronte një proces më të shpejtë dhe u kursente klientëve kohë dhe shpenzime udhëtimi. Për këtë shërbim, ai përfitonte një shpërblim të caktuar. Sa i përket vendit të ushtrimit të kësaj veprimtarie, babai nuk ka pasur një zyrë të caktuar, por e ka ushtruar aktivitetin nëpërmjet noterëve të qytetit të Shkodrës, të cilët e kontaktonin dhe shërbenin si ndërmjetës mes tij dhe qytetarëve që kërkonin legalizimin e dokumenteve të tyre.

⁴⁹ Në bazë të pikës 2, të nenit 32/1, përjashtohen nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin: a) Ambulantët në fushën e tregtisë, këtu përfshihen tregtarët lëvizës, pra ata që nuk kanë një vend fiks biznesi, por tregtojnë mallra ose produkte artizanale në mjete të thjeshta lëvizëse, si karroca, ose qëndrojnë përkohësisht në vende të caktuara, duke shitur me pakicë produkte artizanale apo të tjera, si gazeta, revista, pije freskuese, akullore, misra, zbukurime artistike etj. Ky grup përfshin tregtarë të vegjël ambulantë që nuk kanë një dyqan apo një vend fiks në tregjet e shitjes me shumicë ose pakicë. b) Personat që merren me transport individual, këtu përfshihen shoferët e taksive, furgonëve, autobusëve, kamionëve, kamionçinave apo triçikleve, të cilët transportojnë pasagjerë ose mallra për nevojat e popullatës. Në këtë kontekst theksohet se pika 4.3, shkronja “b” e Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006, nuk ka karakter taksativ, por indikativ (orientues). Pra, përfshin jo

Subjekti ka përdorur të njëjtin arsyetim si për të ardhurat e fituara nga babai në aktivitetin e tij, si shitës ambulant frutash-perimesh, për sa i përket parimeve të proporcionalitetit,⁵⁰ barazisë, objektivitetit dhe ligjshmërisë, si dhe referon në vendimmarrje të Kolegjit dhe Komisionit.

33.6/b. Me qëllim provueshmërinë e pretendimeve të subjektit në raport me konstatimet e Komisionit, trupi gjykues kontrollon dokumentacionin e administruar për këto të ardhura dhe i rezultoi se:

33.6/c. Me shkresën nr. {***} prot., datë 23.02.2022, QKB-ja, ka informuar Komisionin se babai i subjektit, F. Y., figuron të jetë i regjistruar si person fizik: a) Me vendimin nr. {***}, datë 16.03.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të cilin nuk gjendet NIPT, rezulton se babai i subjektit është regjistruar për të ushtruar aktivitetin privat të Agjencisë së Legalizimeve Parakonsullore, me objekt *“Legalizimin e dokumenteve”*, për të cilat ligji parashikon kryerjen e tij në institucionet shtetërore, përfshirë dokumentet përkatëse në zyrën konsullore në Ministrinë e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe nxjerrjen e dëshmimeve të gjendjes gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë. b) Me vendimin nr. {***}, datë 19.08.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për të cilin nuk gjendet NIPT, rezulton se babai i subjektit është regjistruar për të ushtruar aktivitetin privat të porosisë dhe agjencisë. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e interesave periodike të vitit 2006, ka deklaruar të ardhura të përfituara nga aktiviteti privat i babait afërsisht në shumën 300.000 lekë.

33.6/ç. Lidhur me pagesat e kryera nga babai i subjektit në vitin 2022, gjatë procesit të rivlerësimit, (subjekti, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, ka depozituar⁵¹ disa urdhërpagesa të vitit 2022, për të cilat pretendon të jenë bërë për të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i babait të tij), trupi gjykues konstaton se ato janë pagesa të kryera për të ardhurat individuale të babait të tij, në të cilat nuk përcaktohet se për çfarë xhiroje apo për çfarë aktiviteti janë paguar. Ndërsa, në lidhje me pagesat me vonesë të detyrimeve tatimore, trupi gjykues çmon se në legjitimitimin e të ardhurave të krijuara, duhen konsideruar disa rrethana. Së pari, duhet që të provohet bindshëm vetë ekzistenca e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre dhe, së dyti, duhet të mbahet në konsideratë sjellja e subjektit apo e personave të lidhur dhe e personave të tjerë të lidhur në raport me mospagimin në kohë të tyre. Në rastin e babait të subjektit duket se mospagimi në kohë i detyrimit tatimor nuk duket të ketë qenë pasojë e ndonjë pakujdesie apo paqartësie.

33.6/d. Nga sa analizuar më lart, trupi gjykues vëren se, megjithëse vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër për lejimin e ushtrimit të aktivitetit privat të porosisë dhe agjencisë, mund të shërbejë si indicie për të konfirmuar faktin se babai i subjektit e ka ushtruar këtë veprimtari, duke abstraguuar lidhur me përfitimin e të ardhurave në atë periudhë, trupi gjykues çmon se nuk vërtetohet shuma e të ardhurave të pretenduara dhe ligjshmëria e tyre. Ky konkluzion përforcohet edhe referuar shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve⁵², në të cilën nuk rezulton që z. F. Y. të ketë ose

vetëm shoferët, por çdo person që merret me transport individual të mallrave për nevojat e popullatës. Për rrjedhojë, ky përkufizim përfshin edhe veprimtarinë e ushtruar nga babai, i cili transportonte dokumente për legalizim në Ministrinë e Jashtme apo në ambasadat e huaja në Tiranë.

⁵⁰ Parimi i proporcionalitetit do të cenohej, nëse do të argumentohej se duhej paguar një tarifë, e cila nuk do të ishte më shumë se 4.500 lekë, mospagesa e kësaj tarife nuk mund të sillte si pasojë mosllogaritjen e këtyre të ardhurave për efekt të procesit të rivlerësimit, pasi një masë e tillë nuk do të ishte proporcionale me shkëlqjen e supozuar (edhe duke e marrë të mirëqenë se një mospagesë e tillë ka ndodhur).

⁵¹ Urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale, për harkun kohor janar – dhjetor 2011, të z. F. Y., i cili në datën 17.05.2022, ka paguar shumën 109.150 lekë për të ardhura në vlerën 319.750 lekë; urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale, për harkun kohor janar – dhjetor 2011, të z. F. Y., i cili, në datën 19.05.2022, ka paguar shumën 105.400 lekë për të ardhura në vlerën 319.800 lekë; urdhërpagesë për tatimin mbi të ardhurat individuale, për harkun kohor janar – dhjetor 2011, të z. F. Y., i cili, në datën 20.05.2022, ka paguar shumën 104.793 lekë për të ardhura në vlerën 210.193 lekë.

⁵² Me shkresën nr. {***} prot., datë 23.02.2022, drejtuar Komisionit.

të ketë pasur aktivitet tregtar të regjistruar në emër të tij dhe nuk rezulton i punësuar, si edhe faktit se subjekti nuk ka provuar që babai i tij ka qenë i regjistruar në organet tatimore për ushtrimin e aktivitetit tregtar si person fizik, me objekt *“Legalizimin e dokumenteve zyrtare dhe ofrimin e shërbimeve parakonsullore në Ministrinë e Jashtme, Ministrinë e Drejtësisë, ambasadat e huaja dhe institucionet të tjera shtetërore”*. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit, që nuk i ka konsideruar këto të ardhura si të ligjshme dhe si të tilla nuk i ka përfshirë në analizën financiare, është i bazuar.

33.7. Trupi gjykues e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit, *se mospërfshirja e të ardhurave të babait të tij nga aktiviteti privat, cenon parimin e proporcionalitetit, parimin e barazisë, si dhe parimin e objektivitetit dhe ligjshmërisë*, pasi në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

33.8. Lidhur me pretendimin subjektit të rivlerësimit, se ndodhet në pamundësi objektive për të provuar të ardhurat e babait të tij, trupi gjykues vëren se, nëpërmjet aplikimit të parashikimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti synon të legjitimojë të gjithë të ardhurat e përfituara nga babai i tij prej një aktiviteti që duhej t’i nënshtrohej regjimit tatimor në fuqi, ndërsa ky fakt nuk provohet se ka ndodhur, sepse babai i subjektit ka zgjedhur të mosregjistrohet në organet tatimore dhe as të kujdeset për të ruajtur dokumentacionin provues të pagesës së detyrimeve tatimore. Në përfundim të analizës së bërë më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, për provimin e pagimit të detyrimeve tatimore dhe se ai nuk mund të zhvishet nga përgjegjësia/barra e provës që ka në funksion të këtij procesi, për të provuar përfitimin dhe pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruar prej babait të tij, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë.

33.9. Për sa i përket të ardhurave të vëllait, G. Y., subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat e tij, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2006, përbëhen nga tri burime kryesore: a) Të ardhura të siguruara nga Universiteti “{***}”, ku në gjysmën e parë të vitit 2006, G. Y. ka përfutur bursë studentore, pasi në vitin akademik 2004 – 2005 ka dalë me rezultate të shkëlqyera në studime. Si shpërblim, në përputhje me rregulloren e universitetit, atij i është akorduar kjo bursë. b) Të ardhura të siguruara si asistent avokat në Dhomën e Avokatisë Shkodër, gjatë periudhës shtator 2006 – dhjetor 2006. c) Të ardhura të siguruara nga puna e tij pranë xhaxhait, shtetasit F. Y., gjatë periudhës qershor 2006 – gusht 2006. Për të vërtetuar këto të ardhura, subjekti i referohet deklaratës noteriale, të depozituar në ILDKPKI, e hartuar nga G. Y., së bashku me prindërit e tij. Sipas subjektit, vërtetësia e këtyre të ardhurave mbështetet edhe në shpjegimin plotësues të dhënë në ILDKPKI-ja përmes memos së datës 13.02.2015.

33.10. Trupi gjykues konstaton se, për të provuar të ardhurat nga bursa e vëllait, subjekti ka paraqitur vërtetim nga Universiteti i Shkodrës “{***}”, dhe këto të ardhura janë përfshirë në analizën financiare të kryer në Komision⁵³. Ndërsa, lidhur me të ardhurat e pretenduara të përfituara si shitës ambulant apo si asistent avokat i vëllait të tij, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk i ka deklaruar si burim në deklaratën *vetting*, si dhe nuk ka depozituar dokumentacion justifikues ligjor për: (a) ekzistencën e punësimit të vëllait të tij; (b) përfitimin e këtyre të ardhurave; (c) për pagimin e detyrimeve tatimore. Vetëm deklarimi i shumës së përfutur në DIPP-në e vitit 2006 dhe deklarata noteriale e datës

⁵³ Komisioni ka vendosur të përfshijë vetëm të ardhurat nga bursa në vitin 2005, në vlerën 19.500.00 lekë dhe në vitin 2006, në vlerën 39.000.00 lekë.

16.02.2015, e prindërve dhe e vëllait të tij, janë të pamjaftueshme për t'i legjitimuar këto të ardhura si të ligjshme, për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen e tyre në analizën financiare.

33.11. Lidhur me burimin tjetër të krijimit të pasurisë “apartament me sipërfaqe 111 m²”, ndodhur në Shkodër, huamarrja nga shtetasi Xh. Th., në vlerën 1.500.000 lekë, Komisioni ka arritur në përfundimin se mosdeklarimi i huas në deklaratën *vetting*, i shoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme, referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegji,⁵⁴ passjellin që deklarimi i subjektit të jetë jo i plotë dhe i saktë, për pasojë, të bjerë ndesh me përcaktimet e pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, huaja në shumën 1.500.000 lekë nuk është përfshirë në analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti.

33.11/a. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e mësipërm të Komisionit, duke pretenduar se burimi i ligjshëm i të ardhurave që Xh. Th. (bashkëshorti i hallës), i ka dhënë hua babait të tij burojnë nga: a) ushtrimi i aktivitetit tregtar për periudhën 1992 – 2014; b) shitja e tokës së fituar në bazë të ligjit nr. 7501, i vitit 1991, dhe shfrytëzimi bujqësor i tokës. Subjekti pretendon se huadhënësi Xh. Th., vetëm nga shitja e tokave ka arkëtuar në periudhën 1999 – 2003 shumën prej rreth 4.000.000 lekësh, që konsiderohet e ardhur e ligjshme, sipas ligjit nr. 84/2016, pasi në lidhje me këto veprime shitblerjeje janë paguar detyrimet tatimore dhe rezultojnë të regjistruara në regjistra publikë si veprime të ligjshme.

33.11/b. Subjekti pretendon se Komisioni, në mënyrë të padrejtë, e barazon huadhënësin Xh. Th. me vetë subjektin e rivlerësimit, qëndrim i cili del jashtë qëllimit të ligjit nr. 84/2016, për cilësimin që i bëhet “personit tjetër të lidhur”. Sipas subjektit, detyra e tij në lidhje me huan e dhënë babait nga personi tjetër i lidhur Xh. Th. është të provojë ligjshmërinë e krijimit të shumës së dhënë hua dhe jo të provojë mundësinë e krijimit të çdo pasurie nga ky shtetas gjatë jetesës së tij. Subjekti pranon se ka bërë një deklaram të pasaktë mbi burimet e krijimit të apartamentit, duke mos përfshirë disa hua të marra nga babai i tij, por megjithatë, pretendon se këto burime janë deklaruar më parë dhe janë të provuara me dokumente noteriale.

33.12. Trupit gjykues, nga kontrolli i dokumentacionit lidhur me këtë shkak ankimi, i rezulton se: me kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2006, shtetasi Xh. Th. i ka dhënë hua z. F. Y. (babait të subjektit) shumën prej 1.500.000 lekësh, me afat shlyerjeje 3-vjet. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar marrjen e kësaj huaje.

33.12/a. Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *Gjatë vitit 2006 janë shtuar të ardhura në para, duke arritur shumën e përgjithshme 3.300.000 lekë (në anë është shënim: kjo është e përbashkët). Subjekti ka shpjeguar se këtyre parave iu është shtuar një shumë prej 700.000 lekë, të cilat janë përdorur për të lidhur një kontratë sipërmarrjeje për ndërtimin dhe fitimin e pronësisë mbi një apartament banimi të papërfunduar.* Në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të kësaj deklarate, subjekti ka deklaruar: *“Marrë borxh Xh. Th. 1.500.000 lekë, nga kryefamiljari. Detyrimi është marrë me qëllim blerjen e apartamentit. Afati i shlyerjes është 5 vjet. Shlyerja e detyrimit deri në 31 dhjetor 2006 është në shumën prej 800.000 lekë dhe detyrimi i mbetur prej 700.000 lekë.*

⁵⁴ Shihni vendimet nr. 28/2020, nr. 24/2021, nr. 25/2021, nr. 37/2021, nr. 20/2022 dhe nr. 29/2022, të Kolegjit.

33.12/b. Në lidhje me burimin e krijimit të apartamentit, në procesverbalin e datës 16.10.2009,⁵⁵ të mbajtur me inspektorët e ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar të njëjtin burim, duke specifikuar si më poshtë: *Gjendja prej 1.500.000 lekë, e deklaruar në vitin 2007, është gjendja përfundimtare, mbasi gjendja cash e deklaruar më parë, në shumën 3.300.000 lekë, është përdorur për blerjen e apartamentit të banimit në shumën e deklaruar 4.000.000 lekë. Në lidhje me huan e marrë, z. Th. deklaroi se ajo ka qenë në shumën 1.500.000 lekë dhe është shlyer totalisht sipas deklaramëve të dhëna.*

33.12/c. Për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme të huadhënësit Xh. Th., gjatë hetimit, si dhe pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin⁵⁶ e mbledhur për këtë qëllim: Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. {***}, sipas së cilit z. Xh. Th. ka përfituar 9000 m² sipërfaqe tokë bujqësore, nga të cilat 8700 m² arë dhe 300 m² truall; Certifikatë për vërtetim pronësie për pasurinë nr. {***}, ZK {***}, me sipërfaqe 1500 m² në emër të z. Xh. Th.; Kontratë shitblerje nr. {***}, datë 20.10.2014; Certifikatë regjistrimi në organin tatimor; Ekstrakt i personit fizik L. Th., regjistruar në vitin 2014; Kontratë huaje me nr. {***}, datë 24.04.2006, nëpërmjet së cilës babai i subjektit i ka marrë hua z. Xh. Th. shumën 1.500.000 lekë, për një afat 3-vjeçar. Deklaratë e Xh. dhe L. Th., e datës 28.01.2022.

33.12/ç. Lidhur me pretendimin e subjektit për mënyrën e kryerjes së analizës financiare nga Komisioni, referuar huadhënësit Xh. Th., trupi gjykues konstaton se Komisioni e ka kryer këtë analizë pa marrë në konsideratë: (i) përbërjen e plotë familjare (familja Th. ka pasur tre fëmijë në përbërjen e saj familjare në momentin e dhënies së huas); (ii) shpenzimet e mundshme në investime të kryera; dhe (iii) huadhënie të tjera të mundshme apo shpenzimet nga sistemi TIMS. Në këtë analizë, referuar edhe kërkesave të subjektit, janë përfshirë vetëm shpenzimet jetike për dy persona dhe likuiditetet në bankë. Pra, Komisioni nuk e ka barazuar familjen Th. me subjektin e rivlerësimit, si dhe nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për llogaritë bankare të familjes Th. apo për blerjen e automjetit, madje kjo analizë financiare është në përputhje edhe me vendimet e mëparshme të Kolegjit⁵⁷, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

33.12/d. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit mbi origjinën e shumës së dhënë hua, nga z. Xh. Th., duke iu referuar shumës 4.000.000 lekë, të përfituar nga shitja e një toke, pasi referuar dokumentacionit provues, me kontratë shitblerje datë 11.12.2000 rezulton se Xh. Th. dhe z. F. Th. kanë shitur pasurinë “tokë arë” prej 4.000 m² në {***}, Shkodër, në vlerën

⁵⁵ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 14.07.2022, të ILDKPKI-së.

⁵⁶ Certifikata e regjistrimit në organin tatimor, me numër serie {***}, nga e cila rezulton se bashkëshorti i hallës, Xh. C. Th., me vendimin e gjykatës me numër {***}, datë 01.03.2000, është regjistruar në Degën e Tatim-Taksave të Rrethit Shkodër si “Biznes i vogël”, me Kod fiskal {***}, me adresë “{***}”, Komuna Rrethina, Shkodër; Shkresë e DRT-së Shkodër (vërtetimit me numër {***} prot., datë 22.05.2014), nga e cila rezulton se subjekti “Biznes i vogël”, në emër të Xh. Th., me NIPT: {***}, me adresë “{***}”, Shkodër, ka kaluar në status “pasiv” më datën 21.05.2014; Shkresa e DRT-së Shkodër, me numër prot. {***}, datë 14.10.2021, drejtuar shtetasit Xh. Th., nga e cila rezulton kjo përgjigje: “Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. {***}, dt. 14.10.2021 dhe certifikatës së regjistrimit në organin tatimor, me numër serial {***}, konfirmojmë se subjekti Xh. Th. është i regjistruar me vendim gjykate nr. {***}, datë 02.03.2000, me Kod fiskal {***} dhe me aktivitet “Autodyqan”. Sistemi tatimor elektronik (SIT) ka hyrë në zbatim në vitin 2005 për regjistrimin e deklaratave tatimore. Nga të dhënat aktuale të sistemit C@ts të DRT-së Shkodër rezulton tatimpaguesi Xh. Th., me NIPT: {***} dhe aktivitet “Transporti rrugor i mallrave”, i cili është me status pasiv që nga data 21.05.2014. Bashkëngjitur Certifikata e regjistrimit në organin tatimor, me numër serial {***} dhe situata e printuar nga C@ts dhe dokumentacioni i mjetit furgon, në pronësitë bashkëshortit të hallës, dhe konkretisht mjetit me targë: {***}, blerë më datë 21.02.2000, në vlerën 1.500.000 lekë, “Autodyqan”, që përbën edhe vendin në të cilin ai ka deklaruar për ushtrim të aktivitetit të tij në organet tatimore.

⁵⁷ Vendimet nr. 20/2019 (JR) dhe nr. 15/2019 (JR); nr. 36/2022, të Kolegjit.

1.800.000 lekë. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se shtetasi Xh. Th. e ka shitur tokën e tij në shumën 4.000.000 lekë, *pasi çmimi nuk është paguar tërësisht nga blerësi në kohën e lidhjes së kësaj kontrate, por është paguar vetëm vlera 1.800.000 lekë, pjesa tjetër prej 1.000.000 lekësh ia ka dhënë, gjithmonë sipas deklarimeve të bashkëshortit të hallës së subjektit, rreth viteve 2003 – 2004, por ai nuk e mban mend me saktësi, mbeti në nivel deklarativ dhe i pambështetur në prova.*

33.12/dh. Trupi gjykues e konsideron të pabazuar edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, për vitet 1992 – 1997, është në pamundësi objektive për gjetjen e dokumentacionit provues për të ardhurat e huadhënësit Xh. Th., për shkak të trazirave të vitit 1997, pasi nuk përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ⁵⁸, nga ku rezulton se shtetasi Xh. Th. është regjistruar në vitin 2000 për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

Nga dokumentacioni i administruar në dosje nuk gjendet ndonjë e dhënë për të ardhurat e ligjshme të përfituara nga shtetasi Xh. dhe L. Th., nga aktiviteti i tij tregtar. Për këto të dhëna nuk rezulton dokumentacion që të vërtetojë xhiron dhe fitimin nga ky aktivitet.

Mungesa e të dhënave nuk mund të konsiderohet si një situatë e parashikuar nga neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë DRT-ja nuk përcakton ndonjë nga situatat që shkaktojnë pamundësi objektive për të evidentuar pagesat e detyrimeve tatimore. Rrjedhimisht, edhe për shkak të kësaj analize, krahas asaj që lidhet me dijeninë/ndërgjegjësimin për mospagimin e detyrimeve tatimore, subjekti gjendet në kushtet kur nuk arriti të vërtetojë se dokumentacioni provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave objekt vlerësimi është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër.

33.12/e. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se huadhënësit Xh. Th. dhe F. Y. nuk janë persona të lidhur, trupi gjykues çmon se ky pretendim i tij nuk qëndron, pasi mbështetur në deklaratimet e vetë subjektit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ai ka pranuar që ka dhënë kontributin e tij financiar për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë “apartament” dhe, për rrjedhojë, edhe të burimit të ligjshëm të huave të marra nga babai i tij⁵⁹. Trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht se huat janë marrë nga babai i tij dhe kanë shërbyer për blerjen e apartamentit, subjekti është i lidhur me këto marrëdhënie huaje, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dhe këto hua do t’i nënshtrohen verifikimit të ligjshmërisë dhe mjaftueshmërisë së burimeve të krijimit të tyre, në kuadër të analizës financiare për mundësinë e krijimit të tyre. Për më tepër, Komisioni ka ngritur dyshime për fshehje të kësaj pasurie (apartament), për rrjedhojë, subjekti duhet të provonte me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave, jo vetëm të familjes së tij, por edhe të huadhënësve, të pretenduar si burim për blerjen e këtij apartamenti.

33.12/ë. Në kushtet kur kjo hua është pretenduar si burim krijimi për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi dhe, sikurse konstatohet, pagesa për likuidimin e çmimit të apartamentit është kryer në datën 10.04.2006, subjekti nuk arriti të provojë që huaja në shumën 1.500.000 lekë është marrë përpara datës 24.04.2006 (dita kur është nënshkruar kontrata e huas), për më tepër, në deklaratën

⁵⁸ Shkresa e DRT-së Shkodër, me numër prot. {***}, datë 14.10.2021, drejtuar shtetasi Xh. Th., nga e cila rezulton kjo përgjigje: “Në përgjigje të kërkesës tuaj nr. {***}, dt. 14.10.2021 dhe certifikatës së regjistrimit në organin tatimor, me numër serial {***}, konfirmojmë se subjekti Xh. Th. është i regjistruar me vendim gjykate nr. {***}, datë 02.03.2000...”.

⁵⁹ Këtë qëndrim, Kolegji ka mbajtur edhe në vendimin nr. 22/2020 të tij, i cili në pikën 30 të tij, ndër të tjera, citon se: “Subjekti ka pasur detyrimin ligjor të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie dhe të pasurive të tjera të krijuara nga shitja e saj, si pasuri të krijuara edhe me kontributin e tij”.

noteriale nuk përcaktohet qëllimi i përdorimit të huas, kjo hua nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit mbeten në nivel deklarativ.

33.12/f. Trupi gjykues kontrollon analizën financiare të kryer në Komision për shtetasin Xh. Th., bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, duke marrë në konsideratë të gjitha të ardhurat, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore dhe rezultoi se z. Xh. Th. nuk kishte mundësi ekonomike të përballonte shpenzimet jetike dhe të krijonte një gjendje kursimesh të mjaftueshme të ligjshme në vlerën e huas të dhënë babait të subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se Komisioni i rezultoi se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për kthimin e huas z. Xh. Th., për vitin 2006, në vlerën (-) 170.285,15 lekë dhe për vitin 2007, në vlerën (-) 1.462.702,17 lekë, në kuptim të nenit 33/5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Me qëllim mosrëndimin dy herë të situatës financiare të subjektit, Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare kthimin e kësaj huaje, për sa kohë në këtë analizë nuk është përfshirë as marrja e huas nga z. Xh. Th., në shumën 1.500.000 lekë.

33.13. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se si burim krijimi për pasurinë “apartament” ka shërbyer edhe huaja e marrë nga F. Y., në vitin 2006, në shumën prej 2.000.000 (dy milionë) lekë, Komisioni ka vlerësuar se mosdeklarimi i huas në deklaratën *vetting*, si dhe shpjegimet kontradiktore të subjektit, bëjnë që deklarimi i këtij të fundit të jetë jo i plotë dhe i saktë, për pasojë, vlerësoi të mos e marrë në konsideratë huan në shumën 2.000.000 lekë në analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti.

33.13/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdeklarimi i kësaj huaje në deklaratën *vetting* ka qenë i paqëllimshëm, nisur edhe nga ngarkesa emocionale dhe presioni që ka perceptuar në kohën e përpilimit të deklaratës *vetting*, pasi është fakt i njohur botërisht, madje edhe juridikisht (shih opinionin e Komisionit të Venecias për *vettingun*), që procesi i rivlerësimit, që fillon me përgatitjen dhe dorëzimin e deklaratës *vetting*, përbën një ngjarje të jashtëzakonshme. Sipas subjektit, borxhi i marrë nga F. Y. nuk është deklaruar në DIPP-në 2006, sepse ky borxh është marrë dhe është shlyer brenda vitit. Sipas subjektit, duke qenë detyrim i lindur dhe i shuar brenda të njëjtit vit ushtrimor të mbuluar nga kjo DIPP, në atë kohë ka vlerësuar se nuk duhej deklaruar. Huat janë marrë nga babai i tij disa ditë më parë, por në datën 24.04.2006 janë hartuar deklaratat noteriale, me qëllimin blerje apartamenti. Subjekti ka kërkuar që të merren në konsideratë raste të ngjashme në Komision,⁶⁰ si dhe në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit⁶¹.

33.13/b. Trupi gjykues, me qëllim shqyrtimin e këtij shkaku ankimi, që lidhet me një burim tjetër krijimi të kësaj pasurie (huan e marrë nga F. Y., në vitin 2006), nga analizimi i dokumentacionit të administruar në Komision, i rezultoi se: me kontratë huaje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.04.2006, z. F. Y. i ka dhënë z. F. Y. (babait të subjektit) një shumë të hollash prej 2.000.000 lekësh, me afat shlyerjeje 5 (pesë) vjet.

33.13/c. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* si burim për blerjen e këtij apartamenti huan e marrë nga z. F. Y. Subjekti nuk rezultoi që huan në shumën 2.000.000 lekë ta ketë deklaruar si burim në momentin e blerjes së apartamentit në DIPP-në e vitit 2006, madje as kur është pyetur nga inspektorët e ILDKPKI-së, në vitin 2009. Kjo hua është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në memon e datës 13.02.2015,⁶²

⁶⁰ Subjekti ka cituar vendimet e Komisionit nr. 46/2018, nr. 444/2021, nr. 445/2021, nr. 49/2018, nr. 327/2020 dhe nr. 536/2022.

⁶¹ Subjekti ka cituar vendimet e Kolegjit nr. 37/2021 dhe nr. 9/2020.

⁶² Shih shkresë nr. {***} prot., datë 14.07.2022, të ILDKPKI-së.

drejtuar ILDKPKI-së, vetëm pasi është njohur me rezultatin negativ për vitin 2006, në vlerën 1.537.040 lekë,⁶³ nga ana e Inspektorëve të këtij institucioni, duke deklaruar se: *Babai i tij për blerjen e apartamentit të banimit me sipërfaqe 112 m², në vitin 2006, ka marrë borxh shumë 1.500.000 lekë dhe nuk është i sigurt, por i duket se për blerjen e apartamentit, babai i ka marrë një hua dhe vëllait, F. Y., por nuk e di nëse është shlyer brenda vitit apo jo. Nëse po, kjo hua nuk është deklaruar.*

33.13/ç. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se, kur pasaktësitë në deklaratimet periodike janë të pashoqëruara me mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive, ato nuk mund të konsiderohen si shkaqe që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit në kuadër të këtij procesi, trupi gjykues vlerëson se në rastin e subjektit të rivlerësimit nuk jemi në këto kushte, pasi ai jo vetëm që nuk ka provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit, por ka qenë kontradiktor në deklaratimet e tij periodike, të cilat përbëjnë provë, bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, në lidhje me pretendimin e subjektit se kontrata e huas vërtetohet me aktin noterial të datës 24.04.2006, trupi gjykues vlerëson se lidhja e kësaj kontrate, jo detyrimisht provon që shumat e marra hua nga babai i tij janë përdorur për blerjen e këtij apartamenti, për më tepër kur rezulton se ato janë marrë në një kohë më të vonë se pagesa e kryer për këtë apartament. Sipas kontratës së sipërmarrjes, lidhur më datë 10.04.2008, për prenotimin e apartamentit objekt vlerësimi, në pikën 3 të saj citohet se: *“Pagesa për vlerën e apartamentit u likuidua totalisht në momentin e kësaj kontrate (cash)”*, pra më datë 10.04.2006, ndërsa kontrata e huas mban datën 24.04.2006.

33.13/d. Për sa i përket kërkesës së subjektit për thirrjen në cilësinë e dëshmitarit të disa shtetasve, trupi gjykues konstaton se të gjithë këta individë janë shprehur nëpërmjet deklaratës së datës 28.01.2022, të depozituar nga subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sipas së cilës shtetasit F. Y. dhe S. Y. deklarojnë se shumata e dhënë hua, prej 2.000.000 lekësh, shtetasit F. Y., me qëllim blerjen e apartamentit, u është kthyer atyre brenda vitit 2006, si dhe kanë shpjeguar burimin e shumës së dhënë hua në vitin 2006. Për rrjedhojë, vlerësohet se dëgjimi i tyre nuk do të paraqiste asnjë të dhënë të re për procesin e rivlerësimit. Kjo kërkesë e subjektit, sikundër edhe kërkesat e tjera të tij në lidhje me kryerjen e hetimit, vlerësohen nga trupi gjykues se janë bërë me qëllim zvarritjen e procesit të rivlerësimit të subjektit. Për këtë arsye, bazuar në nenin 49, pika 6, gerrat “a” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, me të drejtë, ka vendosur të mos e pranojë këtë kërkesë të subjektit.

33.13/dh. Lidhur me referimin e subjektit në vendimmarrje të tjera të Komisionit, kur i ka marrë në konsideratë në analizë huat e padeklaruara në deklaratën *vetting*, trupi gjykues thekson se çdo vendimmarrje merret në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e situatës faktike dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjerë të rivlerësimit. Vendimet e Komisionit, të cilat përmenden nga subjekti i rivlerësimit, nuk përbëjnë provë të fakteve relevante që lidhen me deklarin e huas nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe, si të tilla, çmohen pa efekt në zgjidhjen e kësaj çështjeje.

33.13/e. Në konsideratë të fakteve të sipërcituara, në mbështetje edhe në jurisprudencën e Kolegjit⁶⁴, duke theksuar se për qartësimin e situatës faktike për këtë hua, saktësia dhe konsistenca e deklarimeve mbetet e rëndësishme dhe është përgjegjësi e subjektit përkundrejt ndryshimit të deklarimeve, që krijojnë dyshim të arsyeshëm se kanë ndodhur në funksion të përmirësimit të situatës financiare, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për moskonsiderimin e huas, në shumën 2.000.000 lekë, si burim për blerjen e këtij apartamenti.

⁶³ *Procesverbal datë 27.01.2015.*

⁶⁴ *Shihni vendimet nr. 16/2022, nr. 22/2022 dhe nr. 25/2022.*

33.14. Trupi gjykues konstaton se në analizën financiare të kryer, Komisioni, pavarësisht se nuk ka përfshirë si burim për blerjen e apartamentit shumë 2.000.000 lekë, marrë hua nga z. F. Y., me qëllim kryerjen e një procesi të plotë rivlerësimi për subjektin, ka analizuar dhe mundësinë e z. F. Y. për dhënien e kësaj huaje, si dhe mundësinë e subjektit për kthimin e saj.

33.14/a. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me të ardhurat e huadhënësit F. Y., ka rezultuar se: (i) Nga ana e bankave të nivelit të dytë konfirmohen llogari bankare në emër të huadhënësit, të cilat janë përfshirë në analizën e mundësisë për kursim nga Komisioni për dhënien e huas në shumë 1.500.000 lekë, sipas gjendjes së tyre në datën e dhënies së huas. (ii) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon se: F. Y. rezulton administratori i subjektit tatimpagues “{***}” me Nuis {***}, me objekt veprimtarie “Tregti me shumicë jo e specializuar e artikujve ushqimorë”, i regjistruar në datën 01.07.1994 dhe aktualisht me status pasiv, nga data 02.03.2001; Shtetasja S. Y. nuk ka leje ushtrimi profesioni privat dhe nuk rezulton e punësuar ose në marrëdhënie pune në sektorin privat ose publik. (iii) Qendra Kombëtare e Biznesit konfirmon regjistrimin e subjektit “{***}” SHPK, me NUIS {***} dhe informon se ky subjekt nuk ka kryer plotësimin e të dhënave në regjistrë. (iv) DPSHTRR-ja informon se nuk identifikohen automjete të regjistruara në emër të shtetasve Fahri e S. Y. (v) ASHK-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 08.08.2022, informon se z. F. Y. është aplikues për legalizimin e banesës me nr. aplikimi 94, viti 2006. Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur shkresës konstatohet se z. F. Y. është pajisur me leje legalizimi për objektin *godinë banimi 1 kat, me sipërfaqe 98.8 m²*.

33.14/b. Lidhur me burimet e ligjshme që i kanë shërbyer xhaxhait të tij, F. Y., për t'i dhënë babait, huan e lartpërmendur, subjekti pretendon se F. Y. e ka përfituar nga shitja e pasurisë truall + ndërtesë nga i ndjeri F. Y.⁶⁵. Dhënia e kësaj shume F. Y. ka qenë rrjedhojë e investimeve dhe e kontributeve të tij për mirëmbajtjen e banesës dhe kujdesin ndaj prindërve. Sipas subjektit, në kohën e realizimit të këtij veprimi, as F. Y. dhe as i ndjeri F. Y. nuk kanë mbajtur akt të shkruar, për shkak të marrëdhënieve familjare. Megjithatë, për të vërtetuar dhënien e kësaj shume F. Y., subjekti ka paraqitur⁶⁶ disa akte gjatë procesit të rivlerësimit, të cilat nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni.

33.14/c. Lidhur me pretendimin e subjektit se është në kushtet e pamundësisë objektive, në kuptim të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016, për shkak se dokumentacioni që provon ushtrimin e aktivitetit të xhaxhait të tij është asgjësuar apo ka humbur për faj të institucioneve shtetërore, trupi gjykues vlerëson se ai nuk qëndron, pasi organet tatimore kanë konfirmuar faktin se xhaxhai i tij ka qenë i regjistruar dhe se ai është me status “pasiv” që në vitin 2001. Pra, nga ana e këtyre organeve nuk është deklaruar se dokumentacioni është asgjësuar apo ka humbur. Dokumentacioni në lidhje me të dhënat

⁶⁵ Subjekti sqaron se F. Y. dhe F. Y. kanë jetuar në dy banesa të ndodhura në qendër të qytetit të Shkodrës, pranë vendit të quajtur “{***}”. Këto dy banesa kanë qenë pjesë përbërëse të një pasurie të paluajtshme truall + ndërtesë, e cila, për shkak të marrëdhënieve familjare, ishte e regjistruar në pronësi vetëm në emër të të ndjerit F. Y. Kjo pasuri truall + ndërtesë është shitur⁶⁵ te blerësi “{***}”, kundrejt shumë prej 47.000 (dyzet e shtatë mijë) USD. Nga kjo shumë, i ndjeri F. Y. ka përfituar 1.500.000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, me të cilat ka blerë⁶⁵ një apartament banimi në qytetin e Shkodrës, për vlerën 1.310.000 (një milion e treqind e dhjetë mijë) lekë. Pjesën tjetër të shumë prej 47.000 USD e ka përfituar F. Y., i cili e ka ruajtur si kursim familjar.

⁶⁶ Deklarata, datë 28.01.2022, të shtetasve F., E., F., S., S. Y. dhe Xh. dhe L. Th.; Deklaratë noteriale nr. {***}, datë 16.02.2015, e G., F. dhe E. Y.; Deklaratë e F. dhe E. Y., e datës 28.01.2022; Deklaratë e Xh. dhe L. Th., e datës 28.01.2022; Kthim përgjigje e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. {***} prot., datë 28.01.2022; Akt shitblerje pasurie të paluajtshme nr. {***}, datë 06.11.2001, me palë shitëse F. Y. dhe palë blerëse N. I., me objekt shitjen e pasurisë “apartament”, në vlerën 1.000.000 lekë; Vërtetim pronësie, datë 29.05.1996, në emër të z. F. Y.; Akt shitblerje pasurie të paluajtshme nr. {***}, datë 15.03.1996, me palë shitëse F. Y. dhe palë blerëse “{***}”, me objekt shitjen e pronës “shtëpi banimi”, në vlerën 47.000 dollarë amerikanë.

tatimore të lëshuara nga institucionet shtetërore, bazuar në legjislacionin për arkivat, nuk asgjësohet, por arkivohet.

33.14/ç. Në lidhje me pretendimin e subjektit se shuma e përfituar nga shitja e banesës, prej 47.000 USD, nga z. F. Y., e cila, përveç vlerës 1.500.000 lekë, i ka kaluar xhaxhait të tij, F. Y., trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë nga ana e tij nuk është provuar me dokumentacion provues ligjor të kohës që kjo shumë është përfituar nga z. F. Y., me të drejtë, Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare. Deklaratat e paraqitura nga subjekti, të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit nga të afërm të tij, duken sikur janë hartuar në funksion të rregullimit të situatës financiare të subjektit. Gjithashtu, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për refuzimin e kërkesës së subjektit për të provuar me dëshmitarë përfitimin e shumës prej 47.000 USD, mbështetur në nenin 49, pika 6, germa “a” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016⁶⁷. Në këtë rast, kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, banesë, është nënshkruar nga gjyshi i subjektit, i cili ka qenë edhe përfituesi i shumës 47.000 USD, për rrjedhojë, është e panevojshme kjo kërkesë e tij në raport me atë çka përpiqet të vërtetojë.

33.14/d. Për sa i përket refuzimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar Komisionit, për të administruar të dhëna nga: Drejtoria e Doganave në lidhje me faktin se shtetasi F. Y. ka importuar mall nga Republika e Greqisë dhe e Maqedonisë së Veriut; Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit në Policinë e Shtetit lidhur me hyrje - daljet në kufi të xhaxhait të tij, F. Y., si dhe të bëjë një vlerësim të përafërt të fitimit të mundshëm që mund të ketë realizuar xhaxhai i tij, për periudhën 1998 – 2006, bazuar në të dhënat e INSTAT-it apo Bankës së Shqipërisë, trupi gjykues e vlerëson atë pabazuar, për sa kohë janë administruar të dhënat nga organet tatimore, duke mos u provuar qarkullimi, fitimi dhe pagimi i detyrimeve tatimore, për më tepër, aktiviteti tregtar i z. Y. rezulton i provuar me status “pasiv” që në vitin 2001. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit pretendon se të dhënat e mësipërme nuk mund të merreshin prej tij, ai i kishte të gjitha mundësitë për t’ia kërkuar xhaxhait të tij t’i administronte këto të dhëna dhe më pas t’i depozitonte si prova në Komision. Sipas parashikimit ligjor të nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës që të provojë me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të të ardhurave të xhaxhait të tij, duke qenë se nga hetimi i Komisionit dhe analiza financiare, z. F. Y. ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas.

33.14/dh. Në lidhje me deklaratat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, me qëllim provimin e deklarimeve të tij, trupi gjykues, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit,⁶⁸ vlerëson se ato kanë fuqi të kufizuar provuese në këtë proces, pasi janë kryer gjatë procesit të rivlerësimit dhe, të para në raport me të dhënat e tjera, nuk mbështeten nga rrethanat dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes, në kuptim të nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, çka të krijon bindjen se janë konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit dhe se nuk mbështeten nga provat e tjera të administruara në këtë proces. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion provues përfitimin e shumës së mbetur nga shitja e banesës së gjyshit të tij. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion provues të ardhurat e pretenduara të përfituara nga aktiviteti tregtar i z. F. Y. Në përfundim, trupit gjykues i rezulton i drejtë konstatimi i Komisionit, se z. F. Y. nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për dhënien e huas në shumën 2.000.000 lekë, hua e cila ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit objekt analize.

⁶⁷ Bazuar në nenin 232 të Kodit të Procedurës Civile nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat, që përbën provë të plotë.

⁶⁸ Vendim nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafët 35 dhe 36; vendim nr. 11/2019 (JR), datë 22.05.2019, paragrafi 27.12.1; vendim nr. 34/2019 (JR), datë 02.12.2019, paragrafi 85.2; vendim nr. 23/2020 (JR), datë 25.09.2020, paragrafi 26.2; dhe vendim nr. 11/2021 (JR), datë 31.03.2021.

33.14/e. Në lidhje me mundësinë e subjektit të rivlerësimit për shlyerjen e huas marrë nga z. F. Y., rezulton se subjekti gjatë hetimit ka deklaruar se kjo hua është kthyer brenda vitit me kursimet *cash* të krijuara gjatë vitit 2006. Komisioni, bazuar në deklaratimet e subjektit për shlyerjen e huas, ka kryer një analizë financiare mbi mundësitë e subjektit për kthimin e kësaj huaje në vitin 2006 dhe i rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për kthimin e huas në vlerën (-) 1.423.056,48 lekë. Komisioni nuk e përfshiu në analizën financiare as marrjen dhe as kthimin e huas z. F. Y., për të mos rënduar pozitën financiare të subjektit. Në këto kushte, Kolegji e konsideron pa relevancë analizën financiare mbi mundësitë e subjektit për kthimin e kësaj huaje në vitin 2006.

33.15. Në përfundim të analizës së burimeve financiare të ligjshme, për të përlogaritur mundësitë e subjektit dhe familjes së tij të origjinës për blerjen e apartamentit me sip. 111 m², lagjja “{***}”, në Shkodër, në datën 10.04.2006, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos konsideruar si burime të ligjshme: të ardhurat nga aktiviteti tregtar si shitës ambulant i babait të subjektit të rivlerësimit; të ardhurat nga aktiviteti i babait për legalizimin e dokumenteve; të ardhurat nga aktiviteti i vëllait si asistent avokat dhe shitjen e fruta-perimeve; të ardhurat nga dhënia me qira e tokës bujqësore; huan marrë shtetasit Xh. Th.; huan marrë shtetasit F. Y., duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, në shumën 2.776.229 lekë.

33.16. Në përfundim, për pasurinë “apartament me sip. 111 m²”, lagjja “{***}”, rruga “{***}”, Shkodër, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë në deklaratën *vetting* lidhur me huat që kanë shërbyer si burim krijimi të kësaj pasurie dhe çmimin e blerjes së saj, duke u gjendur në kundërshtim me nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

34. Lidhur me pasurinë e luajtshme “automjet” tipi “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në bashkëpronësi me bashkëshorten, i blerë në shumën prej 930.000 lekë, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti rezulton me pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti në shumën (-) 51.244,44 lekë, dhe ka vlerësuar se kjo shumë do të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë.

34.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka pasaktësi në analizën financiare të kryer nga Komisioni mbi mundësinë financiare të tij për të blerë automjetin, konkretisht: të ardhurat e marra nga bashkëshortja janë llogaritur pak në vlerën 134.02 lekë; të ardhurat e bashkëshortes janë llogaritur 123.869 lekë më pak sesa shuma reale e marrë; interesat nga bonot e thesarit janë llogaritur më pak dhe konkretisht me 38.585 lekë; nga Komisioni i janë rritur shpenzimet e jetesës me 132.728 lekë. Sipas subjektit, shumatorja e gabimeve të mësipërme ka çuar në një bilanc negativ të pajustificuar, mbi bazën e të cilit është nxjerrë përfundimi se nuk ka pasur mjete të mjaftueshme financiare për blerjen e automjetit. Për këtë arsye, subjekti kërkon një rishikim të analizës financiare me të dhënat e sakta.

34.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ⁶⁹ në Komision, trupit gjykues i rezulton se: *Në deklaratën e pasurisë vetting*,⁷⁰ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *automjet “Mercedes-Benz”, me targa {***}, në bashkëpronësi me bashkëshorten, viti i prodhimit 2009, i blerë në shumën prej 930.000 lekë... meqenëse automjeti është blerë i përdorur, përveç çmimit të blerjes, kam shpenzuar ekstra rreth 80.000 lekë për pajisjen me dokumentacionin tekniko-ligjor të mjetit dhe riparime të ndryshme të tij, duke shkuar shpenzimet në tërësi në shumën 1.010.000 lekë. Mendoj që vlera e automjetit është 1.000.000 lekë, që përbëhet nga çmimi i blerjes dhe shpenzimet ekstra që kam kryer unë. Si burim për blerjen e këtij automjeti, subjekti ka deklaruar kursimet nga të ardhurat familjare të tij dhe të bashkëshortes. Në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Blerje automjeti, i përdorur, në shumën 930.000 lekë. Përveç kësaj vlere kam shpenzuar ekstra rreth 80.000 lekë, duke shkuar në tërësi, në shumën 1.010.000 lekë”.*

34.3. Gjithashtu, në fashikull gjendet: **(i)** Akt shitje i pasurisë së luajtshme me nr. {***}, datë 19.09.2016, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi V. P. automjetin “Mercedes-Benz” tip “Daimler Chrysler 211 e 320 CDI”, vit prodhimi 2009, me vlerë 930.000 lekë. **(ii)** Në dosjen e automjetit evidentohet vërtetimi nr. {***} prot., datë 27.12.2019, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, ku citohet se mbi bazën e të dhënave të ardhura nga Komisariati i Policisë Shkodër për djegien e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targë {***}, në pronësi të shtetasit Andri Ymeri, është regjistruar procedimi penal nr. {***}, datë 10.12.2019. **(iii)** Në përgjigje të pyetësorit standard, në lidhje me këtë automjet, subjekti ka deklaruar: “...ky automjet, aktualisht është jashtë përdorimit, pasi përmes një ngjarjeje kriminale më është djegur, në datën 24.11.2019, në orët e vona të natës, ndërsa ka qenë i parkuar në parkimin publik të pallatit ku unë dhe familja ime banojmë. **(iv)** Nga ana e BKT-së konfirmohet se pagesa për këtë automjet është kryer në datën 16.09.2016, nga subjekti i rivlerësimit, me anë të depozitimit *cash* në llogarinë e znj. L. P., bashkëshortja e shitësit të automjetit.

34.4. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me shpenzimet e kryera prej tij për dokumentacionin dhe riparimin e automjetit, në vlerën prej 80.000 lekësh, qëndron, pasi me të drejtë riparimi i një automjeti kërkon një kohë të caktuar për t’u realizuar, gjë që e bën të pamundur që këto shpenzime të jenë kryer në të njëjtën datë me blerjen. Megjithëse në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2016, por edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, ai nuk ka specifikuar kohën se kur janë kryer këto riparime, Komisioni nuk duhej ta kryente analizën financiare të subjektit dhe të bashkëshortes së tij duke i përfshirë këto shpenzime ditën e blerjes së automjetit, pra brenda datës 19.09.2016, por minimalisht duhet ta kryente këtë llogaritje në një shtrirje më të gjatë kohore, së paku në një periudhë të mëpasshme, pas datës së blerjes së automjetit.

34.5. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, kontrollloi analizën financiare të Komisionit mbi mundësinë e krijimit të kësaj pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit. Në këtë analizë, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij janë marrë sipas kreditimeve të kryera në llogaritë e tyre të pagës. Nga të dhënat e pasqyrave bankare rezulton se të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit, gjatë periudhës 01.01.2016 – 19.09.2016, kanë qenë në shumën 995.226 lekë. Të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga pagat dhe

⁶⁹ Shkresë nr. {***} prot., datë 21.05.2020, drejtuar DPShTRr-së; Kthim përgjigje DPShTRr nr. {***} prot., datë 03.06.2020; Shkresë nr. {***} prot., datë 21.05.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; Kthim përgjigje BKT nr. {***} prot., datë 04.06.2020.

⁷⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) Akt shitje pasuri e luajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 19.09.2016; (ii) Faturë doganore e datës 13.03.2016; (iii) Leja e qarkullimit e datës 27.09.2016, si dhe Policë e Sigurimit të Detyrueshëm, datë 29.06.2016.

pagesat e raportit të lejes së lindjes, për periudhën 01.01.2016 – 19.09.2016, kanë qenë në shumën 387.808 lekë. Të ardhurat e përfituara nga interesat e bonove të thesarit janë përfshirë në analizë sipas kreditimeve në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, në Bankën Societe Generale. Nga të dhënat e pasqyrave bankare rezulton se nga investimi në bonot e thesarit, subjekti i rivlerësimit ka përfitur të ardhura përkatësisht në datat 07.04.2016 dhe 23.12.2016.

34.6. Nga kontrolli i analizës financiare për këtë pasuri rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kishin pamundësi të ardhurash të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, në një diferencë të paktën sa ajo e konstatuar në analizën e Komisionit.

34.7. Në përfundim për pasurinë e luajtshme “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, targa {***}, në bashkëpronësi me bashkëshorten, trupi gjykues, ashtu si Komisioni, ka arritur në përfundimin se subjekti rezulton me pamundësi financiare për blerjen e këtij automjeti në vitin 2016 dhe vlerëson se kjo situatë do të merret në konsideratë në vlerësimin përfundimtar të kriterit të pasurisë.

35. Lidhur me pasurinë “automjet”, tip “Ford Focus”, me targa {*}, në përdorim nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, A. Y.**

35.1. Komisioni, duke marrë në konsideratë: (i) deklaratimet kontradiktore të subjektit në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e këtij automjeti nga vëllai i tij; (ii) pretendimet e subjektit se si burim ka shërbyer edhe një hua në shumën 400.000 lekë, dhënë babait nga ana e tij; (iii) deklaratimet e subjektit se vëllai i tij kishte një automjet tjetër; (iv) mungesën e burimeve të ligjshme të subjektit për të blerë këtë automjet në vitin 2014; (v) dhënien në vitin 2014 të shumës 1.400.000 lekë hua vëllait të tij; (vi) të dhënat e administruara nga AMF-ja, nga ku rezulton se bashkëshortja e subjektit është policëmbajtëse për këtë automjet, për një periudhë të pandërprerë 30.03.2016 – 04.04.2018; si dhe (vii) subjekti nuk ka pasur automjet tjetër në pronësi – vlerëson se automjeti tip “Ford Focus” mund të ketë qenë në pronësi të fshehur të subjektit. Komisioni ka vlerësuar t’i trajtojë konstatimet e mësipërme në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

35.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton gjetjet e Komisionit në lidhje me pronësinë e automjetit të llojit “Ford Focus”, duke argumentuar se ky automjet është në pronësi të vëllait, G. Y., dhe jo të tij. Ai thekson se nuk ka dhënë asnjëherë shpjegime kontradiktore mbi burimin e të ardhurave për blerjen e automjetit dhe se vëllai i tij kishte burime të ligjshme financiare për ta blerë. Subjekti mohon gjithashtu të ketë deklaruar ndonjëherë se huaja e dhënë babait të tij, në vitin 2013, ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit dhe shpjegon se ajo është përmendur vetëm në kontekstin e burimeve financiare të familjes së vëllait.

35.3. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit, se subjekti nuk kishte burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti në vitin 2014, subjekti pretendon se bilanci i tij financiar ka qenë pozitiv në atë vit dhe se mosblerja e një automjeti ka qenë zgjedhje personale, jo pasojë e mungesës së të ardhurave. Po ashtu, ai saktëson se huaja e dhënë vëllait në vitin 2014 nuk ka asnjë lidhje me blerjen e automjetit. Në shpjegimet e tij, subjekti argumenton se pagesa e policës së sigurimit nga bashkëshortja e tij nuk mund të interpretohet si provë e pronësisë së tij mbi automjetin, duke theksuar se në atë periudhë ishte e zakonshme që përdoruesit e mjeteve të regjistroheshin si mbajtës të policës së sigurimit. Për më tepër, ai citon informacionin e marrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, sipas të cilit policat e sigurimit, për vitet 2017 – 2019, janë prerë nga vëllai i tij, duke vërtetuar pronësinë e tij mbi automjetin. Në përfundim, subjekti e cilëson përfundimin e Komisionit si të pabazuar, dashakeq dhe

të motivuar nga qëllimi për t'i atribuar atij pasuri të fshehur, me qëllim aplikimin e nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

35.4. Trupi gjykues, me qëllim ballafaqimin e pretendimeve të subjektit në raport me konkluzionin e Komisionit, mori në analizë deklaratimet e tij për këtë pasuri dhe, pasi i krahasoi ato me dokumentacionin ⁷¹ e ndodhur në dosje, konstaton se:

(i) Automjeti është blerë nga vëllai i subjektit, G. Y., në datën 02.04.2014, me akt shitje pasurie të luajtshme nr. {***}, në vlerën 350.000 lekë. Sipas aktit të shitjes, shuma është likuiduar ndërmjet palëve jashtë zyrës noteriale. Leja e qarkullimit e këtij automjeti, tip “Ford Focus”, me targë {***}, është lëshuar në emër të G. Y., më datë 14.04.2014, i cili është pajisur dhe me certifikatë të pronësisë së mjetit në emër të tij.

(ii) Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, në lidhje me këtë automjet, ka deklaruar se është blerë në gjendje të përdorur prej vëllait, G. Y., në shumën 350.000 lekë, përdorur fillimisht nga vëllai i tij, por ndonjëherë, përdoret edhe nga bashkëshortja e tij, A. Y., në rast nevojë, me miratimin e vëllait. Subjekti ka deklaruar se ata nuk kanë të drejta pronësie për këtë automjet. Si burim krijimi ka deklaruar kursimet nga të ardhurat familjare të vëllait, G. Y.

(iii) Nga të dhënat e administruara nga AMF-ja konstatohet se bashkëshortja e subjektit, A. Y., rezulton policëmbajtëse për këtë automjet, për datat 05.04.2017 – 04.04.2018 dhe 30.03.2016 – 29.03.2017. Sipas informacionit të marrë nga Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare dhe konkretisht shkresa me numër prot. {***}, datë 25.02.2022, pasqyrohet fakti se në lidhje me këtë automjet në policën e sigurimit, për vitet 2017, 2018 dhe 2019, është edhe emri i vëllait të subjektit, G. Y.

(iv) Lidhur me konstatimin e faktit se në kushtet kur vëllai i subjektit e kishte një automjet, cila do të ishte arsyeja e blerjes së automjetit tjetër, subjekti në shpjegimet e dhëna në Komision ka pretenduar se: *“Arsyeja e blerjes së këtij automjeti nga vëllai im ka qenë se, duke qenë se bashkëshortja e vëllait punonte në një fshat të Shkodrës, nevojitej një automjet në dispozicion të saj për të realizuar shkuarjen dhe ardhjen nga puna. Automjeti u ble nga vëllai me qëllim që bashkëshortja e tij, pasi të mësonte ta ngiste, të shkonte dhe të vinte vetë nga puna. Meqenëse pas pak kohësh bashkëshortja e vëllait e rregulloi këtë problematikë transporti në mënyrë tjetër, ky automjet iu dha në përdorim bashkëshortes sime nga vëllai, pasi edhe kjo e fundit e kishte larg punën nga vendbanimi dhe ne nuk kishim automjet tjetër. Megjithatë, theksoj se ky automjet nuk është përdorur vetëm nga bashkëshortja ime, por edhe nga vetë vëllai, sipas nevojave të familjes së tij”.*

35.5. Lidhur me gjetjen e Komisionit, se bashkëshortja e subjektit, A. Y., rezulton se ka prerë policë sigurimi për automjetin tip “Ford Focus”, me targë {***}, trupi gjykues konstaton se, referuar dispozitave të ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, i ndryshuar, në nenin 4, parashikohet se: *Kur mjeti i transportit, në përputhje me ligjet për regjistrimin, është i regjistruar në emër të përdoruesit të mjetit të transportit, dispozitat e këtij ligji, të cilat janë të vlefshme për pronarin e mjetit të transportit, janë, përkatësisht, të zbatueshme edhe për përdoruesit e këtij mjeti. Neni 5: Sigurimi i përgjegjësisë së pronarit të mjetit të transportit për dëme shkaktuar palëve të treta mbulon edhe dëmet e shkaktuara nga përdorimi i mjetit prej*

⁷¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) Akt shitje pasuri e luajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., dt. 02.04.2014, për blerje automjeti “Ford”, vit prodhimi 2001, me palë shitëse Z. Ç. dhe blerës G. Y., me vlerë 350.000 lekë, shumë e likuiduar jashtë zyrës noteriale; (ii) Faturë doganore e datës 25.10.2013, policë për sigurim të detyrueshëm dt.30.03.2016; (iii) Leje qarkullimi e mjetit “Ford Focus”, me targë {***}, në emër të G. Y., dt. 14.04.2014; (iv) Certifikata e pronësisë së mjetit, në emër të G. Y.

personave të tjerë, kur këta e përdorin mjetin me miratimin e pronarit. Sikurse vërehet referuar praktikave të sigurimit të automjeteve, lejohet që, përveç pronarit të mjetit, të përfshihen në policë siguri edhe drejtues të tjerë të autorizuar.

35.6. Në kushtet kur nga analiza financiare, Komisionit i ka rezultuar se vëllai i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e automjetit tip “Ford Focus”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti nga bashkëshortja e tij në deklaratën periodike të vitit 2016, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues e konsideron të paargumentuar bindshëm dyshimin e Komisionit për fshehje të kësaj pasurie nga ana e subjektit, duke u mbështetur në faktin se ky automjet është përdorur disa herë edhe nga bashkëshortja e tij. Për rrjedhojë, e gjen të bazuar pretendimin e subjektit lidhur me këtë shkak ankimi.

36. Për pasurinë e luajtshme “orendi shtëpiake”, të cilat kanë shërbyer për mobilimin e banesës gjatë periudhës 2008 – 2016, Komisioni, për shkak të deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, ka vlerësuar se është e pamundur të verifikohet pasqyrimi i situatës së vërtetë lidhur me vlerën e mobilimit, për rrjedhojë, konstatohet pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të mobilimit. Në këto rrethana, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

36.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimet e Komisionit lidhur me vlerën e mobilimit të banesës, duke argumentuar se nuk ka dhënë deklarime kontradiktore. Ai saktëson se shuma prej 1.200.000 – 1.500.000 lekësh, e përmendur në deklaratën *vetting*, është përafërsisht dhe nuk përfaqëson vlerën e saktë të shpenzimeve të kryera nga familja e tij. Sipas subjektit, Komisioni ka bërë një llogaritje të gabuar të shpenzimeve të mobilimit, duke i përqendruar ato në vitet 2008 – 2009, pa dhënë një bazë të qartë për këtë ndarje dhe pa marrë parasysh vitet e tjera. Subjekti shprehet se Komisioni ka keqinterpretuar deklaratën e tij, duke e trajtuar vlerën totale të mobilimit si një shumë të shpenzuar tërësisht nga ai, pa marrë parasysh dhuratat dhe burimet e tjera. Për të sqaruar situatën, ai paraqet një listë analitike të sendeve të marra si dhuratë dhe një tabelë financiare me ndarjen reale të shpenzimeve për mobilimin e banesës ndër vite.

36.2. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se përgjigjja e tij lidhur me vlerën e mobilimit është dhënë në mënyrë të përgjithshme, pa bërë ndarje mes sendeve të blera dhe atyre të dhuruara, pasi pyetja e Komisionit nuk specifikonte se cilat ishin shpenzuar nga ai dhe cilat ishin dhuratë. Ai thekson se shuma reale që ka shpenzuar për mobilimin e banesës është 623.000 lekë dhe jo 1.200.000 lekë, siç është llogaritur nga Komisioni. Vlerat përkatëse janë 373.800 lekë në vitin 2008, 124.600 lekë në vitin 2009 dhe rreth 17.000 lekë në vitet e mëpasshme.

36.3. Me qëllim analizimin e këtij shkak ankimi, trupi gjykues shqyrtoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe shpjegimet e dhëna në Komision për shpenzimet e mobilimit, nga ku rezulton se:

(i) Subjekti, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar se ka në bashkëpronësi pasuri të luajtshme – orendi shtëpiake, që kanë shërbyer për mobilimin e banesës, vlera e përbashkët e të cilave varion në minimum - maksimum, ndërmjet vlerës 1.200.000 lekë – 1.500.000 lekë.

(ii) Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka deklaruar: *Shpenzimet e mobilimit të shtëpisë time janë maksimumi 1.200.000 lekë, të bërë ndërmjet viteve 2008 – 2020, duke përfshirë çdo pajisje apo send që ndodhet në banesë.*

(iii) Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se ka përfituar në formën e dhurimit shumë 300.000 lekë nga prindërit e tij, me rastin e martesës. Këto të ardhura, sipas deklarimeve të subjektit, kanë shërbyer për mobilimin e banesës. Për të provuar këtë dhurim, subjekti ka depozituar deklaratë noteriale nr. {***}, datë 23.01.2017, të z. F. dhe znj. E. Y., të cilët deklarojnë se në vitin 2008 i kanë dhuruar shumë 300.000 lekë subjektit, me rastin e martesës.

(iv) Në procesverbalin e datës 27.01.2015,⁷² mbajtur në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar se nga viti 2008, kur është futur në shtëpi dhe deri në vitin 2013, vlera e mobilimit mund të ketë qenë 1.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit, në një memo me shpjegime, të dorëzuar në ILDKPKI, në datën 13.02.2015, në lidhje me shpenzimet për mobilim, ka shpjeguar se: deri në vitin 2008, para se të fillonte jetesën me bashkëshorten dhe djalin, shpenzimet e mobilimit kanë qenë në vlerën 300.000 lekë, të dhëna nga prindërit e subjektit të rivlerësimit. Subjekti shprehet se prej dasmës të afërmit e kanë suportuar me dhurata në të ardhura.

(v) Pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, subjekti në lidhje me mobilimin ka deklaruar se ai ka shpenzuar vetëm shumë 623.000 lekë, ndërsa vlera tjetër ka qenë dhuratë. Sipas subjektit përbën fakt të njohur botërisht se shpenzimet e mobilimit bëhen në pjesën dërrmuese në fillim të jetesës në banesë.

36.4. Nga sa konstatuar më lart, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore lidhur me sasinë, kohën dhe mënyrën e përfitimit të dhuratave që kanë shërbyer për shpenzimet e mobilimit, për rrjedhojë, e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për përfshirjen në analizë të vlerës së mobilimit, sipas deklarimit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe të konfirmuar në pyetësorin standard.

36.5. Trupi gjykues konstaton se Komisioni, në rezultatet e para të hetimit, shpenzimet e mobilimit i ka llogaritur sipas shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në pyetësorin standard për vitin 2008 dhe 2009. Për periudhën e mbetur, shpenzimet e mobilimit janë shpërndarë në mënyrë lineare, meqenëse subjekti nuk i ka ndarë ato sipas viteve. Në rezultatet e dyta të hetimit, shpenzimet e mobilimit janë pozicionuar vetëm në vitin 2008 dhe vitin 2009, në vlerën 600.000 lekë për secilin vit, duke hequr kështu shpenzimet e mobilimit të shpërndara në mënyrë lineare nga viti 2010 e në vazhdim. Komisioni ka vlerësuar të mos përfshijë në analizë të ardhurat e dhëna në formën e dhuratës nga prindërit e tij, pasi ata nuk kishin mundësi financiare të jepnin këtë dhurim, në kushtet kur në këtë periudhë ata kanë marrë një hua nga subjekti i rivlerësimit. Në rezultatet e dyta të hetimit është vendosur një tabelë përmbledhëse e të gjitha zërave dhe, nga rezultati financiar, rezulton se nuk është konsideruar si e ardhur shuma prej 600.000 lekësh, por vetëm shuma e dhuruar prej 150.000 lekësh dhe shuma e dhuruar prej 300.000 lekësh.

36.6. Nga kontrolli i kryer në Kolegj, të analizës financiare të Komisionit, për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshorten e tij, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, lidhur me shpenzimet e mobilimit, sipas detajimit që subjekti i rivlerësimit ka bërë në pyetësorët gjatë procesit administrativ në Komision, për vitet 2008 dhe 2009, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kishin mundësi të kryenin shpenzimet e mobilimit për vitin 2008. Nëse do të analizohej pretendimi i subjektit, se shuma e shpenzimeve të mobilimit ka qenë në vlerën 623.000 lekë, e ndarë në 373.800 lekë në vitin 2008, 124.600 lekë në vitin 2009 dhe përkatësisht nga 17.800 lekë në çdo vit deri në vitin 2016, përsëri diferenca negative e vitit 2008 nuk do të përmirësohej.

⁷² Shih shkresën nr. {***} prot., datë 14.07.2022, të ILDKPKI-së.

36.7. Në përfundim, *për pasurinë e luajtshme* – “*orendi shtëpiake*”, të cilat kanë shërbyer për mobilimin e banesës gjatë periudhës 2008 – 2016, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit se, edhe me përfshirjen në analizën financiare të vlerës së mobilimit sipas deklaramit të subjektit në deklaratën *vetting*, në përgjigje të pyetësorëve apo gjatë hetimit administrativ, sërish ai do të kishte një pamjaftueshmëri financiare për të mbuluar shpenzimet e mobilimit për disa vite brenda kësaj periudhe.

37. *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga dhënia në përdorim e tokës bujqësore*,⁷³ me sip. 10.950 m² në bashkëpronësi të F., E., Andri, A. dhe F. Y., Komisioni ka arritur në përfundimin se, për sa kohë nuk është provuar ekzistenca e këtyre të ardhurave, si dhe pagimi i detyrimeve tatimore, ato nuk i ka përfshirë në analizën financiare.

37.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit, duke argumentuar se nuk ka asnjë kontradiktë midis deklaramëve të tij në DIPP-të e viteve 2005, 2006 dhe 2007 dhe deklaratës noteriale të shtetasit Sh. G., të datës 16.02.2015. Ai thekson se ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore si fitime nga prodhimi bujqësor dhe dhënie me qira, ndërsa deklarata noteriale konfirmon përdorimin e tokës nga Sh. G. dhe pagesën për këtë përdorim. Subjekti argumenton se shprehja “*përdorim i tokës bujqësore*” përfshin si marrjen me qira, ashtu edhe shfrytëzimin e prodhimeve bujqësore. Ai pretendon se Komisioni ka keqinterpretuar këtë shprehje për të mos njohur të ardhurat si burime të ligjshme. Sipas tij janë paguar të gjitha detyrimet tatimore nga babai i tij, fakt i provuar me dokumentacion zyrtar.

37.2. Nga analizimi i deklaramëve të subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionit lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se babai i subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e kryefamiljarit të familjes bujqësore, ka përfituar me aktin e marrjes së tokës në pronësi, nr. {***}, datë 16.07.1994, 11.250 m² tokë bujqësore në fshatin Bushat, Shkodër. Kjo pasuri rezulton e regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme në ZVRPP, Shkodër, në emër të kryefamiljarit F. Y., me nr. pasurie {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë: fshati {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Shkodër, me sipërfaqe 10950 m².

37.3. Në deklaratën e pasurisë *vetting*,⁷⁴ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se mbi këtë pasuri të paluajtshme ka vetëm formalisht të drejta bashkëpronësie, pasi nuk e posedon, nuk e gëzon dhe nuk e ka në përdorim që nga viti 2008 e në vazhdim (pas martese). Kjo pasuri “*de facto*” është në pronësi të vetme të prindërve të tij, pasi ai së bashku me motrën dhe vëllain, pas martesave përkatëse, faktikisht, (ndonëse jo formalisht), kanë hequr dorë nga çdo lloj pretendimi bashkëpronësor, mbi këtë pasuri. Subjekti, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, ka depozituar deklaratë noteriale nr. {***}, datë 16.02.2015, me deklarues Sh. G., i cili deklaron se: “*Gjatë periudhës 2005 – 2008 ka marrë në përdorim, nga F. Y., tokë-arë me sip. 10.800 m² dhe i ka dhënë pronarit F. Y., shumën 600.000 lekë*”.

37.4. Nga verifikimi i deklaramëve periodike të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues konstaton se, në lidhje me të ardhurat nga toka bujqësore, ka deklaruar: Në DIPP-në e vitit 2005: “*Fituar nga prodhimi i tokës së babait tim, fitime të bëra gjatë vitit 2005 nga prodhimet bujqësore, në shumën 400.000 lekë*”. Në DIPP-në e vitit 2006 ka deklaruar të ardhura shumën 100.000 lekë nga dhënia me

⁷³ Subjekti i ka bashkëlidhur Deklaratës: (i) Certifikatë pronësie, datë 28.06.2002, e ZVRPP-së, Shkodër; (ii) Hartë treguese e regjistrimit, aplikimi për regjistrim; (iii) Akt i marrjes së tokës në pronësi nr. {***}, datë 18.07.1994.

⁷⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur Deklaratës: (i) Certifikatë pronësie dt. 28.06.2002, e ZVRPP-së Shkodër; (ii) Hartë treguese e regjistrimit, aplikimi për regjistrim; (iii) Akt i marrjes së tokës në pronësi nr. {***}, dt. 18.07.1994.

qira e tokës bujqësore. Në DIPP-në e vitit 2007 ka deklaruar të ardhura në shumën 70.000 lekë nga dhënia me qira e tokës bujqësore.

37.4/a. Bazuar në deklarinimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit, në deklaratat e interesave periodikë vjetorë, rezulton se babai i tij ka përfituar 400.000 lekë të ardhura nga prodhimet bujqësore dhe 170.000 lekë të ardhura nga dhënia me qira e tokës bujqësore. Me qëllim vërtetimin e ligjshmërisë së të ardhurave të përfituara nga kjo pasuri, subjekti ka depozituar, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, Vërtetimin nr. {***} prot., datë 04.05.2022, nga Bashkia Vau i Dejës, sipas së cilit z. F. Y. ka shlyer të gjitha detyrimet për taksat dhe tarifave vendore deri në vitin 2022. Bashkëlidhur gjendet fatura e arkëtimit e datës 04.05.2022, sipas së cilës z. F. Y. ka paguar taksë toke, ndërtesë etj., për vitet 2017 – 2022, në shumën 17.893 lekë. Trupi gjykues, megjithëse konstaton se kjo pagesë është kryer për efekt të procesit të rivlerësimit të subjektit, vëren se shlyerja e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me tokën bujqësore, referuar vërtetimit të mësipërm i përket një periudhe të mëvonshme (2017 – 2022) dhe nuk përkon me të ardhurat e përfituara prej saj, që i përkasin viteve 2005 – 2007.

37.4/b. Trupi gjykues e gjen të drejtë konstatimin e Komisionit, se deklarinimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore nuk përputhen me deklaratën noteriale të depozituar nga vetë subjekti, pasi në vitin 2005, ai ka deklaruar se ka përfituar të ardhura nga toka bujqësore për shkak të prodhimit dhe vetëm nga viti 2006 e në vijim ka deklaruar të ardhura nga dhënia me qira, ndërsa referuar deklaratës noteriale nr. {***}, datë 16.02.2015, të z. Sh. G., ai deklaron se: *“Gjatë periudhës 2005 – 2008 ka marrë në përdorim, nga F. Y., tokë-arë ...”*. Gjithashtu, në kushtet kur nga kontrolli në regjistrin elektronik të QKB-së nuk rezulton që z. Sh. G. të jetë regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti tregtar apo subjekti nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor mbi aktivitetin e tij (të ardhura, fitime etj.), si dhe në konsideratë të faktit që në atë periudhë subjekti i rivlerësimit është pyetur nga inspektorët ILDKPKI-së, rezulton i bazuar dyshimi i Komisionit, se deklarata noteriale e këtij shtetasi mund të jetë hartuar me qëllimin që subjekti i rivlerësimit të mund të provonte përpara ILDKPKI-së në vitin 2015 të ardhurat e pretenduara nga toka bujqësore.

37.5. Në përfundim, lidhur me të ardhurat e pretenduara të përfituara nga toka bujqësore, me sip. 10.950 m², trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit, se shpjegimet e subjektit rezultuan kontradiktore për këto të ardhura. Për sa kohë ai nuk ka depozituar dokumentacion provues të kohës për përfitimin e këtyre të ardhurave, si dhe nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara nga dhënia me qira e saj, ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

38. Për pasurinë *“bono thesari”*⁷⁵, në vlerën 3.150.000 lekë, me datë emetimi 07.04.2016 dhe datë maturimi 06.04.2017 dhe *“bono thesari”*, në vlerën 4.200.000 lekë, me datë emetimi 22.12.2016 dhe datë maturimi 21.12.2017, të depozituara në emër të bashkëshortes së subjektit, A. Y., në Bankën e Shqipërisë

38.1. Në lidhje me bonot e krijuara në vitin 2009, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën -1.926.639,56 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer deklarinim të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë

⁷⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) Vërtetimin mbi shpalljen fitues nga Banka e Shqipërisë, në emër të A. Y., për bono thesari 12-mujore, me dt. emetimi 07.04.2016 dhe dt. maturimi 06.04.2017, të shumës 3.150.000 lekë, nga llogaria e Societe Generale Bank; (ii) Vërtetim mbi shpalljen fitues nga Banka e Shqipërisë, në emër të A. Y., për bono thesari 1-vjeçare me dt. emetimi 22.12.2016 dhe dt. maturimi 21.12.2017, të shumës 4.200.000 lekë, nga llogaria e Societe Generale Bank.

pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

38.2. Trupi gjykues konstaton se si burim krijimi për bonot e thesarit në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se janë krijuar nga kursimet e të ardhurave familjare gjatë viteve të martesës (vitet 2008 e në vazhdim), pjesa e pandarë. Në dokumentacionin bankar,⁷⁶ të administruar në Komision për këtë qëllim, gjenden transaksionet bankare të kryera nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit për investime në bono thesari. Sipas pasqyrës së llogarisë në Bankën e Parë të Investimeve rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka kryer derdhje në llogari dhe kalim në bono thesari në Bankën e Shqipërisë: në datën 28.07.2009 ka derdhur *cash* 2.250.000 lekë të kaluara për blerje bono thesari; në datën 05.04.2010 ka derdhur *cash* 1.750.000 lekë të kaluara për blerje bono thesari; në datën 23.07.2010 ka derdhur *cash* 75.000 lekë të kaluara për blerje bono thesari; në datën 31.03.2011 ka derdhur *cash* 150.000 lekë të kaluara për blerje bono thesari; në datën 18.07.2011 ka derdhur *cash* 750.000 lekë të kaluara për blerje bono thesari; në datën 05.04.2012 ka derdhur *cash* 900.000 lekë të kaluara për blerje bono thesari; në datën 23.07.2012 ka derdhur *cash* 930.000 lekë të kaluara për blerje bono thesari; në datën 29.03.2013 ka derdhur *cash* 350.000 lekë të kaluara për blerje bono thesari. Në total, rezulton se nga data 28.07.2009 deri më 29.03.2013 janë depozituar *cash* për blerje bono thesari 7.155.000 lekë.

Nga sa konstatuar më lart, trupi gjykues vlerësoi të analizojë mundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të familjes së tij për krijimin e bonove të thesarit, që nga momenti fillestar i krijimit të tyre, në vitin 2009.

38.3. Trupi gjykues, pasi analizoi dokumentacionin e administruar, si dhe deklaratimet e subjektit, konstaton se investimi i parë në bono thesari është kryer në datën 28.07.2009. Në deklaratën e interesave periodikë të pasurisë të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit deklaron në rubrikën e ndryshimit të pasurive, shumën prej 2.250.000 lekë, si bono thesari të bashkëshortes së tij, A. Y. Në këtë vit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një kredi në shumën 1.500.000 lekë, të marrë nga vetë subjekti në Tirana Bank. Nga llogaria e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit rezulton se kjo llogari është çelur në datën 28.07.2009.

38.4. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2007, në të cilën nuk janë përfshirë të ardhurat nga aktiviteti privat i babait, të ardhurat nga puna e vëllait si avokat, si dhe të ardhurat nga dhënia e tokës me qira, trupi gjykues shprehet se i qëndron analizës për ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, trajtuar më lart në këtë vendim, dhe nuk i ka përfshirë ato në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

38.5. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se në analizën e vitit 2008, Komisioni nuk ka përfshirë në zërin e të ardhurave shumën e deklaruar prej tij si dhurim nga prindërit dhe për dasmë, në vlerën 600.000 lekë, por ka marrë si vlerë të përfitimeve vetëm shumën 450.000 lekë, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit. Prindërit e tij nuk kishin të ardhura të mjaftueshme për të dhuruar shumën për dasmën, pasi, sikurse rezulton sipas vetë shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit i ka dhënë një hua prindërve të tij në vitin 2008, në shumën prej 270.000 lekësh dhe një hua shumën prej 130.000 lekësh në vitin 2009. Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj kontrollloi analizën

⁷⁶ Shkresë nr. {***} prot., datë 21.05.2020, drejtuar Bankave të nivelit të dytë; Kthim përgjigje OTP Bank nr. {***}, datë 29.05.2020; kthim përgjigje Banka e Parë e Investimeve, nr. {***} prot., dt. 28.05.2020; Kthim përgjigje Tirana Bank nr. {***} prot., datë 29.05.2020; Kthim përgjigje BKT nr. {***} prot., datë 04.06.2020; Kthim përgjigje Banka e Shqipërisë nr. {***} prot., datë 26.05.2020.

financiare të Komisionit për vitin 2008, për mundësinë e krijimit të bonove të thesarit, si dhe provoi edhe variantin e mundshëm, duke marrë në konsideratë shumën e dhuruar prej 600.000 lekësh. Edhe në këtë variant, përsëri subjekti rezultoi me balanca negative për vitin 2008.

38.6. Lidhur me burimet financiare të pretenduara nga subjekti,⁷⁷ të cilat kanë shërbyer për krijimin e bonove të thesarit në vitin 2009, rezulton se: në datën 28.07.2009 janë derdhur *cash* 2.250.000 lekë, të cilat e kanë burimin nga akumulimi i shumës së depozituar nga bashkëshortja në Raiffeisen Bank dhe nga kursimet nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes, nga data 01.01.2009, si dhe një pjesë e vogël nga kredia bankare, e marrë pranë Tirana Bank.

Nga sa më sipër, në kushtet kur burimet e krijimit të depozitimit *cash*, për investim në bonot e thesarit janë: depozita e bashkëshortes së subjektit, kursimet nga paga nga data 01.01.2009 dhe një pjesë e kredisë të marrë në Tirana Bank, trupi gjykues vijoi analizimin e këtyre burimeve si më poshtë:

(i) Kredi bankare në Tirana Bank, në shumën totale 1.500.000 lekë

38.7. Lidhur me këtë kredi, Komisioni në vendim vlerësoi se, për shkak të deklarimeve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, është e pamundur të verifikohet pasqyrimi i situatës së vërtetë lidhur me shumën e saktë të kredisë së përdorur për blerjen e bonove, për rrjedhojë, konstatohet pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të bonove. Në këto rrethana, deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në analizën financiare për blerjen e bonove të thesarit, Komisioni nuk e ka përfshirë këtë kredi, ndërkohë e ka përfshirë në analizën e plotë të vitit 2009.

38.7/a. Subjekti i rivlerësimit, në argumentet e tij për kundërshtimin e konstatimit të Komisionit, ka pretenduar se evidentohet qartë se një pjesë e të ardhurave monetare të marra me këtë kredi janë përdorur për blerjen e bonove të thesarit, pasi nga momenti i marrjes së kredisë (datë 13.07.2009), deri në datën e blerjes së bonove të thesarit (31.07.2009), ka një distancë kohore prej 18 ditësh. Gjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore, ai pretendon se nuk ka kryer asnjë blerje të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme, si dhe nuk ka shpenzuar në udhëtime. Subjekti për të njëjtën kredi, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka shpjeguar⁷⁸ se vetëm një pjesë e vogël e saj është përdorur për blerjen e bonove në vitin 2009, pasi kjo kredi ka shërbyer për blerjen e bonove në datën 05.04.2010. Sipas subjektit, ai gabimisht nuk e ka deklaruar saktësisht në DIPP-në e vitit 2009.

38.7/b. Nga verifikimi i akteve që ndodhen në fashikull, trupit gjykues i rezultoi se subjekti, në datën 10.07.2009, ka marrë kredi nga Tirana Bank, me kontratë nr. {***}, në shumën 1.500.000 lekë, me afat 40 muaj, për qëllime konsumatore. Kredia është siguruar nga shuma 1.850.000 lekë,⁷⁹ në formën

⁷⁷ Subjekti në pyetësorin nr. 3 ka deklaruar si më poshtë në lidhje me burimin e këtyre bonove: “Për bonon e thesarit, për të cilën, më datë 28.07.2009, janë derdhur *cash* 2.250.000 lekë, sqaroj se për financimin e saj kanë shërbyer si burim akumulimi i tërheqjes së shumës së depozituar nga bashkëshortja ime në Raiffeisen Bank dhe i interesave mbi depozitën. Kursimet nga rroga ime dhe ajo e bashkëshortes, nga data 01.01.2009, si një pjesë e vogël e një kredie bankare që kam marrë tek Tirana Bank (në shumën në totale 1.500.000 lekë). Pjesën tjetër të kësaj kredie e kemi përdorur sikurse do të shihet në vijim të këtij deklarimi”.

⁷⁸ “Kjo ka qenë kredi konsumatore e përdorur shumë pak në vitin 2009, duke financuar një udhëtim në Turqi, në shumën 1000 euro, ndërsa pjesën tjetër e kemi përdorur për të plotësuar bonon e krijuar në datën 28.07.2009, pra është përdorur një pjesë e vogël e kësaj kredie, ndërsa pjesën e mbetur të kësaj kredie e kemi përdorur për të financuar bonon e datës 05.04.2010. Lidhur me gabimin e bërë në deklarimin e kësaj kredie, kjo justifikohet me faktin se ka qenë herë e parë që unë kam shkruar me dorën time deklaratën individuale vjetore, pasi herët e tjera janë shkruar nga babai dhe jam ngatërruar” - deklaroi subjekti.

⁷⁹ Kontratë pengu nr. {***}, datë 10.07.2009.

e depozitës me afat dyvjeçar, nga 09.07.2009 – 11.07.2011, në emër të babait të subjektit, z. F. Y. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2009 marrjen e një kredie në vlerën 1.500.000 lekë, në Tirana Bank, si dhe ka deklaruar gjendje *cash* në shtëpi, në shumën 400.000 lekë, por pa përmendur se këto kursime e kanë burimin nga kredia konsumatore. Në lidhje me këtë kredi, subjekti në shpjegimet e dhëna para inspektorëve të ILDKPKI-së, konkretisht në procesverbalin e datës 16.11.2011⁸⁰, ka deklaruar se në datën 13.07.2009 ka marrë kredi konsumatore në Tirana Bank, një pjesë e së cilës është përdorur në bono të krijuara në datën 28.07.2009, pjesa tjetër është përdorur për nevoja familjare.

38.7/c. Komisioni në vendim, pasi analizoi shpjegimet e subjektit në lidhje me këtë kredi, konstatoi se, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk është saktësuar sërish shuma përkatëse e përdorur prej tij, për vitet 2009 – 2010, edhe pse Komisioni i ka kaluar barrën e provës. Komisioni vlerëson se kjo kredi nuk është përdorur për blerjen e këtyre bonove të thesarit. Kjo kredi është deklaruar nga subjekti si burim gjatë hetimit, me qëllim rregullimin e pozitës së tij në analizën financiare, duke u fshehur në këtë mënyrë burimi i ligjshëm i të ardhurave për krijimin e bonove.

38.7/ç. Nga sa më lart, trupi gjykues konstaton se deklarimi i subjektit të rivlerësimit, i kryer gjatë hetimit administrativ, nuk përputhet me deklarimin e tij përpara ILDKPKI-së, në vitin 2011 dhe në DIPP-në e vitit 2009; subjekti ka deklaruar gjendje *cash* 400.000 lekë, si dhe nuk rezulton të ketë deklaruar si kursim *cash* të ardhurat nga kredia. Në kushtet kur subjekti nuk rezulton të ketë saktësuar shumat e përdorura nga kredia për blerjen e bonove të thesarit, në vitet 2009 dhe 2010, bëhet e pamundur përcaktimi i vlerës së saktë të përdorur nga subjekti nga kjo kredi për blerjen e këtyre bonove në këto vite, duke e bërë kështu të pamundur kontrollin nëse kjo kredi ka shërbyer ose jo për këto investime.

38.8. Trupi gjykues mori në analizë edhe shumën prej 1.850.000 lekësh, të depozituar nga babai i subjektit të rivlerësimit, si garanci për marrjen e kredisë së sipërpërmendur, për të cilën Komisioni, duke marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit në lidhje me burimin e shumës 1.850.000 lekë, mungesën e burimeve të ligjshme të babait të subjektit për krijimin e kësaj shume dhe qëllimin e përdorimit të saj tërësisht për interesa të subjektit, ngriti dyshime se ka të bëjë me një pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

38.8/a. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit, pretendon se, për shkak të cilësisë së kësaj shume të depozituar nga babai i tij, “garanci bankare”, nuk ka pasur asnjë detyrim ta deklarojë atë ndonjëherë. Mosdeklarimi i kësaj garancie bankare nuk mund të konsiderohet nga Komisioni as si mosdeklarim dhe as si deklarim i rremë, për shkak se kjo “garanci bankare” nuk sjell asnjë pasojë në analizën financiare të pasurisë së tij, pasi kjo shumë nuk rezulton të jetë futur në qarkullim nga ai për t’u përdorur, as për krijim pasurie, as për mbulim shpenzimesh të tjera të ekonomisë familjare dhe as rezulton të jetë deklaruar si burim për qëllime të kësaj natyre.

38.8/b. Subjekti pretendon se familja tij e origjinës, për vitin 2008, rezulton me balancë pozitive në një shumë më të madhe se 2.000.000 lekë, shumë e cila tejkalon shumën e vënë garanci bankare nga babai i tij. Konkretisht, kjo shumë sipas tij është rrjedhojë e kursimeve të familjes të origjinës për vitet 2007, 2008 dhe 2009, ku veçanërisht duhen përmendur të ardhurat rreth 950.000 lekë nga ekzekutimi i dy vendimeve gjyqësore në favor të nënës, në vitin 2008, të ardhurat nga puna si avokat e vëllait, G. Y., që sikur të llogariten 50% vitin mbi xhiron, janë rreth 2.000.000 lekë. Gjithashtu,

⁸⁰ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 14.07.2022, të ILDKPKI-së.

subjekti pretendon se në këtë periudhë kohore, babai i tij ka marrë kredi bankare pranë ProCredit Bank, shumë e cila tejkalon vlerën monetare të vënë si garanci për këtë kredi bankare.

38.8/c. Nga kontrolli i dokumentacionit në lidhje me shumën 1.850.000 lekë, të depozituar nga babai i subjektit, trupi gjykues konstaton se kjo depozitë është krijuar vetëm dy ditë përpara se subjekti të përfitonte kredinë në Tirana Bank, e cila ka shërbyer për sigurimin e kredisë së marrë nga subjekti. Nga të dhënat që subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, nuk është provuar me të ardhura të ligjshme mundësia financiare e prindërve të subjektit të rivlerësimit dhe vëllait të tij për të krijuar shumën prej 1.850.000 lekësh deri në momentin e depozitimit. Në lidhje me të ardhurat e vëllait të subjektit, nga hetimi ka rezultuar se nuk është provuar pagimi i detyrimeve tatimore për vitet 2008 – 2010, si dhe nga të dhënat e deklaruara për vitet 2011 – 2012, të ardhurat e tij nga aktiviteti si avokat janë në shumën rreth 200.000 lekë. Nëna e subjektit rezulton me të ardhura nga pensioni në shumën 123.569 lekë, ndërsa të ardhurat e pensionit të babait të subjektit rezultojnë në shumën 93.067 lekë. Për sa më sipër, rezulton se babai i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e shumës, e cila është përdorur si garanci për kredinë e marrë nga subjekti.

38.8/ç. Gjithashtu, trupi gjykues, në një vështrim kronologjik të fakteve dhe rrethanave të pretenduara nga subjekti, vëren se nuk ka asnjë logjikë ekonomike që babai i subjektit të merrte një kredi, që ta depozitonte në bankë për të siguruar kredinë që do të merrte vetë subjekti. Në një kohë që babai i subjektit, bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, në vitin 2009, i ka marrë atij hua shumën 400.000 lekë, i ka dhuruar shumën 30.000 lekë për mobilim, si dhe i ka mbuluar shpenzimet e dasmës, ndërkohë që gjatë këtij viti, nga hetimi rezulton se babai i subjektit ka shpenzuar shumën 2.000.000 lekë për shtesën e katit për shtëpinë e blerë në vitin 2004. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se, me të drejtë, Komisioni nuk e ka përfshirë si burim për blerjen e bonove të thesarit, në vitet 2009 dhe 2010, kredinë në shumën 1.500.000 lekë.

38.8/d. Gjithashtu, trupi gjykues mori në shqyrtim edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se: *Komisioni ka tejkaluar kompetencën në verifikimin e të ardhurave të babait, pas ai ndodhet në të njëjtën situatë si në vendimin nr. 1/2022 të Kolegjit*, dhe vlerëson se ky pretendim i subjektit nuk është i mbështetur, pasi situatat që paraqiten nuk janë të njëjta. Në vendimin e referuar prej subjektit, rezulton se shuma e përdorur si garanci bankare nuk ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë dhe as të ndonjë pasurie tjetër të krijuar në vijim nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa në rastin e subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, kredia e përfutur prej tij ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e bonove të thesarit. Për më tepër, Komisioni nuk e ka analizuar shumën 1.850.000 lekë si garanci bankare të babait të tij, por ka ngritur dyshimin si pasuri të fshehur të subjektit dhe, për rrjedhojë, ka kryer verifikimin e mundësisë së krijimit të të ardhurave të babait.

38.8/dh. Në përfundim të analizimit të shumës prej 1.850.000 lekësh, të depozituar nga babai i subjektit dhe të përdorur si garanci bankare për sigurimin e kredisë prej 1.500.000 lekësh, marrë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2009, për të cilën Komisioni ka ngritur dyshimin për pasuri të fshehur, trupi gjykues çmoi ta konsiderojë atë në vlerësimin tërësor, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

38.8/e. Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, për mundësinë e investimit në bono thesari, në datën 28.07.2009, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kishin mundësi të krijonin investimin në bono thesari për një diferencë negative në shumën (-) 1.748.669 lekë.

38.9. Në lidhje me burimin tjetër të krijimit të bonove të thesarit në vitin 2009, shumën prej 1.000.000 lekësh, të cilën bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në datën 28.07.2008, e ka depozituar *cash* në Raiffeisen Bank ShA, dhe që së bashku me interesat është tërhequr në datën 28.07.2009, në vlerën 1.066.000 lekë, Komisioni ka kryer një analizë financiare për mundësinë e krijimit të depozitës në Raiffeisen Bank, në shumën 1.000.000 lekë, në datën 28.7.2008. Nga analiza i rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e kësaj depozite në vlerën (-) 716.962,80 lekë.

38.9/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kjo shumë parash është përdorur pas tërheqjes së saj, si një nga zërat që i kanë shërbyer bashkëshortes së tij për të blerë bonot e thesarit në shumën 2.250.000 lekë, të depozituara po në datën 28.07.2009. Në lidhje me burimin e krijimit të shumës 1.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit, në pyetësorët gjatë procesit të rivlerësimit, ka deklaruar se kursimet e depozituara në bankë nga bashkëshortja e tij kanë qenë kursimet familjare të familjes së saj të origjinës. Subjekti pretendon se vjehrra e tij i ka dhënë një shumë parash bashkëshortes, e cila e përfitonte si trashëgimtare e të atit të saj, A. H.⁸¹. Subjekti shpjegon se pas dasmës të kryer në datën 06.04.2008, ai dhe bashkëshortja e tij, në vjeshtën e vitit 2008, i kanë kthyer nënës së bashkëshortes shumën prej 1.000.000 lekësh.

38.9/b. Trupi gjykues, pas analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, konstaton se ato janë kontradiktore: Në DIPP-në e vitit 2008, subjekti ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja e tij kanë një pasuri të luajtshme në shumën prej 1.000.000 lekësh, të depozituara në Raiffeisen Bank dhe nuk ka deklaruar si burim të kësaj shume të ardhurat e nënës së bashkëshortes, deklaruar prej tij vetëm gjatë hetimit administrativ në Komision. Ky konstatim bazohet dhe në vetë deklaratimet e subjektit përpara ILDKPKI-së, kur në procesverbalin e datës 16.10.2009⁸², subjekti deklaron se depozita është në emër të bashkëshortes dhe është tërhequr në qershor – korrik 2009, por nuk rezulton të ketë deklaruar që ajo është përdorur si burim për blerjen e bonove të thesarit. Në procesverbalin e datës 06.03.2015, përpara ILDKPKI⁸³-së, subjekti ka deklaruar se asetet neto të krijuara në vitin 2008 kanë qenë në vlerën 1.600.000 lekë, përkatësisht 1.000.000 lekë llogaria bankare dhe 600.000 lekë gjendje *cash*, të cilën nuk e ka deklaruar. Subjekti i rivlerësimit, edhe në memon datë 13.02.2015, paraqitur në ILDKPKI, në lidhje me këtë llogari bankare, nuk deklaron si burim të ardhurat nga prindërit e bashkëshortes.

38.9/c. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se kjo shumë është konsideruar në analizën financiare në rezultatet e para të hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se pas riçeljes së hetimit administrativ janë administruar dokumente të reja, ndër to edhe shkresa nr. {***} prot., datë 14.07.2022, e ILDKPKI-së, dokumentacioni i së cilës është cituar më lart në cilësinë e provës në lidhje me shumën 1.000.000 lekë. Pas administrimit të të gjitha provave të reja është vendosur mbyllja e hetimit dhe dërgimi i rezultateve të hetimit subjektit, për rrjedhojë, përfundimet nuk mund dhe nuk

⁸¹ Lidhur me burimin e krijimit të kësaj depozite bankare në emër të bashkëshortes A. Y., subjekti ka shpjeguar: këto kursime janë krijuar nga puna e babait të saj të ndjerë, A. H. (i vdekur në vitin 2001), rroga e nënës së saj si edukatore, nga viti 2002 e në vijim, pensionet e pleqërisë dhe të invaliditetit të gjyshërve të saj, F. dhe M. J. (të vdekur në vitet 2011 dhe 2018). Në kursimet familjare në fjalë përfshihen edhe të ardhurat që ka përfituar i ndjeri A. H. për shkak të shitjes⁸¹ së një apartamenti në datën 15.01.2001, në shumën 2.700.000 lekë. Ky apartament është shitur në rrugë joformale, pasi nuk ka qenë i regjistruar në regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme. Subjekti ka paraqitur si prova vendimin me numër {***}, datë 21.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nga përmbajtja e të cilit rezulton se, me datën 15.01.2001, shtetasit F. dhe A. H. i kanë shitur shtetases M. M. një apartament banimi me sipërfaqe 55 m², të ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, në vlerën 2.700.000 lekë.

⁸² Shih shkresën nr. {***} prot., datë 14.07.2022, të ILDKPKI-së.

⁸³ Shih shkresën kthim përgjigje të ILDKPKI-së.

duhej të ishin të njëjta me rezultatet e mëparshme të hetimit, për sa kohë nga ana e trupit gjykues është kryer një hetim më i thelluar, bazuar edhe në vetë kërkesat e subjektit, pas dërgimit të rezultateve të para të hetimit, por edhe gjatë hetimit.

38.9/ç. Nga kontrolli që Njësia e Shërbimit Ligjor i ka kryer analizës së Komisionit, deri në datën 28.07.2008, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit me të ardhurat e tij nuk kishte mundësi të krijonte kursimin prej 1.000.000 lekësh, të depozituar në bankë nga bashkëshortja e tij. Kjo analizë është kryer vetëm për subjektin e rivlerësimit, edhe pse gjatë kësaj periudhe subjekti ka pretenduar se ka jetuar me familjen e tij të origjinës. Nga kjo diferencë rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të krijonte kursime dhe të përballonte shpenzimet deri në datën 28.07.2008, për një diferencë negative të paktën sa ajo e konstatuar nga Komisioni për të njëjtën periudhë, në shumën (-) 716.962,80 lekë.

38.9/d. Nëse do të konsiderohej alternativa e propozuar nga subjekti i rivlerësimit, se për krijimin e kësaj depozite kanë shërbyer të ardhurat e bashkëshortes para martesë, atëherë do të lindte nevoja e kryerjes së analizës financiare për kthimin e kësaj shume ndaj nënës së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Nga analiza e kryer në Kolegj, për periudhën 01.11.2008 – 31.12.2008, kur subjekti pretendon se ka filluar të jetojë me bashkëshorten dhe djalin e tij, dhe gjithashtu, sipas pretendimit të subjektit se këtë shumë ia kanë kthyer nënës së bashkëshortes në vjeshtë, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk mund të përballonin shpenzimet dhe të krijojnë kursimin në shumën 1.000.000 lekë, për t'ia kthyer nënës së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për një diferencë negative prej (-) 1.556.586 lekësh.

38.9/dh. Në përfundim, në lidhje me burimin e krijimit të depozitës në Raiffeisen Bank, në shumën 1.000.000 lekë, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka kryer deklarime kontradiktore, konkretisht: i) Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar si të ardhura shumën 1.000.000 lekë, të dhuruar nga nëna e bashkëshortes, duke deklaruar vetëm shumën 150.000 lekë, në seksionin e të ardhurave të kësaj deklarate (me numër rendor 13). ii) Subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për depozitim të kësaj shume. iii) Subjekti nuk rezulton që këtë shumë ta ketë deklaruar si burim për krijimin e bonove të thesarit në DIPP-në 2009, përpara ILDKPKI-së, por edhe në deklaratën e pasurisë *vetting* (në këtë deklaratë, subjekti ka bërë një deklaram të përgjithshëm për sa i përket burimit, duke deklaruar kursime dhe të ardhura familjare gjatë martesës). Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për mopërfshirjen e shumës prej 1.000.000 lekësh në analizën financiare si burim për krijimin e bonove të thesarit në vitin 2009.

Në përfundim të analizës financiare për krijimin e bonove të thesarit, për vitin 2009, rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e tyre.

Në lidhje me bonot e thesarit të krijuara në vitin 2010

38.10. Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 1.157.759,41 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka kryer deklaram të pasaktë, të paplotë dhe të pamjaftueshëm për këtë pasuri, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “a”, të nenit 33/5, të ligjit nr. 84/2016.

38.10/a. Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me burimin e krijimit të këtyre bonove, më datë 05.04.2010, ka pretenduar se për financimin e tyre kanë shërbyer si burim: **1. akumulimi i kursimeve familjare të rrogës time deri në këtë datë; 2. i rrogës së bashkëshortes time; 3. gjendja cash prej 400.000 lekësh,**

e deklaruar në DIPP 2009 (e cila është deklaruar në mënyrë jo të qartë në fq. 3 të DIPP 2009, si hua prej 400.000 lekësh, pavarësisht se nuk ka qenë e tillë)⁸⁴. Subjekti pretendon se për vitin 2010, pamundësia financiare prej (-) 383.064 lekësh nuk vjen realisht nga mungesa e mjeteve monetare, por është shkaktuar nga një gabim në raportim (deklarim) në DIPP-në 2009, pasi gabimisht në këtë deklaratë periodike nuk ka deklaruar kursime në fund të vitit, ndonëse nga analiza financiare e vitit 2009 rezulton me një balancë pozitive prej 991.236 lekësh.

38.10/b. Trupi gjykues konstaton se në deklaratën e interesave periodike të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Llogari në Bankën e Shqipërisë (bono thesari), në emër të A. Y., në shumën 1.750.000 (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të depozituara në muajin korrik 2010”*. Në lidhje me burimin e krijimit të tyre, në procesverbalin e datës 16.11.2011⁸⁵, mbajtur në ILDKPKI, subjekti deklaron se bonot e thesarit të krijuara në korrik të vitit 2010 e kanë burimin nga pakësimi i gjendjes *cash* të mbartur nga viti 2009, pra 400.000 lekë kursime +100.000 lekë kthim huaje, dhënë vëllait + 300.000 lekë interesa nga bono e vitit 2009 + kursime nga pagat deri në korrik 2010, si dhe 400.000 lekë të marra në formën e borxhit, nga babai i tij F. Y.

38.10/c. Lidhur me huan e pretenduar të marrë nga babai i tij, në shumën 400.000 lekë, e cila ka shërbyer si burim krijimi për bonot e thesarit, trupi gjykues konstaton se kjo hua nuk është deklaruar si burim për krijimin e bonove në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe në DIPP-në e vitit 2010. Gjithashtu, nuk rezulton që subjekti në DIPP-në 2010 të ketë deklaruar marrjen e kësaj huaje. Në kushtet kur nuk ka gjurmë në dokumentet e kohës, si dhe rezulton e padeklaruar prej subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare këtë hua.

38.10/ç. Në lidhje me pretendimin e subjektit, se kishte kursime *cash* në vlerë më të lartë dhe pasaktësia ka ardhur si pasojë e depozitimit të shumës për blerjen e bonove të thesarit përpara deklarimit të tij periodik të vitit 2009, ky pretendim i tij nuk përputhet me të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ. Sipas të dhënave bankare rezulton se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka kryer derdhje *cash* 1.750.000 lekë, në llogari dhe kalim në bono thesari në Bankën e Shqipërisë, në datën 05.04.2010, pra, sikurse vërehet, depozitimi është kryer pas plotësimit të deklaratës periodike vjetore të subjektit dhe se ai nuk kishte si të ngatërrohej në lidhje me deklarimin e gjendjes *cash* të tij dhe burimit që ka shërbyer për krijimin e shumës së depozituar. Subjekti në DIPP-në 2009 ka deklaruar se ka pasur kursime *cash* në shumën 400.000 lekë dhe këto kursime janë përfshirë në analizën financiare.

38.10/d. Trupi gjykues konstaton se subjekti është përpjekur të japë shpjegime të ndryshme në lidhje me burimin e këtyre bonove të thesarit, si dhe të kursimeve *cash* të tij, me qëllim përmirësimin e situatës së tij financiare. Në përfundim, pas kontrollit të analizës financiare të Komisionit dhe vlerësimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të kryente investimin në bono thesari në datën 05.04.2010, në shumën (-) 1.093.286 lekë,

⁸⁴ Këtë shumë parash, unë ia kam dhënë babait tim, në vitin 2011; 100.000 lekë që më janë kthyer nga vëllai, pasi ia kisha dhënë borxh në vitin 2009, e deklaruar në DIPP-në 2009, si dhe pjesa e papërdorur e kredisë të marrë në vitin 2009 tek Tirana Bank ShA, që unë gabimisht nuk e kam deklaruar saktësisht në DIPP 2009 (duke u shprehur vetëm se kam marrë një kredi tek Tirana Bank, në shumën 1.500.000 lekë, të cilën kam marrë përsipër ta shlyej për 40 muaj). Kjo ka qenë kredi konsumatore, që familja jonë e ka përdorur shumë pak në vitin 2009, duke financuar vetëm një udhëtim në Turqi, që ka kushtuar rreth 1000 euro, ndërsa pjesën tjetër të saj e kemi përdorur për të plotësuar (krahas burimeve të tjera) bonon e krijuar më datën 28.07.2009 (pra është përdorur një pjesë e vogël e kësaj kredie), ndërsa pjesën e mbetur të kësaj kredie e kemi përdorur për të financuar bonon e datës 05.04.2010.

⁸⁵ Shih shkresën nr. {***} prot., datë 14.07.2022, të ILDKPKI-së.

për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për krijimin e bonove të thesarit në vitin 2010.

Në lidhje me bonot e thesarit të krijuara në vitin 2011

38.11. Subjekti i rivlerësimit, duke kundërshtuar analizën e Komisionit, e cila ka konstatuar mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 195.856,77 lekë, për krijimin e bonove të vitit 2011, pretendon se, në mënyrë të padrejtë, Komisioni ka llogaritur shpenzime TIMS në analizën financiare e tij, pasi udhëtimet e kryera me familjen janë bërë në muajt nëntor, dhjetor 2011, pra pas depozitimit të bonove të thesarit në muajin mars dhe korrik. Subjekti kërkon të rishikohen shpenzimet jetike të familjes së tij për vitin 2011, pasi ka pasur një djalë të mitur. Subjekti pretendon se Komisioni, për sa kohë në analizat financiare të viteve 2009, 2010 nuk e njih borxhin e marrë nga babai, nuk duhet të përfshijë zërin *“Kthim huadhënie babait në shumën 100.000 lekë”*. Komisioni nuk ka llogaritur overdraftin në shumën 148.965 lekë.

38.11/a. Nga vlerësimi i akteve të administruara në dosjen e Komisionit, trupi gjykues konstaton se, në deklaratën e pasurisë të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit deklaron: *“Llogari në Bankën e Shqipërisë (bono thesari), në emër të A. Y., në shumën 3.060.000 (tre milionë e gjashtëdhjetë mijë) lekë, të depozituara në muajin korrik 2011. 2- Llogari në Bankën e Shqipërisë (bono thesari), në emër të A. Y., në shumën 1.900.000 (një milion e nëntëqind mijë) lekë, të depozituara në muajin prill 2011”* ... *“cash 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë”*.

38.11/b. Në lidhje me burimin e krijimit të bonove të thesarit, më datë 31.03.2011, subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3 ka shpjeguar se për financimin e tyre kanë shërbyer si burim kursimet familjare nga të ardhurat e deklaruara në DIPP-në 2010 dhe DIPP-në 2011. Për bonon e thesarit për të cilën, më datë 18.07.2011, janë derdhur *cash* 750.000 lekë, për financimin e tyre kanë shërbyer si burim: (1) kursimet familjare nga të ardhurat e deklaruara në DIPP-në 2010 dhe DIPP-në 2011, pra gjendja *cash* prej 120.000 lekësh nga viti paraardhës (shih f. 4 të DIPP-së 2010, të plotësuar më datë 23.03.2011) dhe (2) kursimet familjare deri në datën 18.07.2011, kur është bërë shtesa e fondeve për rinovimin e bonos.

38.11/c. Trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të Komisionit, duke rishikuar edhe zërat e saj, sipas pretendimit të tij për sa i përket shpenzimeve të udhëtimit, shpenzimeve jetike etj. dhe i rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të kryente depozitimin e shumës në vlerën 150.000 lekë, në datën 31.03.2011. Ndërsa, në lidhje me mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të derdhur *cash*, në datën 18.07.2011, në llogarinë e tij bankare shumën prej 750.000 lekësh dhe njëkohësisht investimit në bono thesari, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të investuar në bono thesari për një diferencë negative të paktën sa ajo e rezultuar në Komision, në vlerën 195.857 lekë. Për më tepër, vetë subjekti i rivlerësimit, në parashtrimet e paraqitura në Komision, në përgjigje të barrës së provës, në faqen 95 të tyre, në analizën financiare të përgatitur nga ai vetë, mbi mundësinë e krijimit të bonove të thesarit më datë 18.07.2011, rezulton me një rezultat negativ në vlerën prej (-) 123.139 lekësh.

38.11/ç. Trupi gjykues ka vlerësuar ta konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij, për sa ka të bëjë me një vlerë, e cila nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore.

Në lidhje me bonot e thesarit të krijuara në vitin 2012

38.12. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mungesa e burimeve financiare të ligjshme për mundësinë e krijimit të bonove të thesarit për vitin 2012, në vlerën prej (-) 238.530,87 lekësh, e konstatuar prej Komisionit, është e pabazuar. Sipas subjektit, në mënyrë të padrejtë, Komisioni nuk ka llogaritur në analizën financiare huan e marrë nga O. Y., pasi shuma 5.000 euro, që i ka marrë hua atij, ka shërbyer për krijimin e bonos së dytë të vitit 2012 dhe, pikërisht, atë të datës 23.07.2012, dhe jo të bonos së parë, të datës 05.04.2012. Komisioni ka llogaritur gabim shpenzimet jetike për djalin e tij të mitur, si dhe gjendjen *cash* në shumën 750.000 lekë, deklaruar në DIPP-në e vitit 2011.

38.12/a. Me qëllim analizimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për këtë shkak ankimi, trupi gjykues mori në analizë deklaratimet e subjektit dhe konstaton se subjekti në DIPP-në 2011 ka deklaruar kursime *cash* në shumën 750.000 lekë, pakësimin e të cilave e ka deklaruar në vitin 2012 për blerjen e bonove të thesarit. Komisionit i ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* në shumën (-) 452.500,47 lekë, diferencë e cila konfirmohet edhe në Kolegj, pas analizës së kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor.

38.12/b. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësin nr. 3, ka deklaruar se në lidhje me burimin e krijimit të bonove të thesarit, për të cilat, më datë 05.04.2012, janë derdhur *cash* 900.000 lekë, kanë shërbyer si burim: *1. akumulimi i gjendjes cash prej 750.000 lekë (të deklaruar në f. 4 të DIPP-së 2011, të plotësuar me datën 19.03.2012) dhe 2. kursimet deri në datën 05.04.2011, kur është bërë shtesa e fondeve për rinovimin e bonos së thesarit. Për bonon e thesarit, për të cilën, më datë 23.07.2012, janë derdhur cash 930.000 lekë, kanë shërbyer si burim: 1. akumulimi i kursimeve familjare deri në datën 23.07.2012 dhe 5000 euro, që ia kam marrë borxh djalit të xhaxhait tim, O. Y.*⁸⁶.

38.12/c. Trupi gjykues, në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se si burim krijimi për bonot e thesarit ka shërbyer huaja në shumën 5.000 euro, marrë marrë z. O. Y., konstaton se: subjekti, pas kalimit të rezultateve të hetimit, me qëllim provimin e mundësisë financiare të huadhënësit, z. O. Y., ka depozituar: Ekstraktin e llogarisë së sigurimeve shoqërore, datë 18.05.2022, për z. O. Y., nga ku rezulton se ai, nga viti 2001 deri në vitin 2011, ka përfutur të ardhura në total 209.651.24 euro. Deklaratë zëvendësuese e aktit provues, datë 20.05.2022, sipas së cilës z. O. Y. deklaron se në muajin prill/maj të vitit 2012 ka pritur subjektin dhe bashkëshorten e tij pranë banesës të ndodhur në Brescia. Z. Y. deklaron se i ka dhënë hua shumën 5.000 euro për blerjen e një autoveture dhe në muajin dhjetor i është kthyer shuma 5.000 euro. Me rastin e lindjes së fëmijës së parë, i ka dhënë shumën 500 euro. Komisioni ka konstatuar se kjo deklaratë noteriale nuk përputhet me deklaratimet e subjektit⁸⁷.

⁸⁶ Në lidhje me këtë borxh, në përgjigjet e pyetësorit standard, jam shprehur se: "...Rreth muajit prill të vitit 2012, unë kam qenë në Itali bashkë me bashkëshorten time. Aty kam takuar djalin e xhaxhait tim, të quajtur O. K. Y., që së bashku me familjen e tij jeton që nga viti 1995 në Itali. Atij i kam marrë hua shumën prej 5000 (pesë mijë) euro, sepse kam dashur të blej një automjet të përdorur, në Itali apo Gjermani, pasi sikurse është e njohur botërisht, po të blihet një automjet jashtë shtetit, merret në një gjendje më të mirë teknike, si dhe më çmim më të favorshëm. Burimi i kësaj huaje që më ka dhënë shtetasi O. Y. në atë kohë, kanë qenë të ardhurat dhe/apo kursimet familjare të familjes së tij, ndër vite. Gjithashtu, ju bëj me dije se huan në fjalë e kam shlyer brenda vitit 2012, disa muaj pasi e kam marrë. Kjo pasi nuk e kam blerë automjetin që kam patur për qëllim për të blerë në kohën e marrjes së huas. Faktin e marrjes së huas dhe kohën e shlyerjes së saj, e kam deklaruar në DIPP, që është dorëzuar prej meje në ILDKPKI, në periudhën korresponduese. Në DIPP-në 2012, të plotësuar në datën 15.03.2013, jam shprehur se: "...5000 euro që ia kam marrë borxh djalit të xhaxhait, O. K. Y. (me banim në Itali), në muajin maj, (kur kam qenë në Itali), të cilin nuk e kam blerë dhe ia kam kthyer përsëri në muajin dhjetor...", si dhe 2. interesat e bonos së thesarit të datës 05.04.2012.

⁸⁷ Në pyetësin standard, subjekti për këtë udhëtim ka deklaruar se: Në datat 13.04.2012 – 16.04.2012, unë dhe bashkëshortja ime kemi udhëtuar në Itali, me avion. Me sa mbaj mend, linja e fluturimit të avionit ka qenë Rinas - Venecia. Aty kemi udhëtuar me tren në qytetin e Padovas, ku jemi pritur nga djali i xhaxhait tim, O. Y., me banim në Itali, që nga viti 1994 ose 1995. Aty kemi fjetur në një hotel që nuk e kujtoj më. Të nesërmen kemi udhëtuar në Firence dhe jemi kthyer brenda të njëjtës ditë, ku kemi fjetur në një hotel tjetër, po në Padova, për pjesën e mbetur të kohës. Shpenzimet e hotelit

38.12/ç. Në lidhje me pretendimin e subjektit për burimin e dytë të krijimit të bonove të thesarit, konkretisht huan e marrë z. O. Y., trupi gjykues konstaton se kjo hua është deklaruar nga subjekti që në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2012. Mospërputhja e evidentuar nga Komisioni midis deklaratës së datës 20.05.2022, të z. O. Y., dhe të dhënave në sistemin TIMS nuk qëndron, pasi në këtë deklaratë huadhënësi deklaroi se: *në muajin prill/maj të vitit 2012 ka pritur subjektin dhe bashkëshorten e tij pranë banesës së ndodhur në Brescia, i ka dhënë hua shumën 5.000 euro për blerjen e një automjeti dhe në muajin dhjetor i është kthyer kjo shumë.* Kjo periudhë përkon me të dhënat e sistemit TIMS, ku rezulton se subjekti ka udhëtuar në datën 13.04.2012, në Venezia dhe është kthyer në datën 16.04.2012. Komisioni në konstatimin e mospërputhjeve i referohet deklaratimeve të subjektit në pyetësorin standard, mbi përgjigjet e dhëna prej tij në funksion të pyetjes nr.12, mbi udhëtimet jashtë shtetit, ku deklaroi se ai ka shkuar në Venezia duke udhëtuar drejt qytetit të Padovas, është pritur nga kushëririn e tij, i cili i ka dhënë edhe shumën 100 euro me rastin e dasmës.

38.12/d. Nga sa më lart, për sa kohë subjekti e ka deklaruar huan në shumën 5.000 euro në DIPP-në e vitit 2012, ai ka depozituar dokumentacion justifikues për të ardhurat e O. Y. në shtetin italian, si dhe ka një deklaratë (deklarata e datës 20.05.2022 e huadhënësit, që konfirmon dhënien dhe marrjen e shumës 5.000 euro) në mbështetje të dokumenteve të kohës kur është kryer veprimi, trupi gjykues vlerëson ta përfshijë si të ardhur të ligjshme në analizën financiare të subjektit huan në shumën 5.000 euro, cila ka shërbyer si burim për blerjen e bonove të thesarit. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me të ardhura të mjaftueshme për krijimin e investimit në bono thesari në datën 23.07.2012.

38.13. Në lidhje me bonot e thesarit të krijuara në vitin 2013, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë konstatimin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit gjendet në pamundësi financiare për të kryer këtë investim për një diferencë prej (-) 6.500 lekësh, si dhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim, se arsyeja se përse rezulton me diferencë negative është për shkak se nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e tij të përfituara nga mësimdhënia, vlerëson se kjo shumë e konstatuar nuk merr peshë në balancën negative të subjektit, e për rrjedhojë, nuk ndikon në vendimmarrjen e tij, aq më tepër që Komisioni nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit për bonot e thesarit të krijuara në vitin 2013.

38.14. Në përfundim, për pasurinë “bono thesari”, në vlerën 3.150.000 lekë, me datë emetimi 07.04.2016 dhe datë maturimi 06.04.2017 dhe bono thesari, në vlerën 4.200.000 lekë, me datë emetimi 22.12.2016 dhe datë maturimi 21.12.2017, të depozituara në emër të bashkëshortes së subjektit, A. Y., në Bankën e Shqipërisë, pasi kontrollon mundësinë financiare të investimit në këto asete/pasuri në vitet 2009 – 2013, trupit gjykues, ashtu si edhe Komisionit, i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të kryente këto investime dhe të përballonte shpenzimet me të ardhura të ligjshme për këto vite, duke u gjendur në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë, si dhe të mungesës së burimeve financiare të ligjshme, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

janë paguar nga vetë unë, në mos gaboj 50 (pesëdhjetë) - 60 (gjashtëdhjetë) euro për person, por paratë më janë dhënë nga djali i xhaxhait tim, O. Y., që më dhuroi 200 (dyqind) euro (duke më thënë: “Çoja djalin nga ana ime”). Nuk besoj që kostoja totale të më ketë shkuar më shumë se 500 (pesëqind) – 600 (gjashtëqind) euro, së bashku me shpenzimet e udhëtimit, që janë përballuar nga ana jonë. Në këtë pyetësor, subjekti ka deklaruar se z. O. Y. i ka dhënë shumën 100 euro me rastin e dasmës.

39. Për pasurinë “apartament në përdorim, me sip.73 m²”, lagjja “{***}”, bulevardi “{***}”, pallati {***}, Shkodër, Komisioni vlerësoi se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën (-) 383.137,94 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, dhe vlerësoi ta konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

39.1. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit, pretendon se të ardhurat familjare për vitet 1992 – 2004, (kur babai i tij ka dalë në rezervë si ish-ushtarak), e deri në momentin e blerjes së apartamentit (2004), kanë qenë më se të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës dhe blerjen e apartamentit. Gjithashtu, sipas subjektit, edhe nëse merren në konsideratë vetëm të ardhurat nga pagat e përfituara gjatë viteve 2003 dhe 2004 nga subjekti, motra e tij, nëna e tij, si dhe pensioni i babait për të njëjtat vite, së bashku me të ardhurat nga shitja e apartamentit në Bushat, Shkodër, në shumën prej 430.000 lekësh, dhe gjendja cash e kursyer prej tij në vitin 2003 (sipas DPV-së 2003, ku në faqen 8, ai ka deklaruar se ka kursyer nga pagat shumën prej 200.000 lekësh), rezulton se blerja e apartamentit për shumën 1.000.000 (një milion) lekë, jo vetëm që mbulohet plotësisht me të ardhura të ligjshme, por edhe tejkalohet.

39.1/a. Trupit gjykues, nga analizimi i dokumentacionit lidhur me këtë pasuri, i rezultoi se kjo pasuri me sip. 73 m² është blerë sipas aktit të shitblerjes me nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., më datë 20.07.2004, kundrejt çmimit prej 1.000.000 lekësh. Shuma është likuiduar jashtë zyrës noteriale dhe figuron e regjistruar në bashkëpronësi të prindërve të subjektit.

39.1/b. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2004, 2005, 2006 dhe 2007 adresë banimi: Lagjja “{***}”, rruga “{***}”, pallati {***}, Shkodër. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në përdorim në DIPP-në e vitit 2004, por nuk ka deklaruar vlerën e blerjes, burimin dhe pronësinë (në emër të kujt është kjo pasuri).

39.1/c. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka pasur në përdorim pasurinë “apartament” në Shkodër, lagjja “{***}” ({***}), bulevardi “{***}”, pallati {***}, hyrja e parë, kati i pestë, ku ka banuar nga data 20.07.2004 dhe deri në gjysmën e parë të janarit të vitit 2008. Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, ka depozituar kontratë sipërmarrje nr. {***}, datë 06.02.2009, sipas së cilës babai i subjektit ka porositur ndërtimin e objektit shtesë kati banesë mbi këtë apartament, në shumën 2.070.900 lekë.

39.1/ç. Trupi gjykues e konsideron të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk ka qenë i legjitimuar të kryejë një hetim të plotë në lidhje me këtë pasuri, pasi ai ka pasur dhe ka lidhje interesi me pasurinë e paluajtshme në fjalë për shkak të përdorimit të saj dhe si bashkëfinancues për blerjen e pasurisë “apartament”. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting kontributin e tij financiar dhe as burimin e krijimit të kësaj pasurie të përdorur në vitet 2004 – 2008. Në kushtet kur në përgjigje të pyetësorëve subjekti ka deklaruar se burimi për blerjen e kësaj pasurie ka qenë kontributi i tij dhe i familjarëve, u analizuan këto të ardhura si vijon.

39.1/d. Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për të përfshirë në analizë të ardhurat e motrës së tij nga paga, duke qenë se ajo ka kontribuar me pagën e saj deri në vjeshtën e vitit 2004, trupi gjykues konstaton se motra e subjektit të rivlerësimit, A. P., i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke qenë se ka ushtruar detyrën e prokurores. Në datën 01.11.2021, për subjektin e rivlerësimit A. P. është shpallur nga Komisioni vendimi nr. {***}, duke marrë masën e shkarkimit

nga detyra. Ky vendim është lënë në fuqi edhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në datën 13.11.2024. Nga një vështrim *prima facie* të vendimit të Komisionit, rezulton se motra e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë blerë një apartament në datën 24.11.2004. Në dinamikë të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe hetimit të kryer nga Komisioni në lidhje me subjektin e rivlerësimit A. P., Komisioni ka përfshirë në analizën financiare për mundësinë e krijimit të pasurisë “apartament”, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj gjatë vitit kalendarik 2004, për rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara nga subjekti të përfituara nga motra e tij gjatë vitit 2004 nuk mund të përfshihen në analizën për blerjen e pasurisë të babait të subjektit të rivlerësimit, në datën 20.07.2004, kur vetë motra e subjektit, në nëntor të vitit 2004, ka blerë një apartament për veten e saj.

39.1/dh. Për sa i përket pretendimeve të subjektit në lidhje me kursimet *cash*, nuk rezulton që subjekti në DIPP-në e vitit 2004 të ketë deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* të shumës 200.000 lekë, madje për më tepër ka pretenduar se ka shtuar shumën 200.000 lekë. Kjo shumë, së bashku me kursimet e tjera, i është llogaritur subjektit në analizën financiare për blerjen e shtëpisë në vitin 2006. Për sa i përket shumës 430.000 lekë, të cilën subjekti pretendon se prindërit e tij e kanë përfutur nga shitja e banesës në vitin 1999, Komisioni e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare deri në vitin 2003, pasi pas vitit 2003 subjekti ka deklaruar rregullisht kursime *cash* dhe, për rrjedhojë, kjo shumë nuk mund të përfshihet në analizë, për sa kohë nuk rezulton të jetë deklaruar si e tillë. Në lidhje me pretendimin e subjektit, se në deklaratat periodike ka deklaruar vetëm kursimet e tij *cash*, ky pretendim i tij nuk qëndron, pasi nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, ai në vitin 2005 ka deklaruar si kursime *cash* edhe të ardhurat e babait të tij (pranuar nga ana e tij dhe në faqen 19 të dokumentit “Memo-KPK-Shkodra⁸⁸”), ndërkohë që në vitin 2006, për shumën 3.300.000 lekë, të deklaruar si kursim *cash*, shprehet se kjo është e përbashkët. Për sa më lart, pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë të bazuara në prova.

39.2. Në përfundim, për pasurinë “apartament me sip. 73 m²”, lagjja “{***}”, bulevardi “{***}”, pallati {***}, Shkodër, deklaruar në përdorim gjatë hetimit administrativ, në pronësi të prindërve të subjektit të rivlerësimit, si dhe deklaruar nga subjekti se ka kontribuar në krijimin e saj, trupi gjykues, ashtu si Komisioni, vlerësoi se subjekti ka mungesë burimesh financiare të ligjshme, në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke e konsideruar pa peshë përcaktuese, e cila si e vetme nuk përbën shkak autonom për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit.

40. Lidhur me analizën financiare

40.1. Komisioni, pas kryerjes së analizës financiare, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nga fillimi i detyrës deri në deklaratën *vetting* ka mungesë burimesh financiare të ligjshme në vlerën 4.506.279,70 lekë. Përveç konstatimeve të Komisionit, në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme të të ardhurave, edhe vetë subjekti i rivlerësimit në prapësimet⁸⁹ e tij ka pranuar një rezultat negativ kumulativ në shumën 1.536.333 lekë.

40.1. Trupi gjykues, pasi kontrollloi analizën financiare të kryer në Komision, për periudhën 2003 – 2016, vlerësoi të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive, përballimin e shpenzimeve dhe krijimin e

⁸⁸ Ky fakt është pranuar prej tij, në faqen 19 të dokumentit “Memo-KPK-Shkodra”, ku shprehet tekstualisht: “Fakti që shuma në fjalë është akumulim i kursimeve familjare për tri vite (2004, 2005 dhe 2006), del jo vetëm nga përshkrimi i sipërpërmendur në DPV/2006, por edhe nga shpjegimet me shkrim që kam dhënë në vitet 2009, 2011 dhe 2015, në ILDKPKI, sipas nenit 27 të ligjit nr. 9049/2003 (i ndryshuar)”.

⁸⁹ Referohu në f. 69, f. 90 dhe f. 97 të shpjegimeve të tij, me emërtimin “Memo-KPK-Shkodra” dhe f. 75 të shpjegimeve me emërtimin “Memo”, për raportin e vlerësimit nëntor 2022.

kursimeve në kuptim të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, në një vlerë të paktën sa ajo e konstatuar nga Komisioni në vendimin nr. 604, datë 21.12.2022.

40.2. Në përfundim, në analizë të qëndrimeve të mësipërme, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arrin nivel të besueshëm lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe se ai gjendet në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm për këtë kriter, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

Për kriterin e kontrollit të figurës

41. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK)⁹⁰ ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit dhe, në datën 26.09.2022, i ka dërguar Komisionit raportin e përditësuar, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 10.10.2022, ku citohet ndër të tjera se: *Gjatë periudhës në të cilën subjekti ushtronte detyrën si gjyqtar, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive. Gjithashtu, për subjektin, z. Andri Ymeri, në cilësinë e gjyqtarit, ka ushtruar ndikim të paligjshëm në disa procese gjyqësore, duke dhënë vendime favorizuese gjatë gjykimit të çështjeve lidhur me tjetërsimin e pronave publike. Institucionet verifikuese kanë informuar instancat kompetente.* Sipas DSIK-së, kjo veprimtari e paligjshme i përmbahet përcaktimit të pikës 8, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ku përfshihen veprat penale të nenit 75/a të K. Pr. Penale, “Krim i organizuar, trafikim dhe korrupsion”. Në përfundim, grupi i punës ka ndryshuar konstatimin fillestar, nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës, në papërshtatshmëri në vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit.

41.1. Komisioni arriti në përfundimin se konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës lidhet me dyshimet për favorizim të palëve në gjykim, që duket se përputhet me rezultatet e hetimit, nga analizimi i dosjeve gjyqësore nga Komisioni. Duke qenë se ky rezultat nuk përmbush kushtet e nenit 61, pikat 2 dhe/ose 3 të ligjit nr. 84/2016, këto konstatime Komisioni i vlerësoi në tërësi të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

41.1/a. Trupi gjykues konstaton se Komisioni, pasi ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucioneve, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, përveç elementeve që ka marrë në konsideratë në procedurat e rivlerësimit të figurës, ka konstatuar defekte dhe mangësi që duhet të konsiderohen edhe në kriterin e kontrollit të aftësive profesionale të subjektit. Për këtë arsye, elemente të rivlerësimit janë gërshtuar në të dyja kriteret e mëposhtme të rivlerësimit.

41.2. Subjekti i rivlerësimit në ankim, por edhe në parashtrime, kundërshton konkluzionet e Komisionit lidhur me kriterin e kontrollit të figurës, në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

41.2/a. Lidhur me ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit, për shkak të lidhjeve shoqërore dhe familjare me avokatin L. K., subjekti pretendon se njohja shoqërore nuk nënkupton konflikt interesi. Sipas tij, ligji nr. 8116, datë 29.3.1996, i ndryshuar, Kodi i Procedurës Civile) kërkon një lidhje konkrete interesi, jo thjesht një njohje të zakonshme, pasi të qenët shok shkolle nuk krijon

⁹⁰ DSIK ka dërguar një raport me shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me Vendim të KDZH-së nr. {***}, datë 12.07.2022. Në datën 26.09.2022, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. {***} prot., të përditësuar, të kontrollit të figurës, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 10.10.2022.

automatikisht ndonjë detyrim për dorëheqje nga çështjet. Sipas subjektit, udhëtimi me një person nuk do të thotë që ekziston një lidhje që ndikon profesionalizmin e një gjyqtari.

41.2/b. Subjekti pretendon se shkeljet e supozuara lidhur me nenin 155/1 të Kodit të Procedurës Civile i përkasin viteve 2004, 2005, qartazi janë jashtë periudhës së rivlerësimit, ndërsa për çështjet që i përkasin viteve 2006 – 2009 nuk ka një vendim të ndërmjetëm të relatores për shtrirjen e hetimit administrativ edhe për këtë periudhë. Gjithashtu, subjekti pretendon se këto mangësi nuk mund të trajtohen në kriterin e kontrollit të figurës. Subjekti kundërshton shkeljet e konstatuara të nenit 155/1 të Kodit të Procedurës Civile, pasi sipas tij nuk përputhen me parimet e objektivitetit, proporcionalitetit dhe barazisë në trajtim me subjektet e tjera, për rrjedhojë, nuk mund të shkarkohet nga detyra për shkak të disa shkeljeve të supozuara minore, që nuk kanë pasur asnjë ndikim në vendimet përmbyllëse të procedurave gjyqësore.

41.2/c. Lidhur me shkeljen e supozuar të afatit ligjor 10-ditor për caktimin e seancave gjyqësore, subjekti pretendon se Komisioni, paligjshmërisht, e quan “favor”, neglizhon me dashje natyrën e qartë “tejet simpliste” të gjykimeve ku ka “gjetur” këto shkelje, sikurse janë: 1) kërkesë me objekt *lëshim dëshmie testamentare*; 2) kërkesë me objekt *sigurim prove*; 3) disa gjykime me objekt *vërtetim gjyqësor fakti pa palë*: kryesisht njohje vjetërsie në punë, në marrëdhënie pune me ish-kooperativat bujqësore etj. Sipas subjektit, vetë natyra e këtyre gjykimeve e përjashton mundësinë që të ketë bërë favore gjyqësore në këto gjykime.

41.3. Trupi gjykues vëren se Komisioni, referuar informacioneve të marra nga organet ligjzbatuese, sipas të cilave rezulton se subjekti ka lidhje shoqërore dhe familjare me avokatin L. K., ka administruar dhe vlerësuar pesë dosje gjyqësore, në të cilat njëra nga palët gjyqësore është shtetasi I. K., babai i avokat L. K.,⁹¹ konkretisht:

(1) Në lidhje me çështjen gjyqësore, regjistruar në datën 14.07.2005, me kërkues I. K. dhe objekt “*Lëshim urdhër ekzekutimi të vendimit nr. {***}, dt.10.05.2004*”, subjekti i rivlerësimit, me vendimin e datës 14.07.2005, ka vendosur “*Pranimin e kërkesës*”.

41.3/a. Komisioni, pasi ka konstatuar se: (i) në dosje nuk gjendet njoftimi dërguar palës kërkuese për caktimin e seancës gjyqësore; (ii) pala kërkuese është babai i avokatit L. K., me të cilin rezulton se subjekti ka lidhje shoqërore, ka çmuar se mungesa e njoftimit të palës kërkuese, si dhe gjykimi në kushtet e konfliktit të interesit, ndonëse do të jenë pjesë e vlerësimit etik e profesional të subjektit, e ka konsideruar këtë moment në funksion të dyshimit për favorizim të palës në proces.

41.3/b. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, ashtu sikurse ka shpjeguar në Komision, njoftimi i palëve nuk është detyrë e gjyqtarit, por e sekretarit gjyqësor dhe e nëpunësit gjyqësor (ftuesit), sipas neneve 77/3 dhe 78/2 të Kodit të Procedurës Civile. Gjyqtari ka kompetencë mbikëqyrëse dhe kontrolluese përkundrejt sekretarit dhe ftuesit, por në rastin konkret, vetë fakti i paraqitjes së të njoftuarit në gjykim ka bërë që, sipas vlerësimit të tij, të bien në dekadencë pretendimet e mundshme lidhur me njoftimin e shtetasit I. K. Subjekti ka pretenduar se, për arsye praktike (për t’u mos u mbingarkuar), sekretaria e gjykatës aplikon mënyra të tjera njoftimi të parashikuara në nenin 144 të Kodit të Procedurës Civile⁹².

⁹¹ Marrëdhënia e shtetasit L. K. me subjektin e rivlerësimit është analizuar në pjesën e fundit të këtij vendimi.

⁹² “Njoftimi mund të kryhet në çdo mënyrë tjetër, që garanton një njoftim të rregullt, për sa kohë që personi i thirrur konfirmon personalisht me shkrim se ka marrë njoftimin”.

Sipas subjektit, paraqitja e shtetasit I. K. dhe dokumentimi i faktit të paraqitjes me procesverbal gjyqësor nuk është gjë tjetër veçse konfirmim me shkrim i faktit që njoftimi ka qenë jo vetëm bindës, por edhe se e ka realizuar qëllimin për të cilin është destinuar, ndërsa në lidhje me konfliktin e interesit, subjekti ka pretenduar se, për sa kohë nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me z. L. K., nuk është as me babain e tij.

41.3/c. Nga shqyrtimi i fashikullit gjyqësor që i përket kësaj çështjeje, trupi gjykues konstaton se në kërkesën e z. I. K. nuk gjendet asnjë e dhënë për sa i përket adresës së banimit të tij apo numër kontakti, për të bërë të mundur njoftimin e tij nga ana e sekretarisë gjyqësore. Gjithashtu, në dosjen gjyqësore nuk gjendet i administruar njoftimi i këtij shtetasi, detyrim ligjor i parashikuar nga neni 128 i Kodit të Procedurës Civile i kohës së shqyrtimit të çështjes gjyqësore, ku parashikohet se thirrja në gjykatë bëhet me letërthirrje, e cila si rregull njoftohet me anë të nëpunësit gjyqësor. Neni 144 i Kodit të Procedurës Civile, të cilit i referohet subjekti në kohën e shqyrtimit të çështjes gjyqësore, parashikonte se gjykata mund të urdhërojë me vendim edhe mënyra të tjera njoftimi nga ato të parashikuara nga ligji, si nëpërmjet telegramit me përgjigje, me faks kur vërtetohet me shkrim marrja e tij, me shkresë dorazi dhe me mënyra të tjera, që garantojnë një njoftim të rregullt, kur e kërkojnë rrethana të veçanta ose nevoja e një njoftimi të shpejtë. Trupi gjykues vlerëson se mungesa në dosjen gjyqësore e akteve për njoftimin e seancës gjyqësore, jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 128 të Kodit të Procedurës Civile, por tregon qartë për një njohje personale miqësore të subjektit me kërkuessin, I. K. Kjo miqësi e tyre dëshmohej dhe provohet nga mungesa e nevojës për të kryer njoftimet procedurale sipas kërkesave të ligjit, sikurse për një palë të zakonshme pjesëmarrëse në gjykim, madje prezenca e z. K. në seancën gjyqësore tregon se për njoftimin është përdorur komunikimi i drejtpërdrejtë i gjyqtarit me palën, që të çon në konkluzionin e lidhjes mes tyre, për sa kohë që nuk ka asnjë gjurmë të asnjë komunikimi sipas procedurës ligjore.

41.3/ç. Trupi gjykues konstaton se, megjithëse kjo kërkesë e marrë në shqyrtim nga subjekti ka për objekt “*Lëshim urdhër ekzekutimi të vendimit nr. {***}, dt.10.05.2004*”, përbën një kërkesë pa palë kundërshtare në proces, ajo nuk zhbën faktin se është paraqitur nga babai i një personi, me të cilin subjekti ka pasur njohje shoqërore dhe familjare. Lidhur me situatën e gjendjes së konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me z. L. K., trupi gjykues sjell në vëmendje se kjo marrëdhënie është analizuar më poshtë në këtë vendim.

41.3/d. Për sa më lart, trupi gjykues konkludon se pranimi i kërkesës së z. I. K., për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, megjithëse *a prima facie* ka një karakter deklarativ dhe nuk mund të konsiderohet apriori si favorizim i palës në proces, ashtu sikundër ka ngritur dyshimin Komisioni, mungesa e njoftimit formal të palës kërkuese në kushtet e një marrëdhënie miqësie, si dhe gjykimi në kushtet e konfliktit të interesit do të jenë pjesë e vlerësimit etik e profesional të subjektit.

(2) Në çështjen gjyqësore, regjistruar në datën 23.02.2012, me kërkuess I. K. dhe objekt “*Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë olograf*”, për të ndjerin Xh. K., subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 27.02.2012, ka vendosur: “*Pranimin e kërkesës dhe lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë*”.

41.4. Komisioni ka konstatuar se në këtë proces gjyqësor evidentohen gabime thelbësore dhe serioze, pasi është vendosur lëshimi i trashëgimisë testamentare të z. I. K. në mungesë të testamentit. Subjekti nuk ka respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës. Nuk provohet njoftimi i kërkuessit sipas parashikimeve të K. Pr. Civile. Subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit parashikuar nga neni 72 i K. Pr. Civile, pasi ka gjykuar një çështje ku si palë është paraqitur babai i një personi me të

cilin ai ka patur njohje shoqërore dhe familjare. Për rrjedhojë, Komisioni ka ngritur dyshime për favorizimin e z. I. K.

41.4/a. Subjekti, në kundërshtimin e konkluzioneve të mësipërme të Komisionit, paraqet si argument faktin se natyra e çështjes i përket juridiksionit gjyqësor gracioz, pra, gjykim pa palë kundërshtare, me objekt lëshim dëshmie trashëgimie, që në thelbin e tyre janë vërtetime faktesh gjyqësore, kjo sipas interpretimit literal (gjuhësor) të normës dhe nuk është i detyrueshëm zbatimi i afatit ligjor i parashikuar nga neni 155/1 i Kodit të Procedurës Civile, i cili zbatohet për paditë me palë kundërshtare (të juridiksionit gjyqësor kontencioz). Sipas subjektit, fakti që ndonëse kanë kaluar mbi 10 vjet nuk është ngritur ndonjë padi e tillë, tregon që gabimi i tij nuk ka sjellë ndonjë pasojë juridike për askënd.

41.4/b. Trupi gjykues, pasi analizoi vendimin objekt shqyrtimi, konstaton se subjekti i rivlerësimit në dispozitiv të vendimit ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë testamentare për trashëgimlënësin Xh. K., duke caktuar si trashëgimtar testamentar djalin e tij, I. K., mbi pasurinë e paluajtshme godinë, e cila ndodhet në lagjen “{***}”. Në pjesën argumentuese të vendimit, subjekti shprehet se: z. Xh. K. ka shprehur vullnetin e tij, duke lënë si trashëgimtar të tij djalin I. K.. Ndër të tjera janë administruar në cilësinë e provës dhe një deklaratë dore, sipas së cilës z. Xh. K. i dhuron djalit të tij, I. K., një godinë që ndodhet në lagjen ... (nuk lexohet qartë). Subjekti e ka gjykuar këtë çështje brenda 4 ditëve dhe rezulton se në fashikullin gjyqësor nuk gjendet njoftimi i kërkuarit për datën e seancës gjyqësore. Sikurse konstatohet, subjekti i rivlerësimit ka lëshuar një dëshmi trashëgimie testamentare në mungesë të aktit të testamentit⁹³.

41.4/c. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për mosrespektim të afatit 10-ditor për caktimin e seancës, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka qenë i detyruar ta respektonte këtë afat⁹⁴, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. Nxitimi i kryerjes së veprimeve procedurale prej subjektit duket qartë qoftë nga mosrespektimi i afatit ligjor ashtu edhe nga fakti që me këtë kohë të shkurtër duket të jetë dakordësuar edhe kërkuari z. K., siç rezulton nga dokumentacioni i depozituar prej tij, i cili është noterizuar në datën 27.2.2012, pikërisht datën e gjykimit dhe shpalljes së vendimit. E gjithë kjo situatë, përpos shkeljes së afatit, dëshmon edhe favorizim të konsiderueshëm të këtij kërkuari që përforcon dyshimet e ngritura për veprime të kryera në kushtet e konfliktit të interesit dhe favorizim të palës.

41.4/ç. Nisur nga fakti që nuk ka të dhëna që të jetë ngritur ndonjë pretendim për të drejta pronësie nga ndonjë person në lidhje me këtë pasuri, pasi kanë kaluar mbi 10 vjet nga lëshimi i dëshmisë së

⁹³ Në nenin 372 të K. Civil parashikohet se: Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes. Testamenti nuk mund të bëhet prej dy ose më shumë personave po në një akt, as edhe në dobi të një të treti, as me disponime reciproke.

Në nenin 379 të K. Civil parashikohet se: Trashëgimlënësi nuk mund të përjashtojë nga trashëgimia ligjore fëmijët e tij të mitur ose trashëgimtarë të tjerë të mitur që trashëgojnë me zëvendësim (neni 361, paragrafi i dytë), si dhe trashëgimtarët e tij të tjerë të paaftë për punë, në qoftë se thirren në trashëgim, dhe as të cenojë me testament në çdo mënyrë qoftë, pjesën që u takon këtyre trashëgimtarëve në bazë të trashëgimisë ligjore, përveç kur këta janë bërë të padenjë për të trashëguar.

⁹⁴ Në nenin 155 të K. Pr. Civile parashikohet se: Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë. Kur vendi i njoftimit është jashtë rrethit ose jashtë shtetit, afati për paraqitjen në gjyq duhet të jetë i tillë sa të sigurohet një komunikim normal i padisë dhe paraqitja në gjykatë e të paditurit ose të personave të tretë.

Në çështjet që është e nevojshme të kryhet një njoftim i shpejtë i padisë, me kërkesën e paditësit, gjyqtari kur e sheh atë me vend, mund të lejojë mosrespektimin e afatit të mësipërm të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, por gjithnjë njoftimi duhet të jetë bindës, në përputhje me rregullat e parashikuara prej neneve 132 e 133 të këtij Kodi dhe pa i cenuar të paditurit të drejtën e mbrojtjes.

trashëgimisë testamentare nga subjekti, trupi gjykues çmon se, pavarësisht se vendimmarrja e subjektit mund të mos ketë sjellë asnjë pasojë negative për palët, lëshimi i dëshmisë pa pasur një testament (me akt noterial ose olograf, asnjë dokument tjetër që disponon për së gjalli nuk mund të konsiderohet si bazë për lëshimin e dëshmisë), duke mos respektuar afatin 10-ditor për caktimin e seancës të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, si dhe kur është vërtetuar që subjekti ka njohje me trashëgimtarin testamentar, I. K., për të cilin ka shqyrtuar disa çështje, ku ai ka qenë palë në proces, janë rrethana që krijojnë dyshime për favorizim haptazi të shtetasit I. K. nga ana e subjektit të rivlerësimit. Këto rrethana do të jenë pjesë e vlerësimit etik e profesional të subjektit.

(3) Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 24.09.2014, me kërkues I. K., me objekt: “*sigurim prove*”.

41.5. Nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar se në përmbajtje të dosjes gjyqësore evidentohet vendimi “*Mbi caktimin e çështjes në seancë gjyqësore*”, përmes të cilit subjekti i rivlerësimit ka vendosur kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, si dhe caktimin e seancës në datën 25.09.2014, ora 11:30. Në lidhje me këtë kërkesë është zhvilluar vetëm një seancë gjyqësore në datën 25.09.2014. Në përfundim të kësaj seance, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lejin e sigurimit të provës, duke u pranuar kërkesa për këqyrjen e ndërtimit në një marrëdhënie fqinjësore me pasurinë e kërkuesit. Referuar procesverbalit që i bashkëlidhet vendimit gjyqësor, subjekti së bashku me sekretaren gjyqësore dhe kërkuesin kanë kryer këqyrjen në datën 26.09.2014.

41.5/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i marrë për pranimin e kërkesës me objekt *sigurim prove* është një vendim i ndërmjetëm, që nuk mund të shërbejë si bazë fakti për ta vendosur zyrtarin në gjendjen e konfliktit faktik, në dukje, të mundshëm apo të vazhdueshëm të interesit, referuar ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005⁹⁵. Kjo pasi këqyrja dhe fotografimi i bërë në zbatim të këtij vendimi nuk përbën ndonjë kompetencë as thelbësore dhe as jothelbësore, që ka ndikuar apo mund të ndikonte në vlerësimin pasues me vendimmarrje nga ai si gjyqtar në gjykimin e ndonjë çështjeje konkrete.

41.5/b. Në lidhje me këtë çështje, trupi gjykues konstaton se Komisioni e ka fokusuar barrën e provës në faktin se pala kërkuese është babai i avokatit L. K., me të cilin duket se subjekti ka lidhje shoqërore, për pasojë subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile. Trupi gjykues çmon se, në kushtet kur situata e gjendjes së konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit është analizuar më poshtë në këtë vendim, do ta trajtojë edhe këtë çështje në kuadër të etikës dhe profesionalizmit të subjektit, duke iu referuar nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, që parashikon heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie.

(4) Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 04.12.2003, me paditës I. K., përfaqësuar në gjykim me prokurë nga av. L. K., me palë të paditur bashkëpronarët K.

41.6. Nga hetimi administrativ, Komisionit i rezultoi se në çështjen me objekt: “*Pjesëtimi gjyqësor faktik i pasurisë së përcaktuar me vendim gjyqësor të fazës së parë, ndërmjet trashëgimtarëve të Xh. K.*”, subjekti i rivlerësimit, në datën 10.05.2004, ka vendosur mbarimin e bashkëpronësisë ndërmjet palëve ndërgjyqëse dhe caktimin e pjesëve takuese për secilin bashkëpronar. Pasuritë objekt gjykimi janë një ish-furrë buke me sip. 140 m², dyqane me sip. truall 220 m² dhe një truall i lirë, me sip. 253 m² të ndodhur në lagjen “{***}”.

⁹⁵ Sipas nenit 3, paragrafi 2 i ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, i ndryshuar, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, ku parashikohet se: “2. Për qëllimet e këtij ligji: a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit”.

41.6/a. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit, *se vendimi i marrë për këtë çështje është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër dhe nga Gjykata e Lartë, që sipas tij ka autoritetin e vendimit gjyqësor, e që përbën gjë të gjykuar sipas nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile*, nuk qëndron. Ky konkluzion bazohet në rrethanën se në vendimin e Komisionit nuk është analizuar themeli i çështjes, por është konstatuar fakti se z. I. K. është babai i z. L. K., me të cilën rezultoi e provuar se subjekti ka pasur njohje shoqërore/familjare. Gjithashtu, z. L. K. ka qenë si përfaqësues i palëve në një pjesë të seancave gjyqësore të zhvilluara prej subjektit. Ndërsa lidhur me pretendimin e subjektit se kjo çështje është përtej periudhës së rivlerësimit, trupi gjykues vëren se këto dosje janë administruar nga Komisioni në funksion të informacioneve të ardhura nga organet ligjzbatuese dhe i ka analizuar ato në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës, kriter për të cilin ligji nuk përcakton të njëjtin afat si ai i vlerësimit të aftësive profesionale.

41.6/b. Trupi gjykues vëren se, sa i përket marrëdhënies së subjektit me avokatin L. K., ai ka paraqitur të njëjtat argumente, për të cilat, ashtu siç është shprehur më lart, do të mbajë një qëndrim përfundimtar në raport me vlerësimin e etikës dhe profesionalizmit të subjektit të rivlerësimit dhe në një vlerësim tërësor të çështjes.

(5) Çështje gjyqësore, regjistruar në datën 18.06.2012, me paditës I. K., me palë të paditur Bashkia Shkodër dhe ZVRPP, me objekt: *Detyrimin e palës së paditur të njohë pronar të pasurisë paditësin, mbi pasurinë që ka fituar me parashkrim fitues me vendim gjyqësor të formës së prerë*. Kjo çështje gjyqësore është regjistruar sërish në gjykatë në datën 11.02.2013 (pasi më parë ishte vendosur pushimi i gjykimit) dhe është gjykuar nga i njëjti trup gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. {***}, datë 01.07.2013, është vendosur pranimi i kërkesëpadsisë.

41.7. Komisioni, në lidhje me këtë çështje, ka vlerësuar se ngrihen dyshime për favorizimin e z. I. K., duke marrë në konsideratë faktin që: **(i)** vendimi nr. {***}, viti 2013, nuk është i argumentuar, si dhe evidentohet shkelje procedurale, pasi gjykata në argumentim ka dalë tej objektit të padsisë, duke e kanalizuar çështjen sërish në parashkrim fitues; **(ii)** subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar një çështje, ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka pasur njohje shoqërore dhe familjare; **(iii)** subjekti është përpjekur të paraqesë një situatë në favor të tij, duke depozituar si provë: një fletë, që përmban të dhëna të paprovuara/jo në formën e kërkuar nga ligji; dhe një mendim të pretenduar si pakicë e tij, i cili nuk është paraqitur në formën e kërkuar nga ligji, pasi nuk është nënshkruar nga kryesekretarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, madje duket se është prodhuar pas kalimit të barrës së provës, për sa kohë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër nuk ia ka dërguar Komisionit me shkresë zyrtare, në bazë të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016.

41.7/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjetjet dhe konkluzionet e Komisionit nuk kanë lidhje me të, pasi sikurse rezultoi nga dokumentacioni provues që ka depozituar, konkretisht, nga nënshkrimi i tij në vendimin origjinal, si dhe nga procesverbali i mendimit në pakicë, ai ka votuar për rrëzimin e kërkesëpadsisë së paditësit I. K., për rrjedhojë, gjendja e dukjes së konfliktit të interesit, për të cilën ai është ngarkuar me barrë prove, nuk ekziston. Gjithashtu, lidhur me këtë çështje, subjekti sqaron se formimi i rregullt i ndërgjyqësisë përbën çështje të gjykuar nga Gjykata e Lartë, e cila e ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim, po në Gjykatën e Apelit Shkodër, gjë që e nënkupton faktin se formimi i ndërgjyqësisë ka qenë i rregullt (pasi, në të kundërt, çështja do të kthehej për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë).

41.7/b. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të këtij shkaku ankimi, si dhe konkluzioneve të Komisionit, mori në shqyrtim fashikullin gjyqësor të kësaj çështjeje, si dhe dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti dhe Komisioni, nga i cili rezulton se:

41.7/c. Komisioni ka vlerësuar se vendimi nr. {***}, datë 16.05.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë së paditësit I. K., nuk është i argumentuar drejt, pasi si palë e paditur nuk mund të thirreshin z. F. D. dhe z. F. Z., për sa kohë ata nuk kanë qenë pronarë të kësaj pasurie. Parashkrimi fitues i kunddrejtohet vetëm pronarëve të ligjshëm të pasurisë, që rezultojnë në regjistrat publikë. Në këtë rast, si palë e paditur duhej të thirrej Bashkia Shkodër, pasi kjo pasuri rezulton e regjistruar në emër të saj në ZVRPP, fakt ky që ishte i njohur prej subjektit të rivlerësimit. Pasi z. I. K. është përpjekur të regjistrojë pasuritë e mësipërme në ZVRPP Shkodër, është informuar se pronari i këtyre pasurive nuk kanë qenë z. F. D. dhe z. F. Z., por Bashkia Shkodër. Për rrjedhojë, vendimi i gjykatës krijonte mbivendosje me pasuri të regjistruara në emër të Bashkisë Shkodër, e në këto kushte, z. K. i është drejtuar sërish gjykatës, duke kërkuar që Bashkia Shkodër ta njihte pronar mbi këto pasuri. Komisioni, pasi analizoi vendimin gjyqësor nr. {***}, të vitit 2013, në të cilin është vendosur pranimi i padisë së paditësit I. K., duke u njohur pronar me parashkrim fitues, konstatoi se nga ana e gjykatës nuk është argumentuar parashkrimi fitues sipas dispozitave të K. Civil.

41.7/ç. Subjekti, për të provuar pretendimin e tij se ka votuar për rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësit I. K., ka depozituar një fletë me emërtimin “vendim”, e cila është firmosur nga tre gjyqtarët e çështjes, përfshirë edhe subjektin, në të cilën ka nënshkrimin “në pakicë”. Konstatohet se kjo fletë nuk rezulton të jetë firmosur nga sekretarja gjyqësore e çështjes. Gjithashtu, ai ka paraqitur edhe shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Shkodër, sipas së cilës i vihet në dispozicion mendimi i pakicës për këtë çështje gjyqësore. Subjekti, së bashku me parashtrimet në Kolegj, në mbështetje të argumentit të tij ka depozituar shkresën nr. {***} prot., datë 20.03.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, bashkëlidhur së cilës ndodhet kopje e njëzuar me origjinalin e vendimit nr. {***}, datë 01.07.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kopje e njëzuar me origjinalin “Procesverbal i mbetjes në pakicë”, datë 01.07.2013, bashkë me dispozitivin e vendimit datë 01.07.2013 dhe “zarfi mendim pakice”.

41.7/d. Në lidhje me fletën “mendim pakice”, depozituar nga subjekti, Komisioni ka konstatuar se ajo nuk i përket dosjes gjyqësore, si dhe nuk rezulton të jetë pjesë e vendimit gjyqësor. Gjithashtu, ajo nuk përputhet me vullnetin e subjektit në vendimin origjinal, kopje e të cilit është administruar nga Komisioni, ku subjekti nuk ka shprehur vullnetin e tij “kundër”. Në këto kushte, Komisioni ka ngritur dyshimin se kjo fletë është prodhuar pas kalimit të barrës së provës, me qëllim arritjen e një rezultati pozitiv në favor të subjektit, në lidhje me këtë barrë prove. Komisioni ka argumentuar në vendim se nuk ka tagrat e organit të Prokurorisë dhe nuk mund të merret me autenticitetin e kësaj flete, por vlerësoi të mos e konsiderojë atë si provë.

41.7/dh. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve, konstaton se në vendimin origjinal të administruar nga Komisioni me shkresën nr. {***} prot., datë 13.07.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, por edhe nga kopja e njëzuar me origjinalin, e cila i është përcjellë subjektit me shkresën nr. {***} prot., datë 20.03.2024, nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, rezulton se

subjekti ka firmosur së bashku me dy anëtarët e tjerë dhe nuk ka asnjë shënim “kundër”, si dhe as mendim kundër bashkëlidhur, sikurse parashikojnë dispozitat⁹⁶ e Kodit të Procedurës Civile.

41.7/e. Trupi gjykues konstaton gjithashtu se të dhënat që pasqyrojnë dokumentet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, janë kontradiktore. Në lidhje me fletën e depozituar nga subjekti, “mendim pakice”, konstatohet se ajo nuk përputhet me vullnetin e subjektit në vendimin origjinal, kopja e të cilit është administruar nga Komisioni, ku subjekti nuk ka shprehur vullnetin e tij kundër. Akti i quajtur “procesverbal për mbetje në pakicë”, nuk përmbush elementet e formës që parashikon neni 307/2 i K. Pr. C., përpos që, edhe sikur të ishte konceptuar nga ligji si i tillë, mungojnë edhe firmat e dy anëtarëve të tjerë të trupit gjykues. Gjithashtu, ajo që evidentohet në aktet e përcjella nga subjekti, tregon minimalisht se janë përpiluar akte me ekstremitete të njëjta, por me përmbajtje të ndryshme, lidhur me mënyrën e nënshkrimit të anëtarëve, në referim të dispozitivit të përcjellë nga Gjykata e Apelit, ku subjekti ka nënshkruar “në pakicë”, e cila është një problematikë që minimalisht tregon një sjellje komprometuese në raport me përpilimin e dokumenteve zyrtare. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit duket i pabesueshëm në shpjegimet e tij, në përpjekje për të justifikuar veprimet e kryera, të cilat janë në kundërshtim me nenet 307 dhe 308 të Kodit të Procedurës Civile.

41.7/ë. Lidhur me pretendimin e subjektit, se nuk i është kaluar barrë prove për parregullsinë e dokumentit të vendimmarrjes së trupit gjykues, konkretisht për vendimin e tij të pakicës, trupi gjykues konstaton se subjekti e ka dorëzuar dokumentin “mendim pakice” pas rezultateve të hetimit administrativ, për rrjedhojë, nuk kishte se si Komisioni t’i kalonte barrë prove për këtë akt. Nga verifikimi i dokumentit “Rezultatet e hetimit”, në drejtim të kriterit të kontrollit të figurës, trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës si vijon: *Evidentohen shkelje procedurale, pasi gjykata në argumentim ka dalë tej objektit të padisë, duke e kanalizuar çështjen sërish në parashkrim fitues. Subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka gjykuar një çështje ku si palë është paraqitur babai i një personi me të cilin ai ka patur njohje shoqërore dhe familjare; ngrihen dyshime për favorizimin e z. I. K.* Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit në kuadër të gjetjes nga rezultati i hetimit, për të cilën subjektit i ka kaluar barrë prove mbi ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit, duke ngritur dyshime për favorizimin e shtetasit I. K.

41.7/f. Në lidhje me pretendimin e subjektit, se kjo çështje nuk mund të merret në vlerësim nga Komisioni, për sa kohë është ende në gjykim në një gjykatë më të lartë, trupi gjykues sjell në vëmendje se vlerësimi i aftësisë së subjektit nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim, në kohën e kryerjes së procesit të rivlerësimit prej vetë magjistratit dhe jo nga organe të tjera më të larta apo alternative, siç është rasti në fjalë. Në këto rrethana, çështja gjyqësore e analizuar ka përfunduar shqyrtimin e saj prej subjektit të rivlerësimit, i cili është shprehur me vendimin përfundimtar për zgjidhjen e saj dhe qenia e saj e varur, në pritje të një gjykimi tjetër, nuk e bën këtë çështje “nën shqyrtim”, në kuptim të parashikimit të nenit E, paragrafi 2 i Aneksit të Kushtetutës.

⁹⁶ Në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i parë, parashikohet se: “Vendimi duhet të nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues që kanë marrë pjesë në dhënien e tij. Gjyqtari, mendimi i të cilit ka mbetur në pakicë, shkruan fjalën ‘kundër’ dhe nënshkruan vendimin”.

Në nenin 307 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafi i dytë, parashikohet se: “Së pari voton gjyqtari më i ri në moshë dhe së fundi voton kryetari i seancës. Asnjë nga gjyqtarët nuk mund të abstenojë nga vendimi. Mendimi i gjyqtarit të mbetur në pakicë, i parashtruar me shkrim, bashkohet me vendimin”.

41.8. Në përfundim të analizimit të dosjeve gjyqësore të mësipërme, trupi gjykues çmon se, pavarësisht se mangësitë e konstatuara në respektimin e afateve procedurale do të përfshihen në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit, në këtë moment ato u vlerësuan në funksion të kryerjes së veprimeve/mosveprimeve favorizuese, të njëres palë në mënyrë të përsëritur, pikërisht të shtetasit I. K., ndërsa situatën e konfliktit të interesit do ta vlerësojë në kuadër të etikës dhe profesionalizmit.

Për shkak të volumit të madh të dokumentacionit të administruar, Komisioni ka analizuar një pjesë të dosjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht çështjet gjyqësore si më poshtë.

41.9. Në lidhje me çështjen gjyqësore me palë kërkuese shtetasin Sh. M., regjistruar në datën 26.09.2011, dhe objekt: *Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, vërtetim fakti të qenies së kërkuarit bashkëpronar të pasurisë në lagjen “{***}”, Shkodër, si dhe rivendosje në afat për t’iu drejtuar AKKP Tiranë*, subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. {***}, datë 17.10.2011, ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë.

41.9/a. Komisioni konstatoi se: (i) Kërkimet e palës paditëse nuk mund të shqyrtoheshin në të njëjtin proces gjyqësor, pasi kanë të bëjnë me objekte të ndryshme dhe dëshmia e trashëgimisë nuk përbën vërtetim fakti juridik. (ii) Njohja bashkëpronar i një pasurie të paluajtshme nuk bëhet me vërtetim fakti, pasi nuk mund të prodhojë pasoja për palët e treta. (iii) Vërtetimi i faktit nuk është një nga format e padisë për të fituar njohjen e pronësisë së një pasurie të paluajtshme. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se veprimet e subjektit në këtë pikë demonstrojnë favorizim të palës, fakt ky që do të mbahet në konsideratë në vlerësimin e figurës.

41.9/b. Subjekti i rivlerësimit pretendon se kërkesa me objekt “lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë” është vërtetim fakti juridik. Neni 55 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Gjykata që gjykon padinë kryesore është kompetente për të shqyrtuar edhe kërkesat dytësore, kundërpadinë ose ndërhyrjen kryesore. Në këtë rast, gjykata merr vendim për bashkimin e tyre në një çështje të vetme”. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, sipas subjektit është e qartë se kërkimet kryesore të çështjes janë dy: (a) lëshimi i dëshmisë së trashëgimisë dhe (b) përcaktimi përmes rrugës së vërtetimit gjyqësor të faktit, të planvendosjes së pasurisë, të sipërfaqes së saj, të faktit se i ati i kërkuarit ka bërë pjesë në bashkëpronarët e pasurisë, përpara se ajo (sipas kërkuarit) të shtetëzohej.

41.9/c. Subjekti pretendon se kërkimi me objekt “rivendosje në afat” ka karakter dytësor, pra mund të gjykohet së bashku me kërkimin për përcaktimin përmes rrugës së vërtetimit gjyqësor të faktit, të planvendosjes së pasurisë, të sipërfaqes së saj, të faktit se i ati i kërkuarit ka bërë pjesë në bashkëpronarët e pasurisë, përpara se ajo (sipas kërkuarit) të shtetëzohej. Neni 159 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Në një kërkesëpadi mund të parashtrohen shumë kërkime, në rast se gjykata është kompetente për të gjitha kërkimet. Kur gjykata çmon se shqyrtimi i përbashkët i tyre do të shkaktojë vështirësi të dukshme në zhvillimin e gjykimit, vendos që ato të shqyrtohen veç e veç”. Sipas subjektit, në zbatim të kësaj dispozite ligjore, të tria kërkimet mund të gjykohen së bashku, përderisa gjykata ka qenë kompetente për të gjitha⁹⁷.

⁹⁷ Subjekti sqaron se: Për më tepër, gjykata nuk ka pasur ndonjë rol për të luajtur, sepse përcaktimin e objektit të gjykimit e ka realizuar kërkuari Sh. M., përmes kërkesës së paraqitur prej tij dhe jo gjykata. Sipas neneve 5 dhe 185 të Kodit të Procedurës Civile, e drejta e disponimit të padisë i përket në këtë mënyrë paditësit/kërkuarit dhe gjykata nuk mund të ndërhyjë për kufizimin e saj. Subjekti sqaron se Komisioni ka keqinterpretuar vendimin e tij, duke ngatërruar palët, për faktin se me të njëjtin vendim është lëshuar njëkohësisht edhe dëshmia e trashëgimisë dhe, për rrjedhojë, Komisioni i konsideron të gjithë trashëgimtarët e ish-pronarit S. M. si bashkëpronarë të pasurisë, për shkak të faktit se të gjithë këta bashkëtrashëgimtarë do të duhet të ishin përfytyes nga vendimi i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

41.9/ç. Trupi gjykues konstaton se bashkimi në një gjykim, prej subjektit të rivlerësimit, i kërkit për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së bashku me kërkesat e tjera që burojnë nga të drejtat trashëgimore, është i gabuar. Dëshmia e trashëgimisë është akti që legjitimon palën t'i drejtohet gjykatës për kërtime të të drejtave trashëgimore dhe, pa këtë akt, pala nuk legjitimohet në asnjë kërkim të kësaj natyre. Në këto kushte, ajo nuk mund të gjykohej bashkërisht me kërkesat e tjera të padisë, por fillimisht duhej të ishte lëshuar dëshmia e trashëgimisë sipas ligjit, që më pas të legjitimohej pala në ngritjen e padisë.

41.9/d. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të fashikullit gjyqësor, konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar në vendim arsyet që e çuan në pranimin e padisë për rivendosjen në afat. Në faqen 5 të këtij vendimi, subjekti shprehet: *“Subjekti i interesuar Sh. M. provoi para kësaj gjykate se e ka pasur objektivisht të pamundur të respektojë afatin ligjor ...”*, por në asnjë moment në këtë vendim nuk ka argumentuar se cilat kanë qenë provat apo faktet mbi të cilat ka arritur në këtë konkluzion. Fakti i cituar prej tij, se kërkuesi ka deklaruar se ka qenë në padijeni të ekzistencës së notës së transkriptimit të pasurisë së babait të tij mbi pronën, bie në kundërshtim me arsyetimin e përdorur në vendimin objekt vlerësimi, sipas të cilit, në faqen 4, subjekti shprehet se: *Kërkuesit i është dashur të plotësojë dokumentacionin e tij të pronësisë në aspektin hartografik*. Për rrjedhojë, ashtu si edhe Komisioni, trupi gjykues konstaton mungesë të argumentimit të vendimit në lidhje me pranimin e kërkesës për rivendosjen në afat⁹⁸.

41.9/dh. Gjithashtu, nga aktet e dosjes rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 15.01.2018, shtetasi Sh. M. së bashku me ekspertin e thirrur nga subjekti në këtë gjykim, z. G. S., janë deklaruar fajtorë për veprën penale *“Falsifikim në lidhje me dokumentin notë transkripti”*, të depozituar nga shtetasi Sh. M. në këtë proces gjyqësor. Për rrjedhojë, edhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk qëndrojnë, pasi edhe në rastin e vërtetimit të faktit juridik, ai është mbështetur mbi një dokument që, siç rezultoi më pas, është deklaruar i falsifikuar. Subjekti, megjithëse pretendon se nuk ka qenë në dijeni se ky dokument ishte i falsifikuar, në vendimin e kësaj çështjeje nuk argumenton se pse kjo notë transkripti përbën provë të plotë. Konkretisht, në faqen 4, paragrafi 6, të vendimit, subjekti shprehet se: *“Gjykata vlerëson aktekspertimin me fuqi provuese për faktin se, sipas konkluzioneve të ekspertimit topografik, pretendimet e palës kërkuese lidhur me vendndodhjen e pronës objekt gjykimi nuk kanë mbivendosje me pretendimet e ndonjë pronari të vjetër apo me rrugët publike”*, ndërkohë që rezulton e provuar se në dosjen gjyqësore nuk është administruar asnjë dokument që mbështet konkluzionet e aktekspertimit.

41.9/e. Për sa i përket pretendimeve të subjektit, se Komisioni ka analizuar themelin e çështjes, trupi gjykues vlerëson se ato nuk qëndrojnë, pasi në asnjë moment Komisioni nuk është shprehur për vendimmarrjen e subjektit, por është bazuar në kriteret e vlerësimit të parashikuara nga nenet 72-76 të ligjit nr. 96/2016, ndër të cilat është edhe cilësia e analizës dhe argumentimit logjik sipas nenit 72/3, si dhe aftësia për të identifikuar konfliktin e normave dhe analizuar jurisprudencën sipas nenit 72/2, por vetëm ka konstatuar mungesën e arsyetimit ligjor të vendimit. Komisioni nuk ka kryer një

⁹⁸ Në nenin 388 të K. Pr. Civile parashikohet se: Kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë. Kërkesa për vërtetimin e fakteve paraqitet në Gjykatën e Shkallës së Parë, në territorin e së cilës ka banimin kërkuesi. Kur kërkohet vërtetimi i faktit për një send të paluajtshëm, ajo paraqitet në Gjykatën e Shkallës së Parë në territorin e së cilës ndodhet sendi. Në mënyrën e treguar më sipër mund të kërkohet edhe korrigjimi i gabimeve të akteve të treguara në paragrafin e parë të këtij neni.

arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të çështjes, si dhe nuk ka analizuar zgjidhjen në themel të çështjes, sikundër parashikohet në nenin 72/4 të ligjit nr. 96/2016.

41.9/ë. Në përfundim, trupi gjykues, pasi analizoi veprimet e subjektit të rivlerësimit në këtë vendimmarrje, i rezultoi se ai ka kryer shkelje procedurale në lidhje me gjykimin e tri padive të llojeve të ndryshme, si: (i) lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë; (ii) vërtetim fakti të qenies bashkëpronar të pasurisë; (iii) rivendosje në afat në një padi të vetme, si dhe mosargumentimit e vlerësimit të provave e akteve mbi të cilat ka bazuar vendimmarrjen e tij, për rrjedhojë, i konsideron të bazuara dyshimet e ngritura nga Komisioni për favorizim të paditësit Sh. M.

(2) Çështja gjyqësore regjistruar në datën 15.12.2011, me palë kërkuese Sh. M. dhe me objekt: *“Vërtetimin e faktit juridik të qenies pronar të ish-pronarit S. M., për pasurinë e ndodhur në fshatin {***}, Komuna Bushat, Shkodër, me sip. 20.000 m² dhe rivendosje në afat të së drejtës së kërkuarit për t’iu drejtuar AKKP Tiranë”*.

41.10. Komisioni ka konstatuar se: (i) subjekti ka caktuar tri seanca gjyqësore në harkun kohor të 5 ditëve. Seanca e parë është caktuar në datën 19.12.2011 dhe seanca e fundit në datë 23.12.2011. Në seancën e datës 21.12.2011, subjekti ka caktuar ekspert, duke i dhënë vetëm 2 ditë kohë për kryerjen e aktit të ekspertimit. (ii) Në dosjen gjyqësore nuk gjendet njoftimi i shtetasit Sh. M. për zhvillimin e seancës, duke marrë në konsideratë që vendimi është marrë ditë të premtë dhe seanca është caktuar për ditë të hënë. (iii) Nga analizimi i vendimit konstatohet se nga ana e subjektit nuk është argumentuar kërkesa për rivendosjen në afat të së drejtës së kërkuarit Sh. M., për t’iu drejtuar AKK Pronave Tiranë. (iv) Subjekti nuk ka respektuar afatet ligjore të nenit 155 të K. Pr. Civile për caktimin e seancës. Komisioni ka arritur në përfundimin se problematikat e evidentuara tregojnë favorizim të palës, që do të jetë pjesë e vlerësimit të figurës për subjektin.

41.10/a. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të njëjtat argumente lidhur me mosrespektimin e afatit ligjor, të parashikuar nga neni 155/1 i Kodit të Procedurës Civile. Sipas tij, ky afat zbatohet për paditë me palë kundërshtarë, ndërsa lidhur me mungesën e njoftimit të shtetasit Sh. M., subjekti pretendon se pas shortimit të çështjes, që është data 15.12.2011, kërkuari ka marrë njoftim për emrin e gjyqtarit, është paraqitur personalisht dhe ka marrë kontakt me sekretaren, e cila e ka njoftuar gojarisht dhe pa e dokumentuar njoftimin për seancën e parë, që është zhvilluar në datën 19.12.2022, seancë në të cilën ai është paraqitur.

41.10/b. Në lidhje me afatin e caktuar për ekspertin, subjekti pretendon se në seancën e dytë të datës 21.12.2011, eksperti është paraqitur dhe ka marrë detyrat, dhe vetë eksperti ka kërkuar dy ditë. Për rrjedhojë, ka shtyrë seancën, aq kohë sa i është dashur ekspertit. Lidhur me arsyen se përse ka shqyrtuar bashkë kërkimin e vërtetimit gjyqësor të faktit dhe kërkimin për rivendosjen në afat, subjekti pretendon se nga ana e kërkuarit i është deklaruar se e ka humbur afatin për të paraqitur kërkesën në AKP, për trajtimin e ish-pronës, pikërisht për shkak të faktit se pa u përcaktuar më parë hartografikisht planvendosja e pasurisë në rrugën e vërtetimit gjyqësor të faktit, AKP-ja nuk pranon që ta shqyrtojë dokumentacionin, për këtë arsye ka vlerësuar se ky pretendim është i bazuar, pasi është çështje ligji dhe jo fakti.

41.10/c. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, mori në shqyrtim fashikullin gjyqësor lidhur me këtë çështje dhe konstaton se: në kërkesën e shtetasit Sh. M. nuk gjendet asnjë e dhënë, për sa i përket adresës së banimit të tij apo ndonjë numër kontakti, për të bërë të mundur njoftimin nga sekretaria gjyqësore. Gjithashtu, në dosjen gjyqësore nuk gjendet

i administruar as njoftimi zyrtar i këtij shtetasi, detyrim ligjor i parashikuar nga neni 128 i Kodit të Procedurës Civile, si dhe as ndonjë shënim nga ana e sekretarisë gjyqësore për të provuar pretendimin e subjektit se kërkuesi është paraqitur personalisht në zyrën e gjyqtarit.

41.10/ç. Në lidhje me vendosjen e një afati 2-ditor për ekspertin, pretendimi i subjektit se në seancën e dytë të datës 21.12.2011, eksperti është paraqitur dhe ka marrë detyrat, e vetë eksperti ka kërkuar dy ditë, është i pabazuar në fakte, pasi në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 21.12.2011 rezulton se eksperti ka kërkuar kohë, por pa specifikuar afatin 2-ditor. Komisioni ka kryer krahasimin e dy gjykimeve të subjektit për të njëjtin objekt padie, për të njëjtin shtetas, lidhur me afatet për të cilat i është dhënë koha ekspertit për të paraqitur aktin. Në gjykimin e parë (analizuar më lart, në paragrafin 41.9 të këtij vendimi), çështja është regjistruar në datën 26.09.2011 dhe ka përfunduar në datën 17.10.2011. Aktekspertimi i kryer nga i njëjti ekspert mban datën 17.10.2011, duke u kryer për një periudhë më shumë se 3-javore, ndërkohë në çështjen objekt shqyrtimi, aktekspertimi është kryer për një afat 2-ditor.

41.10/d. Nga sa më lart, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë: (i) kohën shumë të shkurtër të gjykimit të çështjes; (ii) mungesën e njoftimit të shtetasit Sh. M.; (iii) mosrespektimin e afatit 10-ditor për njoftimin e kërkesës; (iv) mosargumentimin në vendim për arsyet, të cilat e çuan atë në pranimin e padisë për rivendosjen në afat; (v) moscitimin e provave apo fakteve mbi të cilat është mbështetur për të arritur në konkluzione, çmon se të gjitha veprimet/mosveprimet e subjektit të rivlerësimit kanë sjellë favorizimin e palës paditëse dhe problematikat e konstatuara më lart do të analizohen në një vlerësim tërësor të çështjes.

(3) Lidhur me 2 (dy) çështjet gjyqësore me palë H. T. dhe H. T., konkretisht:

(i) Në çështjen gjyqësore me palë paditëse H. H., e përfaqësuar në gjykim nga av. L. K., të paditur H. B. dhe persona të tretë H. e H. T. dhe A. D., përfaqësuar nga z. L. K., me objekt gjykimi: *Detyrimin e të paditurit për të njohur pronar paditësin*, subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 23.12.2015, ka vendosur pushimin e padisë.

(ii) Në çështjen gjyqësore me palë paditëse H. H., e përfaqësuar në gjykim nga av. L. K., të paditur H. Behri dhe persona të tretë H. e H. T. dhe A. D.; me objekt gjykimi: *Detyrimin e të paditurit për të njohur pronar paditësin dhe saktësimin e kufijve*, subjekti i rivlerësimit, me vendimin datë 04.10.2016, vendosi pranimin e pjeshëm të padisë, duke rrëzuar kërkimin për zërin “ndërtesë”. Pas ankimit të palëve, Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim pranë kësaj gjykate, me një tjetër trup gjykues. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga pala e paditur dhe çështja është regjistruar për gjykim pranë Gjykatës së Lartë.

41.11. Komisioni, pasi ka konstatuar se: (i) subjekti nuk ka argumentuar arsyet se pse kjo padi duhet të pranohet, por ka argumentuar arsyet se pse prapësimet e palës së paditur nuk duhet të pranohen. Në vendim, subjekti shprehet për ekzistencën e tri vendimeve gjyqësore të formës së prerë, sipas së cilave në lidhje me padinë objekt gjykimi duket se kemi të bëjmë me gjë të gjykuar. (ii) Pala paditëse dhe palët e treta përfaqësohen në këtë proces nga ana e z. L. K., me të cilin subjekti ka njohje shoqërore dhe familjare; ka çmuar se aftësitë argumentuese të subjektit do të vlerësohen në kuadër të rivlerësimit profesional të tij, por në funksion të vlerësimit të figurës vlerësohet se subjekti me veprimet/mosveprimet e tij ka favorizuar njërin nga palët.

41.11/a. Për sa i përket vlerësimit të Komisionit, se subjekti nuk ka argumentuar arsyet se pse kjo padi duhet të pranohet, por ka argumentuar arsyet se pse prapësimet e palës së paditur nuk duhet të pranohen, subjekti shpjegon se kjo ka të bëjë me cilësinë e arsyetimit, e cila është jashtë kompetencës

juridiksionale të Komisionit. Megjithatë, subjekti ka sqaruar se vetë natyra e çështjes, si dhe struktura e arsyetimit të vendimit e nënkuptojnë që ose do të pranohej padia dhe nuk do të merreshin në konsideratë prapësimet për truallin ose e kundërta, do të pranoheshin prapësimet dhe, për rrjedhojë, të rrëzohej padia për truallin. Po ashtu, subjekti pretendon se janë cilësuar të gjitha provat që ka vlerësuar në krijimin e bindjes se padia duhej pranuar pjesërisht për zërin “truall të pasurisë”, ka përshkruar saktësisht faktet, gjë që vërehet edhe nga fakti se këtë përshkrim e ka marrë të mirëqenë fjalë për fjalë edhe Gjykata e Apelit në vendimin e saj.

Në lidhje me konfliktin e interesit, subjekti ka dhënë të njëjtat shpjegime si më lart, por thekson se për sa kohë çështja është në Gjykatën e Lartë për shqyrtim, Komisioni nuk mund të shprehet për themelin e saj. Gjithashtu, në parashtrimet e depozituara në Kolegj, subjekti ka bërë me dije se pas vendimit të Komisionit është njohur me vendimin e ILD-së për këtë çështje, i cili nuk ka konstatuar problematika.

41.11/b. Lidhur me pretendimin e subjektit për interpretimin e “gjësë së gjykuar”, trupi gjykues, bazuar në vendimin nr. {***}, datë 14.05.2018, të Gjykatës së Apelit Shkodër, i cili në faqen 11 shprehet se: *e gjen të drejtë arsyetimin e bërë nga Gjykata e Shkallës së Parë në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar*, vlerëson se, për sa kohë ka një vendim gjykate që shprehet specifikisht në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar, e vlerëson si të debatueshëm qëndrimin e Komisionit rreth kësaj problematike, për pasojë, pa peshë specifike në qëndrimin që duhet mbajtur rreth kësaj çështjeje.

41.11/c. Për sa i përket pretendimit të subjektit, *se Komisioni ka analizuar themelin e çështjes*, trupi gjykues konstaton se, në asnjë moment, nuk rezulton që Komisioni të jetë shprehur për vendimmarrjen e subjektit, por është bazuar në kriteret e vlerësimit të parashikuara nga nenet 72-76 të ligjit nr. 96/2016, ndër të cilat është edhe cilësia e analizës dhe argumentimit logjik sipas nenit 72/3, si dhe aftësia për të identifikuar konfliktin e normave dhe analizuar jurisprudencën sipas nenit 72/2. Në asnjë rast, Komisioni nuk ka kryer një arsyetim e analizë të ndryshme të fakteve e rrethanave të çështjes, si dhe nuk ka analizuar zgjidhjen në themel të çështjes, sikundër parashikohet në nenin 72/4 të ligjit nr. 96/2016, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

41.11/ç. Trupi gjykues e konsideron të drejtë konstatimin e Komisionit, se subjekti ka gjykuar një çështje ku përfaqësues i palëve ka qenë z. L. K., me të cilin ai ka pasur marrëdhënie shoqërore, si dhe duke marrë në konsideratë informacionin e organeve ligjzbatuese ngrihet dyshimi për favorizimin e palës paditëse.

(4) Në lidhje me çështjen gjyqësore të regjistruar në datën 13.09.2004, gjykuar nga një trup gjykues, në përbërje të të cilit ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, të paraqitur për gjykim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, kundër të pandehurit V. C., i akuzuar për veprën penale të “*vrasjes me paramendim të kryer në bashkëpunim*” dhe “*armëmbajtje pa leje*”.

41.12. Trupi gjykues konstaton se, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti ka paraqitur shkresën nr. {***} prot., datë 02.11.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, sipas së cilës konstatohet se subjekti ka qenë në mendim pakice për këtë çështje gjyqësore. Në kushtet kur Komisioni në vendim nuk ka konkluduar me evidentimin e ndonjë shkeljeje ligjore të subjektit për këtë çështje, për ta ngarkuar me përgjegjësi atë, trupi gjykues çmon të mos vijojë më tej me shqyrtimin e saj.

(5) Në lidhje me çështjet gjyqësore të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit me palë Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër

41.13. Komisioni, bazuar në informacionet e përcjella nga organet ligjzbatuese, ka administruar të gjitha vendimet gjyqësore ndër vite të subjektit me palë Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër. Nga hetimi i ka rezultuar se subjekti ka gjykuar me vendim⁹⁹ përfundimtar për periudhën 2003 – 2015, në total 918 çështje me palë DRSSH Shkodër, nga të cilat ka rrëzuar 49 padi të palës paditëse ose vetëm 5% të padive, duke ngritur dyshimin për favorizimin e palës paditëse në këto procese.

41.13/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjetjet e Komisionit nuk mund të shërbejnë si dyshim i arsyeshëm se ka favorizuar gjyqfutesit, pasi në tërësinë e 918 çështjeve që ka gjykuar me palë DRSSH-në Shkodër, ka edhe vendime pushimi, edhe pranime të pjesshme të padisë. Sipas subjektit, po të mblidhen të gjitha së bashku me rrëzimet e padive, bëjnë më shumë se 20% të totalit të çështjeve. Përveç kësaj, pothuajse 99% e vendimeve (nga tërësia prej 918 vendimesh) kanë marrë formë të prerë, pa u ankimuar ose janë lënë në fuqi. Subjekti pretendon se kjo tregon drejtësinë e këtyre vendimeve, për më tepër, vendimet që përbëjnë gjë të gjykuar, janë tashmë pjesë e rendit juridik dhe fuqia detyruese e tyre shtrihet edhe mbi autoritetin e Komisionit. Komisioni në vendim ka analizuar disa dosje gjyqësore¹⁰⁰ dhe ka konstatuar se: (i) nuk është administruar njoftimi i palëve gjyqësore ose njoftimi i palës paditëse dhe (ii) nuk janë respektuar afatet e parashikuara nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile.

41.13/b. Në vijim të pretendimeve të tij, subjekti parashtron se, edhe nëse njoftimet kanë pasur parregullshmëri në formën e dokumentimit, në asnjë rast kjo nuk ka sjellë pasojë dështimin e seancave. Kjo pasi, sipas nenit 119/3 të KPC, pavlefshmëria e një akti nuk mund të shpallet kur ka arritur qëllimin për të cilin është destinuar, kjo tregon që sekretarja i kishte njoftuar palët, pavarësisht se nuk e kishte dokumentuar si duhet veprimin procedural të njoftimit. Subjekti sqaron se për këtë kategori gjykimesh, ku palë ishin të moshuar, që iu nevojitej plotësimi i dokumentacionit për të përfutur pension pleqërie, ka menduar se duhej bërë një diskriminim pozitiv në kohëzgjatjen e gjykimit, pra që çështjet e tyre të gjykoheshin sa më shpejt. Subjekti pretendon se data e regjistrimit në vendim nuk lidhet me datën e depozitimit të kërkesëpadisë, si dhe me shortimin e çështjes. Ai vijon shpjegimet e tij, duke deklaruar se regjistrimi i çështjes nga sekretaria gjyqësore bëhej më vonë se shortimi i dosjeve, duke u bazuar edhe në dosje konkrete, të cilat i citon. Në lidhje me njoftimin e palëve, ai pretendon se parregullsitë nuk mund të cenojnë procesin, për sa kohë palët janë paraqitur në gjykim.

41.13/c. Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar në Komision, lidhur me gjykimet e subjektit me palë Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër, i konsideron të pabazuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë është konstatuar se në këto dosje gjyqësore nuk është administruar njoftimi i palëve gjyqësore ose njoftimi i palës paditëse, dhe nuk janë respektuar

⁹⁹ Shih Aneksin 1 të rezultateve të hetimit.

¹⁰⁰ (i) Për vendimin nr. {***}, datë 21.05.2009. Padia me objekt “Pasaktësi emri i shënuar gabim në regjistrin e kooperativës {***}”, është paraqitur më datë 30.04.2009. Në datën 15.05.2009, subjekti ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve, regjistrimi dhe formimi i fashikullit është bërë nga sekretarja më datë 16.05.2009, subjekti ka planifikuar seancën më datë 21.05.2009 (pas 6 ditësh). (ii) Për vendimin nr. {***}, datë 07.07.2006. Padia me objekt “Pavërtetësi dokumenti lidhur me vjetërsinë në punë në ish-kooperativën bujqësore {***}” është paraqitur më datë 05.05.2006, subjekti ka planifikuar seancën më datë 07.05.2006. Njoftimi i palës së paditur është bërë nga sekretarja po në datën 05.05.2006, ndërsa regjistrimi dhe formimi i fashikullit është bërë nga sekretarja më datë 07.07.2006. (iii) Për vendimin nr. {***}, datë 22.05.2009. Padia me objekt “Pasaktësi gjeneralitetet të shënuara në regjistrin e ish-kooperativës {***}”, është paraqitur më datë 05.05.2009, është shortuar në datën 07.05.2009. Më datë 15.05.2009, subjekti ka nxjerrë urdhrin për regjistrimin e padisë dhe njoftimin e palëve, për seancën e planifikuar në datën 22.05.2009.

prej tij afatet¹⁰¹ e parashikuara nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile. Respektimi i kërkesave procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile nuk mund të shmanget me argumentet e sjella nga subjekti për natyrën e çështjeve dhe objektin e tyre, për sa kohë Kodi nuk ka parashikuar përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, për më tepër kur kjo krijon premisa për trajtim të pabarabartë me palën e paditur, së cilës më së shumti i shërben koha e njoftimit për të siguruar mbrojtjen ndaj kërtimeve të padisë. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë dyshimin e ngritur prej Komisionit për favorizimin e palëve paditëse, në këndvështrim edhe të informacioneve të përcjella nga organet ligjzbatuese.

41.14. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se vendimmarrjet e tij janë kontrolluar edhe nga shkallë të tjera të gjyqësorit, trupi gjykues sqaron se procesi i rivlerësimit është një proces i parashikuar nga Kushtetuta e Shqipërisë, i miratuar dhe i gjithëpranuar si një proces i jashtëzakonshëm kontrolli për subjektet e rivlerësimit, i cili kryhet në funksion të përmbushjes së qëllimit të shpallur në nenin 179/b të Kushtetutës, për rikthimin e besimit të publikut te drejtësia. Qëllimi dhe objektivi i kontrollit të ushtruar gjatë këtij procesi mbi të tria kriteret e rivlerësimit nuk janë të njëjtë me qëllimin dhe objektivin që ndjek kontrolli gjyqësor i zakonshëm apo qoftë i veçantë, që kanë kryer strukturat kontrolluese brenda sistemit të drejtësisë, në zbatim të kuadrit ligjor të përgjithshëm në fuqi. Kjo nuk pengon, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, të drejtën e organeve të rivlerësimit për të kryer kontrollin dhe vlerësimin e tyre në mënyrë të pavarur e objektive dhe, sigurisht, në përputhje me qëllimin e parashikuar në ligj për kryerjen e këtij procesi për verifikimin e nivelit të aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit, dhe përcaktimin e nivelit të besueshmërisë së këtij kriteri, sipas parashikimeve të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

41.15. Në lidhje me pretendimet e subjektit, *se në kriterin e vlerësimit profesional janë analizuar dosje gjyqësore të marra në kuadër të vlerësimit të kriterit të kontrollit të figurës, duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit, përkatësisht vendimeve nr. 20/2020 dhe nr. 28/2020*, trupi gjykues vlerëson se nuk jemi para të njëjtave rrethana. Komisioni, në rastin e subjektit Andri Ymeri, në kuadër të kriterit të kontrollit të figurës, i ka kaluar atij barrë prove edhe në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional. Ky fakt i është vënë në dijeni subjektit me dërgimin e rezultateve të hetimit, në të cilin Komisioni shprehet se analizimi i këtyre dosjeve do të jetë pjesë e vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale. Analizimi i dosjeve gjyqësore në funksion të rivlerësimit të figurës është bërë edhe në kuadrin e vlerësimit profesional, por përfundimet për gjetjet janë të ndara, sipas kriterit që do të rivlerësohet. Në zbatim të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, dhe gjatë hetimit administrativ mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Sipas së njëjtës dispozitë, institucionet e rivlerësimit kanë akses të gjerë në informacion të ruajtur nga ente publike dhe private në drejtim të kontrollit të secilit prej kriterëve të rivlerësimit. Me fjalë të tjera, në ngritjen e procesit të rivlerësimit, ligjvënësi i ka treguar kujdes të veçantë rëndësisë së hetimit nga institucionet e rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin, për të siguruar saktësinë e informacionit dhe për të garantuar të drejtat e subjekteve të rivlerësimit në funksion të misionit të procesit – kthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Në rastin objekt gjykimi, analizimi i dosjeve të marra në vlerësim,

¹⁰¹ Në nenin 155 të K. Pr. Civile parashikohet se: *Ndërmjet datës që është njoftuar padia dhe asaj të paraqitjes në gjykatë, duhet të sigurohet një afat jo më pak se dhjetë ditë.*

...Në çështjet që është e nevojshme të kryhet një njoftim i shpejtë i padisë, me kërkesën e paditësit, gjyqtari kur e sheh atë me vend, mund të lejojë mosrespektimin e afatit të mësipërm të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, por gjithnjë njoftimi duhet të jetë bindës, në përputhje me rregullat e parashikuara prej neneve 132 e 133 të këtij Kodi dhe pa i cenuar të paditurit të drejtën e mbrojtjes.

është iniciuar nga informacioni i agjencive ligjzbatuese të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji i posaçëm, për të ndihmuar institucionet e rivlerësimit në veprimtarinë e tyre për kryerjen e procesit të rivlerësimit. Vendimet e Kolegjit bazohen në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për faktet e provuara gjatë gjykimit. Pavarësia e veprimeve hetimore dhe e vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit, sa u takon çështjeve të rivlerësimit kalimtar, është konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën. Në terma praktikë, ky parim i analizuar nga Gjykata Kushtetuese, por edhe nga një zbërthim i nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nënkupton që çdo vlerësim i kryer nga organet ndihmëse duhet t'i nënshtrohet një hetimi të pavarur të organeve të rivlerësimit. Nën këtë dritë, analiza e kryer nga Komisioni për indiciet që rezultojnë nga informacioni i dërguar nga organet ligjzbatuese, është e bazuar në ligj dhe në përputhje të plotë me detyrimet kushtetuese për një proces të rregullt për subjektet e rivlerësimit. Kjo linjë interpretimi është ndjekur gjerësisht edhe nga trupa të ndryshëm të Kolegjit, në vendime të ndryshme ndër vite¹⁰². Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

41.16. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se Komisioni ka shkelur jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës të Lartë, duke bazuar procesin e rivlerësimit të tij në çështje që janë gjykuar, është i pabazuar. Sikurse rezulton e qartë nga vendimi, Komisioni nuk ka vlerësuar themelin e çështjeve të shqyrtuara nga subjekti, por sjelljen e tij në raport me kërkesat e ligjit nr. 84/2016, për kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale, kriter i cili është parashikuar nga neni E i Aneksit të Kushtetutës, Kreu VI i ligjit nr. 84/2016 – lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, etike dhe personale të magjistratëve – dhe Pjesën IV, nenet 68-99 të ligjit nr. 96/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se lënia ose jo në fuqi e vendimeve të dhëna nga subjektet e rivlerësimit mund të shërbejë si element statistikor në analizimin e veprimtarisë së gjyqtarëve dhe gjykatave, por jo në vlerësimin profesional të subjekteve, pasi në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 96/2016, vlerësimi i aftësive profesionale të një gjyqtari adresohet nga një këndvështrim formal i zbatimit të normave ligjore, i cili nuk gjykon korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, dhe asnjëherë nuk synon të zëvendësojë interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

41.17. Si konkluzion, për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës, trupi gjykues, në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, dosjeve gjyqësore, shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti, në përgjigje të barrës së provës, në seancë dëgjimore, si dhe në ankim, ashtu si edhe Komisioni, çmon se subjekti Andri Ymeri ka dhënë vendime favorizuese për palë të caktuara gjatë gjykimit të çështjeve, çka përputhet me gjetjet e hetimit administrativ.

41.18. Trupi gjykues vëren se konstatimi i DSIK-së, për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës, nuk lidhet me saktësinë dhe vërtetësinë e plotësimit të deklaratës së figurës, pasi nga rrethanat e konstatuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe nga Komisioni për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit nuk rezulton që ai të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm, sipas parashikimeve të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, në kushtet kur ky rezultat nuk përmbush kushtet e nenit 61, pikat 2 dhe/ose 3 të ligjit nr. 84/2016, konstatimet e mësipërme do të mbahen në konsideratë në një vlerësim tërësor të çështjes lidhur me rivlerësimin e subjektit, brenda përcaktimeve të tjera të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁰² Vendimi i Kolegjit nr. 38, datë 20.09.2023, që i përket subjektit të rivlerësimit S. S.

42. Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në: (i) Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLGJ-ja, me nr. {***} prot., datë 15.05.2020; (ii) Kriteret e vlerësimit, të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*; (iii) Denoncimet e publikut. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të papranueshme në punë, në atë shkallë sa programi i trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës nuk mund ta zgjidhë këtë çështje për një vit.

Komisioni konkludoi se në vlerësimin e aftësive profesionale, subjekti Andri Ymeri është i papërshtatshëm, në kuptim të gërmes “c”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016.

43. Analizimi i 5 (pesë) dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short

Nga verifikimi i akteve të dosjeve gjyqësore lidhur me çështjet për të cilat subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, janë evidentuar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe analizuar nga ana e Komisionit dosjet me gjetjet në vijim:

43.1. Në lidhje me dosjen nr. 1, që i përket çështjes civile nr. {***} regj. them., datë 07.05.2014, me paditës K. K. dhe A. K., të paditur M. G., person i tretë shoqëria “{***}” ShPK, Zyra Vendore e RPP Shkodër dhe Bashkia Shkodër, me objekt “njohje bashkëpronar në sip. truall 302 m²”, Komisioni ka çmuar se subjekti nuk e ka rregulluar ndërgjyqësinë e palëve në proces, pasi duhej të thërriste si palë ndërgjyqëse edhe trashëgimtarët e tjerë ligjorë të pasurisë së paluajtshme, duke vlerësuar se veprimet e subjektit afektojnë kriterin e vlerësimit të përcaktuar në nenin 74, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, dhe për sa i përket zhvillimit të seancave gjyqësore joproduktive, ato afektojnë kriterin e vlerësimit të përcaktuar në nenin 74, pika 3 e të njëjtit ligj.

43.1/a. Subjekti i rivlerësimit kundërshton qëndrimin e Komisionit për mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë, pasi sipas tij, në momentin e ngritjes së padisë, truall me sipërfaqe 302 m² nuk ekzistonte më si pasuri e mëvetësishme, pra nuk kishte më aftësinë për të marrë pjesë në qarkullimin civil në mënyrë të pavarur. Kjo pasi, mbi këtë truall ishte ndërtuar një pallat dhe njësitë përbërëse të këtij pallati ishin shitur nga shoqëria “{***}” ShPK personave të tretë. Si rrjedhojë, truall në fjalë, në momentin e ngritjes së padisë, ishte pjesë e bashkëpronësisë në tërësi (bashkëpronësi të detyrueshme) të pronarëve të njëjësive përbërëse të pallatit (apartamente, dyqane, depo, garazhe etj.), sipas neneve 209, 146 dhe 150 të Kodit Civil. Sipas subjektit, edhe nëse do të merrej parasysh që personat e përmendur, si trashëgimtarët e N. dhe L. P., mund të kishin pasur të drejta bashkëpronësore mbi truallin, ky interes është humbur për shkak të kalimit të afatit dekadencial të parashikuar nga Kodi Civil. Në këtë mënyrë, ata nuk mund të ndërhyjnë në procesin gjyqësor për të kontestuar ndërtimin e pallatit ose titujt e pronësisë.

43.1/b. Subjekti pretendon se formulimi i nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile, duke iu referuar foljes “çmon”, të përdorur në tekstin e normës, duket se është një proces diskrecionar dhe jo detyrues për Gjykatën. Sipas jurisprudencës së KBGJL-së, vendimmarrjet diskrecionare të gjyqtarëve, si rregull i përgjithshëm, nuk i nënshtrohen kontrollit gjyqësor (e aq më pak atij administrativ), përveç kur kanë tiparet e arbitraritetit ose paaftësisë së rëndë profesionale. Sipas subjektit në rastin konkret, nuk bëhet fjalë për arbitraritet dhe kërkon nga Kolegji të vlerësojë se aftësia e tij profesionale është e lartë. Prandaj, sipas subjektit, qëndrimi i Komisionit, që kërkon thirrjen e të gjithë trashëgimtarëve

ose blerësve si persona të tretë në gjykim, pas kalimit të afatit dekadencial, është i gabuar dhe do të sillte një zvarritje të procesit gjyqësor pa një bazë ligjore të qëndrueshme.

43.1/c. Nga verifikimi i akteve të fashikullit gjyqësor të kësaj çështjeje, trupit gjykues i rezulton se çështja gjyqësore është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër në datën 07.05.2014. Subjekti, nëpërmjet vendimit nr. {***}, datë 06.10.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër vendimit ka ushtruar ankim pala paditëse dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 05.11.2015, ka vendosur prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, por me një tjetër trup gjykues. Gjithashtu, nga aktet ka rezultuar se të ndjerët N. dhe L. P. kanë pasur në pronësi një pasuri të paluajtshme – një shtëpi banimi në lagjen “{***}” të qytetit të Shkodrës. Një nga trashëgimtarët ligjore, M. G., ka regjistruar në ZRPP Shkodër shtëpinë e banimit, si pronë të vetme të saj, por jo truallin mbi të cilin ajo ishte ngritur. Më tej, e paditura M. G. ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “{***}” ShPK, duke rënë dakord për shembjen e ndërtesës ekzistuese dhe ndërtimin e një pallati shumëkatësh mbi truallin prej 302 m².

43.1/ç. Nga verifikimi i dosjes gjyqësore konstatohet se trashëgimtarët ligjorë të N. dhe L. P. kanë pasur të drejta bashkëpronësore mbi truallin dhe nga ana e subjektit nuk janë thirrur si palë ndërgjyqëse në çështjen ku objekt gjykimi ka qenë pikërisht kjo pasuri e paluajtshme, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën e pronarëve të sendit objekt gjykimi për t’u mbrojtur. Sipas parashikimeve të nenit 193 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim shtyn seancën gjyqësore. Pretendimi i subjektit për shuarjen e së drejtës së bashkëpronësisë është i pabazuar, për sa kohë ky konkluzion duhej të kishte rezultuar në fund të gjykimit të çështjes dhe jo të përdorej si argument prej subjektit për të shmangur ndërtimin e ndërgjyqësisë në një formë të caktuar.

Në analizë të pretendimit të subjektit, se folja “çmon”, përdorur në tekstin e normës, është një proces diskrecionar dhe jo detyrues për gjykatën, trupi gjykues vlerëson se vendimmarrjet e gjyqtarëve nuk mund dhe nuk duhen të jenë të tilla që, në kuadër të diskrecionit, të kufizojnë të drejtat e palëve në gjykim. Pavarësisht sa më lart, trupi gjykues vlerëson se ky veprim i subjektit nuk mund të konsiderohet i tillë sa të afektojë kriterin e vlerësimit profesional të përcaktuar në nenin 74, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

43.1/d. Lidhur me konstatimin e Komisionit, se në zhvillimin e 10 seancave gjyqësore, subjekti ka zhvilluar 4 seanca jo produktive, pasi për 2 rastet e shtyra, për shkak të mospagesës së ekspertit, gjykata nuk duhej të shtynte seancën, por të urdhëronte nxjerrjen e detyrueshme të shpenzimeve për ekspertët me anë të përmbaruesit gjyqësor, sipas nenit 105 të K. Pr. Civile, subjekti i rivlerësimit pretendon se veprimet e tij kanë qenë të tilla për t’i dhënë më shumë kohë paditësve për të siguruar paratë dhe për të shmangur masat ekstreme, si urdhri për shërbimin përmbarimor, duke e vlerësuar si më praktike dhe më efikase për të shmangur vonesat dhe për të siguruar se gjykimi vazhdon pa u penguar nga probleme administrative.

43.1/dh. Nga verifikimi i akteve të fashikullit gjyqësor, trupi gjykues konstaton se seanca e datës 31.07.2014 dhe seanca e datës 09.09.2014 janë shtyrë për faktin se pala paditëse ka deklaruar se nuk ka pasur mundësi të paguajë tarifën e ekspertit të thirrur në gjykim. Në nenin 105 të Kodit të Procedurës Civile, “Parapagimi i shpenzimeve gjyqësore”, parashikohet se, kur një palë është e detyruar që të paguajë shpenzimet gjyqësore dhe nuk i paguan vullnetarisht, gjykata urdhëron me vendim nxjerrjen e tyre të detyrueshme.

Trupi gjykues çmon se nuk mund të konsiderohen si seanca gjyqësore joproduktive shtyrjet e tyre, pasi, nëse do të ishte ndjekur rruga e shërbimit përmbartimor, padyshim që ky proces do të kishte qenë më i ngadalshëm dhe do të kishte sjellë shtyrje të tjera të seancave, duke shtuar ngarkesën për palët dhe duke vonuar përfundimin e çështjes. Kjo gjithashtu do të kishte sjellë një kosto shtesë për paditësit, të cilët do të duhej të përballonin jo vetëm shpërblimin e ekspertit, por edhe shpenzimet përmbartimore. Kjo qasje e subjektit vlerësohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit, ku çdo masë duhet të jetë e përshtatshme dhe e nevojshme për të arritur qëllimin e saj, dhe nuk duhet të jetë më e ashpër sesa kërkohet nga situata. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se vonesa e krijuar në shtyrjen e dy seancave për shkak të mospagesës së ekspertit nuk paraqet problematikë të tillë, që mund të afektojë kriterin e vlerësimit të përcaktuar në nenin 74, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.

43.2. Lidhur me dosjen nr. 2, që i përket çështjes penale nr. {***} regj. them., datë 28.01.2015, kundër të pandehurit A. K., akuzuar për veprën penale të “*vjedhjes së energjisë elektrike dhe impulseve telefonike*”, të parashikuar nga neni 137/1 i K. Penal, rezulton se kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, më datën 27.01.2015, për *vleftësim të arrestit në flagrancë dhe gjykim të drejtpërdrejtë*. Në përfundim të gjykimit, subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 30.01.2015, duke vendosur: *deklarimin fajtor të pandehurit A. K., të akuzuar për veprën penale të “vjedhjes së energjisë elektrike”*, dhe, bazuar në nenin 406 të K. Pr. Penale, dënimin përfundimtar me 14 ditë burgim. Kundër vendimit nuk është ushtruar ankim nga palët.

43.2/a. Subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe në parashtrime, ka kundërshtuar¹⁰³ qëndrimin e Komisionit lidhur me arsyetimin në vendim, duke pretenduar se lloji dhe masa e dënimit që ka caktuar, është në përputhje të plotë me parimin e drejtësisë dhe të proporcionalitetit, si dhe të dy qëllimeve që ka dënimi penal¹⁰⁴.

43.2/b. Trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk i ka përfshirë gjetjet e evidentuara për këtë rast në vlerësimin profesional të subjektit, dhe për sa kjo çështje ka të bëjë me masën e dënimit, si dhe për të shmangur gjykimin e korrektësisë së vendimit të subjektit, vlerëson të mos analizojë më tej rrethanat e vendimmarrjes së subjektit për këtë çështje.

43.3. Lidhur me dosjen nr. 3, që i përket çështjes civile nr. {***} regj. them., datë 22.01.2015 regjistrimi, me paditëse A. L., kundër të paditurit A. L., me objekt “*zgjidhje martese dhe të pasojave që rrjedhin prej saj*”, Komisioni ka vlerësuar se veprimet e subjektit afektojnë kriterin e vlerësimit të parashikuar nga neni 74, pikat 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016, pasi subjekti nuk ka respektuar afatin e parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile, seancat nuk janë zhvilluar me regjistrim audio, në funksion të solemnitetit dhe të transparencës së gjykimit.

43.3/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, referuar parashikimeve të nenit 155, paragrafi 1 i Kodit të Procedurës Civile, afati 10-ditor i parashikuar nga neni, nuk është as afat prekluziv dhe as afat i prerë,

¹⁰³ Sipas subjektit, i dënuari ka qenë abonent familjar, ai nuk ka paguar energjinë elektrike me të cilën është furnizuar familja e tij, në një shumë akumulative relativisht jo të madhe. Pasi OSHEE ShA i ka ndërprerë energjinë elektrike dhe e ka gjobitur, ai ka konsumuar veprën penale të rilidhjes së energjisë elektrike, për të cilën është dënuar. Lloji dhe masa e dënimit me 14 ditë burgim (me gjykim të shkurtuar), është në proporcion si me shumën e parave që ai ka përfutur nga kryerja e veprës penale, si me masën e dëmit ekonomik të llogaritur nga vetë OSHEE ShA, si e dëmtuar nga vepra penale, si me gjendjen familjare të të pandehurit, që është në moshë relativisht të madhe, kryefamiljar, me fëmijë, i papunë, me gjendje ekonomike familjare të varfër, i padënuar më parë, që ka shprehur pendim për veprën duke e pranuar atë.

¹⁰⁴ Konkretisht, subjekti sqaron se qëllimet lidhen me parandalimin e posaçëm (që është edukimi i autorit të veprës penale përmes dënimit, që në të ardhmen të mos përsërisë më kryerjen e veprave penale), dhe me parandalimin e përgjithshëm, (që është edukimi i publikut në përgjithësi, përmes dhënies së shembullit të dënimit të autorit të veprës penale, që të mos kryejë vepra penale).

pasi kjo nuk parashikohet shprehimisht në ligj (shih fjalinë e dytë të nenit 145 të K. P. C.-së dhe fjalinë e parë të nenit 146 të këtij Kodi). Për rrjedhojë, ky afat ligjor është një afat i zakonshëm (shih fjalinë e parë të nenit 146 të K. P. C.-së) dhe, duke u bazuar si në interpretimin sistematik ashtu edhe në atë literal të këtij neni, në lidhje me paragrafin 3, të nenit 155, të po këtij Kodi, ai mund të shkurtohet kur është e nevojshme, me kërkesë të paditësit dhe me miratimin e gjyqtarit, pa cenuar të drejtën e mbrojtjes së palës së paditur. Sipas subjektit, fakti që as paditësi dhe as e paditura nuk kanë paraqitur kundërshtime në lidhje me këtë ndryshim, sipas subjektit, jo vetëm që tregon se veprimi i tij është kryer në përputhje me kërkesën e palëve, por edhe se njoftimi për datën e shqyrtimit gjyqësor ka qenë i qartë dhe bindës, për rrjedhojë, nuk është cenuar e drejta e mbrojtjes së palës së paditur. Subjekti, si në ankim, ashtu edhe në parashtime, pretendon se mosregjistrimi audio i seancave gjyqësore nuk ka qenë për shkak të fajit tij, por për një sërë faktorësh objektivë¹⁰⁵.

43.3/b. Nga shqyrtimi i fashikullit gjyqësor rezulton se çështja është regjistruar në gjykatë në datën 22.01.2015. Me vendimin e datës 28.01.2015 (pas 6 ditësh), gjyqtari ka caktuar seancën përgatitore të pajtimit në datën 06.02.2015, ora 15:00. Subjekti, me vendimin nr. {***}, datë 20.02.2015, ka vendosur: *Pranimin e padisë, duke zgjidhur martesën midis palëve ndërgjyqëse, pa përcaktuar fajësinë*. Ndaj vendimit nuk është ushtruar ankim.

43.3/c. Në lidhje me mosrespektimin e afatit ligjor të parashikuar në paragrafin 1, të nenit 155, të K. P. C.-së, trupi gjykues vëren se parashikimi i afatit shoqërohet me termin “duhet”, pra nuk është një çështje opsionale, por detyrim i gjykatës. Ndërsa përjashtimi që bëhet në paragrafin e tretë të nenit 155 kërkon që përsheptimi i afatit të bëhet me kërkesën e paditësit, çka nuk rezulton që në fashikullin gjyqësor të jetë administruar prej subjektit një kërkesë e tillë në formë të shkruar, ashtu siç e kërkon procedura ligjore. Kjo mangësi lidhet me mënyrën e dokumentimit të vullnetit të paditësit dhe mund të cilësohet si një mangësi organizative nga ana e subjektit, e cila lidhet me indikatorin e “aftësisë për të administruar dosjet gjyqësore”, konkretisht me treguesin e rregullshmërisë ose plotësisë së dokumentacionit të dosjes, sipas paragrafit 5, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016. Pretendimet e subjektit të rivlerësimit për prekluzivitet të afateve vlerësohen jorelevante nga trupi gjykues, për sa kohë ato nuk lidhen me ushtrimin e ndonjë të drejte prej palëve, por me veprimtarinë gjyqësore. Në kushtet kur kjo shkelje procedurale nuk rezulton të ketë sjellë ndonjë pasojë negative për palët dhe çështja është zgjidhur pa kontestime prej tyre, trupi gjykues vlerëson se mbetet një shkelje me natyrë formale. Ndërsa, lidhur me qëndrimin e Komisionit për mosregjistrimin e seancave audio, trupi gjykues konstaton se, duke marrë parasysh rrethanat objektive, si pasojë e faktorëve teknikë dhe organizativë që ekzistonin në atë periudhë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, vlerëson se mosregjistrimi

¹⁰⁵ Së pari, sistemi RDA është instaluar dhe ka qenë funksional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër rreth mesit të vitit 2015. Në kohën kur është zhvilluar gjykimi i çështjes përkatëse, në periudhën janar - shkurt 2015, aftësia e sekretareve gjyqësore për të përdorur këtë sistem nuk ishte e plotë. Kjo për shkak se, nga fillimi i vitit 2015 deri në prill të po atij viti, sekretaret gjyqësore kishin zhvilluar vetëm tre sesione trajnimi njëditore për të mësuar përdorimin e sistemit RDA. Për më tepër, nga janari deri në prill 2015, sistemi ishte ende në fazë prove dhe nuk ishte funksional plotësisht. Në këto kushte, në kohën kur çështja u gjykua, nuk kishte ende një mundësi reale për regjistrimin audio të seancave. Së dyti, një tjetër faktor me ndikim në këtë çështje ishte mungesa e sallave gjyqësore të pajisura me sistemin RDA. Në atë kohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër kishte 14 gjyqtarë, por vetëm 5 sala të pajisura me sistemin e regjistrimit audio. Kjo kufizonte ndjeshëm mundësinë që çdo gjykim të zhvillohej në një sallë të pajisur me këtë sistem. Në parashtime, subjekti ka paraqitur kthim përgjigjen e Kancelares së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, kërkesës së tij të datës 29.08.2024, drejtuar Gjykatës, sipas së cilës (në të përfshihet dokumentacioni shoqërues, një informacion me shkrim nga IT-ja e gjykatës, A. R., të dhëna elektronike të gjeneruara nga Sistemi ICCMISS+RDA).

audio i seancave nuk mund t'i atribuohet si një shkelje e subjektit e aq më tepër që mund të afektojë indikatorët e nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.

43.4. Lidhur me dosjen nr. {***}, që i përket çështjes civile nr. {***} regj. them., datë 27.05.2015 regjistrimi, me paditës H. D., kundër të paditurit Sh. R. etj., me objekt *“njohje pronësie me parashkrim fitues mbi një shtëpi banimi”*, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka demonstruar mangësi në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 dhe mangësi në drejtim të aftësive organizative, sipas përcaktimeve të nenit 73, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

43.4/a. Subjekti, në kundërshtimet e tij lidhur me këtë konstatim, pretendon se mosveprimi i tij lidhur me njoftimin e të paditurit për seancën e parë gjyqësore, duke pasur parasysh se ai ishte shpallur më parë në mungesë në seancën përgatitore, nuk ka sjellë asnjë dëm ndaj interesave të tij. Ky konkluzion sipas tij bazohet në faktin se, jo vetëm se i padituri rezultoi gjyqfitues me vendimin përfundimtar të gjykatës, i cili u la në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër, por edhe se gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, ky gabim është riparuar nga vetë ai gjatë vijimit të procesit, duke siguruar që i padituri të ishte i informuar dhe të kishte mundësinë për të ushtruar të drejtat e tij procedurale. Sipas subjektit, një masë ndëshkuese ndaj tij do të ishte në kundërshtim me parimet e drejtësisë, objektivitetit dhe proporcionalitetit.

43.4/b. Nga verifikimi i akteve të dosjes, trupi gjykues konstaton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër më datë 27.05.2015. Me vendimin e datës 01.06.2015 (pas 3 ditësh), gjyqtari ka caktuar seancën përgatitore në datën 29.06.2015. Subjekti me vendimin nr. {***}, datë 24.12.2015, ka vendosur: *rrëzimin e kërkesëpadisë*. Ndaj vendimit është ushtruar ankim nga pala paditëse dhe Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 11.12.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Trupi gjykues konstaton se janë shtyrë 4 herë seancat gjyqësore, si pasojë e mungesës së konfirmimit të njoftimit për të paditurit. Seanca e parë gjyqësore është zhvilluar në mungesë të palës paditur pa pasur njoftim, me arsyen se është deklaruar mungesa në seancë përgatitore në kundërshtim me nenet 175 dhe 179 të K. Pr. Civile, pasi për seancën e parë gjyqësore palët duhej të rinjoftoheshin përsëri me anë të fletëthirrjeve apo shpalljes publike.

43.4/c. Trupi gjykues, referuar nenit 128 të Kodit të Procedurës Civile, në të cilin parashikohet se gjyqtari kujdeset dhe kontrollon procesin e njoftimit, që kryhet nga nëpunësit e administratës gjyqësore, vlerëson se nga ana e subjektit nuk janë marrë masat e duhura për të shmangur shtyrjen e seancave gjyqësore, për shkak të mungesës së konfirmimit të njoftimit nga ana e palëve në gjykim. Ky është një detyrim ligjor dhe nuk është në diskrecion të gjyqtarit të vlerësojë dhe të abstragojë në lidhje me vullnetin e palëve për sa i përket gjykimit, nëse ky vullnet nuk shfaqet me veprime ose mosveprime sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile.

43.5. Në përfundim të analizimit të 5 (pesë) dosjeve të përzgjedhura me short, të evidentuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe për të cilat Komisioni ka konstatuar mangësi, trupi gjykues vlerëson se mangësitë e konstatuara në veprimtarinë gjyqësore të subjektit të rivlerësimit e të konfirmuara si më sipër, nuk marrin peshë të tillë që të afektojnë kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, përcaktuar në nenin 74, pikat 2, 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016.

44. Denoncimet nga publiku

Komisioni ka administruar 26 denoncime nga publiku për subjektin e rivlerësimit Andri Ymeri.

Komisioni pas analizimit të tyre konstatoi se për disa¹⁰⁶ prej tyre nuk evidentoi shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit, dhe i kaloi barrën e provës për 10 prej tyre, si vijon:

44.1. Lidhur me denoncimin e shtetases D. D.,¹⁰⁷ e cila pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. {***}, datë 12.01.2021, pa u shprehur më parë prokuroria për përfundimin e procedimit penal nr. {***}, Komisioni në vendim ka vlerësuar se, për sa kohë subjekti ka përdorur akte të fashikullit penal në procesin e tij civil, si dhe ka konkluduar se kemi të bëjmë me shkelje të rregullave të sigurimit në punë, ai nuk mund të vijonte gjykimin e kësaj çështjeje derisa të përfundonte procedimi penal. Këto veprime të subjektit tregojnë mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

44.1/a. Subjekti pretendon se interpretimi që i bën Komisioni përmbajtjes së nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile është jo i drejtë, pasi në një interpretim gjuhësor vihet re qartësisht se në këtë nen përdoret folja “mund”. Kjo folje nënkupton diskrecionalitet të gjykatës, hapësirë vlerësimi nga ana e saj të karakterit të çështjes, në mënyrë që të vendosë nëse duhet apo jo të bëhet pezullimi i gjykimit. Sipas subjektit, duke pasur këtë natyrë diskreciale, hapësira e vlerësimit të gjykatës, nëse çështja duhet apo jo të pezullohet derisa të zgjidhet çështja penale, është çështje e bindjes së brendshme të gjyqtarit, të cilën ai e krijon nga vlerësimi i rrethanave të çështjes. Në rastin konkret, sipas tij, nga zgjidhja që ai i ka dhënë çështjes, nuk është cenuar parimi i sigurisë juridike, duke pasur parasysh nenin 70 të Kodit të Procedurës Penale, që parashikon se: “1. *Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm për sa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari.* 2. *Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër*”.

44.1/b. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore me paditës E. M. etj., të paditur shoqërinë “{***}” ShPK, me objekt “*Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësve dëmshpërblimin për dëmin pasuror dhe jopasuror për aksidentin me plagosje në punë, më datë 05.03.2019*”, trupit gjykues i rezultoi se paditësi E. M. ka qenë i punësuar mbi bazën e kontratës individuale të punës pranë shoqërisë “{***}” ShPK dhe, gjatë marrëdhënies së punës, ai ka pësuar aksident me pasojë plagosjen. Për këtë ngjarje ka filluar procedimi penal nr. {***}/viti 2019. Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vijuar seancat në mungesë të palës së paditur “{***}” ShPK, me caktimin e ekspertëve dhe, në datën 12.02.2021, ka vendosur pranimin e padisë, duke detyruar palën e paditur t’i paguajë paditësve vlerën prej 8.551.403 lekë. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur “{***}” ShPK, duke pretenduar se gjykata ka kryer njoftimin e të paditurit në një adresë në të cilën aktiviteti i saj është pezulluar, si dhe ka gjykuar çështjen pa pritur përfundimin e hetimeve të kryera nga prokuroria në lidhje me këtë ngjarje. Gjykata e Apelit, pasi kërkoi informacion nga prokuroria lidhur me fazën e hetimit të procedimit penal, në vijim pezulloi gjykimin deri në përfundimin e hetimeve për procedimin penal nr. {***}/2019, bazuar në parashikimet e nenit 297/a të K. Pr. C.

44.1/c. Me qëllim analizimin e veprimeve të subjektit në këtë çështje, fillimisht, trupi gjykues iu referua dispozitave ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie, konkretisht në nenin 297/a të Kodit të

¹⁰⁶ Në lidhje me denoncimet e P. G. (nr. {***} prot., datë 11.01.2021); K. G. e K. C. (nr. {***} prot., datë 05.02.2020); Th. M. (nr. {***} prot., datë 30.12.2019); A. B. (nr. {***} prot., datë 08.09.2021); A. Rr. (nr. {***} prot., datë 12.2.2021); T. N. (nr. {***} prot., datë 26.01.2018); M. C. (nr. {***} prot., datë 21.06.2018); M. Ll. (nr. {***} prot., datë 20.03.2018); G. H. (nr. {***} prot., datë 30.04.2018); S. L. (nr. {***} prot., datë 13.07.2018); R. Xh. (avokat).

¹⁰⁷ Nr. {***} prot., datë 24.03.2021.

Procedurës Civile është parashikuar se: “Gjykata vendos pezullimin kur çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative”. Në vështrim të rregullimit të bërë në këtë dispozitë, gjykata mund të pezullojë shqyrtimin e çështjes, atëherë kur ndërthurja midis dy çështjeve është e tillë që e vendos atë në pamundësi objektive për të përfunduar gjykimin e nisur, nëse nuk përfundon çështja tjetër.

44.1/ç. Për rrjedhojë, në kushtet kur nga aktet e kësaj çështjeje rezulton se subjekti ishte në dijeni të faktit që kishte një procedim penal dhe akte të këtij procedimi (procedimi penal nr. {***}/2019) i përmend si prova në këtë çështje gjyqësore, pra vetë subjekti referon në një procedim penal, ndërkohë pretendon se ky procedim penal nuk kishte lidhje me çështjen që po shqyrtohej nga ana e tij, pretendimi i subjektit është i pabazuar. Duke marrë në konsideratë vlerën e lartë monetare që do të duhej të paguante i padituri, si edhe parashikimin e nenit 70 të Kodit të Procedurës penale, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, me qëllim zgjidhjen e drejtë të çështjes dhe përcaktimin e saktë të përgjegjësisë civile dhe palës që duhej të përgjigjej ndaj saj, duhej të kishte vlerësuar pezullimin e shqyrtimit të çështjes, sipas parashikimit të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile¹⁰⁸, ashtu sikurse veproi Gjykata e Apelit Shkodër, për rrjedhojë, veprimet e mësipërme të subjektit konsiderohen se afektojnë indikatorët e nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

44.1/d. Lidhur me pretendimin e subjektit, se për të njëjtën ankesë ka kontrolluar edhe ILD-ja, e cila me vendimin nr. {***}, datë 30.07.2021, ka vendosur për të mos hapur një hetim disiplinor, si dhe duke pretenduar se Komisioni ka shkelur kompetencat e tij, pasi ka marrë përsipër të vlerësojë drejtësinë e vendimeve të ndërmjetme apo ndoshta edhe të vendimit përfundimtar, aq më tepër kur kjo çështje është për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Shkodër, trupi gjykues sqaron se procesi i rivlerësimit është një proces i parashikuar nga Kushtetuta e Shqipërisë, i cili kryhet në funksion të përmbushjes së qëllimit të shpallur në nenin 179/b të Kushtetutës, për rikthimin e besimit të publikut te drejtësia. Qëllimi dhe objektivi i kontrollit të ushtruar gjatë këtij procesi mbi të tria kriteret e rivlerësimit nuk janë të njëjtë me qëllimin dhe objektivin që ndjek kontrolli rutinë/periodik apo qoftë i veçantë, që kanë kryer strukturat kontrolluese të sistemit të drejtësisë, në zbatim të kuadrit ligjor të përgjithshëm në fuqi. Kjo nuk pengon në kuptim të ligjit nr. 84/2016 të drejtën e organeve të rivlerësimit për të kryer kontrollin dhe vlerësimin e tyre në mënyrë të pavarur dhe objektive. Gjithashtu, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk ka gjykuar mbi meritat e çështjes, por ka analizuar çështjen në përputhje me qëllimin e parashikuar në ligj për kryerjen e këtij procesi, për verifikimin e nivelit të aftësive profesionale dhe etike të subjektit të rivlerësimit dhe përcaktimin e nivelit të këtij kriteri sipas parashikimeve të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

44.2. Për sa i përket denoncimit të z. M. K.,¹⁰⁹ i cili pretendon se subjekti ka rrëzuar dhe kërkesën e tij për “pezullimin e gjykimin të çështjes”, pas kallëzimit të bërë prej tij në ngarkim të paditësit D. H., për veprën penale të “falsifikimit të dokumenteve” dhe denoncueses N. K.,¹¹⁰ e cila pretendon se subjekti i rivlerësimit duhet ta kishte thirrur atë në këtë gjykim, në cilësinë e personit të tretë, për shkak të mbivendosjes së pronës së saj me pronat objekt gjykimi, Komisioni ka vlerësuar se këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të arsyetimit ligjor në kuptim të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, pasi nuk ka argumentuar shkaqet e rifillimit të gjykimin, si dhe të aftësive organizative, në

¹⁰⁸ Gjykata vendos pezullimin e gjykimin kur: (a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative.

¹⁰⁹ Denoncim nr. {***} prot., datë 03.03.2020; nr. {***} prot., datë 18.01.2021.

¹¹⁰ Denoncim nr. {***} prot., datë 05.02.2020; nr. {***} prot., datë 03.03.2020; nr. {***} prot., datë 18.01.2021.

kuptim të nenit 74/3 të ligjit nr. 96/2016, sepse nuk ka nxjerrë vendimet e ndërmjetme, duke mos kryer veprimet e nevojshme procedurale.

44.2/a. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit me argumentin se, jo vetëm që nuk ka ardhur ndonjë pasojë nga mospezullimi i gjykimit, por kanë ardhur pasoja pozitive për drejtësinë, pasi nëse do të kishte vepruar ndryshe, jo vetëm do të kishte zbatuar gabim ligjin, por sot kjo çështje do të ishte duke pritur radhën e gjykimit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm. Sipas subjektit, për këtë ankesë ka hetuar mbi të njëjtat pretendime edhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, i cili me vendimin nr. {***} prot., datë 12.02.2021, ka vendosur të mos fillojë një hetim disiplinor dhe fakti që vendimi i dhënë prej tij është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër tregon se nuk ka gabuar në zbatimin e legjislacionit procedural, për sa kohë një gjykatë më e lartë ka lënë në fuqi vendimin e tij. Gjithashtu, pretendimet për falsifikim janë hedhur poshtë me vendimin gjyqësor penal nr. {***}, datë 15.11.2021, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

44.2/b. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të këtij shkakui ankimi, mori në shqyrtim aktet e fashikullit gjyqësor që i përket palëve: paditës/i kundërpaditur: D. H.; Të paditur/kundërpaditës: M. K. etj.; Objekt padie: *“Kthim sendi, njohje pronar me parashkrim fitues”*, dhe i rezultoi se, në kërkesëpadi, në cilësinë e të paditurit, përveç shtetasve M. dhe P. K., është thirrur dhe shtetasja N. K. Kjo çështje civile ka qenë e regjistruar më parë në vitin 2016, pranë gjyqtarit B. S., i cili ka vendosur pezullimin e gjykimit të çështjes derisa të zgjidhej çështja penale nr. {***}. Me transferimin e këtij gjyqtari në një gjykatë tjetër, kjo çështje i ka kaluar subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri, me status *“Pezulluar”*. Çështja ka vijuar të jetë e pezulluar deri më datë 25.01.2019, datë në të cilën subjekti ka urdhëruar njoftimin e palëve për seancën gjyqësore të radhës. Gjatë gjykimit të kësaj çështjeje, në datën 04.03.2019, përfaqësuesja e palës së paditur (denoncuesit) ka paraqitur: (i) Kërkesë për *“pezullimin e gjykimit të çështjes”*, me argumentin se të paditurit kanë paraqitur në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, kallëzimin penal nr. {***}, datë 2.3.2018, për veprën penale *“falsifikim të dokumenteve”*. Në këtë kërkesë, përfaqësuesja e të paditurve informon gjykatën se prokuroria ka vendosur *“mosflimin e procedimit penal”*, ndaj të cilit është ushtruar ankim në gjykatë. Me vendim të Gjykatës së Apelit Shkodër është urdhëruar vazhdimi i hetimeve dhe kjo çështje penale vijon të jetë në hetim nga Prokuroria e Rrethit Shkodër, si dhe (ii) Kërkesë *“për konstatimin e falsifikimit të dokumentit”*, përmes së cilës kërkuksi informon gjykatën se një pjesë e dokumenteve të depozituara nga pala paditëse në këtë proces civil janë objekt hetimi në çështjen penale nr. {***}, datë 02.03.2018, si pasojë, ai kërkon konstatimin e falsitetit të këtyre dokumenteve.

44.2/c. Në lidhje me këto dy kërkesa, në fashikull gjendet i administruar vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër nr. {***}, datë 04.06.2018, sipas të cilit është prishur vendimi i mosfillimit të procedimit penal, inicuar me kallëzim penal nr. {***}/2018 të z. M. e P. K. ndaj z. D. H. dhe është urdhëruar prokuroria të regjistrojë procedimin penal dhe të kryejë hetimet e nevojshme në lidhje me këtë kallëzim. Në fashikull nuk ndodhet vendimi i ndërmjetëm i subjektit të rivlerësimit për rifillimin e gjykimit, por në vendimin përfundimtar nr. {***}, datë 24.04.2019, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera,¹¹¹ është shprehur në lidhje me kërkesat e mësipërme se: *Kërkesat për pezullimin e gjykimit,*

¹¹¹ Gjykata i vlerëson si të papranueshme pretendimet e ndërgjyqësve K., lidhur me falsitetin e vendimit të KKKP-së Shkodër dhe notës së transkriptimit, pasi këto pretendime nuk u mbështeten në prova nga ana e paditësit. Marrja në konsideratë e këtyre pretendimeve/prapësimeve bie në kundërshtim me parimin e *“gjësë së gjykuar”*, pasi po të merren në konsideratë, vihen në diskutim fakte krijuese të pranuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë, që është vendimi i vitit 2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Sipas jurisprudencës së konsoliduar gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare, fuqia detyruese e vendimit gjyqësor të formës së prerë, në kuptimin procedural, mbulon jo vetëm pjesën

grykata i ka konsideruar si të paligjshme, pasi ndërgjyqësiti H., sendin objekt grykimi e kanë fituar përmes një vendimi gryqësor të formës së prerë. Për sa kohë nuk ka ndonjë procedurë ligjore që të vihet në diskutim ligjshmëria e këtij vendimi, atëherë rezultatet e këtij grykimi nuk ndërvaren nga ndonjë çështje tjetër.

44.2/ç. Trupi grykues konstaton se nga ana e subjektit është vijuar grykimi pa u nxjerrë më parë vendimi për rifillimin e grykimit, si dhe pa u argumentuar shkaqet e rifillimit të çështjes gryqësore, pasi shkaku për të cilin ishte pezulluar çështja nuk ishte zhdukur sipas parashikimeve të nenit 298 të Kodit të Procedurës Civile. Kërkesat për pezullim kanë qenë një mënyrë reagimi i palëve kundër vendimit për rifillim, duke qenë se ndaj tij nuk parashikohet ankim i veçantë referuar nenit 301 të K. Pr. Civile. Për rrjedhojë, subjekti, bazuar në nenin 315 të Kodit të Procedurës Civile, kishte detyrimin ligjor që të vendoste revokimin e këtij vendimi dhe rifillimin e grykimit. Nga ana e subjektit, në këtë rast, nuk është vepruar sipas parashikimeve të Kodit të Procedurës Civile, pasi ai nuk ka marrë asnjë vendim për revokimin e vendimit të pezullimit dhe të rifillimit të grykimit.

44.2/d. Gjithashtu, trupi grykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka vijuar grykimin pa u zgjidhur më parë çështja penale, duke mos respektuar parashikimet ligjore të nenit 297/a të Kodit të Procedurës Civile. Për sa kohë kallëzimi penal kishte për objekt falsifikimin e një dokumenti, i cili lidhej me procesin civil, dhe çështja ka qenë akoma nën hetim nga ana e Prokurorisë së Rrethit Gryqësor Shkodër, kërkesat procedurale për pezullim të grykimit të çështjes kanë pasur një interes të ligjshëm material për të mbrojtur, për pasojë janë cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt. Në lidhje me argumentimin e subjektit se paditësit pronësinë e kanë fituar nëpërmjet një vendimi gryqësor, ky argument nuk qëndron, pasi në vendimin nr. {***}, datë 11.12.2001, është vendosur ndryshimi i vendimit të Komisionit, Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Shkodër, duke u ndryshuar sipërfaqja e pronës së kthyer për shkak të njësisë matëse.

44.2/dh. Lidhur me gjetjen e Komisionit, se subjekti nuk ka nxjerrë vendimet e ndërmjetme në lidhje me kërkesat e palëve për pezullimin e vendimit dhe konstatimin e falsifikimit të dokumentit, trupi grykues konstaton se subjekti i ka shprehur verbalisht ato në seancat gryqësore, por mungon një arsyetim shterues mbi arsyet e rrëzimit të kërkesave dhe sipas neneve 171/a, paragrafi 3, 171/b, paragrafi 1, si dhe 183/1 të K. P. C. -së, edhe pse nuk parashikohet detyrimi i gryqtarit për të zbardhur me shkrim këtë tipologji vendimesh të ndërmjetme, por sërish i ngarkohet atij detyrimi ligjor për t'i arsyetuar në vendimin përfundimtar, ku mund t'i nënshtroheshin ankimit.

44.2/e. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se kjo çështje është trajtuar më parë nga ILD-ja, trupi grykues konstaton se në ankesën e znj. N. K., pranë ILD-së, janë cituar disa gryqtarë dhe prokurorë, vendimi i ILD-së, në faqen 6, paragrafi 3 i tij analizon vetëm pretendimet e ankueses për korrupsion të subjektit dhe nuk analizon veprimet procedurale të tij.

Pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se ky vendim është lënë në fuqi nga Grykata e Apelit dhe nuk mund të jetë pjesë e vlerësimit profesional, si edhe pretendimi i subjektit se është trajtuar themeli i grykimit të tij nga Komisioni, nuk qëndron, pasi Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për themelin e çështjes apo për veprime procedurale që prekin zgjidhjen e çështjes. Barra e provës që i

urdhëruese të vendimit gryqësor, por gjithashtu edhe pjesën arsyetuese të tij. Sipas vlerësimit të grykatës, falsitetet e pretenduara nga të paditurit përbëjnë gjë të grykuar të nënkuptuar, që nuk ekzistojnë. Kjo mosekzistencë përbën fakt juridik të pranuar në një vendim gryqësor të formës së prerë, dhe nuk mund të vihet në bisedë përsëri në këtë grykim.

ka kaluar Komisioni nuk ka pasur të bëjë me vendimmarrjen, por me veprime procedurale të tij, të cilat vlerësohet se prekin kriteret e vlerësimit profesional të parashikuara nga neni 71 e në vijim të ligjit nr. 96/2016.

44.2/ë. Nga sa më lart, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit, se këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, të arsytimit ligjor në kuptim të nenit 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, pasi ka vepruar në kundërshtim me parashikimin ligjor.

44.3. Lidhur me denoncimin e znj. A. M.,¹¹² e cila ankohet se subjekti i rivlerësimit vijoi gjykimin e çështjes me objekt *“pjesëtim pasurie”*, pa pritur përfundimin e procesit penal, Komisioni përtej sa ka pretenduar ankuesja, ka konstatuar se: (i) përfaqësues i njërit prej palëve në gjykim ka qenë z. K., i cili sipas deklarimeve të subjektit ka qenë shok shkolle me të dhe, sikurse ka rezultuar nga hetimi administrativ, subjekti ka kryer disa udhëtime me të. Në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 01.02.2016, vetë subjekti është shprehur se z. K. e ka njoftuar nëpërmjet *sms*-së, se është shtruar në spital një ditë përpara zhvillimit të seancës gjyqësore. (ii) Nga verifikimi i deklaratës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se ai ka deklaruar si kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar shtetasin K. M. (pala e paditur) dhe ka pasur kontakte me këtë shtetas gjatë vitit 2011 – 2012. Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka gjykuar këtë çështje, pasi: (i) ka pasur marrëdhënie shoqërore me shtetasin L. K.; (ii) si dhe njohje me shtetasin K. M. Ky përfundim i Komisionit është përfshirë në vlerësimin e konfliktit të interesit, të trajtuar në pikën 95 të vendimit të Komisionit.

44.3/a. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtimin e qëndrimit të Komisionit, pretendon se në analizimin e veprimtarisë së tij gjyqësore, Komisioni ka tejkalluar kufijtë e denoncimit të paraqitur nga shtetasja A. M. Konkretisht, kjo shtetase nuk ka paraqitur asnjë denoncim lidhur me pretendimin se ai ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit për shkak të marrëdhënieve të supozuara (por të pavërteta), miqësore me shtetasin L. K.¹¹³, si dhe as për ndonjë marrëdhënie *“njohjeje”* me shtetasin K. M. Kjo ka sjellë, sipas subjektit, një cilësim të gabuar të situatës faktike ose, ç’është më e rëndësishme, mungesën e një cilësimi ligjor të kësaj situatë faktike, në referim të neneve 3 (paragrafët 1 dhe 4) të ligjit nr. 9367 (i ndryshuar), që përcakton kuptimin e gjendjeve të konfliktit të interesit.

44.3/b. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në vitin 2016, kur ka gjykuar çështjen, nuk ka pasur asnjë interes privat nga ato të parashikuara në nenin 5 të ligjit nr. 9367, që të ketë ndikuar ose të duket se ka ndikuar në ushtrimin e detyrës së tij në vitin 2016. Subjekti pretendon se kur ka deklaruar në formularin e figurës kontaktin me shtetasin K. M., nuk ka pasur miqësi me të, kontaktet kanë qenë rastësore, madje aq të tilla, sa as nuk i mban mend. Sipas subjektit, këto kontakte kanë qenë në kohën kur ai as ka pasur dhe as mund të kishte pasur dijeni për qenien e këtij shtetasi të dënuar. Ky shtetas, në kohën që ai ka pasur kontaktet rastësore në fjalë, ka qenë Kryetar i Komunës Rrethina, ku ka punuar vëllai i tij, G. Y. Subjekti, në sqarimet e tij thekson se në momentin që ai dhe vëllai i tij ka marrë dijeni mbi faktin që ky shtetas ka qenë i dënuar, menjëherë kanë ndërprerë çdo kontakt me të, madje vëllai, me këshillën e subjektit, ka lënë menjëherë edhe punën në Komunën Rrethina, duke u distancuar qartë nga ky person.

¹¹² Denoncim nr. {***} prot., datë 07.01.2019.

¹¹³ Për të kundërshtuar qëndrimin e Komisionit, se ai ka qenë në konflikt interesi gjatë gjykimit të çështjes, për shkak të marrëdhënieve miqësore me avokatin L. K., i cili ka qenë përfaqësues i paditësit D. M., subjekti ka dhënë shpjegime të hollësishme në pjesën që do të analizohet më poshtë në këtë vendim, mbi marrëdhëniet mes subjektit dhe shtetasit L. K.

44.3/c. Subjekti pretendon se për herë të parë dhe të fundit, me cilësimin ligjor se bëhet fjalë për një “konflikt të mundshëm interesi”, të parashikuar nga pika “c” e paragrafit 4, të nenit 3, të ligjit nr. 9367 (i ndryshuar), është njohur vetëm përmes vendimit të Komisionit, konkretisht përmes fjalisë së dytë, të paragrafit 87.11, të vendimit të Komisionit. Sipas subjektit, kjo përbën një shkelje procedurale, pasi Komisioni, në funksion të garantimit të së drejtës për një mbrojtje efektive, kishte për detyrë që faktet, provat dhe cilësimin ligjor të tyre t’i shprehte qartë dhe drejtpërdrejt në raport, dhe jo në mënyrë të nënkuptuar. Për këtë arsye i kërkon Kolegjit të konstatojë dhe të riparojë këtë shkelje procedurale të Komisionit.

44.3/ç. Trupi gjykues konstaton se, lidhur me këtë denoncim, Komisioni ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër kopje të fashikullit gjyqësor që i përket çështjes me palë paditëse shtetasin D. M. (përfaqësuar në gjykim nga av. L. K.), palë të paditur K. M. etj., me objekt “*pjesëtimin e sendit të përbashkët*”. Nga shqyrtimi tërësor i fashikullit gjyqësor nuk rezulton që denoncuesja të ketë paraqitur pretendim për falsifikim dokumentacioni dhe as kërkesë për pezullim gjykimi për shkak të një procesi penal.

44.3/d. Lidhur me pretendimin e subjektit, se Komisioni ka tejkaluar tagrat në hetimin e këtij denoncimi, trupi gjykues konstaton se nga dosja e administruar për këtë denoncim, Komisioni ka gjetur dhe analizuar prova e fakte, për të cilat i ka rezultuar se veprimet e subjektit ishin kryer në kushtet e konfliktit të interesit, në këtë kontekst Komisioni i ka kaluar dhe barrën e provës subjektit. Ky veprim i Komisionit është në përputhje me nenin 53, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon madje se edhe heqja dorë e personit nga raportimi nuk sjell pushimin e hetimit, nëse Komisioni ose Kolegji i Apelit çmon se veprimi ose praktika e dyshuar përmbajnë shkaqe të mjaftueshme për fillimin e hetimit kryesisht. Gjithashtu, i pabazuar është edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se është njohur vetëm në vendim me cilësimin ligjor për një “konflikt të mundshëm interesi”, pasi nga kontrolli i rezultateve të hetimit të administrativ, të cilat i janë përcjellë subjektit, duke i kaluar në këtë mënyrë barrën e provës, rezulton se në f. 72 të këtij raporti, subjektit i është bërë me dije ky fakt, megjithëse nuk i është specifikuar baza ligjore përkatëse, për rrjedhojë, nuk konstatohen shkelje procedurale të kryera nga Komisioni. Në lidhje me shtetasin K. M. rezulton se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove subjektit për shkak të kontakteve të papërshtatshme, pasi nga ana e tij në deklaratën e kontrollit të figurës është deklaruar një gjë e tillë. Barra e provës i ka kaluar për shkak të mundësisë së një konflikti interesi, duke qenë se ai vetë e ka deklaruar këtë shtetas si njohje të tij.

44.3/dh. Trupi gjykues, pasi konstatoi se në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 01.02.2016, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, është shprehur: “...nuk u paraqit av. L. K., përfaqësuesi i paditësit. Av. K. ka dërguar një sms... sipas sms-së, përfaqësuesi i paditësit është i shtruar në spital në qytetin e Athinës. Komunikimi është zhvilluar dje, në ora 12.13 min.”, çmon se shtyrja e seancës gjyqësore nga subjekti i rivlerësimit, vetëm nëpërmjet dërgimit të një sms-je nga shtetasi L. K., mund të ketë favorizuar palën paditëse, për sa kohë kjo mënyrë komunikimi nuk është një nga format e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile (pasi çdo kërkesë duhet të paraqitet në sekretarinë gjyqësore me shkrim, shoqëruar me dokumentacion provues). Në këtë mënyrë ka mbetur e paverifikuar arsyeja ligjore e mosparaqitjes së palës në seancë gjyqësore, duke u evidentuar dhe konfirmuar sërish marrëdhënia shoqërore dhe e besimit mes subjektit të rivlerësimit dhe z. Karini.

44.3/e. Nga sa më lart, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka gjykuar një çështje, ku përfaqësues i njëjës prej palëve ka qenë një person me të cilin subjekti ka pasur marrëdhënie shoqërore, si dhe njëra nga palët e paditura është deklaruar nga ana e tij në deklaratën e kontrollit të figurës, provon minimalisht njohjen dhe marrëdhënien me këtë palë. Referuar nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile,

ku parashikohen rastet e përjashtimit të gjyqtarit, trupi gjykues çmon se, për të shmangur çdo lloj dyshimi për anshmëri të tij në proces, subjekti i rivlerësimit duhej të vlerësonte me objektivitet rrethanat e njohjes me këta shtetas dhe të mos merrte pjesë në gjykime me palë të njohurit e tij.

44.3/ë. Lidhur me kërkesën e subjektit në parashtrime për marrjen në cilësinë e provës të shkresave të Këshillit të Lartë Gjyqësor,¹¹⁴ të cilat përmbajnë dy praktika të inspektimit të ankesave të paraqitura nga shtetasja A. M., trupi gjykues konstaton se ankesat e denoncueses janë të ndryshme nga ato të paraqitura në denoncimin në Komision, pasi përmbajnë fakte dhe argumente të ndryshme. Për më tepër që Komisioni nuk i ka kaluar subjektit barrë prove për shkeljet e pretenduara në atë denoncim. Si të tilla, në drejtim të vlerës së tyre provuese, këto akte nuk ndihmojnë në zgjidhjen e çështjes, pasi nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

44.4. Në denoncimin tjetër nga publiku, z. S. K.¹¹⁵ pretendon se subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar gjykimin bazuar në dokumentacion të falsifikuar, ka refuzuar pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative dhe më pas pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen e çështjes penale. Denoncuesi pretendon se avokati me të cilin ai konsultohet për problematikën e pronës, është shprehur se: *“Ky gjyqtar, që ta mbyllë çështjen në një seancë të vetme, kërkon 3 mijë euro”*.

44.4/a. Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të paraqitura në këtë denoncim, trupi gjykues konstaton se Komisioni ka administruar, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, kopje të vendimit datë 08.07.2015, dhënë për këtë çështje nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka vendosur: *“pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë”*. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur S. K. dhe Gjykata e Apelit Shkodër ka vendosur *“prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe pushimin e gjykimit të çështjes”*. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs nga pala paditëse dhe dosja ndodhet për gjykim pranë Gjykatës së Lartë.

44.4/b. Lidhur me pretendimin e subjektit për administrimin si provë të vendimit të Gjykatës së Lartë¹¹⁶, pasi sipas tij jo vetëm kjo gjykatë nuk ka shprehur asnjë kritikë mbi mënyrën se si ai e ka zhvilluar gjykimin në shkallën e parë, por edhe Gjykata e Apelit dhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë (ILD), me vendimet e tyre, mbështesin qëndrimin e tij dhe jo atë të Komisionit, trupi gjykues vlerëson se ky akt, në kuptim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, duket i panevojshëm, pasi fakti që kërkohet të provohet, përmban të dhëna të parëndësishme për vendimmarrjen e Kolegjit dhe që lidhen me thelbin e vendimmarrjes së subjektit, e cila nuk mund të merret në shqyrtim.

44.4/c. Trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove për shkakun se subjekti ka vijuar gjykimin pa u zgjidhur më parë çështja penale, duke mos respektuar parashikimet ligjore të nenit 297/a të K. Pr. Civile, duke cenuar të drejtat e palëve për një proces të rregullt. Në kushtet kur Komisioni në vendim nuk e ka lidhur këtë konstatim me ndonjë referencë ligjore, për ta ngarkuar më pas me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, trupi gjykues në këto rrethana çmon të mos e analizojë më tej këtë vendimmarrje të tij.

¹¹⁴ Subjekti ka përcjellë me parashtrimet shkresën Kthim përgjigje nr. {***}, datë 17.07.2024, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, bashkëlidhur praktikën që i përket Ankesës me nr. {***} prot., datë 07.09.2015, paraqitur në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe në Ministrinë e Drejtësisë, nga A. M.

¹¹⁵ Denoncim nr. {***} prot., datë 07.06.2018.

¹¹⁶ Dokumenti në fjalë është vendimi nr. {***}, datë 20.09.2023, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, për çështjen me palë paditëse Gj. (Gj.) D. dhe të paditur S. K., vendim i cili mund të aksesohet nga burimet e hapura në internet, konkretisht nga faqja elektronike e Gjykatës së Lartë.

44.5. Lidhur me denoncimin e znj. D. K.,¹¹⁷ Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka zvarritur nxjerrjen e vendimit të ndërmjetëm, e për pasojë, cenuar të drejtën e palës në lidhje me një proces brenda afateve të arsyeshme, duke treguar mangësi në kriterin e parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3, si dhe neni 74, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016.

44.5/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, për sa i përket pengimit të supozuar të së drejtës së palës për të ushtruar ankim efektiv, përmes mosdorëzimit të dosjes që t'i jepte rrugë ankimit të veçantë, ky shkak i ekspozuar, për përjashtimin e tij nga gjykimi, mbështetet në të dhëna pjesërisht të rreme dhe/ose të paprovuara, si dhe të paligjshme. Sipas subjektit, ai nuk ka qenë në dijeni ndonjëherë mbi faktin që pala ka paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit të ndërmjetëm gjyqësor për moslegjitimitimin e personit të tretë, gjithashtu fakti i paraqitjes së ankimit të veçantë nuk pezullon vazhdimin e gjykimit. Subjekti pretendon se nuk është bërë pengesë për dërgimin e dosjes gjyqësore në Gjykatën e Apelit, pasi nuk ka pasur dijeni që është paraqitur ankim i veçantë. Subjekti pretendon se, sapo është njohur me kërkesën për përjashtimin e tij nga gjykimi, të bazuar, ndër të tjera, edhe mbi këtë shkak (dhe, për rrjedhojë, edhe për faktin se është paraqitur ankim i veçantë), menjëherë ka udhëzuar dhe urdhëruar sekretaren gjyqësore që të fotokopjojë dosjen gjyqësore, për të vijuar procedurat e përcjelljes së saj në Gjykatën e Apelit.

44.5/b. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të pretendimit të subjektit duke i vlerësuar ato në raport me konkluzionet e Komisionit, lidhur me gjykimin e çështjes gjyqësore me: palë paditëse – E. K. e D. K.; të paditur: A. K. dhe E. R.; palë e tretë: {***} dhe {***} Shkodër; me objekt: *“konstatim i pavërtetësisë së pjesshme të dokumentit – Libër i pronësisë qyteti Shkodër në lidhje me regjistrimin në emër të H. K. dhe saktësimin e dokumentit”*, mori në shqyrtim aktet e kësaj çështjeje, nga ku rezulton se: gjykata, në seancën e datës 06.03.2020, ka vendosur të mos i legjitimojë si persona të tretë {***}-në, Drejtorinë Rajonale Shkodër dhe {***}-në Shkodër, me argumentin se emërtimet e tyre nuk janë të sakta dhe nuk është bërë me dije gjykata përmes padisë apo shpjegimeve të dhëna mbi arsyet e pjesëmarrjes së tyre në gjykim. Gjykata ka sqaruar se pjesëmarrja në cilësinë e personit të tretë nuk mund të justifikohet me kërkesën për të konstatuar të pavërtetë një dokument të arkivuar në këtë institucion. Sipas gjykatës, një proces për pavërtetësinë e një dokumenti nuk zhvillohet me institucionin përkatës në cilësinë e personit të tretë, por në një pozitë tjetër procedurale, e cila nuk është detyrë e gjykatës për ta përcaktuar. Më datë 08.03.2020, pala paditëse ka paraqitur ankim kundër këtij vendimi të ndërmjetëm në Gjykatën e Apelit Gjyqësor Shkodër, por për më shumë se tre muaj nga ana e gjyqtarit të çështjes nuk i janë përcjellë sekretarisë gjyqësore aktet, me qëllim dërgimin e tyre më pas në këtë gjykatë.

44.5/c. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer në kohë të gjitha procedurat e nevojshme për sa i përket zbardhjes dhe vënies në dispozicion të vendimit të ndërmjetëm për refuzimin për marrje pjesë të personit të tretë, vendim ndaj të cilit mund të bëhet ankim i veçantë, bazuar në nenin 194 të Kodit të Procedurës Civile. Bazuar në nenin 316 të Kodit të Procedurës Civile,¹¹⁸ subjekti kishte detyrimin ligjor që të njoftonte palët për këtë vendim të ndërmjetëm, e drejta e ankimit të së cilit është 3 ditë nga marrja dijeni dhe, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda tri ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se ishte në padijeni të depozitimit të kërkesës për ankim të veçantë,

¹¹⁷ Denoncimi nr. {***} prot., datë 03.08.2020.

¹¹⁸ Vendimet përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit, u njoftohen palëve ose pjesëmarrësve të tjerë në proces brenda tri ditëve nga marrja e vendimit ose, në rast se vendimi i arsyetuar shpallet më vonë, brenda 3 ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar. Njoftimi bëhet sipas rregullave të parashikuara në Kreun IV, të titullit VI, të pjesës I.

në kushtet kur pala paditëse kishte më shumë se tre muaj që përpiquej për përcjelljen e akteve dhe afati për komunikimin e vendimit të ndërmjetëm është brenda 3 ditëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit, se vonesat e subjektit në zbardhjen e vendimit të ndërmjetëm kanë cenuar të drejtën e palës në lidhje me një proces të rregullt dhe konsiderohen si tregues të mangësisë në kriterin e parashikuar nën 74, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 96/2016.

44.5/ç. Lidhur me pretendimin e subjektit për administrimin si provë¹¹⁹ nga Kolegji të vendimit nr. {***} prot., datë 06.10.2023, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pasi sipas tij ky vendim është në mbështetje të argumenteve të tij, si dhe duke qenë se në kohën e shqyrtimit të procesit të rivlerësimit nga Komisioni, nuk ishte njohur me të, trupi gjykues, duke mos rënë në përsëritje, sqaron se qëllimi dhe objekti i kontrollit i kryer nga organet e rivlerësimit nuk janë të njëjta me objektivin që ndjekin institucione të tjera të sistemit të drejtësisë, për rrjedhojë, e vlerëson të pabazuar këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit.

44.6. Në denoncimin nr. {***} prot., datë 17.08.2021, të paraqitur në Komision, shoqëria “{***}” ShA pretendon se në çështjen gjyqësore me palë paditëse N. M. dhe palë të paditur “{***}” ShA, nga ana e subjektit të rivlerësimit janë kryer shkelje të rënda të standardit të procesit të rregullt ligjor dhe shkelje të rënda të etikës profesionale,¹²⁰ si dhe është evidentuar njëanshmëri¹²¹ e theksuar e subjektit në favor të palës paditëse. Shoqëria “{***}” ShA ka paraqitur disa kërkesa¹²² gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, të cilat janë rrëzuar të gjitha nga ana e subjektit të rivlerësimit.

44.6/a. Trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove si vijon: (i) Subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi sipas pretendimeve të denoncuesit, ai ka pasur njohje me avokatin e palës paditëse (nga verifikimi i deklaratës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit konstatohet se ai ka deklaruar si kontakt të përshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar shtetasin N. R., i cili ka qenë avokat i palës paditëse), është shprehur privatisht për themelin e çështjes, si dhe ka biseduar me njërin prej ekspertëve në zyrën e tij. (ii) Padia mund të jetë hedhur në disa kopje me qëllim shortimi i saj të subjekti të rivlerësimit. (iii) Subjekti nuk ka argumentuar caktimin e masës së dëmshpërblimit, si dhe të dhënies së vendimit me ekzekutim të

¹¹⁹ ILD-ja i ka përcjellë subjektit, për dijeni, shkresën nr. {***} prot., datë 06.10.2023. Përmes kësaj shkrese, ILD-ja ka njoftuar subjektin se është disponuar “arkivimi pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara nr. {***} prot., datë 24.06.2020, nr. {***} prot., datë 03.08.2020 dhe nr. {***} prot., datë 08.09.2020, të paraqitura nga shtetasit E. K. dhe D. K. (K.), ndaj veprimtarisë së magjistratit Andri Ymeri, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, në kohën kur ka ndodhur ngjarja e pretenduar.

¹²⁰ Subjekti ka caktuar seancat përgatitore dhe gjyqësore në një hark të shkurtër kohor, madje në seancën e parë përgatitore ka caktuar 6 ekspertë. Subjekti ka kryer gjykim të njëanshëm, duke orientuar palën paditëse dhe duke e udhëzuar në përgjigjet e saj. Ky fakt mund të verifikohet nga regjistrimi audio i seancës së datës 30.06.2021.

¹²¹ Kërkesat e përfaqësuesve ligjore të palës së paditur janë rrëzuar sistematikisht, edhe pse kanë qenë të mbështetura në ligj në prova (mbështetura në raporte mjekësore e bileta udhëtimi jashtë vendit).

Duke marrë në konsideratë artikujt mediatikë, gjyqtari nuk merr në konsideratë seancën e parë të mbështetura në ligj në prova (mbështetura në raporte mjekësore e bileta udhëtimi jashtë vendit).

Duke marrë në konsideratë artikujt mediatikë, gjyqtari nuk merr në konsideratë seancën e parë të mbështetura në ligj në prova (mbështetura në raporte mjekësore e bileta udhëtimi jashtë vendit).

Sipas informacioneve informale, kërkesëpadia mund të jetë hedhur në disa kopje në gjykatë, për të rritur mundësitë që çështja të kalonte për gjykim gjyqtarit Andri Ymeri. Kërkimi i dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

¹²² Padia është parashikuar pasi ka kaluar afati 1-vjeçar, i parashikuar nga neni 115/e i Kodit Civil, pasi ajo është ngritur në datën 11.04.2021 dhe marrëdhënia e punës është ndërprerë në datën 27.06.2018; afati 180-ditor i parashikuar nga neni 146/2 i Kodit të Punës; afati 30-ditor i zbulimit të motivit abuziv. Subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit, pasi është shprehur për themelin e çështjes në një bisedë private që ka pasur me përfaqësuesin e shoqërisë {***}. Avokati N. R., që ka përfaqësuar palën paditëse, është akuzuar për afëra të bashku me subjektin, i cili nuk ka mohuar njohjen me këtë avokat. Eksperti i Vlerësuar z. T. M. është parë në zyrën e subjektit duke biseduar me të, pas përfundimit të një prej seancave gjyqësore.

përkohshëm. (iv) Subjekti ka caktuar seanca, si dhe ka përfunduar gjykimin në një afat shumë më të shkurtër se afatet normale të shqyrtimit të çështjeve të ngjashme nga ana e tij. (v) Subjekti ka gjykuar një padi, e cila është parashkuar. Duke qenë se pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk depozitoi dokumentacionin e kërkuar në lidhje me këtë çështje gjyqësore, Komisioni vlerësoi ta bazojë qëndrimin e tij në një pjesë të konkluzioneve të vendimeve të ILD-së dhe KLGJ-së. Refuzimin nga ana e subjektit për të depozituar dokumentacionin e kërkuar, Komisioni e konsideroi si mungesë bashkëpunimi, në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, pasi sipas tij duket se është bërë me qëllim arritjen e një rezultati në favor të subjektit. Në përfundim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe të arsyetimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

44.6/b. Sa i përket vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit për ekzekutimin e përkohshëm, ai pretendon se ka qenë në përputhje me nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile, duke theksuar se kjo normë nuk është shteruese, por orientuese. Për më tepër, pretendimi i Komisionit, se nuk janë paraqitur prova për të mbështetur këtë vendim, është i pabazuar, pasi vendimi përmban si prova aktet e ekspertimit psikologjik dhe mjekoligjor. Subjekti pretendon se vendimi i Komisionit nuk merr parasysh qëndrimin e ILD-së, e cila ka trajtuar çështjen e respektimit të pavarësisë së magjistratit jo vetëm në këtë rast, por edhe në raste të tjera të inspektimit të dhënies së vendimeve me ekzekutim të përkohshëm, gjithashtu, sipas subjektit, duhet marrë në konsideratë qëndrimi i KLGJ-së, e cila nuk ka parë arsye për fillimin e një procedimi disiplinor, duke hedhur poshtë ankesën ndaj subjektit. Subjekti pretendon se, edhe sikur pjesa e vendimit të tij për ekzekutimin e përkohshëm të konsiderohej e gabuar, ajo është një vendimmarrje e ndërmjetme dhe nuk ndikon në përfundimin e gjyqimit në themel, për rrjedhojë, duhet respektuar parimi i proporcionalitetit. Komisioni, duke marrë përsipër të rivlerësojë thelbin e vendimit të tij për ekzekutimin e përkohshëm dhe masën e dëmshpërblimit, ka cenuar parimin e ligjshmërisë, pasi një organ vlerësues nuk mund të zëvendësojë arsyetimin e një gjyqtari me logjikën e tij mbi zgjidhjen e një çështjeje.

44.6/c. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se kërkesa e Komisionit, gjatë kalimit të barrës së provës, për depozitim të të gjithë fashikullit gjyqësor të kësaj çështjeje, është jopropocionale, trupi gjykues sjell në vëmendje se, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, është subjekti i rivlerësimit i cili ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Pavarësisht këtij argumenti, në kushtet kur Komisioni ka pasur korrespondencë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, ka administruar disa fashikuj gjyqësorë prej saj, në funksion të mos ngarkimit me shpenzime ekonomike të konsiderueshme për subjektin, Komisioni, edhe në këtë rast, mund ta administronte këtë fashikull gjyqësor nëpërmjet korrespondencës institucionale, për rrjedhojë, nga vlerësimi i kësaj situate, trupi gjykues nuk mund ta konsiderojë vetëm këtë fakt të veçuar, si mungesë bashkëpunimi në kuptim të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, nga ana e subjektit të rivlerësimit.

44.6/ç. Në lidhje me pretendimin e subjektit, se KLGJ-ja dhe ILD-ja janë shprehur në lidhje me këtë ankesë, trupi gjykues, ashtu si edhe më lart, vlerëson se kompetencat e ILD-së dhe KLGJ-së nuk lidhen me kompetencat që i përkasin organeve të rivlerësimit. Për më tepër, juridiksioni i Komisionit dhe i Kolegjit lidhet vetëm me procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve, i cili është i pavarur nga çdo vendimmarrje e organeve të tjera. Për të shmangur përsëritjen, përpos sa më lart në këtë vendim, trupi gjykues sjell në vëmendje detyrimet e institucioneve të rivlerësimit, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të kryer hetim të pavarur. Kjo dispozitë është në përputhje edhe me qëndrimin e Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, sipas të cilit rrjedh që Komisioni ka tagrin që, pavarësisht

rezultateve të hetimit të kryer nga autoritetet e pavarura, të kryejë verifikime dhe hetime të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, për të vërtetuar çdo indicie apo të dhënë që rezulton nga dokumentacioni i mbledhur gjatë procesit, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

44.6/d. Trupi gjykues, me qëllim shqyrtimin dhe ezaurimin e plotë të pretendimeve të subjektit lidhur me këtë shkak ankimi, që i përket dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm për palën paditëse N. M., në një analizë të dispozitave ligjore, që rregullojnë këtë marrëdhënie, vëren se për sa i përket aplikimit të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, ai është shterues, si dhe ka përcaktuar kritere të qarta për zbatimin e tij. Konkretisht, ky nen përcakton se vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur: a) detyrimi për ushqim; b) për shpërblim nga puna; c) për rivendosje në posedimin e banesës bashkëshortore. Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast, gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci.

44.6/dh. Konkretisht në vendimin nr. {***}, datë 08.06.2022, për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm për palën paditëse N. M., subjekti është referuar në nenin 317/1/b të Kodit të Procedurës Civile. Ky referim i subjektit nuk përputhet me parashikimin e kësaj dispozite, pasi paditësi në kërkesëpadi ka kërkuar shpërblim dëmi, madje subjekti, në paragrafin 195/b të këtij vendimi, shprehet se: *“Të gjitha rastet e tjera që nuk përfshihen në kategorinë e parë, vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm kur paditësi vërteton me prova se ekzekutimi i vendimit i dhënë nga Gjykata e Shkallës së Parë mund të bëhet i pamundur... Gjykata mund të ushtrojë diskrecionalitet për të vendosur nëse duhet dhënë apo jo vendimi me ekzekutim të përkohshëm vetëm kur paditësi paraqet prova...”*.

44.6/e. Gjithashtu, trupi gjykues e vlerëson të pambështetur interpretimin prej subjektit të kësaj dispozite, ku sipas tij shpërblimi i dëmit bie njëkohësisht në fushën e zbatimit të pikës “b”, të paragrafit 1, të nenit 317, të K. P. C.-së, si dhe në fushën e zbatimit të pikës “a” të të njëjtit nen, që trajton detyrimin për ushqim, edhe në atë të shpërblimit nga puna. Trupi gjykues vlerëson se interpretimi i kësaj dispozite është në kapërcim të kufijve ligjorë të parashikuar, nuk është i saktë dhe duket sikur kryhet me qëllim për të favorizuar palën paditëse, pasi dhënia me ekzekutim të përkohshëm të shpërblimit të dëmeve nuk parashikohet në rastet e përcaktuara në nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile. Sa i përket pretendimit të subjektit, se pala paditëse ka paraqitur prova për të vërtetuar se ekzekutimi i vendimit mund të bëhet i pamundur, trupi gjykues konstaton se në përmbajtjen e vendimit janë parashtruar si prova vetëm akti i ekspertimit psikologjik dhe akti i ekspertimit mjekoligjor, që kanë konstatuar dëmtime të paditësit, prova të cilat lidhen me masën e shpërblimit të dëmit, por jo me faktin se ekzekutimi i vendimit të dhënë nga gjykata mund të bëhet i pamundur. Në përfundim, trupi gjykues, duke konstatuar edhe vlerën e lartë të objektit të padisë në shumën 49.000.000 lekë, i konsideron të pajustificuara tërësinë e veprimeve të subjektit lidhur me këtë çështje dhe qëndrimet e tij sa i përket rrëzimit të kërkesave të paraqitura nga pala e paditur “{***}” ShA, ndër të tjera, për parashkrimin e padisë, për refuzimit të kërkesës për shtyrje të seancës gjyqësore, edhe pse kjo e dokumentuar me raport mjekësor apo bileta udhëtimi jashtë shtetit, për zhvillimin në mungesë të seancës përgatitore të datës 12 korrik 2021, si dhe zhvillimit të seancave gjyqësore në një hark tejet të shkurtër kohor në raport me çështjet e tjera, veprime të cilat kanë sjellë si pasojë cenimin e mundësisë për t’u mbrojtur të palës së paditur, në kuptim të procesit të rregullt ligjor, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar në ligj.

44.6/ë. Nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

44.7. Në denoncimin nr. {***} prot., datë 22.05.2020, të shoqërisë "{***}" ShA, paraqiten fakte për veprime të kryera nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me etikën profesionale e gjyqësore, me qëllim dëmtimin e interesave të ligjshëm të kësaj shoqërie. Konkretisht denoncuesi në çështjen me palë paditëse V. H., në mënyrë të përmbledhur,¹²³ pretendon se subjekti nuk ka pranuar asnjë nga kërkesat e shoqërisë "{***}" ShA, si palë e paditur në procesin civil, por ka pranuar tërësisht kërkesat e palës paditëse, gjë që ka sjellë humbjen e besimit për një gjykim të drejtë e të paanshëm. Ndërsa në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse G. A., denoncuesi, në mënyrë të përmbledhur,¹²⁴ pretendon se ai ka kërkuar pezullimin e gjykimit, duke qenë se mungonte vendimi penal i formës së prerë, që shërben si provë për procesin civil, por kjo kërkesë është rrëzuar nga subjekti.

44.7/a. Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe në aspektin e njohurive organizative, parashikuar nga neni 74, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016, pasi ka cenuar të drejtat e palëve, duke mos zbatuar parimin e kontradiktoritetit. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se, për sa kohë subjekti ka përdorur akte të fashikullit penal në procesin e tij civil, ai nuk mund të vijonte gjykimin e kësaj çështjeje derisa të përfundonte procedimi penal. Sipas Komisionit, këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore, në kuptim të nenit 72, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

44.7/b. Në argumentet e tij për kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit, për sa i përket vendimit të dhënë prej tij, me ekzekutim të përkohshëm, subjekti i rivlerësimit pretendon se qëllimi i ligjvënësimit në përcaktimin e këtyre rasteve është mbrojtja e të drejtave themelore si e drejta e jetës, e drejta e shëndetit dhe e drejta e personalitetit.¹²⁵ Subjekti ka argumentuar se në një arsyetim paralel, të bazuar

¹²³ Në seancën përgatitore të datës 22.11.2020, denoncuesi ka kërkuar nga gjykata kthimin e padisë me të meta, për arsye se pala paditëse nuk ka plotësuar dokumentacionin ligjor mbi të cilin bazon të drejtën për dëmshpërblim, si dhe pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje sipas parashikimeve të nenit 297/a të K. Pr. Civile.

Në seancën e datës 11.12.2019, gjykata ka caktuar ekspert mjekoligjor G. M. Denoncuesit kanë kërkuar përjashtimin e tij, për shkak se ky ekspert ka qenë në marrëdhënie kontraktuale pune me shoqërinë "{***}" ShA dhe ka bashkëpunuar me avokatin e palës paditëse në një tjetër gjykim. Gjykata, pa analizuar provat mbi të cilat mbështetej ankesa e shoqërisë, ka rrëzuar kërkesën. Në seancën e datës 07.02.2020, gjyqtari ka pranuar prova, të cilat nuk janë dorëzuar konform parashikimeve të neneve 158, pika 6 dhe 186 të K. Pr. Civile, pasi janë paraqitur gjatë gjykimit. Gjykata ka pranuar prova të marra në mënyrë të njëanshme nga eksperti. Pavarësisht kërkesës së shoqërisë "{***}" ShA për përjashtimin e subjektit, ai ka vazhduar gjykimin, duke orientuar avokatin e paditësit për saktësimin e objektit të padisë. Në kohën kur do të mbyllej hetimi gjyqësor, gjyqtari pranoi kërkesën e palës paditëse për pyetje shtesë drejtuar ekspertit. Në përgjigjen e tij elektronike, eksperti njoftoi gjykatën se nuk mund të kryejë detyrën shtesë të caktuar nga gjykata, duke dhënë argumentet ligjore përkatëse. Gjykata ka urdhëruar të kryhet detyra e caktuar, pasi në rast të kundërt do të paraqitet kallëzim penal. Eksperti është detyruar të përgjigjet dhe vlera e rezultuar në aktin shtesë përputhet me saktësimin e objektit të padisë që kishte bërë avokati i paditësit, disa seanca më parë.

¹²⁴ Subjekti ka caktuar si ekspert në gjykim, dy vlerësues, me të cilët shoqëria "{***}" ShA ka pasur konflikte të mëparshme. Njëri prej tyre ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie dhe ai është përjashtuar nga çdo proces gjyqësor. Subjekti ka rrëzuar kërkesën e të paditurit për përjashtimin e ekspertëve, pa analizuar provat mbi të cilat mbështetej kjo kërkesë. Duke marrë shkas shkëljet e mësipërme procedurale, është kërkuar ndërprerja e seancës, me qëllim paraqitjen e kërkesës për përjashtim të gjyqtarit, por ai ka vazhduar gjykimin, duke caktuar detyrat e ekspertëve. Po në këtë seancë gjyqësore, ai urdhëroi sekretaren që të merrte dorazi dosjen penale të lidhur me çështjen në gjykim, e cila ndodhej në fashikullin gjyqësor pranë një tjetër gjyqtari. Me këtë veprim, gjyqtari ka vepruar në kundërshtim me nenin 12 të K. Pr. Civile, pasi është detyrim i palëve dhe jo i gjykatës për të bazuar pretendimet e saj me anë të provave. Ky interesim personal nga gjyqtari shfaq haptazi një qëndrim favorizues të avokatit të palës paditëse.

¹²⁵ Në çështjen gjyqësore të paditësit G. A. kundër "{***}" ShA, aksidenti automobilistik, nga i cili pretendohet se është dëmtuar shëndeti i tij, ka ndodhur rreth dy vjet para dhënies së vendimit përfundimtar civil. Pas aksidentit, paditësi ka deklaruar se ka qenë në pamundësi të plotë për të lëvizur dhe për t'u kujdesur për veten. Në këtë rast, sipas subjektit vihet re qartë se e drejta për mbrojtjen e shëndetit, e drejta për t'u ushqyer, e drejta për punë, si dhe një sërë të drejtash dhe

në interpretimin teleologjik të nenit 317 të K. P. C.-së, paragrafi i parë i këtij neni nuk ka karakter shterues, por indikativ, duke e lejuar zbatimin e tij në raste të ngjashme sipas parimit të drejtësisë. Sipas subjektit, përmbajtja e nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, duke iu referuar *ratios* së normës, nuk mund të konsiderohet si dispozitë taksative (pra, me raste të mbyllura), por si dispozitë indikative, orientuese (pra, e hapur dhe rastet që tregohen në të kanë natyrë ilustrative). Në këtë kontekst është interpretuar se shpërblimi i dëmit që buron nga vdekja apo dëmtimi i shëndetit bie njëkohësisht në fushën e zbatimit të pikës “b”, të paragrafit 1, të nenit 317, të K. P. C.-së, si dhe në fushën e zbatimit të pikës “a” të të njëjtit nen, që trajton detyrimin për ushqim.

44.7/c. Në lidhje me pezullimin e gjykimit, subjekti pretendon se Komisioni nuk mund të japë vlerësime lidhur me çështjen se a kanë qenë apo jo të mjaftueshme faktet juridike, mbi të cilat gjyqtari ka dhënë vendimin gjyqësor përfundimtar. Këto çështje, sipas subjektit kanë të bëjnë me mënyrën se si e ka planifikuar, organizuar dhe zbatuar gjykata hetimin gjyqësor të çështjes dhe, për rrjedhojë, kanë të bëjnë me procesin e formimit të bindjes së brendshme të gjyqtarit, të krijuar nga interpretimi i fakteve dhe interpretimi i ligjit që ai vlerëson, në mënyrë të pavarur dhe të pandikuar nga askush dhe për asnjë arsye, dhe që kanë rëndësi për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Sipas subjektit, me interpretim gjuhësor vihet re qartësisht se në shkronjën “a” të nenit 297 të Kodit të Procedurës Civile, përdoret folja “mund”. Kjo folje nënkupton diskrecionalitet të gjykatës, hapësirë vlerësimi nga ana e saj të karakterit të çështjes, në mënyrë që të vendosë nëse duhet apo jo të bëhet pezullimi i gjykimit. Duke pasur këtë natyrë diskreciale, hapësira e vlerësimit të gjykatës, nëse çështja duhet apo jo të pezullohet derisa të zgjidhet çështja penale, është çështje e bindjes së brendshme të gjyqtarit, të cilën ai e krijon nga vlerësimi i rrethanave të çështjes. Lidhur me provat e marra nga gjykata, kryesisht, por mbi bazën e kërkesës së palëve, sikurse ka ndodhur në rastin objekt analize, subjekti ka pretenduar se gjykata ka detyrim pasiv dhe jo aktiv për t’u mundësuar palëve njohjen me provat e marra kryesisht. Në rastin konkret, sipas subjektit, gjykata nuk ka penguar asnjërin palë në këtë drejtim, madje, pala e paditur është njohur me këto prova, duke marrë kopje të tyre përmes fotografimit (gjë për të cilën ajo ka dhënë vetë pëlqim).

44.7/ç. Trupi gjykues, pasi verifikoi dokumentacionin e administruar në dosje lidhur me të dhënat që paraqiten në këtë denoncim, konstaton se: **1.** Në rastin e gjykimit të çështjes me palë paditëse G. A.: **(i)** Denoncuesi ka paraqitur kërkesë për pezullimin e gjykimit, pasi çështja civile nuk mund të zgjidhet pa përfunduar gjykimi i çështjes penale. **(ii)** Denoncuesi ka kërkuar përjashtimin e ekspertëve E. J., H. G., pasi ata kanë qenë më parë në marrëdhënie me këtë shoqëri (bashkëlidhur kërkesës gjendet dokumentacioni¹²⁶ i depozituar në seancën gjyqësore). **(iii)** Bazuar në procesverbalin e seancës të datës 25.02.2020, konstatohet se subjekti ka urdhëruar sekretaren për të tërhequr fashikullin origjinal penal, duke e administruar atë si provë. **2.** Në rastin e gjykimit të çështjes me palë paditëse V. H., subjekti në vendim shprehet se ka tërhequr, në cilësinë e provës, kopje të vendimit gjyqësor penal, me kërkesë të përfaqësuesit të ndërgjyqësve paditës dhe për të plotësuar kërkesat e nenit 14 të K. Pr. Civile. Në vendim, subjekti ka pranuar dhe kërkesën për ekzekutim të përkohshëm të vendimit për palën paditëse V. H.

interesash të tjera thelbësore, të cilat janë njëkohësisht edhe të drejta të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, janë cenuar. Ky cenim, sipas subjektit, është përkeqësuar më tej nga heshtja e gjatë e Prokurorisë dhe e Gjykatës Penale në trajtimin e çështjes.

¹²⁶ Vendim nr. {***}, datë 29.02.2009, i Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, ku z. H. G. rezulton kryetar i Komisionit Mjekësor të trajtimit të praktikave të dëmeve shëndetësore. Ky vendim është nënshkruar dhe nga përfaqësuesi i shoqërisë “{***}”. Akt vlerësimi, dëmi shëndetësor, datë 14.01.2010, me logo të shoqërisë “{***}”, firmosur nga z. E. J. Miratim praktike dëmi për pagesë, datë 12.02.2010, firmosur në emër të “{***}” nga z. E. J.

44.7/d. Lidhur me interpretimin që subjekti i bën nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues konstaton se objekti i padisë nuk klasifikohet në një nga rastet e parashikuara nga neni 317/a,¹²⁷ si dhe nuk plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 317/b i këtij Kodi, pasi objekti i padisë është “dëmshpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror”. Pretendimi i subjektit është i pabazuar, pasi neni 317 i Kodit të Pr. Civile është shterues për sa u përket rasteve kur jemi përpara aplikimit të ekzekutimit të përkohshëm, duke specifikuar të tria rastet dhe, më pas, në paragrafin e dytë, ky nen i jep diskrecion gjykatës për të marrë vendim në bazë të kriterëve të përcaktuara. Rastet e përcaktuara në gerrat “a”, “b” dhe “c” janë raste shteruese dhe nuk mund të konsiderohen si orientuese/indikative, sikundër pretendon subjekti, pasi në këtë rast nuk do të kishte kuptim paragrafi i dytë i këtij neni, që përcakton kriteret në vlerësim të gjykatës për të vendosur edhe në raste të tjera dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm.

44.7/dh. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se provat e marra prej tij janë marrë bazuar në kërkesën e palëve, trupi gjykues vlerëson se, në nenin 223 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se gjykata, me kërkesën e palës së interesuar, mund të urdhërojë palën tjetër ose një person të tretë që nuk merr pjesë në çështje, të paraqesë në gjykim një dokument ose një send tjetër, kur çmohet e nevojshme prej saj. Subjekti nuk ka vepruar sipas dispozitave të parashikuara nga ky Kod, përkatësisht nenet 8-12 dhe 19-21, pasi referuar procesverbalit të seancës së datës 25.02.2020, në lidhje me çështjen gjyqësore me palë paditëse G. A., konstatohet se subjekti ka urdhëruar sekretaren për të tërhequr fashikullin origjinal penal tek një gjyqtar tjetër, si dhe e ka administruar si provë, pa u paraqitur kërkesë nga palët, duke marrë dukshëm rol aktiv në këtë gjykim, dhe cenuar parimin e kontradiktoritetit, e për rrjedhojë, ky pretendim i tij është i pabazuar.

44.7/e. Lidhur me arsyet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi refuzimin e kërkesës së palës “{***}” ShA, për pezullimin e çështjes civile, trupi gjykues konstaton se ato nuk qëndrojnë, pasi në aktin e ekspertimit autoteknik, të depozituar nga pala paditëse, rezulton se vetë paditësi G. A. ka shkëlur rregullat e qarkullimit rrugor, konkretisht nenin 115 të Kodit Rrugor. Referuar nenit 8, pika 1/f e rregullores nr. 53/2009, “Për trajtimin e dëmeve që mbulohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit”, parashikohet se shoqëria e sigurimit është përgjegjëse për mbulimin e dëmeve të shkaktuara palëve të treta, vetëm në rast se pala e dëmtuar vërteton fajësinë e personit të siguruar pranë kësaj shoqërie me vendim gjykate ose vendim prokurorie. Për rrjedhojë, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë edhe vlerat e larta për të cilat kërkohej dëmshpërblimi i dëmit pasuror dhe jopasuror, dhe dëmet që mund t’i shkakttoheshin palës së paditur, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të vijonte gjykimin e kësaj çështjeje në procesin civil, për sa kohë nuk kishte përfunduar procedimi penal, i cili do të përcaktonte subjektin përgjegjës për shkaktimin e dëmit, situatë kjo e parashikuar edhe në nenin 297/a të Kodit të Procedurës Civile.

44.7/ë. Nga sa konstatuar më lart, trupi gjykues vlerëson se është i bazuar konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit, me veprimet tij në çështjet gjyqësore, me paditës V. H. dhe G. A., me të paditur “{***}” ShA, ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore, bazuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe në aspektin e njohurive organizative, parashikuar nga neni 74, pikat 1, 2 dhe 3 i këtij ligji.

¹²⁷ Vendimi i gjykatës mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm, kur është vendosur: a) detyrimi për ushqim; b) për shpërblim nga puna; c) për rivendosje në posedimin e banesës bashkëshortore. Vendimi mund të jepet me ekzekutim të përkohshëm edhe kur nga vonesa e ekzekutimit, paditësi mund të pësojë dëme të rëndësishme, që nuk mund të vihen në vend, ose kur ekzekutimi i vendimit do të bëhej i pamundur, ose do të vështirësohej së tepërmi. Në këtë rast, gjykata mund të kërkojë që paditësi të japë një garanci.

44.8. Për sa i përket denoncimit nr. {***} prot., datë 18.12.2019, të Byrosë Shqiptare të Sigurimit, Komisioni në vendim, pasi ka konstatuar se subjekti ka vijuar gjykimin e kësaj çështjeje në kundërshtim me nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile, duke shqyrtuar një çështje, e cila ishte duke u gjykuar në një gjykatë më të lartë, ka arritur në konkluzionin se këto veprime të subjektit tregojnë për mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore dhe arsyetimit ligjor, në kuptim të nenit 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

44.8/a. Në shpjegimet e dhëna prej subjektit, në kundërshtim të konstatimit të mësipërm të Komisionit, evidentohet fakti se çështja e gjykuar nga ai dhe çështja e regjistruar mbi bazë ankimi në Gjykatën e Apelit nuk kanë pasur të njëjtin “objekt” dhe “shkak ligjor”. Në çështjen e gjykuar prej subjektit, objekti i padisë, përmbledhtas, ka qenë: *Kërkimi i paditësve F. N. dhe C. N. për të detyruar palën e paditur, {***}, që t'i japë secilit prej tyre shpërblimin për dëmet pasurore dhe jopasurore, të shkaktuara nga aksidenti automobilistik i datës 02.08.2017, ku është dëmtuar në shëndetin e tij paditësi F. N.* Ndërsa, në çështjen e regjistruar në Gjykatën e Apelit, objekti i mosmarrëveshjes, i përcaktuar nga objekti i ankimit, ka qenë: *Kërkimi i palës ankuese për prishjen dhe kthimin për rigjykim me trup tjetër gjykues të vendimit nr. {***}, datë 18.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin ishte disponuar pushimi i gjykimit.* Gjithashtu, sipas subjektit, edhe shkaku ligjor i mosmarrëveshjes ka qenë i ndryshëm, pasi në padinë e gjykuar prej tij, nga pikëpamja faktike, ka qenë interesi i ligjshëm që ka buruar nga ndodhja e aksidentit dhe dëmtimi i shëndetit të paditësit F. N., ndërsa në çështjen e ndodhur për gjykim në Gjykatën e Apelit, sipas subjektit, shkaku ligjor i mosmarrëveshjes, i përcaktuar nga përmbajtja e ankimit dhe normat ligjore të referuara nga ankuesi, Byroja Shqiptare e Sigurimeve, ka qenë i paqartë. Në ankim nuk është treguar ndonjë e drejtë subjektive materiale apo ndonjë interes material faktik dhe konkret që t'i jetë cenuar palës ankuese nga vendimi nr. {***}, datë 18.10.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

44.8/b. Trupi gjykues, në funksion të analizimit të pretendimeve të subjektit në raport me qëndrimin e Komisionit dhe faktet e pasqyruara në denoncim, pas shqyrtimit të dokumentacionit, konstaton se: paditësi F. N. ka paditur Byronë Shqiptare të Sigurimit, në padinë me objekt “shpërblim dëmi”. Gjatë gjykimit të çështjes pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë kryer të gjitha veprimet përgatitore, si dhe është caktuar eksperti mjekoligjor. Në seancën ku eksperti do të dorëzonte aktin e ekspertimit, përfaqësuesi i palës paditëse paraqiti kërkesën për pushim, pa dhënë ndonjë shkak të ligjshëm dhe pa u paraqitur në seancë. Kjo kërkesë është kundërshtuar nga i padituri/denoncuesi, pasi është dorëzuar deklarata e mbrojtjes nga pala e paditur. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***}, datë 18.10.2019, ka vendosur pushimin e gjykimit. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur pranë Gjykatës së Apelit Tiranë. Më pas, pala paditëse ka ngritur padi pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kjo çështje është gjykuar nga subjekti.

Denoncuesi pretendon se gjyqtari ka shkelur hapur ligjin, pasi në kundërshtim me nenin 58 të K. Pr. Civile ka pranuar të vijojë gjykimin e kësaj çështjeje pavarësisht se është vënë në dijeni nga i padituri se kjo çështje, me të njëjtat palë dhe të njëjtin objekt e bazë ligjore, po gjykohet pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

44.8/c. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit, se objekti dhe shkaku ligjor në padinë e ngritur nga pala paditëse, F. N. dhe C. N., në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, janë të ndryshëm nga padia e ngritur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi nga verifikimi akteve të kësaj çështjeje konstaton se palët në gjykim janë të njëjta, objekti i padisë është dëmshpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror, dhe në të dyja rastet, ky dëmshpërblim kërkohet nga palët për aksidentin automobilistik të datës 02.08.2017, me palë të paditur Byronë Shqiptare të Sigurimit.

44.8/ç. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, megjithëse ka administruar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe ankimin e paraqitur në Gjykatën e Apelit Tiranë, nga pala e paditur, Byroja Shqiptare e Sigurimit, përsëri ai ka insistuar për të vijuar me gjykimin e kësaj çështjeje, duke mos pranuar kërkesën e palës së paditur për pushimin e gjykimit, edhe pse çështja ishte në pritje të gjykimit në Gjykatën e Apelit Tiranë. Trupi gjykues vlerëson se veprimet e kryera prej subjektit të rivlerësimit bien në kundërshtim me nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile¹²⁸ dhe, sjelljen e tij, duke anashkaluar në mënyrë të hapur parashikimet e dispozitave ligjore në këtë rast, madje në kushtet e ekzistencës së një padie, me objekt të një vlere të lartë (4.827.346 lekë, për dëmin pasuror dhe 1.237.500 lekë, për dëmin jopasuror), e konsideron të papranueshme dhe të pajustificueshme për një magjistrat.

Për pasojë, trupi gjykues e çmon të pabazuar edhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit në parashtrime, për administrimin si provë të vendimit nr. {***}, datë 20.11.2023, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 18.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi në kuptim të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, është një provë që duket e panevojshme, pasi fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen, për sa kohë që evidenton një situatë faktike që nuk ekzistonte në kohën e gjykimit të çështjes prej subjektit, e që për pasojë, nuk mund të kishte ndikuar atë vendimmarrje.

44.8/d. Nga sa më lart, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit, se veprimet e subjektit të rivlerësimit, në kundërshtim me nenin 58 të Kodit të Procedurës Civile, tregojnë mangësi profesionale të tij në aspektin e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, në kuptim të nenit 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

44.9. Lidhur me denoncimin nr. {***}, datë 03.10.2022, të {***} ({***}), i cili pretendon se subjekti, në vendimin e tij për dhënien me ekzekutim të përkohshëm, ka vepruar në shkelje të nenit 317 të K. Pr. Civile, duke sjellë pasoja të parikuperueshme për shoqërinë {***} ShA, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk e ka argumentuar vendimin e tij në lidhje me pranimin e kërkesës për ekzekutim të përkohshëm, duke arritur në përfundimin se subjekti ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe arsytimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

44.9/a. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të njëjtat argumente lidhur me mënyrën se si e interpreton ai nenin 317 të Kodit të Procedurës Civile, për dhënien e vendimit me ekzekutim të përkohshëm. Subjekti, në mbështetje të argumenteve të tij, ka paraqitur vendimin nr. {***}, datë 20.09.2022, të ILD-së, e cila ka vendosur arkivimin e ankesës të ankuesit {***} ShA. Nga aktet e fashikullit, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. {***}, datë 19.09.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me palë paditëse Sh. N. dhe të paditur {***}, ka vendosur të dëmshpërblejë palën paditëse për dëmin pasuror dhe jopasuror, në shumën 16.700.000 lekë. Ky vendim është dhënë me ekzekutim të përkohshëm, në një kohë që objekti i padisë ka qenë “shpërblim dëmi”, i cili nuk klasifikohet në llojet e padive të përfshira në nenin 317 të K. Pr. Civile. Trupi gjykues, duke iu qëndruar argumenteve të dhëna më lart mbi mënyrën e interpretimit të nenit 317 të Kodit të Procedurës Civile, vlerëson se me veprimet e tij subjekti i rivlerësimit, edhe në këtë rast, ka treguar mangësi në aspektin e njohurive ligjore dhe të arsytimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

¹²⁸ Kur në të njëjtën gjykatë ose gjykata të ndryshme shqyrtohen, në të njëjtën kohë, mosmarrëveshje midis të njëjtave palë dhe kanë të njëjtin shkak e të njëjtin objekt, vendoset pushimi i gjykimit të mosmarrëveshjeve të paraqitura pas asaj të regjistruar më parë.

45. Në lidhje me konfliktin e interesit

45.1. Nga hetimi i Komisionit, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, janë ngritur dyshime mbi faktin se subjekti i rivlerësimit ka bashkëpunuar me z. L. K. (gjatë kohës që ky ka ushtruar/ushtroi detyrën e avokatit), të cilin e ka patur shok shkolle. Subjekti i rivlerësimit, në pyetësorin standard ka deklaruar se, *në datën 03.01.2012, me sa mban mend, kur është kthyer nga pushimet e Vitit të Ri e ka marrë me veturë një shok shkolle i tij, që quhet L. K., që ndodhej në Mal të Zi dhe është kthyer në Shkodër.* Në lidhje me këto të dhëna Komisionit, pasi ka kryer një hetim për sa i përket marrëdhënies midis subjektit të rivlerësimit dhe z. L. K., i ka rezultuar si më poshtë:

45.1/a. Nga verifikimi i sistemit TIMS është konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe z. L. K. kanë udhëtuar së bashku më shumë se një herë dhe në disa raste prezente ka qenë dhe bashkëshortja e subjektit. Konkretisht: **(i)** Në datën 02.02.2007, subjekti ka dalë së bashku me z. L. K. me automjetin me targa {***} (i cili ka qenë në pronësi të z. K.), nga pika kufitare Murriqan dhe ka hyrë, në po të njëjtën datë, me këtë shtetas. **(ii)** Në datën 30.03.2008, subjekti ka dalë së bashku me z. L. K. me automjetin me targa {***}, nga pika kufitare Murriqan dhe ka hyrë, në po të njëjtën datë, me këtë shtetas. **(iii)** Në datën 29.11.2009, subjekti ka dalë së bashku me z. L. K. me automjetin me targa {***}, tip furgon, nga pika kufitare Hani i Hotit dhe ka hyrë në datën 01.12.2009, po me këtë shtetas. **(iv)** Në datën 27.11.2010, subjekti ka dalë së bashku me z. L. K. me automjetin me targa {***} (i cili ka qenë në pronësi të z. K.), nga pika kufitare Morinë. **(v)** Në datën 26.11.2011, subjekti ka dalë së bashku me z. L. K. me automjetin me targa {***}, nga pika kufitare Murriqan. Në këtë udhëtim, subjekti ka qenë i shoqëruar dhe nga bashkëshortja e tij. **(vi)** Në datën 10.11.2013, subjekti ka hyrë së bashku me z. L. K., me automjetin me targa {***}, nga pika kufitare Hani i Hotit.

Sikurse konstatohet me lart, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar disa herë me z. K. në vite të ndryshme, ku në dy udhëtime prezente ka qenë dhe bashkëshortja e tij. Referuar këtyre udhëtimeve, si dhe deklarimit të subjektit, se z. K. e ka patur në shokollë, është vlerësuar se ekziston një marrëdhënie shoqërore dhe familjare e subjektit me z. L. K., e shtrirë në kohë.

45.1/b. Bazuar në të dhënat e mësipërme, Komisioni i ka kërkuar informacion Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me çështjet e gjykuara nga subjekti, ku përfaqësues i palëve apo palë ka qenë z. L. K., i cili ushtroi profesionin e avokatit. Në aneksin nr. 2 të rezultateve të hetimit administrativ gjendet lista e çështjeve¹²⁹ për periudhën nga viti 2006 deri aktualisht, të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri, ku si përfaqësues i palëve në gjykim rezulton z. L. K. Subjekti në total ka gjykuar 122 çështje gjyqësore me z. L. K. si përfaqësues i palëve në gjykim.

45.1/c. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka dështuar që me veprimet e tij të shmangë dyshimin për paanësinë e tij, duke mos paraqitur dorëheqjen nga çështjet e gjykuara prej tij, bazuar në nenin 17, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale dhe nenin 72/6 të Kodit të Procedurës Civile, që parashikon heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, duke afektuar kështu indikatorin e parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sa i përket kujdesit ndaj konfliktit të interesit. Në kushtet kur janë evidentuar 122 raste të konfliktit të interesit bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit,¹³⁰ me konsideratë rrethanat e çështjes, Komisioni ka vlerësuar se ky konflikt interesi do të ishte i mjaftueshëm për të afektuar kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.

¹²⁹ Shih shkresë “Kthim përgjigje” nr. {***} prot., datë 02.08.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

¹³⁰ Shih paragrafin 33.3 të vendimit nr. 3/2020, paragrafin 23.9 të vendimit nr. 35/2021 dhe paragrafin 23.13 të vendimit nr. 31/2022, të Kolegjit.

45.2. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar se:
- Njohja shoqërore me L. K. nuk përbën automatikisht konflikt interesi, pasi të qenët shok shkolle nuk do të thotë që ka një lidhje miqësore apo interes të përbashkët me këtë avokat, shumë njerëz mund të kenë njohje të tilla, por kjo nuk nënkupton ndikim të ndërsjellë në vendimmarrje. Subjekti pranon se ka udhëtuar në disa raste me L. K., të cilat nuk tregojnë domosdoshmërisht lidhje të ngushtë, pasi disa nga këto udhëtime kanë qenë rastësore ose si pjesë e grupeve më të mëdha.¹³¹

45.2/a. Subjekti pretendon se nga numri total prej 112 çështjesh, 43 prej tyre i përkasin viteve 2003, 2004 dhe 2005, pra jashtë periudhës së rivlerësimit të përcaktuar nga neni 3 i ligjit nr. 84/2016, i cili mund të shtrihet më së shumti duke filluar nga data 01.01.2006. Si rezultat, vetëm 69 çështje mund të vlerësohen në kuadrin e etikës dhe të angazhimit profesional ($112 - 43 = 69$). Nga numri 69 i çështjeve të mbetura, sipas subjektit duhen zbritur çështjet që i përkasin periudhës 2006 – shtator 2013, të cilat janë 28 në total (13 nga viti 2006 dhe 15 nga periudha 2007 – 2013), dhe përfshijnë të gjitha rastet e përmendura në kriterin e kontrollit të figurës. Për rrjedhojë, sipas subjektit, vetëm 41 çështje mund të merren në konsideratë për vlerësimin e etikës dhe të angazhimit profesional ($69 - 28 = 41$). Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka bërë dallim mes llojeve të çështjeve, pasi 14 çështje kanë qenë me Entin Kombëtar të Banesave, një institucion shtetëror, ku nuk ka asnjë interes privat, 14 çështje të tjera ishin raste ku avokati K. ishte caktuar kryesisht nga gjykata, jo i zgjedhur nga klienti, ndërsa rastet e tjera kanë përfunduar me vendime të ndryshme, duke përfshirë pranime, rrëzime dhe pushime të çështjeve.¹³²

45.3. Në lidhje me situatën e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit me shtetasin L. K., trupi gjykues fillimisht konstaton se, edhe nëse do të merrej në konsideratë pretendimi i subjektit, që nga numri total i çështjeve të analizuar prej Komisionit të zbriten çështjet e gjykuara prej tij para vitit 2013, do të rezultonte se ai ka gjykuar 41 çështje gjyqësore për periudhën 2014 – 2022, në të cilat ka qenë avokat L. K. Në vlerësim të trupit gjykues rezulton që të jetë një numër i lartë çështjesh gjyqësore, i mjaftueshëm për të arritur në konkluzionin mbi situatën e konfliktit të interesit, në të cilën është gjendur subjekti i rivlerësimit¹³³. Trupi gjykues, gjithashtu, vlerëson edhe sjelljen e subjektit lidhur me këto gjykime, ku ai në asnjë rast nuk është kujdesur ta konsiderojë këtë marrëdhënie si shkak serioz njëanshmërie, për shkak të të cilit duhej të hiqte dorë nga gjykimi i tyre, dhe t'ia besonte gjykimin e kësaj situate, vlerësimit të kryetarit të gjykatës ku ushtronte funksionet, edhe si një test për të orientuar sjelljen e tij në këtë drejtim, pasi nga aktet në fashikull nuk rezulton ndonjë kërkesë e tij për heqje dorë.

45.3/a. Lidhur me pretendimin e subjektit, se Komisioni ka analizuar çështjet që i përkasin kriterit të vlerësimit profesional përtej periudhës së parashikuar nga ligji, trupi gjykues sjell në vëmendje se, në kuptim të nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *“Vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim, sipas informacionit që disponohet për etikën dhe*

¹³¹ Subjekti pretendon se në dy raste, në udhëtim ka qenë e pranishme edhe bashkëshortja e tij. Në një rast tjetër, udhëtimi ka ndodhur sepse një shok i përbashkët (dentist) i kishte ftuar ata në Mal të Zi. Subjekti në shpjegimet e tij shpreh se, po të kishte pasur një lidhje të veçantë me këtë avokat, numri i udhëtimeve do të ishte më i madh dhe marrëdhënia e tyre do të ishte e dukshme edhe në aspekte të tjera. Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se shtetasi L. K., për periudhën për të cilën bëhet fjalë, nuk ka ushtruar profesionin e avokatit, por ka qenë Drejtor i Degës Shkodër të Entit Kombëtar të Banesave. Konkretisht (sikurse rezulton nga shkresa nr. {***} prot., datë 02.06.2006, e Drejtorit të Përgjithshëm të EKB-së), ai e ka filluar këtë detyrë në datën 02.06.2006 dhe e ka përfunduar në datën 24.10.2014 (shkresa {***} prot., datë 24.10.2014).

¹³³ Ndër çështjet e identifikuara mund të përmendim çështjen për tjetërsimin e pronave publike; çështje për njohjen e vjetërsisë në punë, për efekt pensioni; çështje penale, ku avokat K. është caktuar kryesisht nga gjykata si mbrojtës i të pandehurit, çështje ku z. K. ka përfaqësuar Entin Kombëtar të Banesave.

aftësitë profesionale. Komisioni ose Kolegji i Apelimit merr parasysh këto informacione nëse relatori i çështjes ose vëzhguesi ndërkombëtar i çmon si të domosdoshme për procesin e rivlerësimit”, për rrjedhojë etika dhe nënindikator i paanësisë në lidhje me situatën e konfliktit të interesit është përfshirë në vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Në zbatim të përcaktimeve të neneve 40 dhe 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procedura e vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale të subjekteve të rivlerësimit bëhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Në këtë drejtim, indikator i etikës dhe i paanësisë vlerësohet dhe në lidhje me kujdesin e magjistratit ndaj konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Referuar këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore arrihet në përfundimin se periudha 3-vjeçare lidhet me vlerësimin e aftësive profesionale sa u përket dosjeve të shortuara për këtë qëllim apo të përzgjedhura nga vetë subjekti, por vlerësimi i aftësive profesionale mund të shtrihet edhe përtej kësaj periudhe, siç është parashikuar në pikën 4 të këtij neni, që nga viti 2006 e në vazhdim, pa e kufizuar në kohë. Si rrjedhojë, këto parashikime ligjore nuk kufizojnë çështjet që lidhen me kriterin e aftësive profesionale vetëm në afatin 3-vjeçar të përcaktuar në pikën 3, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, por nëse ka indicie apo të dhëna mbi fakte, të cilat afektojnë vlerësimin e institucioneve të rivlerësimit mbi të tria kriteret, atëherë këto institucione kanë detyrimin ligjor për t’i marrë në shqyrtim dhe për t’i vlerësuar. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

45.3/b. Lidhur me referimin e subjektit të rivlerësimit në dy çështje të përfunduara në Kolegj, që i përkasin subjekteve të rivlerësimit A. I. dhe N. Rr., trupi gjykues konstaton se situata faktike dhe rrethanat që paraqiten në këto çështje nuk janë të ngjashme me atë në të cilën ndodhet subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri. Konkretisht, intensiteti i lartë i udhëtimeve të subjektit të rivlerësimit me shtetasin L. K. dhe çështjet e gjykuara me këtë avokat, flasin për një marrëdhënie të ndryshme të subjektit me këtë shtetas, në krahasim me rastet e referuara prej tij, e për pasojë, vlerësimi objektivisht për këtë situatë të çon drejt thirrjes për përgjegjësi të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë sjellje, e cila është e tillë që nuk e lejon zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

45.3/c. Trupi gjykues, pasi mori në shqyrtim pretendimin e subjektit, *se në çështjen H. H. kundër H. T. dhe H. T., ku avokat ka qenë L. K., janë përmendur informacione konfidenciale të organeve ligjzbatuese, të cilat, pavarësisht kërkesës së tij, Komisioni nuk ia vuri në dispozicion, duke i përdorur këto informacione në vendimin përfundimtar*, konstaton se:

Komisioni i ka kaluar subjektit barrë prove konkrete për çështje konkrete, duke e informuar se do të jenë pjesë edhe e vlerësimit të kriterit profesional dhe të vlerësimit të përgjithshëm në kuadër të cenimit të besimit të publikut. Trupi gjykues konstaton, më datë 03.11.2022, se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar deklaratën për njohjen me dokumentacionin fizik dhe marrjen në formë elektronike (CD) të dosjes së hetimit administrativ të zhvilluar në Komision, pjesë e të cilit ka qenë edhe raporti i DSIK-së për kontrollin e figurës, deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. {***}, datë 10.10.2022, sipas së cilit: *Gjatë periudhës në të cilën subjekti ushtronte detyrën si gjyqtar, dyshohet se është përfshirë në veprime korruptive. Gjithashtu, për subjektin z. Andri Ymeri, në cilësinë e gjyqtarit, ka ushtruar ndikim të paligjshëm në disa procese gjyqësore, duke dhënë vendime favorizuese gjatë gjyqimit të çështjeve lidhur me tjetërsimin e pronave publike.* Nga sa më lart, trupi gjykues konstaton se Komisioni i ka vënë në dispozicion subjektit raportin e deklasifikuar pjesërisht, duke përmbushur në këtë mënyrë standardet për kalimin e barrës së provës, sipas neneve DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se të dhënat e rezultuara të Komisionit, bazuar në informacionet e organeve ligjzbatuese për përfshirje të subjektit në veprime

korruptive, dëshmojnë se subjektit i janë komunikuar natyra e informacioneve që e kanë shtyrë Komisionin drejt hetimit të çështjeve gjyqësore, analizuar më lart në këtë vendim. Ky fakt dëshmon se subjekti nuk është surprizuar për shkaqet për të cilat hetimi administrativ po kryhej, por dhe se ka qenë i qartë për kufizimin e njohjes me dokumentacionin e klasifikuar, sipas parashikimeve ligjore që rregullojnë procedurën administrative.¹³⁴ Trupi gjykues konstaton se Komisioni e ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, jo për rrethanat e përcjella me informacionin e klasifikuar, por për gjetjet e konstatuara në analizën e dosjeve të shqyrtuara mbi bazën e këtyre informacioneve, për të cilat subjekti nuk arriti ta përmbysë barrën e provës.

45.3/ç. Në përfundim të vlerësimit të kësaj çështjeje, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë faktet e mëposhtme të rezultuara nga hetimi administrativ në Komision, se: i) subjekti ka udhëtuar disa herë me shtetasin L. K., me të cilin ka qenë shok klase, në prani të bashkëshortes ose në prani të rrethit shoqëror, udhëtime këto të shtrira në kohë, kryesisht në raste festash, që tregon për një marrëdhënie të konsoliduar shoqërore; ii) Subjekti ka pranuar se z. K. ka pasur numrin e tij të telefonit dhe i ka dërguar mesazhe për shtyrjen e seancave, të paktën në një rast të evidentuar; iii) Subjekti ka gjykuar disa çështje gjyqësore me palë babain e z. K., ku, të paktën në njërin prej tyre, janë konstatuar gabime thelbësore (të pranura dhe nga vetë subjekti) dhe serioze; iv) Janë evidentuar çështje gjyqësore të gjykuara nga ana e subjektit, ku përfaqësues i njëres palë ka qenë z. K. (si në kohën kur ka qenë avokat, ashtu dhe kur ka qenë drejtues i EKB-së); v) Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në Komision, pasi është pyetur nga vëzhguesi ndërkombëtar, subjekti ka deklaruar: *se mund të ketë pirë edhe ndonjë kafë me z. K., specifikisht duke iu referuar vitit të fundit, ai pretendon se mund të ketë ndodhur një apo dy herë, por nuk e mban mend*; vi) Nga aktet e dosjes së përcjellë nga Komisioni nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimet e çështjeve - e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 5, pika 1, gerrat “dh/i” dhe “v”, të ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Ky konkluzion vjen si shkak i marrëdhënies së provuar shoqërore dhe familjare me shtetasin L. K., në gjykimin e çështjeve ku ai ka qenë palë apo përfaqësues i palës, apo babai i tij ka qenë palë ndërgjygjëse.

Për rrjedhojë, në bazë të nenit 17, pika 1, germa “ë” e Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, që parashikojnë heqjen dorë nga çështja kur ekzistojnë shkaqe të tjera të rëndësishme njëanshmërie, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor të heqë dorë nga çështjet, në zbatim të nenit 26 të Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 73 të Kodit të Procedurës Civile, për të mos vepruar në kushtet e konfliktit të interesit, duke afektuar kështu indikatorin e parashikuar nga neni 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, sa i përket kujdesit ndaj konfliktit të interesit.

45.3/d. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se gjyqtarët kanë përgjegjësinë që edhe në jetën jashtëgjyqësore të jenë të vëmendshëm për të mos cenuar autoritetin e pushtetit gjyqësor dhe besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Veprimet jashtëgjyqësore të gjyqtarëve duhet të jenë të atilla që të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tyre, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore dhe nuk duhet të krijojnë ose të lejojnë të tjerët të krijojnë

¹³⁴ Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, në nenin 46, të titulluar “Kufizimi i së drejtës së palëve për njohje me dosjen”, parashikon: “E drejta e palëve, sipas nenit 45, të këtij Kodi, kufizohet vetëm në ato raste dhe në atë masë që parashikohet nga legjislacioni në fuqi”.

përshtypjen se ata gjenden në një pozitë të veçantë për të ndikuar mbi të.¹³⁵ Duke mbajtur në konsideratë se qëllimi i procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve është rikthimi i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se veprimet e subjektit të rivlerësimit, duke pasur marrëdhënie miqësore me individë të cilët i ka pasur palë në proces, sikurse ka ndodhur me subjektin e rivlerësimit, përbëjnë sjellje që minimalisht nuk i shërbejnë besimit të publikut te drejtësia. Ky vlerësim bazohet ndër të tjera edhe në testin e “vëzhguesit të pavarur”, sipas Parimeve për Sjelljen Gjyqësore, parë në kontekstin e sjelljes së denjë. Sipas këtyre standardeve, gjyqtari duhet të shmangë kontakte, të cilat mund të interpretohen se favorizojnë një palë në proces apo të evitojë kontakte, të cilat mund të krijojnë spekulimin se gjyqtari ka një marrëdhënie të veçantë me dikë të cilin/cilën gjyqtari mund ta favorizojë në një mënyrë të caktuar. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit, dukshëm, ka reflektuar sjellje, të cilat nuk përputhen me etikën dhe sjelljen jashtëgjyqësore që një gjyqtar pritet të ketë/ose ka gjykuar në kushtet e cenimit të parimit të paanësisë, pa ia nënshtruar atë vlerësimit të organit kompetent, duke krijuar kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

45.4. Trupi gjykues i Kolegjit, në përfundim të analizimit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi shqyrtoi aktet në fashikull dhe pretendimet e tij, vlerësoi se qëndrojnë problematikat e konstatuara nga Komisioni.¹³⁶ Subjekti ka marrë vazhdimisht vendime bazuar në një model që ngre dyshime për paanshmërinë e tij; nuk ka ndjekur procedurat e duhura të gjykimit, pasi: (a) nuk ka njoftuar rregullisht palët nga gjykata në mënyrë të vazhdueshme; (b) nuk ka përmbushur afatet ligjore për procedurat gjyqësore; (c) ka proceduar në mënyrë të parregullt me gjykimet civile, pa pritur përfundimin e hetimeve përkatëse penale; (ç) nuk ka nxjerrë vendime të ndërmjetme kur ishte e nevojshme; (d) ka dhënë vendime me ekzekutim të përkohshëm në kundërshtim me dispozitat ligjore; dh) ka zhvilluar gjykime në kushtet e konfliktit të interesit.

45.5. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mban në konsideratë se qëndrojnë mangësitë e konstatuara nga Komisioni, të paraqitura në denoncimet nga publiku, ku janë konstatuar: gabime thelbësore dhe serioze në zbatimin e ligjit, ekzistenca e gjykimeve të dobëta e të gabuara, që vijnë ndesh me indikatorët e vlerësimit profesional, në: (i) aspektin e njohurive ligjore dhe të arsytimit ligjor, parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3; (ii) aspektin e aftësive organizative, parashikuar nga neni 74, pikat 1, 2, 3 dhe 5; si dhe (iii) aspektin e etikës dhe të angazhimit ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në të njëjtin përfundim, ashtu si Komisioni se subjekti i rivlerësimit, në vlerësimin e aftësive profesionale është i papërshtatshëm, në kuptim të germës “c” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016.

45.5/a. Nga ana tjetër, disa nga shkaqet e ankimit për këtë kriter, që u vlerësuan të bazuara, nuk passollën ndryshimin e këtij vlerësimi, në konsideratë të të gjitha aspekteve mbi të cilat mbështetet konkluzioni për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit.

45.6. Në konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit rezulton i papërshtatshëm, sipas nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

¹³⁵ Shih Parimet e Bangalores, miratuar nga Kombet e Bashkuara me rezolutën 2006/23, komentet nr. 111-114-
http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf dhe rregullat e Kodit të Etikës, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, më datë 08.12.2006.

¹³⁶ Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni, në dosjet e trajtuara më lart, në kriterin e vlerësimit të figurës, ka konstatuar: në 41 raste mungesë të njoftimit të palëve në gjykim/në dosjen gjyqësore nuk gjendet njoftimi i palëve; në 40 raste nuk është respektuar afati i parashikuar nga neni 155 i Kodit të Procedurës Civile; në 6 raste, subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit; në një rast, subjekti ka kryer gabime thelbësore dhe serioze; në 5 raste, vendimi gjyqësor nuk është i argumentuar.

46. Në lidhje me konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e këtij ligji, pretendimi i subjekti të rivlerësimit është i orientuar në përgënjeshttrimin e konkluzioneve të Komisionit, për shkeljet e evidentuara për secilin kriter të rivlerësimit, duke argumentuar se ato janë të pabazuara ligjërisht, të padrejta dhe të mangëta,¹³⁷ si dhe të ngritura në dyshime të paprovuara. Sipas subjektit, shkeljet që Komisioni i ka atribuuar, nuk kanë sjellë pasoja konkrete, prandaj ato nuk duhet të përdoren si shkak për shkarkimin e tij nga detyra.

46.1. Trupi gjykues, fillimisht, çmon të theksojë se termi “besim i publikut” gjen vend në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në rastin kur nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Vendimi në kuadër të këtij procesi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave. Në këto kushte, parashikimi në nenin 48 të ligjit, se në marrjen e vendimit, Komisioni dhe Kolegji mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit nuk mund të përjashtohet nga analizimi në kuadër të cenimit të besimit të publikut. Bashkëpunimi me Komisionin, në kuptim të këtij neni, bën pjesë në vlerësimin tërësor të procedurave dhe sjellja e subjektit gjatë këtij procesi vlerësohet në vendimmarrje.

46.2. Në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të bazuar konkluzionin e Komisionit, sipas të cilit konstatimi i DSIK-së për papërshtatshmëri të subjektit lidhet me dyshimet për favorizim të palëve në gjykim, që duket se përputhet edhe me rezultatet e hetimit nga analizimi i dosjeve gjyqësore prej Komisionit. Gjithashtu, trupi gjykues i vlerëson të drejta konkluzionet e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për të fshehur ose deklaruar në mënyrë të pasaktë pasuri të zotëruara prej tij, si dhe nuk ka treguar një sjellje korrekte dhe bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit. Veprimet e subjektit të rivlerësimit, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, kronologjia dhe dinamika e veprimeve, sikurse edhe pohimet e përfaqësuesve të tij ligjorë, dëshmojnë për përpjekje të kryera në kufijtë e abuzivizmit dhe nuk duken të synojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por zvarritjen dhe tejzgjatjen e këtij procesi, deri në pamundësimin e tij. Në këtë drejtim dhe nën dritën e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, edhe në Kolegj u vlerësuan të pabazuara kërkesat e përsëritura të subjektit gjatë procesit, e sidomos gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore në Komision.

¹³⁷ Subjekti pretendon se ky konkluzion është i gabuar dhe i padrejtë, pasi ka paraqitur në mënyrë të plotë të gjitha pasuritë e tij, si dhe ato të personave të lidhur me të, në deklaratën vetting, ka dhënë shpjegime dhe prova të mjaftueshme që mbështesin burimin e ligjshëm të pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, dhe ka paraqitur prova të reja që e bëjnë të padiskutueshëm faktin që ai justifikon pasuritë e tij me të ardhura të ligjshme. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, që ai “ka bërë përpjekje për të fshehur ose bërë deklarim të pasaktë të pasurive të zotëruara aktualisht prej tij”, subjekti e konsideron këtë qëndrim të Komisionit si abuziv, të gabuar, të paligjshëm, arbitrar, keqdashës, pasi apartamenti i blerë nga babai i tij nuk është pasuri e fshehur e tij dhe depozita prej 1.850.000 lekësh, e babait të tij, në “Tirana Bank” nuk mund të ketë dyshime se është pasuri e fshehur e tij. Ai ka argumentuar gjithashtu se bonot e thesarit në emër të bashkëshortes së tij, për vitet 2009 dhe 2010, nuk janë krijuar me të ardhura të fshehta të tij, por janë të ndara nga kursimet, të ardhurat, kredia bankare dhe depozita bankare e vitit 2008. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, që ai “ka qenë vazhdimisht i gatshëm të gjykonte çështje, pavarësisht nga konflikti i drejtpërdrejtë i interesave”, subjekti e konsideron këtë konkluzion të padrejtë dhe të pabazuar, duke shpjeguar se marrëdhënia e supozuar me shtetasin L. K. është një thashethem dhe nuk ka pasur asnjë provë të fortë që e mbështet këtë dyshim.

46.3. Duke e vlerësuar sjelljen e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, trupi gjykues, në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kritereve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave, sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, e për rrjedhojë, vlerëson se ndaj tij duhet të aplikohet neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

47. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se, mbështetur në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 61, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit Andri Ymeri nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, nuk arrin nivel kualifikues në lidhje me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Në përfundim, trupi gjykues çmon se vendimi nr. 604, datë 21.12.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë, i bazuar në fakte dhe në ligj, dhe si i tillë ai duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 604, datë 21.12.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Andri Ymeri.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 03.07.2025.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi